



TITULLI ORIGINAL
SAADET DAMLALARI

PËRKTHEU
Ilir Hoxha

REDAKTOI
Alban Kali

FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Prill 2021, Shkodër

PROGRESI BOTIME
Sheshi “2 Prilli”, Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

Bulëza Lumturie

NGA KOPSHTI I ZEMRËS

OSMAN NURI TOPBASH

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Teube, 100.)



O Allah! Stolisi zemrat me dashurinë për Profetin (a.s.), sahabët e nderuar dhe njerëzit e devotshëm që ndjekin gjurmët e tyre deri në ditën e kiametit. Na dhuro prej cilësive të mira të muhaxhirëve dhe ensarëve dhe na ringjall bashkë me ta në botën tjetër!..

O Allah! Bëji zemrat tona burim mëshire dhe dhembshurie për të gjitha krijesat! Mbuloji gjynahet dhe të metat tona me sevape dhe punë të mira! Na e bëj të mundur ta kryejmë ashtu siç duhet thirrjen drejt Teje dhe rrugës së drejtë, të gjendemi gjithmonë në ndihmë të nevojtarëve dhe të vuajturve dhe të kujdesemi për zemërthyerit dhe të hidhëruarit.

*O Allah! Na e bëj të lehtë llogarinë
para Teje në ditën e gjykimi!..*

Amin!..

PARAFJALË

Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, i Cili na është drejtuar butësisht me fjalët, **“O robërit e Mi!..”**, na ka nderuar duke na bërë umetin e Profetit të Tij të dashur (a.s) dhe popullin e Librit të Tij të fundit dhe të përsosur, Kuranit Fisnik!

Salavatet dhe selamet e pafundme qofshin mbi të Dërguarin fisnik (a.s.), i cili ndriçoi njerëzinë, solli lumturinë e udhëzimit duke e përjetuar Kuranin Fisnik në jetën e tij dhe, duke e përcjellë atë në zemrat e besimtarëve, ndërtoi “Epokën e Lumturisë” me anë të personaliteteve të larta që edukoi! Përsëndetjet më të përzemërta i takojnë familjes së tij fisnike dhe shokëve të tij të nderuar!

Një prezantim i shkurtër i kësaj vepre sipas temave:

Bota njerëzore ka gjithmonë nevojë për **“Bulëzat e lumturisë nga atmosfera shpirtërore e të devotshmëve”** dhe frymëzimin shpirtëror që përhapet prej tyre, sepse besimtarët mund të gjejnë qetësi shpirtërore vetëm në sajë të vesës së tyre frymëzuese.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i fali njerëzimit Profetin e mëshirës (a.s.), shokët e tij fisnikë dhe robërit e devotshëm e shembullorë që ndjekin hapat profetikë.

Këshillat e ngrohta të njerëzve të ditur dhe të devotshëm, i stolisin me frymëzim shpirtëror zemrat e besimtarëve përgjatë gjithë kohës. Kështu, duke i zbatuar këto këshilla, besimtari arrin ta kontrollojë gjith-



monë veten dhe të deshifrojë enigmën e “zemrës së pastër”, duke “*e llogaritur veten para se të llogaritet në botën tjetër*”. Si rezultat i kësaj, besimtari vë rregull në jetën personale dhe atë familjare, bën një jetë në rrugën e kënaqësisë së Allahut dhe dhuron prej mirësive për hir të Tij.

Synimi më i lartë i horizontit të devotshmërisë, është përvetësimi i moralit të Profetit tonë (a.s.), duke studiuar edhe “**reflektimet e moralit profetik tek sahabët**”, sepse ata i kanë kuptuar dhe zbatuar me pasion fjalët dhe veprat e bekuara të Profetit tonë (a.s.). Për shkak se ata u edukuan me bukuritë e pafundme që reflektuan prej gjuhës dhe zemrës së Profetit (a.s.), arritën majat në sakrificë, dinamizëm, urtësi, qëndresë dhe virtyte të larta njerëzore.

Ashtu siç reflekton dielli gjigand në një pasqyrë, ashtu edhe në zemrat e sahabëve gjendeshe shkëlqimi i së vërtetës dhe urtësisë së Profetit (a.s.). Sahabët e nderuar, e pasuan të Dërguarin e Allahut (a.s.), ashtu si udhëtarët e kujdesshëm që ndjekin me përpikëri gjurmët e hapave mbi dëborë. Dhe kjo, nuk ishte gjë tjetër veçse, “**entuziazmi i besimit të sahabëve në gjurmët e Profetit (a.s.)**”...

Sahabët fisnikë që u edukuan nën mbikëqyrjen shpirtërore të Profetit të Allahut (a.s.), ia kushtuan të gjitha energjitë përhapjes së fjalës së Allahut. Ata e zbukuruan jetën e tyre me “**paqen dhe ngushëllimin që i falte besimi**”. Duke vendosur në zemrat e tyre dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.), edhe pse nuk dinin shkrim e këndim, ata morën dijen më të rëndësishme, pra, “njohjen e Allahut”, sepse ajo ishte periudha e meditimit të thellë dhe e njohjes nga afër të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.).

Ja pra, në një entuziazëm të tillë jetuan sahabët e nderuar. Nisur nga kjo, edhe dëshira jonë më e madhe, duhet të jetë shijimi sadopak i këtij entuziazmi dhe pasioni të sahabëve në rrugën e Allahut. Për këtë arsye, duke menduar për “kujtimet nga epoka e lumturisë”, menduam të sjellim ndërmend atmosferën e dashurisë që mbante gjallë zemrat e besimtarë në ditët e vështira, siç ishin beteja e Uhudit dhe e Tebukut... Kjo, sepse në ato vendet të shenjta, janë paguar çmimet më të



rënda që mund të paguhen në jetën e kësaj bote të përkohshme për të manifestuar dashurinë dhe besnikërinë e përjetshme ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Në këtë rrugë, janë kaluar sprovat më të mëdha, duke sakrifikuar pasuritë dhe jetët nën entuziazmin e besimit. U përjetuan situata prekëse të vëllazërisë fetare, të cilat nuk mund të krahasohen me asgjë. Dhurimi, sakrifica, dorëzimi dhe dashuria arritën kulmin. Në ato kohë dhe vende tepër të vështira, u kërkuva vazhdimisht vetëm kënaqësia e Allahut. U kuptua vështirësia e luftës me veten, duke u vetëdijesuar për dallimin mes xhihadit të madh dhe atij të vogël. Kështu, në këtë botë të përkohshme, u shijua ëmbëlsia e takimit të përjetshëm.

Të gjitha këto mirësi, ishin si rezultat i përpjekjeve në rrugën **për t'u pajisur me moralin profetik**, sepse sahabët e kishin kuptuar shumë mirë se për të merituar titullin “sahab”, duhej të kapeshin fort pas sunnetit të Profetit (a.s.) dhe ta përvetësonin mirë moralin e tij.

Një nga manifestimet më të rëndësishme të përvetësimit të moralit profetik, është edhe nderi për t'i shërbyer Kuranit Fisnik, që iu zbrit **“zemrës së pastër të Profetit (a.s.)”** dhe u interpretua nga ai me jetën dhe shembujt e tij personal. Për këtë arsye, *“Edukimi i Kuranit Fisnik”*, është detyra dhe përgjegjësia kryesore e çdo besimtari. E thënë ndryshe, **“Dashuria dhe Shërbimi ndaj Kuranit Fisnik”**, është treguesi kryesor i të qenit besimtar.

Nisur nga kjo, mund të themi se të gjitha veprat e shkruara në botën Islame që prej katërmëdhjetë shekujsh, janë shkruar për të shpjeguar një libër vetëm, pra, Kuranin Fisnik.

Kurani Fisnik, është si një sofër plot të mira që Allahu i Madhëruar ua ka falur zemrave besimtare. Ai e ka lehtësuar memorizimin e tij dhe ua ka bërë të dashur robërve të Vet leximin dhe meditimin rreth manifestimeve të fuqisë hyjnore në gjithësi. Besimtarëve që dëshirojnë t'i luten Allahut dhe të flasin me Të, u është falur një zemër e pastër që gjen paqe me Kuran. Për rrjedhojë, ai që dëshiron të jetë bashkë me Allahun, duhet të marrë pjesë në sofrën e Tij dhe t'i shërbejë asaj. Dhe, shërbimi ndaj kësaj sofre, është respektimi dhe dashuria ndaj Kuranit



Fisnik, mësimi dhe leximi i tij në mënyrën më të mirë dhe zbatimi i tij në të gjitha fushat e jetës.

Ata që nuk arrijnë të marrin pjesë prej shpirtit të Kuranit, nuk mund ta kuptojnë kurrë gjuhën e natyrshme të gjallesave dhe bimëve. Ashtu si një trup i vdekur, të cilit nuk i mbetet më asnjë bukuri, ashtu edhe shpirti i atyre që qëndrojnë larg Kuranit, nuk ka as kuptim, e as vlerë.

Pra, për të marrë vlerë dhe për të arritur grada të larta në Xhenet, është e domosdoshme të jetosh vazhdimisht me Kuranin, gjë që duhet t'i jepet edhe më tepër rëndësi sidomos në muajin e Ramazanit, që konsiderohet edhe "Muaji i Kuranit". Në fakt, Ramazani nuk është vetëm muaji i Kuranit, por edhe "Muaji i adhurimeve", në të cilin të gjitha adhurimet fitojnë një frymëzim shpirtëror edhe më të madh. Në këtë muaj, ku derdhet si lum mëshira hyjnore, besimtarët mësohen të jetojnë gjithë jetën me entuziazmin e Ramazanit dhe ta konsiderojnë vdekjen si një moment të takimit me Zotin. Në këtë mënyrë, besimtarët hyjnë në sezonin e lumturisë së jetës së përzetshme.

Ndërsa "**Haxhi i pranuar dhe Umreja**", janë kohë të veçanta kur manifestohet mëshira hyjnore dhe bëhen vepra të mira. Haxhi dhe Umreja janë prej adhurimeve ku edukohet egoja dhe vullneti, kur fitohet dorëzimit tek Zoti, ku vërehen shenjat e Allahut dhe fitohen grada të larta të devotshmërisë.

Ata që e bëjnë haxhin dhe umren me zemër të pastër dhe të vetëdijshëm se ato toka të bekuara janë të mbushura me kujtime të shenjta të profetëve, ushqehen me ndjenjat shpirtërore të zemrave besimtare dhe ujiten me lotët e të dashuruarve me Allahun dhe Profetin e Tij (a.s.), do të përfitojnë atë që duhet prej këtyre adhurimeve.

Paqja, qetësia, mirëqenia dhe lumturia e një shoqërie, mund të arrihet vetëm në sajë të udhëheqësve që i kanë zemrat të ndriçuara me dritën e Kuranit dhe Sunetit, janë pastruar prej egoizmit, kanë përvetësuar modestinë dhe kanë kuptuar përgjegjësinë e amanetit. Kjo, sepse masat tërhiqen nga karakteri dhe personaliteti.



Në fakt, ka shumë njerëz të dashuruar pas pushtetit, të cilët nuk e bartin vetëdijen e amanetit dhe përgjegjësisë, dhe nuk kanë asnjë veprë përveç fjalëve të bukura. Lidhur me këta, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“E kur largohet, përpiqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë. Por Allahu nuk e do shkatërrimin.”

(Bekare, 205.)

Në fakt, synimi kryesor i shkatërrimtarëve, është brezi i ri. Prandaj, “mbrojtja e brezave”, edukimi i fëmijëve tanë me vlera fetare e kombëtare dhe me dashuri ndaj Kuranit dhe atdheut, është shumë i domosdoshëm. Popujt që nuk i edukojnë fëmijët e tyre me ndjenja fetare dhe kombëtare, kanë një të ardhme të hidhur. Nëse në një shoqëri shtohen trupat pashpirt dhe në një luftë vdesin njerëz pa zemër, fundi i tyre është humbja.

Roli më i rëndësishëm në mbrojtjen dhe edukimin e brezit, i takon familjes, sepse fëmijët i janë lënë amanet prindërve të tyre. Dhe, kënaqësia e Allahut, qëndron në kujdesin dhe edukimin e duhur të atij amaneti.

Allahu i Madhëruar na ka bërë të ditur se fëmijët janë stoli për ne. Mirëpo, nuk duhet të harrojmë se, fëmijët mund të bëhen stolia e jetës vetëm nëse edukohen në rrugën e kënaqësisë së Allahut. Nëse lihen pas dore, ata shndërrohen në elementë negativë si për veten, ashtu edhe për shoqërinë, duke ua nxirë prindërve edhe këtë botë, edhe botën tjetër.

Prindërit që e kanë kuptuar mirë **“përgjegjësinë ndaj fëmijëve”**, duhet të përpiqen të jenë shembulli më i mirë për ta në adhurime, në vepra dhe në moral të bukur. Nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të rriten të përsosur, si fillim duhet të jemi vetë prindër të përsosur.

Përfitimi i këtyre cilësive të bukura dhe sigurimi i paqes dhe harmonisë individuale, familjare dhe shoqërore, arrihen vetëm në sajë të **“dashurisë”** ndaj Allahut, të Dërguarit të Tij (a.s.), besimtarëve dhe të gjitha krijesave. Ashtu siç një jetë pa dashuri është e privuar nga begatia



si një tokë e shkretë, ashtu edhe një mendim, një fjalë apo një vepër që nuk ushqehet nga burimi i dashurisë, është e dënuar të mbetet pa fryte, si pemët e thata pa rrënjë që nuk kanë asnjë shenjë jete.

Një nga cilësitë e mira që duhet të ketë besimtari i cili përpiqet të arrijë dashurinë e Allahut të Madhëruar, është **“ihsani dhe mbikëqyrja hyjnore”**. Nëse besimtari arrin vetëdijen e vëzhgimit hyjnor, atëherë të gjitha fjalët, ndjenjat dhe veprat e tij bëhen për hir të Allahut.

Tek besimtari që thellohet në ndjenjat e ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, kuptimi i jetës dhe i vdekjes lartësohet dhe fiton një përmbajtje tjetër. Tashmë, ai njeri fillon të ndjejë frymëzimet shpirtërore të Kuranit Fisnik. Po ashtu, ai bëhet i vetëdijshtë se të gjitha mirësitë dhe mundësitë që i janë falur, janë vetëm amanete që i janë besuar atij. Kështu, shpenzimi bujarisht **“i jetës dhe i pasurisë”** në ngritjen e fjalës së hyjnore, për të cilën Allahu ka premtuar Xhenetin, kthehet në një kënaqësi të papërshkrueshme.

Një besimtar i mençur, duhet ta mbajë zemrën e tij larg çdo lidhjeje që e tërheq në indiferencë, dhe ia kushton atë vetëm Zotit të tij. Po ashtu, dhembshurinë dhe mëshirën, duhet të bëjë natyrë të zemrës së tij. Kështu, besimtarët që arrijnë këto cilësi të larta, si tregues të mëshirës së tyre të madhe, do të nxitojnë në ndihmë të njerëzve, të cilët janë **“nevojtarët, jetimët dhe skamnorët e shoqërisë sonë”**. Allahu i Madhëruar e ka urdhëruar Profetin (a.s.), të qëndrojë pranë jetimëve dhe skamnorëve dhe na ka bërë të ditur se Ai i furnizon njerëzit për hir të tyre. Prandaj edhe Profeti ynë (a.s.), u dha aq shumë rëndësi atyre, sa që ata që kujdesen për jetimët, i përgëzoi se do të jenë bashkë në Xhenet, si dy gishtat pranë njëri-tjetrit.

Të nderuar lexues!

Këto ishin pak a shumë temat që do të përpiqemi të trajtojmë në këtë libër me lejen e Allahut. I gjithë qëllimi ynë është të arrijmë dashurinë e Allahut dhe të bëhemi umeti i merituar i Profetit tonë (a.s.). Dhe për këtë, na duhet t’ia kushtojmë gjithë jetën sunnetit të Profetit (a.s.), të pajisemi me moralin e tij dhe të sakrifikojmë të gjitha mundësitë



materiale dhe shpirtërore në rrugën e Allahut të Madhëruar. Vetëm kështu mund të arrijmë majat e lumturisë.

Është e qartë se koha në të cilën jetojmë, e bën të domosdoshme t'i shpejtojmë sa më shumë punët dhe përpjekjet në lidhje me fenë dhe botën tjetër. Për këtë arsye, e kemi për detyrë që mendjen, jetën dhe pasurinë që na ka falur Allahu, t'i shpenzojmë në rrugën e kënaqësisë së Tij, duke i kthyer në një kapital për botën tjetër. Dhe, shërbimi më i madh që mund t'i bëhet Islamit, është ta kuptojmë atë siç duhet dhe ta predikojmë duke jetuar me përsosmëri adhurimet, veprat dhe moralin që na mëson ai.

Shpresojmë që kjo vepër të jetë një sadaka e pandërprerë për të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre në realizimin e saj.

O Zot! Na e bëj të mundur të pajisemi me moralin profetik, të arrijmë të bëhemi Kuranë të gjallë dhe të bëjmë një jetë të mbushur me vepra të mira! Dhuroju zemrave tona pjesë prej dashurisë Tënde! Na bëj prej atyre që e meritojnë t'i quash “robërit e Mi” dhe e meritojnë të jenë “vëllezërit” e të dashurit Tënd, Muhamedit (a.s.)! O Allah! Na fal pasardhës që do të luten për ne dhe do të jenë drita e syve tanë në të dyja botët!..

Amin!..

Osman Nuri TOPBASH

Korrik 2005

Yskydar



Bulëza lumturie -1-

NGA BOTA E ZEMRËS SË TË DASHURVE TË ALLAHUT

(LLOGARIA E NJË DITE)



Të vish në këtë botë i plotësuar me mirësi të jashtëzakonshme si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror, dhe në fund të kalbesh nën tokë si një kallëp prej mishi, është një fatkeqësi shumë e madhe për njeriun, i cili është krijuar në formën më të bukur (ahseni takuim). E për më tepër, të mos e kuptosh dhe të mos e ndjesh këtë fatkeqësi të madhe, është një dështim kolosal për njeriun që bart qoftë edhe një thërrime ndërgjegje në zemrën e tij!..

BULËZA LUMTURIE -1-

NGA BOTA E ZEMRËS SË TË DASHURVE TË ALLAHUT

(LLOGARIA E NJË DITE)

Lumturia e vërtetë e njeriut si qenia më e nderuar dhe më e lartë në botë, qëndron në largimin e të gjithave gjendjeve që shqetësojnë shpirtin dhe mbushjen e tij me freskinë e besimit, kënaqësinë e adhurimit dhe qetësinë e moralit të bukur. Prandaj duhet të bëjmë një jetë të ndershme, të hijshme dhe të moralshme, sepse jeta e njeriut është e kufizuar. Njeriu nuk është krijuar për lojë, por për një qëllim të caktuar. Ai çdo ditë afrohet me vdekjen, dhe për pasojë, me gjykimin e madh. Prandaj, jetën që ia ka dhënë Allahu si amanet, ai duhet ta përdorë në përputhje të plotë me qëllimin e krijimit.

Preokupimi më i madh i njeriut ka qenë bota e përtejme. Vdekja është një realitet i domosdoshëm për të kapërcyer në botën tjetër. Por para se të vijë vdekja, ne duhet të bëjmë përgatitjet e domosdoshme për botën tjetër, sepse fundja, qëllimi final është vet bota tjetër.

Aliu (r.a.), duke parë neglizhencën e njerëzve në lidhje me botën e përtejme ka thënë:

“Kjo botë ka kthyer shpinë e po shkon, e bota tjetër po vjen drejt nesh. Të dyja këto kanë fëmijët e vet të veçantë. Ju bëhuni fëmijët e botës tjetër, e jo fëmijët e kësaj bote, sepse sot ka vepër pa llogari, ndërsa nesër ka llogari pa vepër!” (Buhari, Rikak, 4.)



Ata që nuk e kuptojnë urtësinë e qëllimit të krijimit dhe nuk zhyten në botën e imët të botës shpirtërore e materiale, nuk arrijnë të meditojnë dot as mbi krijimin, nuk mund të bëjnë as një jetë të qetë dhe nuk mund të ngjiten as në majat e virtytit.

Për të rrokur si duhet urtësinë e krijimit, duhet patjetër të kuptohet siç duhet jeta dhe vdekja. Dhe kjo është e mundur vetëm përmes udhëzimit hyjnor dhe profetik.

Të vish në këtë botë i plotësuar me mirësi të jashtëzakonshme si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror, dhe në fund të kalbesh nën tokë si një kallëp prej mishi, është një fatkeqësi shumë e madhe për njeriun, i cili është krijuar në formën më të bukur (ahseni takuim). E për më tepër, të mos e kuptosh dhe të mos e ndjesh këtë fatkeqësi të madhe, është një dështim kolosal për njeriun që bart qoftë edhe një thërrime ndërgjegje në zemrën e tij!..

Jeta është një e vërtetë shumë e lartë, e cila nuk mund të kufizohet në distancën mes djepit dhe varrit. Ndërsa zgjidhja e nyjes së të ardhmes në lidhje me vdekjen dhe gjithçka që gjendet përtej saj, të cilat nuk mund të perceptohen vetëm prej mendjes njerëzore, bën të domosdoshëm kapërcimin e pengesës së egos dhe dëgjimin me gjithë zemër të zërit të Shpalljes.

Në udhëtimin drejt vdekjes e përtej saj, i vetmi pishtar që do të ndriçojë rrugën para nesh, është meditimi dhe vetëdija e mbështetur në shpallje. Për të gjallët, nuk ka ndonjë ndodhi më të rëndësishme se vdekja. Prandaj, është e domosdoshme të kuptohet në mënyrën e duhur që rëndësia që i jepet asaj në lajmet hyjnore.

Të urtët janë përpjekur gjithmonë të frenojnë egon duke i dhënë më shumë hapësirë shpirtit. E gjithë përpjekja e tyre ka qenë jeta në rrugën e Allahut. Lidhur me këta, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar!» (Fussilet, 30.)



Një besimtar që shqetësohet për botën tjetër, jeton në këtë botë midis dy frikash:

1. Me frikën se do t'i mbyllet dosja për t'iu hapur në gjykatën supreme. E në fakt, pasi atë dosje ta kenë vulosur melekët, nuk do të ketë më asnjë mundësi për ta përmirësuar apo korrigjuar. Prandaj, e vetmja rrugëzgjdhje, është bërja e veprave të mira dhe kërkimi i mëshirës dhe faljes hyjnore.

Nga ana tjetër, nuk është e sigurt nëse do mund të bëjmë teube dhe që ajo do të na pranohet.

Xhelaledin Rumi e shpreh shumë bukur ndikimin e gjynaheve në jetën e njeriut:

“Falje ka, por, ku është ajo devotshmëri që mund të zbardhë fytyrën në ditën e gjykimit. Hajduti, edhe sikur të falet, ai gëzohet se shpëtoi jetën, por për atë është e pamundur tashmë të bëhet vezir apo ministër i thesarit.”

2. Frika e dytë është shqetësimi se çfarë do të sjellë e ardhmja në pikëpamjen sasiore dhe cilësore. Shqetësimi më i madh i njeriut duhet të jetë si të fitojë dashurinë e Allahut dhe si mund t'i korrigjojë gabimet që ka bërë në të kaluarën.

Profeti (a.s.), thotë: *“Feja është këshillë”*¹, prandaj më i miri, është ai që bën një jetë të bazuar në moral dhe adhurime pandërprerje dhe me një entuziazëm të plotë.

Dhunnun Misri thotë:

“Tre gjëra janë prej shenjave të besimit:

1. Të gjendesh pranë myslimanit në ditë të vështira.
2. Të sillesh mirë dhe të bësh bamirësi edhe ndaj atyre që të kanë bërë keq, si Jusufi (a.s.), me vëllezërit e vet.

3. Të përpiqesh për të udhëzuar njerëzit me fjalë të ëmbla dhe vepra të sjellshme, pavarësisht vështirësive me të cilat mund të përballesh në këtë iniciativë.

1. Muslim, Iman, 95.



Këshillat e njerëzve të urtë në lidhje me këtë që thamë, janë shumë të çmuara dhe një mirësi e madhe për besimtarët. Një nga rrugët më të mira për të arritur në nivele shpirtërore të larta, është të përfitojmë prej gjendjes shpirtërore dhe atmosferës shpirtërore të dijetarëve dhe të urtëve. Shoqërimi me njerëzit e mirë, besnikë, të singertë e bamirës, bën të mundur arritjen e një niveli shpirtëror shumë të lartë. Këshillat kuranore dhe profetike na nxisin të qëndrojmë dhe të shoqërohemi me njerëz të devotshëm, sepse siç thotë edhe Profeti (a.s.), *“njeriu është në fenë e shokut të vet”*.

Një ditë, kur Hasan Basriu po kalonte rrugës, pa një preson shumë të gëzuar dhe i tha:

- A e ke kaluar urën e Siratit?
- Jo! - Ia ktheu personi në fjalë.

Pastaj e pyeti përsëri:

- A e di ku do të shkosh; në Xhenet apo Xhehenem?
- Jo nuk e di! – Tha ai.

Atëherë Hasan Basriu tha:

- Allahu të faltë! Përse qesh kaq shumë kur e di se ditën e Kijametit do ta kesh punën shumë të vështirë?

Fudajl ibn Ijaz e përsëriste shpesh në këshilla hadithin; *“Njerëzve u mjafton si këshillë vdekja.”* Një ditë, kur u takua me një person i cili i kërkoi një këshillë i tha:

- A e ke gjallë babanë?
- Jo! -U përgjigj ai.
- Atëherë, a nuk të mjafton kjo si këshillë!? – I tha Fudajli.

Ahmet ibn Harb thotë:

“Toka habitet me dy persona: Me atë që grindet me vëllain e tij për një copë tokë në këtë jetë të përkohshme, ndërkohë që ajo duket sikur u thotë: «Mendoni pak për ata që ishin para jush në këtë vend për të cilin ju po grindeni tani! Sa e sa veta para jush kanë pretenduar se e kanë zotëruar atë pjesë toke, por asnjëri nuk ka arritur ta zotërojë përjetësisht!»



Dhe me atë që e përgatit krevatin me kujdesin më të madh për të fjetur sa më rehat, ndërkohë që toka duket sikur i thotë: «O njeri! Përse nuk e kujton varrin në të cilin do të qëndrosh për një kohë të gjatë pa dyshek dhe jorgan?!»

Me qëllim që kapitali i jetës të përdoret në rrugë të Allahut, Mevlana Xhelaledin Rumi na jep këto këshilla:

“Mirësinë që duhet të bësh sot, mos e lërë për nesër! Mblidhe mendjen, dhe thesin e botës tjetër, mos e mbush me gurë, por me xhevahire (punë të mira) të denja, që mund t’i ofrohen sulltanëve dhe mbretërve! Në fund, edhe ti do ta kuptosh këtë, prandaj eja në vete dhe shihe që tani ditën e fundit, pra jetën tjetër! Syrin që do të shohë të vërtetën, mos e verbo me indiferencë dhe prirje egoiste! Kush sheh të ardhmen gjen lumturinë. Një njeriu të tillë nuk i rrëshqet e nuk i pengohet kurrë këmba në rrugën e Zotit. Nëse nuk dëshiron të të rrëshqasë, të të pengohet këmba, e të rrëzohesh kur ecën, lyeji sytë me dheun ku ka shkelur këmba e njeriut të devotshëm dhe ec në gjurmët e tij! Mblidhe mendjen, e mos e mblidh kapitalin për të sotmen, por për të arritur kënaqësinë e Allahut dhe Xhenetin në të ardhmen!”

O ti që e do udhëtimin! Udhëtar i thonë atij që mendon për rrugën, llogarit vendin ku do të arrijë dhe e ka mendjen përherë përpara (me shqetësimin e të ardhmes). Kur njeriut i merret forca, mundësia dhe dëshira për të bërë diçka, pra kur vjen momenti i lamtumirës së kësaj bote dhe bie në rrjetën e vdekjes, atëherë çdo gjë merr fund. Për këtë arsye, thirri mendjes, dhe mos e çoj dem kapitalin e jetës! E gjithë forca dhe fuqia jote, janë kapitali i jetës që do të sjellë fitime dhe punët e mira që ke arritur të bësh. Prandaj vlerësoje drejtë jetën e kësaj bote ku je i fortë dhe i fuqishëm, dhe mos e lërë të të ikë rasti që ke në dorë!..”

Shejh Sadi, në veprën e tij “Bostani”, na këshillon të mos e çojmë dem jetën e kësaj bote, duke u shprehur kështu:

“Nëse je i mençur, ano nga aspekti shpirtëror i gjithçkaje!.. Sepse pamja humbet, ndërsa shpirti qëndron. Përgatitjen për botën tjetër, bëje vetë në këtë jetë, sepse pasi të vdesësh, të afërmit do t’i



kaplojë lakmia dhe nuk kanë për të bërë asnjë të mirë për shpirtin tënd. Mirësitë që zotëron, jepi vetë sa je gjallë, sepse kur të vdesësh, nuk do t'i kesh më! Nëse nuk do të vuash, kujto ata që po vuajnë në varr! Dhuro shpejt aty ku duhet prej thesarit që ke ende në dorë, e mos e lër për nesër! Sepse nesër, çelësat e tij nuk do t'i kesh më. Dërgoji vet që sot të mirat! Mos shpreso që pasi të vdesësh, të afërmit dhe miqtë që ke lënë pas të tregohen mjaftueshëm të dhembshur me ty! Kush e çon vetë furnizimin në botën tjetër, ka arritur një mirësi të madhe, sepse askush nuk ta kruan shpinën duke menduar për ty! Atë mund ta kruash vetëm me thonjtë e tu!

Nëse të vjen ndonjë nevojtar në derë, mos e kthe duarbosh. -Zoti mos e dhëntë!-; mbase një ditë edhe ti mund bëhesh nevojtar dhe do shëtisësh derë më derë! Njeriu i pjekur, i ndihmon nevojtarët duke menduar se një ditë mund të ketë edhe vet nevojë për dikë. Pyeti zemërthyerit për hallet dhe kujdesu për ta. Kushedi mbase një ditë edhe ti bie në situatën e tyre! Gëzoji zemrat e njerëzve të vuajtur. Mbase një ditë, edhe ti bëhesh i vuajtur. Ti, që sot nuk shkon në derën e askujt për të kërkuar diçka, si falënderim për këtë, ndihmoje nevojtarin që vjen në derën tënde! Ai që sot nuk mbjell farën e dashurisë, nesër nuk mund të hajë fruta prej degëve të pemës Tuba në Xhenet.

Nesër, Ditën e Kiametit do të ngrihet tregu i Xhenetit dhe gjithsecili do të shpërblehet sipas punës së vet. Sa kapital të kesh dërguar në atë botë, aq mirësi do të arrish. Nëse je i falimentuar, s'mund të bësh gjë tjetër përveçse të turpërohesh. Ditët e jetës tënde tashmë janë bërë e shkuar. Ajo që ka shkuar nuk kthehet më pas. Të paktën këto pak ditë që të kanë mbetur, konsidero si mirësi dhe vlerësoi siç duhet. «O njeri i gjallë! Përmende Allahun sa të punon ende gjuha! Mos i mbyll buzët! Koha jonë na kaloi në indiferencë, e ti mos u bëj si ne! Stolisi frymëmarrjet e tua të numëruara me përmendjen e Zotit dhe konsideroje si mundësi këtë jetë!..»

Profeti (a.s.), e shpreh kështu pendimin dhe keqardhjen që do të ndiejnë besimtarët e mirë pas vdekjes:



“Banorët e Xhenetit nuk do të ndjejnë keqardhje për asgjë tjetër, përveç kohës që kanë kaluar në dynja pa përmendur Allahun.”

(Hejthemi X, 73-74)

Po keqardhja e atyre që nuk do të hyjnë në Xhenet si do të jetë?

Imam Gazaliu, duke u shprehur se një mysliman duhet ta llogarisë shpesh jetën e tij të përditshme, na jep këto këshilla:

“Pasi të ketë falur namazin e sabahut dhe para se ta fillojë ditën e re, besimtari duhet të ulet për të biseduar me vetveten, të bëjë disa marrëveshje dhe të vërë disa kushte. Kështu vepron edhe tregtari me ortakun e vet, të cilit duhet t’i dorëzojë mallin. Madje ia tërheq vëmendjen edhe për disa gjëra. Kështu, edhe njeriu duhet t’ia tërheqë vëmendjen vetes dhe t’i sugjerojë këto gjëra:

«Jeta ime është kapitali im. Po të më marrë fund jeta, më merr fund edhe kapitali bazë, edhe fitimi. Por, kjo ditë që sapo ka filluar, është një ditë e re. Allahu më nderoi duke më lejuar edhe këtë ditë! Po të ma kishte marrë jetën, sigurisht do t’i kërkoja të kthehesha qoftë edhe një ditë të vetme për të bërë punë të mira.»

Biri im! Tani mendo sikur ke vdekur, por të kanë kthyer prapë në këtë botë. Prandaj, sot mos iu afro kurrresi mëkatit dhe gjërave të kota dhe kurrresi mos e shpenzo kot qoftë edhe një çast të vetëm, sepse çdo frymëmarrje është një dhunti e paçmueshme!”

Kjo gjendje e Rebi bin Hejthemit është një shembull shumë domethënës në çështjen e vetllogarisë:

Ai kishte hapur një varr në bahçen e tij. Kur e ndjente se zemra i ishte ngurtësuar, shkonte te varri dhe qëndronte atje për njëfarë kohe. Ai mendonte se një ditë do t’i japë lamtumirën kësaj bote dhe se në varr do të ketë nevojë për një kërkim faljeje dhe sadaka që ka dhënë, duke menduar llogarinë në botën tjetër. Pastaj, thoshte këto ajete: **“Kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: «O Zoti im, më kthe pas që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që e lashë!..»**” (Mu’minun, 99-100) Kur dilte nga varri, i thoshte vetes:

“O Rebi! Shiko, sot të kthyen përsëri! Do të vijë edhe një kohë që kjo lutje nuk do të pranohet dhe nuk do të kthehesh në këtë

botë. Merri masat që tani dhe shtoji veprat e mira, përpjekjet në rrugën e Allahut dhe përgatitjet për botën tjetër!”

Nisur nga kjo, duhet të kujtojmë çdo moment edhe porosinë e Omerit (r.a.), i cili ka thënë: *“Llogariteni veten para se të llogariteni në gjykatën hyjnore!”* (Tirmidhi, Kiamet, 25/2459.)

Po ashtu, edhe dijetarët kanë dhënë këshillat e tyre për umetin, me atë të cilave çdo besimtar mund të llogarisë veten në jetën e tij të përditshme:

1. Çdo agim që lind, është hapje e një tjetër faqeje të bardhë prej librit të jetës tënde... Si e hape librin e jetës këtë mëngjes? A e falënderove Zotin tënd që të fali një ditë të re? A e rinovove premtimin e devotshmërisë ndaj Zotit tënd në këtë ditë të re? A ke menduar ndonjëherë se me çfarë do të jenë mbushur këto fletë kur të lexohen në mëngjesin e ditës së gjykimit?

2. Sa arrite të përfitoje prej mëshirës dhe faljes hyjnore kur Allahu të ftoi për t'i kërkuar falje në kohën para agimit? Apo mos ndoshta i ke humbur në gjumë këto mundësi të vyera, njëlloj siç humbasin kot pikat e shiut që bien mbi shkëmbinj? Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Allahu (xh.sh.) zbret çdo natë në qiellin e dynjasë, në një të tretën e fundit të saj dhe urdhëron:

«Kush më lutet Mua, që t'i përgjigjem atij, kush më kërkon Mua, që Unë t'i jap atij dhe kush pendohet tek Unë, që ta fal atë?» (Buhari, Teuhid 35, Tehexhud 14, Deauat 13; Muslim, Musafirin, 166.)

3. A ke mundur ta bartësh gjatë gjithë ditës frymëzimin e kohës para agimit? Sa kohë ke kaluar sot në atmosferën e përmendjes së Allahut? Sa kohë qëndrove në frymëzimin shpirtëror të përmendjes së Zotit tënd?

4. Sa kohë namazi ke falur me xhemat, duke iu përgjigjur ftesës hyjnore *“Hajja ale's-salah”*, që ngrihej prej minareve? A munde t'i falje namazet me përkushtimin e duhur dhe harmoninë zemër-trup me të cilën kënaqet Allahu?

5. A ke treguar sot vullnet të fortë për t'iu kundërvënë dëshirave të ulëta të egos që përpiqen të shtien apo të kanë shtënë në dorën e



tyre? A të ka vrarë ndopak ndërgjegjja për sjelljet apo zakonet e këqija që posedon dhe janë të ndaluara nga Allahu? A ke derdhur lot pendese për shkak të këtyre?

6. A e ke ruajtur gjuhën tënde sot nga fjalët e kota e të padobishme, nga gënjeshttrat dhe thashethemet, nga përgojimet dhe debatet dhe nga shpimi i ndonjë zemre me fjalë helmuese?

7. A ke mundur t'i vëzhgosh me syrin e zemrës yjet që janë krijuar për ty, pafundësinë e kozmosit, diellin dhe hënën që i japin jetë tokës, gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve që dalin nga e njëjta tokë, natyrën e tyre, frutat e ndryshme në ngjyrë, aromë, shije e formë, dizajnin e mrekullueshëm të krahëve të fluturave të cilat nuk kanë më tepër se dy javë jetë dhe fazat e mahnitshme të krijimit të njeriut? A ke marrë mësim prej shfaqjeve të fuqisë hyjnore në gjithësi dhe a ke fituar thellësi ndjenjash prej këtyre?

8. A ke mundur sot t'i shohësh krijesat me syrin e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë së Krijuesit?

9. Me kë dhe sa ke ndarë sot prej të mirave që të ka dhuruar Allahu i Madhëruar?

10. A e ke përjetuar sot kënaqësinë shpirtërore që të jep gëzimi i një besimtari? A ke ngushëlluar ndonjë hallexhi, duke e bërë të buzëqeshë? A ke fituar ndonjë zemër sot?

11. A e ke përkëdhelur sot kokën e një jetimi?

12. A e ke vizituar ndonjë të sëmurë? A e ke përcjellë ndonjë xhenaze?

13. A je interesuar sot për fqinjët dhe nevojtarët përreth teje? A ta ka drithëruar zemrën një fqinj që ka mbetur i uritur apo ndonjë i pastrehë që dridhet në të ftohtë?

14. A të kanë hidhëruar sot hallet e myslimanëve që vuajnë qoftë edhe në anën tjetër të botës? A je gjendur sot pranë të vuajturve dhe a e ke ndarë hidhërimin e tyre? A t'u prek zemra pranë tyre, a të lotoi syri prej halleve të tyre, a të shkaktoi dhimbje në zemër vuajtja e tyre?

15. A ke bërë ndonjë përpjekje sot për ngopjen e të uriturve,



shërimin e të sëmurëve dhe për lehtësimin e atyre që janë të shtypur nën barrën e borxheve? A je lutur për këtë çështje me fjalë, me zemër, dhe ç'është më e rëndësishme, me vepra?

16. A je kujdesur sot për të drejtat e njerëzve apo të kafshëve? A ke menduar se je përgjegjës edhe për macen apo qenin që ke gjetur tek dera jote?

17. A ke mundur që sot, atyre që kanë nevojë për udhëzim, t'u afroresh me gjuhë të ëmbël dhe me një zemër që shpërndan mëshirë? A i ke urdhëruar ata për të mirë dhe a i ke ndaluar nga e keqja? A je lutur për udhëzimin e tyre? A ke mundur të bëhesh shembull për ta me "identitetin e një myslimani"?

18. A i ke pyetur sot prindërit apo të afërmit e tu për hallet e tyre, a ua ke gëzuar zemrat? Nëse ata kanë ndërruar jetë, a je lutur për ta dhe i ke kujtuar me mirësi? Sa besnik ke qenë ndaj miqve të tyre të vjetër?

19. A ke përshëndetur sot me selam të gjithë njerëzit që i njeh dhe nuk i njeh? A i ke pritur njerëzit me fytyrë të qeshur duke e ditur se buzëqeshja është sadaka?

20. A ke fituar sot ndonjë mik dhe me sa miq e ke freskuar miqësinë?

21. A ke hequr sot nga rruga ndonjë pengesë që i bezdis kalimtarët?

22. A ke mundur ta shohësh sot familjen tënde me syrin e zemrës, si kopshtin tënd të Xhenetit, duke u përpjekur ta mbrosh atë nga ndikimet negative të kohës?

23. Çfarë u mësove sot nga edukata fëmijëve të tu, të cilët Allahu i Madhëruar t'i ka lënë amanet? A ke mundur të fusësh në zemrat e tyre dashurinë për të Dërguarin e Allahut (a.s.), profetët e tjerë dhe robërit e mirë të Allahut? A je përpjekur që ata të fitojnë një personalitet të mbrujtur me moral Islam? A ke menduar se ata do të jenë ose nder, ose turp për ty në ditën e gjykimit?

24. Nëse je zonjë shtëpie, a e ke përcjellë burrin tënd me fytyrë të



qeshur e dashuri, duke u lutur që të sjellë furnizim hallall në shtëpi? Po ashtu, a e ke pritur me fjalë të ëmbla në mbrëmje, duke u përpjekur t'i largosh lodhjen dhe të bëheni një familje e pastër e shembullore?

25. Nëse je zot shtëpie, me sa butësi dhe mëshirë je sjellë ndaj gruas dhe fëmijëve të tu? A e ke menduar se, trashëgimia më e madhe që mund t'u lësh atyre, është ajo e botës tjetër dhe, a je përpjekur aq sa duhet për zhvillimin e tyre fetar, moral e shpirtëror?

26. A ke mundur t'i vetëdijësosh fëmijët e tu se feja, besimi, atdheu dhe të gjitha gjërat e shenjta janë amanete që duhen mbrojtur? A ia ke kujtuar fëmijëve të tu dëshmorët që kanë rënë në mbrojtje të atdheut? A i ke mësuar ata se Kurani që është mirësia më e madhe e Allahut, ezani që jehon në qiejt tanë dhe flamuri ynë që valëvitet i lirë në këtë vend, janë nderi dhe krenaria jonë më e madhe?

27. Duke filluar prej familjes, a ke marrë masa mbrojtjeje për njerëzit që ke nën përgjegjësi, kundër të këqijave dhe problemeve të kohës, ndërkohë që sot breza të tërë po humbasin si trungjet në përrenj?

28. A je përpjekur sot të qëndrosh me ndonjë njeri të mirë? A ke bërë miqësi me ndonjë besimtar të sinqertë që do t'i thotë të vërtetat për hir të Allahut edhe pse nuk do t'i pëlqenin egos tënde? A ke bartur ndopak shqetësim në zemrën tënde për t'u ruajtur nga qëndrimi me gjynahqarët dhe njerëzit e këqij?

29. A ke marrë pjesë sot në ndonjë veprimtari që të shton dijen dhe kulturën? A ke kërkuar urtësi duke marrë shembull prej jetës së Profetit tonë (a.s.)? A je përpjekur t'i përjetosh këto gjendje shpirtërore dhe mirësi?

30. A ke bërë kujdes nëse fitimi yt i sotëm, ushqimi, pija dhe veshja jote janë hallall, të dyshimta apo haram? A të ka shoqëruar ndjenja e ruajtjes prej haramëve në çdo veprim?

31. A je sjellë me mirësi dhe a e ke falur sot ndonjë që të ka bërë keq ose është sjell keq me ty?

32. Sa faqe ke lexuar sot prej Kuranit Fisnik, i cili është mrekullia më e madhe që do të vazhdojë deri në ditën e Kiametit? A ke mundur



të punosh siç duhet me të duke medituat mbi mesazhet që jep ai? A je prej atyre që ia kanë mësuar dikujt Kuranin, i kanë shërbyer atij dhe e kanë ndihmuar atë për t'u bërë prej robërve më të mirë?

33. A ke menduar se sot mund të vdesësh, të qefinosesh, të varrosesh dhe, pasi familja dhe të afërmit të të lënë në varr e të kthehen pas, do të mbesësh vetëm për vetëm me besimin dhe punët e tua? A ke menduar se do të pendohesh shumë për momentet e kaluara kot të kësaj jete? A je penduar sinqerisht duke i organizuar sjelljet dhe mendimet e tua në këtë drejtim?

34. Si e ke mbyllur ditarin e jetës sot? Çfarë kanë shkruar Kira-men Katibin aty? A do të mund të japësh llogari në ditën e gjykimit për faqen e kësaj dite?

35. Shkurtimisht, a e ke menduar se sot je duke u regjistruar nga kamerat hyjnore në çdo lëvizje dhe çdo veprim tëndin për të mbushur kasetën e jetës tënde? A e ke bërë llogarinë e 24 orëve të fundit që ke kaluar dhe a e ke kontrolluar veten?..

Të parët tanë kanë thënë: “Mendja njerëzore ka sëmundjen e harresës.” Kalimi i kohës, merr prej memories së njeriut edhe shumë ndjenja. Prandaj është e domosdoshme që herë pas here t'i mendojmë këto me qëllim që t'i kujtojmë mirësitë e harruara dhe t'i rifreskojmë virtytet e zemrës që janë zvetënuar. Ja pra, lidhur me këtë, sjelljet, porositë dhe veprat e njerëzve të urtë e të devotshëm, bartin një vlerë të paçmueshme, sepse për të bërë një jetë të devotshme dhe vigjilente si ata, është e mundur në sajë të llogarisë së çdo dite të jetës sonë në peshoren e besimit.

Kjo lutje e Jahja bin Muadhrit, shfaq para nesh një ndjesi shpirtërore, e cila është shembull për ne:

“O Allah! Netët mund të zbukurohen vetëm me lutjen dhe strehimin tek Ti. Ditët mund të zbukurohen vetëm me adhurimet dhe veprat e bukura për Ty. Bota mund të zbukurohet vetëm me përmendjen Tënde dhe meditimn rreth krijesave të Tua. Pasvdekja mund të zbukurohet vetëm me faljen Tënde. Xheneti mund të zbukurohet vetëm me bukurinë Tënde.”



O Zot! Na e bëj të mundur të bëjmë një jetë të devotshme në rrugën Tënde dhe ta përdorim kapitalin e jetës sonë vetëm për kënaqësinë Tënde!..

Amin!..



Bulëza lumturie -2-

NGA BOTA E ZEMRËS SË TË DASHURVE TË ALLAHUT

(ZEMRA E PASTËR)



Për të arritur dashurinë hyjnore, e cila është rruga më e shkurtër për t'u takuar shpirtërisht me Allahun, duhet që më parë ta pastrosh zemrën prej dëshirave të egos që të largojnë prej Tij dhe ta zbardhësh atë me përmendjen e vazhdueshme të Tij, me qëllim që ajo të bëhet pasqyra e së vërtetës dhe mistereve. Dhe, një zemër aq e pastër dhe e kthjellët sa të bëhet pasqyrë e bukurive hyjnore, është dhurata më e merituar për t'iu dhënë Allahut të Madhëruar. E në fakt, edhe pranimi ynë në prezencën hyjnore të Zotit tonë, është i mundur vetëm me “zemër të pastër”.

BULËZA LUMTURIE -2-

NGA BOTA E ZEMRËS SË TË DASHURVE TË ALLAHUT

(ZEMRA E PASTËR)

Në këtë botë, e cila është shkolla e urtësive hyjnore, Allahu Teala ka dhënë shumë mundësi që na shpion ne, robërit e Tij, te e vërteta. Librat hyjnorë, profetët dhe të devotshmit, që janë udhërrëfyes drejt udhëzimit, e orientojnë gjithmonë njerëzimin tek e drejta dhe e vërteta duke luajtur edhe rolin e korrierëve të “ftesës hyjnore drejt Xhenetit”. Allahu i Madhëruar thotë:

“Allahu i fton robërit e Tij në Daru’s-Selam (Xhenet, që është vendi i lumturisë)...” (Junus, 25)

Normalisht që çdo ftesë ka kushtin e pranimit dhe çdo mirësi ka një kosto. Se cila është kostoja, Allahu na e tregon në një ajet tjetër:

“Ditën kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen tek Allahu me zemër të pastër!” (Shuara, 88-89)

Zemra e pastër, është një zemër e pastruar nga të gjitha dashuritë e tjera jashtë asaj për Allahun dhe ka rritur të bëhet vendi ku shfaqen cilësitë e bukura hyjnore, si një pasqyrë e shndritshme. Kur Allahu i Madhëruar shikon shfaqjet e cilësive të bukura në zemrën e robit, Ai e do atë dhe kënaqet prej tij.

Për të merituar ftesën e Xhenetit dhe mirësitë e pafundme të



Zotit tonë, është e domosdoshme të largohemi nga çdo dashuri tjetër përveç Tij dhe t'i drejtohem Atij me gjithë shpirt, sepse Zoti ynë, prej nesh kërkon një zemër ku do të pasqyrohen cilësitë hyjnore, pra, një zemër të pastër.

Mevlana, në veprën e tij “Mesnevi”, tregon një ndodhi të tillë:

“Jusufit (a.s.), i vjen një mik i largët me zemrën e mbushur plot dashuri dhe i bëhet mysafir në shtëpi. Ata ishin miq të përzemërt që prej fëmijërisë. Pasi bisedoi me të për një farë kohe, Jusufi, që kishte një bukuri magjepsë, e pyet mikun e tij:

«Na thuaj miku im! Çfarë dhuratash na solle prej vendeve ku ke shkuar?»

Mysafiri, në fillim u hutua disi përballë kësaj pyetje. Por, më pas i shpreh kështu ndjenjat e tij:

«Pashë shumë gjëra në këtë botë të përkohshme, me qëllim që të zgjedh një dhuratë për ty. Mirëpo, asnjëra nuk më pëlqeu, sepse asnjëra nuk të kishte hije. E si mund ta çoj si dhuratë një thërrime floriri tek një lum me flori apo një pikë uji, tek një det? Cila farë mund të jetë e njëjtë me bukurinë tënde, të cilën mund ta gjejë në hambarët e Egjiptit? Dhurata që të ka hije ty, mund të jetë vetëm diçka e ngjashme me bukurinë tënde. Për këtë arsye, unë mendova të të sillja një pasqyrë të ndritshme e të pastër si drita e zemrës.

O Jusuf, që je drita e qiellit ashtu si dielli! Të kam sjellë një pasqyrë prej dritës së zemrës, me qëllim që sa herë që ta shohësh, të vësh bukurinë tënde e të mahnitesh. Dhe, sa herë që të shohësh bukurinë e fytyrës tënde, të vësh shfaqjet e bukurisë së Allahut tek ty dhe të më kujtosh mua.»

Pasi mbaroi fjalën, mysafiri nxjerr një pasqyrë prej ari dhe ia ofron Jusufit .”

Rumiu thotë:

“Çfarë është pasqyra e qenies? Pasqyra e qenies është mosqenia. O ti i dashuruar pas Hakut! Nëse nuk je budalla, te Zoti yt shko si mosqenie.”



Marifet është njohja shpirtërore dhe metafizike e Allahut, e cila ka karakter intuitiv ose mund të shpjegohet në këtë mënyrë me anë të koncepteve me të cilat gjykojmë dhe veprojmë ne. Retë në qiell dhe unë në det nuk kanë ngjyrën e vet. Ai që i bën ato ngjyra-ngjyra është dielli në qiell. Kështu edhe ti zhvishu nga dëshirat egoiste, shko në gjendje hiçi, sepse përsosja e çdo pasqyrimi hyjnor fillon pasi arrihet hiçi.

Nëse dëshiron të miqësohesh me Allahun e Madhëruar, dije mirë se tek miqtë nuk shkohet duarbosh! Të shkosh duarbosh tek miqtë, është si të shkosh pa grurë në mulli.

Allahu i Madhëruar do t'i pyesë robërit e Tij në ditën e gjykimit:

«Çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit?»

Pastaj do të thotë:

«Ju keni ardhur duarbosh, pa furnizim, të vetmuar dhe nevojtarë ashtu siç ju krijuam në fillim. Na tregoni çfarë dhurate keni sjellë për ditën e Kiametit? Apo ndoshta nuk shpresonit se do të ktheheshit nga dynjaja në ahiret e do të dilnit para Allahut? A mos ju duk kot lajmi i Kuranit në lidhje me Kiametin?»

O ahsen-i takuim, pra, o njeri që je krijuar me cilësitë më të bukura! Nëse nuk e mohon ditën e Kiametit, si shkel në derën e Atij Miku kështu, duarbosh? Pakësoje gjumin, ushqimin dhe pijen në këtë botë të përkohshme dhe përgatit një dhuratë për kohën kur do të takohesh me Allahun e Madhëruar!..”

Njeriu ka për detyrë të kuptojë dobësinë dhe paaftësinë e vet përballë pafundësisë së madhështisë dhe fuqisë hyjnore. Kjo, sepse Allahu është krijuesi dhe zotëruesi i gjithçkaje. Për këtë arsye, Ai nuk ka nevojë për krijesat. Nuk ka asnjë lloj dhurate që mund t'i dërgohet, e që të mos gjendet në thesarin e Tij. Ai është burimi i të gjitha të mirave dhe bukurive. Për këtë arsye, gjëja më e bukur dhe më e vlefshme të krijesat, është një “zemër e pastër dhe e dëlirë”, e cila mund të bëhet pasqyrë e “esmau'l-husna”, pra, e emrave të bukur të Allahut. Për këtë arsye, dhurata më e përshtatshme që mund t'i paraqitet Zotit, është “zemra e pastër”, që Zoti i Madhërishëm kërkon prej nesh. Sa bukur shprehet poeti:



“O tregtar! Mos pandeh se prej teje ar dhe argjend dëshirojnë! Ditën e gjykimit, kur nuk kanë dobi pasuria dhe fëmijët, vetëm zemër të pastër kërkojnë!”

Një rob me zemër të pastër, është i sigurt nga turpërimi dhe poshtërimi në ditën e gjykimit, atëherë kur çdo gjë e fshehtë dhe e hapur do të dalë në shesh para Allahut, të Dërguarit të Tij (a.s.) dhe gjithë njerëzimit. Kështu, ai shpëton prej të gjitha vështirësive dhe vuajtjeve të asaj dite.

Profeti (a.s.), thotë:

“O Zoti im! Kërkoj prej teje qëndrueshmëri në fe... një gjuhë që thotë të vërtetën dhe një zemër të pastër...” (Tirmidhi, Deauat, 23/3407.)

Nuk ka fatkeqësi më të madhe se ta bësh zemrën rob të dëshirave egoiste. A ka fatkeqësi më të madhe se ta ndotësh atë që është krijuar vetëm për dashurinë e Allahut? Çfarë kuptimi ka të pastrosh trupin kur e ke të ndotur zemrën?

Mbi derën e një hamami të vjetër në Stamboll shkruhej:

“Nëse je njeri me karakter dhe vese të këqija, mos prit ndonjë gjë të madhe prej hamamit! Nëse dëshiron pastërti, së pari shko laj zemrën pastaj trupin!..”

Zemra e pastër, është si një fener i kristaltë, brenda të cilit shkëlqen drita e besimit. Me këtë dritë në zemër, besimtari arrin të dallojë të vërtetën nga gënjeshtra, të drejtën nga e shtrembëta dhe hallallin nga harami. Uabisa ibn Ma’bedi (r.a.), që ishte një sahab i ndjeshëm dhe sypërplotur, tregon:

Në ditë, shkova tek i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili mu drejtua dhe më tha:

- A ke ardhur të më pyesësh se çfarë është mirësia?

- Po, o i Dërguari i Allahut!

I Dërguari i Allahut (a.s.), vazhdoi:

- Konsultohu me zemrën tënde. Mirësi është ajo gjë që mendja e sheh të përshtatshme dhe zemra pranon të bëhet. Ndërsa gjynah



është ajo gjë që të copëton zemrën dhe që heziton ta bësh, edhe nëse të tjerët të japin shumë fetva për ta bërë.” (Ahmed bin Hanbel, Musned, IV, 227-228; Darimi, Buju 2.)

Profeti (a.s.), e këshillon këtë sahab të devotshëm, që për të dalluar të vërtetën, të këshillohet me zemrën. Nisur nga kjo, një zemër e pastër dhe e pandotur me gjynahe dhe lakmi, ka aftësinë të dallojë të vërtetën nga gënjeshtria dhe të mirën nga e keqja. Kjo, sepse zemra e pastër, është një busull e sigurt për të gjetur drejtimin. Gjërat që e ndotin dhe sëmurin atë, janë dëshirat e egos, indiferenca dhe gjynahet.

Profeti (a.s.) thotë:

“Kur robi kryen një gjynah, në zemrën e tij shfaqet një pikë e zezë. Nëse ai largohet prej gjynahut, kërkon falje dhe pendohet, zemra e tij pastrohet. Por, nëse ai nuk vepron kështu dhe drejtohet përsëri tek ato gjynahe, pikat e zeza shtohen, dhe si përfundim, ato ia mbulojnë zemrën. Ja pra, pikërisht ky është “ndryshku” për të cilin Allahu i Madhëruar thotë: «Jo, nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë ndryshkur zemrat.»” (Tirmidhi, Tefsir, 83; Ibn Maxhe, Zuhd, 29.)

Hasan Basriu këshillon:

Gjashtë gjëra e prishin zemrën:

1. Gjynahu që bëhet me mendimin se do pendohesh.
2. Dituria pa vepra.
3. Mungesa e sinqeritetit në sjellje dhe vepra.
4. Mungesa e falënderimit ndaj mirësive të Allahut.
5. Pakënaqësia me caktimin e Allahut.
6. Mos marrja mësim prej të vdekurve.

Zemra ndikohet nga mjedisit ku gjendet. Nëse përballet me mirësi dhe bukuri, tek ajo reflektohen të njëjtat mirësi e bukuri. Në të kundërtën, nëse ajo përballet me të këqija dhe shëmti, ato do ta nxijnë atë.

Sipas një transmetimi, edhe “Haxheri Esued / Guri i Zi”, i cili me-

ndohet të ketë ardhur prej Xhenetit dhe është vendosur në një qoshe të Qabesë nga Ibrahim (a.s.), si shenjë e fillimit të tavafit, është nxirë si pasojë e gjynaheve të njerëzve dhe reflektimeve negative të zemrave të ngurtësuara. Në fakt, ky gur ka qenë borë i bardhë kur ka dalë nga Xheneti. Por me kalimin e kohës, është nxirë për shkak të gjynaheve të njerëzve që e kanë prekur.

Duhet menduar se, nëse gjynahet e njerëzve kanë ndikuar kaq shumë edhe tek një gur, saqë e kanë nxirë atë, si mund të ndikojnë ato tek zemra, e cila njësoj si uji, merr formën dhe ngjyrën e mjedisit kur gjendet!? Prandaj, për të ruajtur pastërtinë dhe kthjelltësinë e zemrës, duhet bërë kujdes shumë i madh ndaj gjynaheve.

Kur zemra pushtohet plotësisht nga njollat e gjynaheve, ajo zhytet në errësirën e indiferencës dhe ngurtësimit. Pluhurat dhe njollat që formohen me kalimin e kohës mbi një pasqyrë, e turbullojnë kthjelltësinë e saj. Në të njëjtën mënyrë, edhe njollat e gjynaheve e verbojnë syrin e zemrës dhe e paaftësojnë njeriun në dallimin e të bukurës dhe të shëmtuarës, të mirës dhe të keqes. Pas një farë kohe, shuhet edhe drita e besimit që i jep jetë zemrës. Një kraharor i tillë, tashmë nuk ndryshon aspak nga një varr që mban brenda një kufomë.

Si rezultat i vdekjes shpirtërore të zemrës, njeriu e humbet aftësinë më të rëndësishme që arrin të bëjë dallimin mes së mirës dhe së keqes. Tashmë, edhe gjynahet më të mëdha që helmatisin zemrën, mund të bëhen pa e ndjerë peshën e tyre. Këtë të vërtetë, e shprehin shumë bukur edhe këto fjalë të Omer bin Abdulazizit:

“Haramet janë zjarr. Drejt tyre e zgjasin dorën vetëm ata që kanë zemra të vdekura. Nëse ata që i zgjasin duart do të kishin zemra të gjalla, patjetër që do ta ndjenin djegien e atij zjarri.”

Vigilencën dhe shqetësimin që biri i njeriut shfaq përballë humbjes materiale e të përkohshme, nuk e shfaq përballë humbjeve shpirtërore e të përrjetshme të shkaktuara nga indiferenca. Dhe, indiferenca më e tmerrshme, është mungesa e vuajtjes së robit përball vdekjes së zemrës. Vehb bin Munebbih, ka thënë:



“Sa të çuditshëm janë njerëzit! Qajnë për ata të cilëve u vdesin trupat, e nuk qajnë për ata që u vdesin zemrat. E në fakt, fatkeqësia e vërtetë, është vdekja e zemrës!”

Ndërsa Fadl ibn Abbasi (r.a.), i cili përpiquej vazhdimisht ta kryente namazin në mënyrë të përkushtuar, thotë:

“Çuditë me njerëzit; kur më vdiq një fëmijë, më erdhën me mijëra njerëz për ngushëllim, por kur më iku një namaz me xhemat, askush nuk më erdhi të më shprehte ngushëllimet. Beto hem se, mospjesëmarrja në një namaz me xhemat, për mua është fatkeqësi shumë më e madhe se sa vdekja e njerit prej fëmijëve të mi të edukuar, të ditur dhe të devotshëm.”

Ja pra, njerëzit e devotshëm, të cilët e përjetojnë në maksimum këtë të vërtetë, më tepër se ndaj humbjeve materiale dhe të përkohshme, shqetësohen dhe qëndrojnë vigjilentë ndaj humbjeve shpirtërore që kanë lidhje me botën e përjetshme.

Ndërsa atyre të cilëve u janë nxirë zemrat nga gjynahet, u janë rrënuar edhe aftësitë e perceptimit shpirtëror. Për këtë arsye, ata nuk arrijnë ta perceptojnë dot të vërtetën.

Ebu Turab en-Nahshebi, ka thënë:

“Zemra e nxirë ka tre shenja:

- 1. Nuk ndjen frikë nga gjynahet.*
- 2. Nuk ndjen ëmbëlsi nga adhurimet.*
- 3. Nuk preket nga këshillat.”*

Prandaj, me qëllim që zemrat tona të mos bien në këtë nivel, duhet t'i japim rëndësi Kuranit, Sunnetit dhe dijetarëve të devotshëm, të cilët Allahu na i ka falur si udhëzuesit tanë në rrugën e drejtë.

Rumiu ka thënë:

“Ai që qëndron larg njerëzve të mirë e të devotshëm dhe dashurohet pas vetes, është i vdekur ndaj së vërtetës, edhe nëse është sundues i botës.”

Kurse Ebu Uname (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Lukmani (a.s.), i ka thënë birit të tij:

«Biri im! Qëndro me të diturit dhe përpiku të mos ndahesh prej tyre! Dëgjoji fjalët e të urtëve, sepse Allahu i Madhëruar i ringjall zemrat me dritën e urtësisë, ashtu siç e ringjall tokën me begatinë e shiut.»” (Hejthemi, I, 125.)

Ndërsa Zoti ynë që ka krijuar zemrën, lidhur me ruajtjen e shëndetit shpirtëror të saj dhe kurimin e një zemre të sëmurë, ka thënë:

“...Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Ra'd, 28)

Zemra është në pozicionin e sunduesit të mbretërisë së trupit. Kur ajo gjallërohet me përmendjen e Allahut dhe ndriçohet aq shumë sa ta ndajë mirë të vërtetën nga e kota, i drejton siç duhet edhe organet që ka nën urdhrat e vet. Për rrjedhojë, ajo arrin pjekurinë e devotshmërisë me të cilën kënaqet Allahu i Madhëruar.

Jahja bin Muadh, ka thënë:

“Freskojini zemrat me përmendjen e Allahut, sepse ato plogështohen shumë shpejt!”

Dhe, me të vërtetë që, për të arritur dashurinë hyjnore, e cila është rruga më e shkurtër për t'u takuar shpirtërisht me Allahun, duhet që më parë ta pastrosh zemrën prej dëshirave të egos që të largojnë prej Tij dhe ta zbardhësh me përmendjen e vazhdueshme të Tij, me qëllim që ajo të bëhet pasqyra e së vërtetës dhe mistereve.

Për të bërë një jetë të devotshme me sinqeritet dhe pasion, është e domosdoshme të përfitohet prej frymëzimit shpirtëror gjatë natës.

Kur ishte në shtratin e vdekjes, Ebu Bekri (r.a.), e këshillon kështu Omerin (r.a.):

“... O Omer! Janë disa punë që Allahu dëshiron të bëhen natën, prandaj nuk është mirë të bëhen ditën! Por ka edhe disa punë që duhen bërë ditën, të cilat nuk bëhen siç duhet gjatë natës!..”

Mevlana Xhelaledin Rumi, ka thënë:

“O i dashuruar me Zotin! Bëhu prej atyre që flenë pak natën dhe kërkojnë t'u falen gjynahet!”



Të paktën lëviz pak, si foshnja në barkun e nënës, që të të falen ndjenja të ndritura. Nëse del nga kjo botë e mbushur me vështirësi, hidhërime dhe vuajtje, do të hapesh në një botë më të gjerë dhe më të rehatshme se toka.

Nata, ngjyra e së cilës nuk është e pëlqyeshme, bart shumë bukuri. Eliksiiri i jetës është miqësuar me errësirën dhe në të është fshehur.

Mos më shih me paaftësinë tënde shpirtërore; nata, për ty është natë, por për mua e njëjta natë është si fillim dite.

Kush e kupton të vërtetën e natës, nuk e dëshiron gjumin, por ikën prej tij. Shumë zemra të ndritura dhe shpirta të pastër e gjallë-rojnë natën, nuk flenë, por adhurojnë dhe i përgjyerojnë Allahut.

Nata është velloja e bukurive shpirtërore!

Si mundet dita të jetë e njëjtë me natën? Në sytë e tu, nata është si një tenxhere e zezë, sepse ti nuk e ke shijuar ëmbëlsinë dhe nuk e ke kuptuar të vërtetën e saj...”

Po ashtu, Xhelaledin Rumi në veprën e tij poetike Divani Kebir, e shpreh në vargje pasionin dhe ëmbëlsinë e adhurimit të përjetuar gjatë netëve:

Saki, mbushe kupën me dashuri hyjnore plot!
Lëre të dehurin, për bukë ç'i flet kot!

Shërbeje eliksirin të ngopen zemrat e etura!
Gjallesa që noton në det, veç ujit tjetër ç'do?

Mbushe nga ajo pije, mbushe prapë e na sill!
Të ndalet nata! Ndale natën në vend, o mik!

Lidhma gjumin me zinxhirë, çastet të mos kalojnë!
S'e kuptojnë sekretin e natës, o mik, ata që flenë!

Netët, e në veçanti koha para agimit, janë mundësi të jashtë-zakonshme për t'iu afruar Allahut. Prandaj duhet që këto kohë të konsiderohen si mirësi të mëdha. Shkaku kryesor i privimit prej kësaj mirësie, është verbimi i zemrës nga gjynahet dhe tërheqja e njeriut drejt indiferencës.



Hasan Basriu, ka thënë:

“Shkaku i vetëm që njeriu nuk ngrihet për adhurimin e natës, është gjynahu që ka bërë. Prandaj, çdo mbrëmje bëni një vetllogari dhe provojeni veten! Pendohuni tek Allahu, që të ngriheni në adhurimin e natës, sepse ngritja në adhurimin e natës, i vjen rëndë vetëm atij që është i shtypur nën peshën e gjynaheve.”

Për të përfituar siç duhet nga frymëzimi shpirtëror i netëve, duhet që ditën të qëndrosh larg gjynaheve dhe frymëzimin e natës ta bartësh gjatë gjithë ditës. Njëherë, një person i ankohet Ibrahim bin Ed'hemit:

- Nuk po arrij të ngrihem në adhurimet e natës. Më jep një zgjidhje!

Ibrahim Ed'hemi, i thotë:

- Mos e kundërshto Allahun gjatë ditës, që Ai të të pranojë natën. Nëse Ai të pranon natën, ky është një nder shumë i madh, të cilin gjynahqarët nuk e meritojnë!

Krahas gjallërimit të netëve me adhurimeve, është shumë e rëndësishme që adhurimet të bëhen me kujdes dhe përkushtim të madh. Ibn Abbasi (r.a.), ka thënë:

“Dy rekat namaz të falura me përkushtim, janë më mirë se të kalosh gjithë natën me adhurim me një zemër indiferente ndaj Zotit.”

Ndërsa Ebu Derda (r.a.), ka thënë:

“Një orë meditim, është më e mirë se dyzet net adhurim nafile (vullnetare).” (Dejlemi, II, 70-71, nr: 2397, 2400.)

Siç shihet, adhurimet marrin vlerë vetëm në se bëhen me vigjilencë shpirtërore, përkushtim dhe meditim të thellë. Cilësia më e rëndësishme e sahabëve dhe besimtarëve të devotshëm, është zotërimi i kësaj pjekurie shpirtërore. Abdullah bin Mes'ud (r.a.), ka thënë:

“Ju falni më shumë namaz se sahabët dhe përpigëni më shumë se ata. Mirëpo, ata ishin më të virtytshëm se ju, sepse ata ishin më asketë se ju ndaj kësaj bote dhe më të dhënë ndaj botës tjetër!” (shih,

Ibni Xheuzi, Sifatus-Safve, I, 420.)



Ajo që i bën adhurimet të pranuar tek Allahu, është sinqeriteti dhe devotshmëria. Pra, nënshtrimi i plotë me sinqeritet dhe respekt të thellë ndaj urdhreve dhe ndalesave të Allahut dhe vazhdimi në rrugën e drejtë të kënaqësisë hyjnore.

Allahu i Madhëruar na bëftë të gjithëve prej besimtarëve të devotshëm që frymëzohen prej botës shpirtërore të Profetit tonë (a.s.) dhe dijetarëve të devotshëm, që konsiderohen trashëgimtarë të tij!..

Amin!..



Reflektimet e moralit profetik tek sahabët

-1-



I Dërguari i Allahut (a.s.), njerëzimin, i cili po mbytej në padrejtësi dhe anarki, e përqafoi me mëshirë, që është edhe fryti më i çmuar i besimit. Në sajë të sjelljeve të tij plot mëshirë e dashuri, ai shënoi majën më të lartë në aspektin e shembullit për njerëzimin.

Lum ata besimtarë që sot kanë vendosur shpirtin e Kuranit në zemra, entuziazmin e shërbimit në shpirtra dhe kthjelltësinë e moralit të bukur në ndërgjegjet e tyre, duke bërë një jetë brenda një kënaqësie shpirtërore të pashtershme të lumturisë së përvetshme...

REFLEKTIMET E MORALIT PROFETIK TEK SAHABËT -1-

Epoka më e rëndësishme Islame, është padyshim “Epoka e Lumturisë”, kur bota u ndriçua me dritën e profetësisë dhe Profeti ynë (a.s.), bashkë me shokët e tij, u bënë stolia më e çmuar e asaj kohe të bekuar.

Duke e parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), me dritën e besimit, sahabët fisnikë, të cilët arritën të sakrifikonin bujarisht jetët dhe pasuritë e tyre për hir të Fjalës së Allahut, ishin një dhuratë hyjnore prej Allahut, për t’u bërë **“brezi shembullor”** i umetit të Muhamedit (a.s.).

Nisur nga kjo, çdo zemër e nderuar me besim, duhet të jetë e mbushur plot me ndjenja respekti, dashurie dhe mirënjohjeje ndaj sahabëve, të cilët kanë një rëndësi të veçantë në përcjelljen e fesë sonë të bukur deri tek ne. Për rrjedhojë, të lutesh duke thënë “radijallahu anh / Allahu qoftë i kënaqur me të”, pasi të përmendësh emrin e çdo njeri prej tyre, tregon respektin dhe mirënjohjen që kemi ndaj tyre.

Ata arritën t’i jepnin formë edhe kohës kur jetuan, edhe shekujve që pasuan. Në sajë të tyre, netët u kthyen në ditë dhe dimrat u bënë pranvera. Ata i dhuruan njerëzimit një botë meditimi dhe ndjenjash të thella. Ata e prezantuan njerëzimin me esencën e vet dhe i mësuat atij urtësinë e krijimit të gjithësisë. I mësuat meditimin e thellë mbi urtësitë dhe misteret e fuqisë hyjnore, që prej trupit të njeriut të formuar nga



një pikë uji, zogjtë që zhvillohen nga një vezë shumë e vogël, pemët që marrin hov nga një bërthamë pothuajse e padukshme, e deri tek krijimi i qiejve e i tokës. Po në sajë të tyre, zemrat besimtare arritën të kuptonin ndjenjat e larta të falënderimit, durimit dhe mirënjohjes.

Siç dihet, para profetësisë së Muhamedit (a.s.), gadishulli arabik ishte një shkretëtirë fatkeqësish. Armiqësitë mes fiseve, gjakmarrjet, varrosja e vajzave për së gjalli, amoraliteti, alkooli, fajdet, adhurimi i idhujve, besëtytnitë e paimagjinueshme dhe shumë e shumë të këqija të tjera ishin përhapur si epidemi. Dy librat hyjnorë, Teurati dhe Inxhili, ishin zbrazur nga e vërteta dhe ishin mbushur me gjëra të kota sipas dëshirës njerëzore. Në një situatë të tillë kaosi dhe injorance, Allahu i Madhëruar i fali njerëzimit dritën e udhëzimit. Në sajë të dritës profetike të Muhamedit (a.s.), bota u zgjua nga gjumi i indiferencës, sepse ai erdhi si mëshirë dhe udhëzim për botët.

I Dërguari i Allahut (a.s.), njerëzimin, i cili po mbytej në padrejtësi dhe anarki, e përqafoi me mëshirë, që është edhe fryti më i çmuar i besimit. Në sajë të sjelljeve të tij plot mëshirë e dashuri, ai shënoi majën më të lartë në aspektin e shembullit për njerëzimin. Në një kohë të shkurtët, ai edukoi një bashkësi besimtarësh aq të ndritur dhe të fisme, sa që tregimet rreth tyre do të jenë shembuj virtyti për të gjithë njerëzimin deri në ditën e kiametit. Kjo, sepse ata jetuan duke u përpjekur vazhdimisht të fitonin kënaqësinë e Allahut me të gjitha ndjenjat dhe veprat që bënin. Në sytë e tyre, momentet më të kënaqshme dhe kuptimplote të jetës, ishin ato kur u predikonin njerëzve mesazhin e teuhidit. Madje, në një rast, kur një sahabiu iu dhanë pak çaste për të shprehur dëshirën e fundit para se të ekzekutohej, e falënderoi “të mjerin” që ia dha këtë të drejtë dhe i tha: “Të jam mirënjohës për këto çaste që më fale. Mbase në këto momente do të kem mundësi të të tregoj të vërtetën e teuhidit.”

Sahabët gjelbëruan në tokën e dashurisë dhe mëshirës profetike dhe përjetuan një atmosferë dashurie të papërshkrueshme. Përkushtimi shpirtëror në adhurime, delikatesa në vepra, etika në moral, butësia në zemra dhe thellësia në ndjenjat e tyre, ishin të gjitha reflektime



shpirtërore nga Profeti ynë (a.s.). Lidhur me nivelin moral që arritën ata duke marrë shembull të Dërguarin e Allahut (a.s.), gjenden hadithe të shumta. Ja disa shembuj pre tyre:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), u ndau muhaxhirëve plaçkën e luftës që morën nga Beni Nadir dhe ensarëve nuk u dha asgjë, përveç tre vetëve që ishin nevojtarë. Pastaj, duke u kthyer nga ensarët, u tha:

“Nëse doni, ato që u keni dhënë muhaxhirëve më parë, le t’u mbeten atyre, ndërsa ju merrni pjesë nga plaçka e luftës. E nëse jo, atëherë kërkojuani atyre ato që u keni dhënë dhe kjo plaçkë t’u mbetet komplet atyre.”

Por ensarët, me një altruizëm të madh, dhe duke u dhënë përparësi vëllezërve besimtarë, dhanë këtë përgjigje të shkëlqyer:

“O i Dërguari i Allahut! Vëllezërve muhaxhirë u japim edhe nga pasuria edhe nga shtëpitë tona. Po ashtu, edhe këto mallra ua lëmë të gjitha atyre.”

Lidhur me këtë ngjarje, zbriti ky ajet fisnik, i cili jep sihariqin se mirësitë që bëhen me sakrificë të sinqertë, do të jenë shpëtim për robin:

“Ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe që besuan, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në zemrat e tyre ndonjë brengë nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre. Kush ruhet prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.” (el-Hashr, 9)²

Ndërsa Xhabiri (r.a.), e tregon kështu altruizmin dhe bamirësinë që treguan ensarët ndaj vëllezërve të tyre muhaxhirë:

“Kur Ensarët i mblidhnin hurmat, i ndanin në dy pjesë, në njërën pjesë hidhnin shumë dhe në tjetrën hidhnin pak. Pastaj, pjesën që kishte pak, e sajnin sikur kishte shumë, duke vendosur degë hurmash nën to, dhe u thoshin muhaxhirëve: «Merrni cilën pjesë të doni!» Kështu, ata merrnin grumbullin që dukej se kishte më pak, duke menduar se pjesa më e madhe duhej t’u takonte en-

2. Razi, XXIX, 250; Kurtubi, XVIII, 25.



sarëve. Në këtë mënyrë shumica e hurmave u mbetj muhaxhirëve, ndërsa ensarët mbanin për vete pjesën që kishte më pak hurma...

(Hejthemi, X, 40.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), thirri në fillim ensarët për të ndarë tokat e Bahrejnit mes sahabëve. Ensarët, duke treguar një sakrificë dhe tolerancë të paarritshme, thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Mos na jepni gjë ne, para se t’u jepni vëllezërve tanë muhaxhirë dy herë më tepër!”

Në lidhje me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“O Ensarë! Meqë nuk doni të merrni (duke u dhënë përparësi vëllezërve besimtarë), duroni derisa të më takoni te Burimi i Keuttherit, sepse pas meje, së afërmi do të vijë një kohë që do t’ju jepet përparësi juve para të tjerëve.” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 8)

E gjithë kjo, tregon se ensarët zotëronin një shpirt dhe një ndërgjegje në sajë të së cilës e ndjenin veten përgjegjës për vështirësitë dhe problemet materiale e shpirtërore të shoqërisë ku jetonin.

Po ashtu, edhe muhaxhirët, pavarësisht nevojave që kishin, përpqeshin të bënin një jetë të thjeshtë, duke mos dëshiruar t’i bëheshin barrë të tjerëve. Për rrjedhojë, në vend që t’i kërkonin për vete mirësitë e kësaj bote, ata zgjodhën kënaqësinë e Allahut.



Pozitën e kësaj bote që Allahu ua ka dhënë si amanet, sahabët e nderuar nuk e kanë bërë kurrë mjet të iluzionit për epërsi, siç janë mendjemadhësia dhe mburrja; ndërsa jetën modeste të Profetit (a.s.), e kanë bërë parim të jetës së tyre.

Kështu, kur Selmani (r.a.), ishte guvernatori i Medainit, i erdhi një person i fisit Beni Tejm nga Shami, i cili kishte sjellë edhe një sasi fiqsh. Selmani (r.a.), kishte veshur një rrobë dhe një pelerinë. Personi nga Shami nuk e njohte Selmanin (r.a.) dhe, kur e pa në atë gjendje, i tha:

“Eja mbarte këtë!”



Selmani (r.a.), shkoi dhe e mori ngarkesën në shpinë. Kur populli e pa, e njohën dhe i thanë personit nga Shami:

“Ky njeri që po mbart ngarkesën, është vet guvernatori!”. Pas kësaj, edhe pse personi nga Shami i tha:

“Ju kërkoj ndjesë, sepse nuk ju njoha!”, Selmani (r.a.) i tha:

“S’ka asgjë! Nuk do ta ul ngarkesën nga shpina, derisa ta çoj në shtëpinë tënde.” (Ibn Sa’d, IV, 88.)

Ky veprim i Selmanit (r.a.), tregon një shembull konkret të modestisë që duhet të bartë myslimani në çfarëdo pozite qoftë. Po ashtu, ky veprim përbën një shembull të gjallë të ajetit:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë me modesti...” (Furkan, 63.)



Kjo ndodhi, e shpreh qartë kujdesin e sahabëve në lidhje me mbrojtjen e jetimëve në shoqëri dhe rëndësinë e unitetit Islam në solidaritetin shoqëror:

Bera bin Adhib (r.a.), e tregon kështu ngjarjen kur i Dërguari i Allahut (a.s.), bëri umren kaza, një vit para çlirimit të Mekës:

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut (a.s.), po dilte nga Meka, pasi kishte mbaruar umren, bija e dëshmorit të Uhudit, Hamzait (r.a.), Uame (r.anha), e ndoqi nga pas duke i thirrur:

- Xhaxha, xhaxha!

Aliu e përqafoi vajzën e vogël dhe i tha të shoqes, Fatimes, (r.a.), që gjendej mbi deve:

- Merre me vete vajzën e xhaxhait tënd!

Kur arritën të gjithë në Medinë, mes Aliut, Zejd bin Harithes dhe Xhaferit (r.anhum), pati një mosmarrëveshje në lidhje me çështjen se ku do të qëndronte Uame.

- Ajo është vajza e xhaxhait tim! – Thoshte Aliu (r.a.).

- Ajo është edhe vajza e xhaxhait tim. Mbi të gjitha, unë jam i martuar me tezen e saj! – Thoshte Xhaferri (r.a.).



Kurse Zejdi thoshte:

- Ajo është vajza e tim vëllai, sepse Profeti (a.s.), na bëri vëllezër me babanë e saj!

Më pas, i Dërguari i Allahut (a.s.), ndërhyri dhe vendosi që Umame të qëndronte tek e shoqja e Xhaferrit (r.a.), duke thënë:

“Tezja është në vend të nënës!”

Pastaj, iu drejtua Aliut (r.a.) dhe i tha:

“Ti je prej meje dhe unë jam prej teje!”

Ndërsa Xhaferrit (r.a.), i tha:

“Ti më ngjan mua edhe në pamje, edhe në karakter!”

Më pas, iu drejtua edhe Zejdit (r.a.), të cilit i tha:

“Ti je edhe vëllai dhe miku ynë!”³

Në një hadith fisnik, thuhet:

“Personi që kujdeset për jetimin e vet apo për jetimin e një personi tjetër, ka për të qenë së bashku me mua në xhenet, ja kështu.”

Raportuesi i hadithit, Malik ibn Enesi tregon se si Profeti (a.s.), kishte ngritur dorën dhe kishte treguar bashkë gishtin tregues dhe gishtin e mesit. (Muslim, Zuhd, 42.)

Këto ngjarje që tregojnë virtytet e larta të sahabëve, janë padyshim rezultat i dorëzimit dhe dashurisë që kishin ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe të vlerësimit të duhur që i bënë ata fitimit dhe humbjes në këtë botë dhe në botën tjetër. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar e ka bërë ndjekjen e sunnetit profetik një nga kushtet për të fituar kënaqësinë e Tij. Për këtë arsye, dy pikat më kryesore në fenë Islame, janë **“Libri i Allahut dhe Sunneti i Profetit (a.s.)”**.

Nëse njeriu nuk e pason siç duhet Kuranin Fisnik dhe Sunnetin profetik, nuk mund të jetë besimtar me kuptimin e plotë të fjalës dhe



nuk mund të arrijë shpëtimin e përjetshëm. Ja edhe një shembull i bukur që tregon kujdesin e sahabëve për të jetuar sipas mësimave të Kuranit dhe sunnetit:

Një ditë, Kadi Shurajhi i shkroi një letër Omerit, ku e pyeste se si duhej të gjykonte në zonën e tij. Omeri (r.a.), i ktheu këtë përgjigje me shkrim:

“Gjyko me librin e Allahut. Nëse nuk e gjen përgjigjen aty, atëherë gjyko me Sunnetin e të Dërguarit të Allahut. Nëse nuk e gjen as në Librin e Allahut, e as në Sunnetin e të Dërguarit të Allahut, atëherë gjyko me gjykimet e vepërmirëve. Nëse nuk e gjen as aty gjykimin e nevojshëm, atëherë nëse dëshiron, vazhdo e jep gjykimin tënd, e nëse nuk e dëshiron këtë, atëherë tërhiq fare nga gjykimi. Mendoj se të tërhiqesh është më e mirë për ty. Ve’s-salam.” (Nesai, Kudat, 11/3.)



Ashtu si në çdo çështje, sahabët e kanë pasuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), edhe në zbatimin e përpiktë të Kuranit në jetën e tyre, duke e përvetësuar shumë mirë kuptimin e tij.

Kinane el-Adevi tregon:

Omer ibn Hattabi (r.a.), u shkroi komandantëve të ushtrisë:

“Identifikoni ata që e kanë mësuar përmendësh Kur’anin dhe m’i tregoni mua, t’i nderoj, t’u jap të mira dhe t’i dërgoj në zonat përreth që t’ua mësojnë Kuranin njerëzve.”

Ebu Musa el-Esh’ari (r.a.), e njoftoi Omerin (r.a.), së nën administrimin e vet kishte rreth 300 hafiza. Një pjesë e këshillave që Omeri (r.a.), u shkroi hafizëve, janë si më poshtë:

“Dijeni se, për ju, Kurani është një thesar shpërblimesh dhe nderi. Ndiqeni atë dhe mos e komentoni sipas interesave tuaja! Kush e komenton Kuranin sipas interesave vetjake, ai e rrëzon atë dhe e hedh në Xhehenem. Kush e ndjek Kuranin, ai e dërgon atë në Xhenetin Firdeus. Nëse keni mundësi, përpiquni ta bëni Kuranin ndërmjetësuesin tuaj dhe jo armikun tuaj, sepse ai për të



cilin Kurani bëhet ndërmjetësues, shkon në Xhenet, e ai ndaj të cilit Kurani ankohet, shkon në Xhehenem. Dijeni se Kur'ani është burimi i udhëzimit dhe dija më e shkëlqyer. Ai është libri i fundit që ka ardhur nga Rrahmani dhe me të hapen sytë e verbuar, veshët e shurdhër dhe zemrat e kyçura..." (Ali el-Muttaki, II, 285-286/4019.)

Ndërsa Kettani tregon:

"Sahabët e lexonin shumë Kuranin Fisnik dhe nuk dëshironin kurrë që t'u kalonte ndonjë ditë pa e lexuar atë dhe pa i parë faqet e tij. Ata e fillonin ditën e tyre me Kuran dhe, personave që kishin probleme me sytë, u këshillonin të shikonin librin e Kuranit."⁴

Po ashtu, edhe Ikrime (r.a.), e merrte Kuranin Fisnik në dorë, e vendoste në fytyrë dhe e shprehte madhërimin e dashurinë që kishte ndaj Allahut dhe qante duke thënë: "*Fjala e Zotit tim! Libri i Zotit tim!*" (Hakim, III, 272/5062.)

Ja pra, për shkak se sahabët e dashuronin kaq shumë Kuranin, ata patën fatin të ishin në një pozitë të veçantë tek Allahu i Madhëruar. Një nga njerëzit e devotshëm të Allahut, Hasan el-Basri, ka thënë:

"*Sahabët dhe pasardhësit e tyre ishin të bindur se Kurani është urdhër i Allahut, dhe në bazë të kësaj vepronin. Ata tregonin kujdes të veçantë për të ditë e natë; e analizonin, e merrnin për bazë dhe punonin sipas tij. Ndërsa sot, ju bëni më tepër kujdes ndaj rregullave të leximit, sesa ndaj urdhrave që përmban ai. Madje, as që e kuptoni atë!*" (Kandehlevi, Fedail.)

Kështu, duke marrë shembull kujdesin e sahabëve ndaj Kuranit Fisnik, edhe ne duhet të bëjmë një llogari me veten tonë, sepse të gjitha këto shembuj, nuk kanë ardhur deri në ditët tona që të mbeten në faqet e librave, por të që të gjejnë jetë në zemrat e besimtarëve të umetit Islam.



Këtu përmendëm vetëm disa shembuj të sjelljeve të bukura dhe të pashoqe të sahabëve të nderuar, që kanë pasur fatin ta shohin Profetin

4. Nizamu'l-Hukumeti'n-Nebeuijje, II, 197.



(a.s.), si besimtarë dhe që arritën majat më të larta në aspektin moral. Ndërkohë që ata ishin në këto nivele të larta të virtyteve morale, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Ummeti im i ngjan shiut, që nuk dihet se cila pjesë është më e mirë, fillimi apo fundi i tij.” (Tirmidhi, Edeb, 81.)

Ky hadith fisnik, është një derë e madhe shprese për ne si besimtarë që nuk kemi pasur fatin ta shohin të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Në ditët tona, shumica e njerëzve dashurohen pas dëshirave të egos dhe tërhiqen në vorbullat e ndikimeve negative, ndërkohë që shoqëria distancohet nga feja, e cila në fakt është burim i paqes dhe forcë lëvizëse për të. Për rrjedhojë, përpjekjet frymëzuese që shfaqin në një kohë të tillë besimtarët që mundohen të jetojnë me shpirtin dhe entuziazmin e sahabëve, kanë një vlerë të jashtëzakonshme tek Allahu i Madhëruar.

E në fakt, përpjekjet e singerta në lidhje me fenë që zhvillohen në një kohë të tillë, janë më të virtytshme se shumë shërbime të tjera në kohët kur njerëzit janë më të lidhur me fenë, sepse shpërblimi i një mirësie, është në përpjesëtim të drejtë me vështirësitë që kalohen në realizimin e saj. Nisur nga kjo, edhe një sukses i vogël që mund të arrijmë, me gjithë efektet negative të kësaj kohe në të cilën jetojmë, do të ketë një shpërblim shumë të madh.

Në përputhje me sprovën hyjnore, në këtë jetë, ndonjëherë përballemi me vështirësi, e ndonjëherë me mirësi. Por, e rëndësishme është që duke i braktisur dëshirat e egos dhe duke e pastruar botën tonë të brendshme, të qëndrojmë në rrugën e kënaqësisë hyjnore dhe të dalim të fituar edhe nga vështirësitë, edhe nga mirësitë me të cilat përballemi.

Në një hadith fisnik thuhet:

“E çuditshme është çështja e besimtarit, sepse çdo gjendje e tij është mirësi për të dhe kjo është e tillë vetëm për të. Nëse besimtarit i ndodh një gëzim, ai falënderon (Allahun) dhe kjo i sjell dobi. E nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), dhe po ashtu, edhe kjo i sjell dobi.” (Muslim, Zuhd, 64.)



Prandaj, në vend që të justifikohemi, duke e orientuar zemrën dhe vullnetin tonë drejt së vërtetës dhe së mirës, duhet që si fillim, të gjallërojmë dhe ndërtojmë veten, e më pas, në këtë bazë, të vlerësojmë kohën dhe vendin ku jetojmë. Të zgjasësh dorën e ndihmës me një zemër të mbushur me mëshirë ndaj atyre që kërkojnë rrugën e drejtë, të dobëtëve, jetimëve dhe të vetmuarve, është një nga shërbimet më të rëndësishme që mund bëhet shkak i kënaqësisë së Allahut.

Lum si ata besimtarë që pajisen me dashurinë dhe entuziazmin e Profetit (a.s.) dhe të sahabëve të tij fisnikë, vendosin ëmbëlsinë dhe pasionin e besimit në zemra, shpirtin e Kuranit në kraharorë, entuziazmin e shërbimit në shpirtra dhe kthjelltësinë e moralit të bukur në ndërgjegjet e tyre, duke bërë një jetë brenda një kënaqësie shpirtërore të pashtershme të lumturisë së përjetshme...

Allahu i Madhëruar i gjallëroftë zemrat tona me frymëzimin që do të marrim prej historive nga jeta e sahabëve dhe i bëftë veprat tona që të meritojnë kënaqësinë e Tij!..

Amin!..



Reflektimet e moralit profetik tek sahabët

-2-



Sahabët e nderuar, në çdo kohë dhe vend ku arritën, u shfaqën popujve të privuar nga e drejta dhe vërteta, identitetin dinjitoz dhe origjinal të Islamit. Ata ishin besimtarë të sinqertë që i shihnin robërit e Allahut me mëshirë, i kishin zemrat të mbushura me dritën e mëshirës, butësisë, drejtësisë, modestisë, altruizmit, shpalljes hyjnore dhe dashurisë për shërbimin në rrugë të Allahut.

REFLEKTIMET E MORALIT PROFETIK TEK SAHABËT -2-

Sahabët fisnikë dhe njerëzit e devotshëm që pasojnë hapat e tyre dhe arrijnë burimin e miqësisë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.), do të mbeten përjetësisht miqtë e gjithë njerëzimit.

Përsosmëria dhe maja e besimit, është morali i bukur. Për rrjedhojë, në njëfarë aspekti, të gjitha gjendjet dhe veprat e Profetit tonë (a.s.), janë një sistem moral.

Zoti i botëve, e ka krijuar dhe edukuar Profetin (a.s.), në mënyrën më të bukur, si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Lidhur me këtë, vet i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “*Mua më edukoi Zoti im me një edukatë të bukur.*”⁵

Prandaj mund të themi se morali më i lartë që i është ofruar njerëzimit, është ai mbështetet në ligjet e Allahut dhe meriton kënaqësinë e Tij, gjë e cila i është shpallur gjithë njerëzimi me anë të jetës së Profetit tonë (a.s.).

Të marrim shembull Profetin tonë (a.s.) dhe të pajisemi me moralin e tij aq sa kemi mundësi, është nderi më i madh në të dyja botët; dhe për ta arritur këtë, është e domosdoshme ta njohim atë ashtu siç duhet.

Profeti ynë, Muhamedi (a.s.), është njeriu i vetëm në histori, të cilit i është studiuar çdo imtësi dhe detaj i gjithë jetës. Përveç Profetit tonë

5. Sujuti, Xhamiu's-Sagîr, I, 12.



(a.s.), prej jetëve të gjithë profetëve të tjerë, veprat dhe shembujt e të cilëve mund të shërbejnë për orientimin e njerëzimit drejt Zotit të Vërtetë dhe që janë të dobishme deri në ditët tona, kanë mbërritur vetëm disa rrëfime të caktuara. Kurse, veprat, fjalët dhe bota emocionale të cilën e ka shfaqur Profeti i fundit (a.s.), janë ndjekur pikë për pikë dhe janë shënuar si një tabelë nderi. Për më tepër, që të gjitha këto fjalë, vepra dhe detaje që kanë të bëjnë me Profetin tonë (a.s.), kanë rastin dhe nderin të mbarten deri në kiamet.

Detyra e përcjelljes së adhurimeve, veprave dhe sjelljeve të Profetit tonë (a.s.), tek brezat e ardhshëm, u takoi sahabëve besnikë dhe vetëmohues, sepse njeriu bëhet pjesë fatit të njeriut për të cilin ndjen dashuri. Për të shprehur sakrificën dhe pozitën e veçantë të sahabëve në këtë çështje, po japim si shembull gjendjen e Ebu Hurejres (r.a.), i cili është sahabi që ka transmetuar më shumë hadithe nga i Dërguari i Allahut (a.s.):

Ebu Hurejre (r.a.), u bë mysliman në vitin e shtatë Hixhri. Ai jetonte në një pjesë të Xhamisë së Profetit (a.s.), që quhej “sofa” dhe ishte një prej myslimanëve të varfër që quheshin **“As’hab-i Suffe”**. Ai nuk ndahej nga Profeti (a.s.), as natën, as ditën, dhe përherë mendohej të mësonte hadithet që dëgjonte prej tij. Së bashku me përsëritjet e tyre, ai ka transmetuar 5374 hadithe, të cilat i ka dëgjuar personalisht nga Profeti ynë (a.s.), tre vitet e fundi të jetës së tij (Profetit) dhe prej sahabëve të mëdhenj. Kështu, ai ka transmetuar më shumë hadithe se çdo sahab tjetër. 609 prej transmetimeve të tij, gjenden edhe në Sahihun e Buhariut, edhe në atë të Muslimit.

Atyre që i thoshin se ka transmetuar shumë hadithe, u është përgjigjur duke thënë:

“Vëllezërit tanë prej muhaxhirëve merreshin me tregti dhe shit-blerjet në treg, ndërsa vëllezërit tanë prej ensarëve merreshin me bujqësi dhe plantacionet e hurmave. Kurse unë mjaftohesha me mbushjen e barkut dhe nuk ndahesha prej Profetit (a.s.). Unë gjendesha pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), kur ata nuk ishin dhe mësoja përmendësh ato që ata nuk i mësonin.” (shih. Buhari, Ilm, 42.)



Ebu Hurejre (r.a.), i cili kishte marrë përsipër nderin e përcjelljes së fjalëve, veprave dhe gjendjeve të bekuara të Profetit tonë (a.s.), ia dorëzoi shpirtin Allahut në Medinë, në vitin 59 hixhri kur ishte në moshën 78 vjeçare. Prej këtij sahabiu të madh, kanë transmetuar hadithe më shumë se 800 sahabë dhe tabiinë.

Në sajë të begatisë së virtyteve dhe sakrificave të ngjashme të sahabëve, të gjitha gjendjet, fjalët dhe veprat e Profetit tonë (a.s.), janë përcjellë brez pas brezi dhe do të kenë mundësinë të arrijnë deri në kiamet. Ka pasur raste, kur sahabët dhe besimtarët e sinqertë e vetëmohues, kanë udhëtuar një muaj në kushtet e vështira të kohës, vetëm e vetëm për të marrë një hadith nga dikush. Ata kishin arritur në një nivel aq të lart moral në këtë fushë, saqë nuk e merrnin hadithin nga dikush që e gënjente edhe kafshën e vet duke e ndjellë me ushqim. Pra, ata e konsideronin të papranueshëm transmetimin e dikujt që nuk jetonte sipas sunnetit të Profetit (a.s.) dhe bartte zakone mashtrimi, qoftë edhe ndaj një kafshe.

Sahabët jetuan në një atmosferë të veçantë meditimi; dhe për shkak se në qendër të mendimit të tyre kishin vendosur “teuhidin”, ata bënë sakrifica të jashtëzakonshme për të arritur ëmbëlsinë e atij teuhidi.

Shteti i vogël Islam që u themelua në Medinë me rreth katërqind familje, brenda dhjetë viteve i zgjeroi kufijtë e vet deri në Irak dhe Palestinë. Në kohën kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut (a.s.), myslimanët luftonin me Bizantin dhe Persët, dhe plaçka e këtyre luftërave rridhte si lum në Medinë. Mirëpo, gjendja që kishin sahabët dhjetë vjet më parë, pra jeta modeste dhe entuziazmi për të dhuruar në rrugë të Allahut, nuk kishte ndryshuar aspak nga këto zhvillime. Nga frika se mos u cenohej ëmbëlsia e besimit, ata ruheshin nga përdorimi i pasurisë së kësaj bote për veten e tyre. Për këtë arsye, ata bënë një jetë në përputhje me kënaqësinë e Allahut.

Sahabët e nderuar, në çdo kohë dhe vend ku arritën, u shfaqën popujve të privuar nga e drejta dhe vërteta identitetin dinjitoz dhe origjinal të Islamit. Ata ishin besimtarë të sinqertë që i shihnin robërit e Allahut me mëshirë, i kishin zemrat të mbushura me dritën e më-



shirës, butësisë, drejtësisë, modestisë, altruizmit, shpalljes hyjnore dhe dashurisë për shërbimin në rrugë të Allahut.

I Dërguari i Allahut (a.s.), na ka lënë një trashëgimi shumë të veçantë në të gjitha fushat e jetës. Çdo njeri mund të gjejë sjellje në sunnetin profetik, të cilat mund t'i marrë si shembull për veten e tij. Pra, jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ngjan një buqete të veçantë trëndafilash, në të cilën gjenden të gjitha llojet e ngjyrave dhe aromave.

Jeta e Profetit tonë (a.s.), është si një pasqyrë e pastër dhe e kthjellët. Prandaj, është detyrë e çdo myslimani që, duke parë veten në këtë pasqyrë, të zbukurojë sjelljen e tij dhe të korrigjojë shtrembërimet e veta. I Dërguari i Allahut (a.s.), është pika kulmore në çështjen e kuptimit të Kuranit Fisnik në mënyrën më të përsosur. Ndërsa ata që e kanë kuptuar më mirë të Dërguarin e Allahut (a.s.), kanë qenë sahabët. Në një hadith fisnik, thuhet:

*“Sahabët e mi janë si yjet (në qiell). Cilindo të ndiqni, do të gjeni rrugën e drejtë.”*⁶

Kjo deklaratë e Profetit tonë (a.s.), tregon qartë se sahabët do të jenë shembull i mirë për të gjithë njerëzimin deri në ditën e kiametit. Bota e zemrës së sahabëve, e cila në kohën e injorancës i ngjante shkretëtirës, në sajë të edukimit profetik, u mbryjtën me mëshirë dhe begati shpirtërore. Kështu, shumë fara të virtytshme dhe me potencial të madh që më parë ishin të mbuluara, gjetën mundësinë për të çelur e gjelbëruar. Njerëzit me zemër të ngurtë, pashpirt dhe pandërgjegje që më parë i varrosnin për së gjalli edhe vajzat e tyre, tashmë ishin kthyer në njerëz altruistë, të mëshirshëm dhe të ndjeshëm. Zemrat e tyre ishin gjithmonë në gjendje falënderimi dhe përmendje të Allahut. Si rezultat i edukimit shpirtëror që morën nga Profeti (a.s.), ata kishin arritur një gjendje të tillë, që sipas Abdullah bin Mes'udit (r.a.), *“e dëgjonin edhe dhikrin e kafshatave që hanin”*⁷.

6. Ibni Abdi'l-Berr, Xhamiu Bejani'l-Ilm, II, 91.

7. Buhari, Menakib, 25.



Me këtë rast, po paraqesim disa prej shembujve të shumtë që tregojnë moralin e lartë të sahabëve të nderuar që ishin frymëzuar prej burimit profetik:

Kur po bëheshin përgatitjet për fushatën e Tebukut, shtatë sahabë të varfër që futeshin në kategorinë e të përjashtuarve nga lufta, iu drejtuan me lutje Profetit (r.a.), për t'u dhënë nga një kafshë me qëllim që të mund të merrnin pjesë në luftë. Por, kur morën përgjigjen se “*nuk kishte më deve*”, ata u kthyen duke qarë. Këta lot të derdhur në rrugën e Allahut, fituan pëlqimin hyjnor dhe Profetit (a.s.), iu zbrit ky ajet fisnik:

“(Nuk ka gjynah) **as për ata të cilët, kur vijnë te ti për të kërkuar kafshë shalimi e ti u thua: “Unë nuk mund t’ju siguroj kafshë shalimi”, kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë** (në rrugë të Allahut). (Teube, 92)

Pas kësaj, Osmani, Ibni Jamini dhe Abbasi (r.a.), u siguruan deve dhe ushqime të shtatë këtyre sahabëve të varfër.⁸ Më pas, edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), u siguroi kafshë një sërë nevojash disa prej sahabëve të tjerë.⁹



Në çlirimin e Mekës, Ebu Bekri (r.a.), solli te i Dërguari i Allahut (a.s.), babanë e tij të verbër për tu bërë mysliman. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e pa, i tha:

“*Përse e ke munduar dhe e ke sjellë këtu babanë tënd të mos-huar? Ne mund të shkonim te ai.*”

Mirëpo, Ebu Bekri (r.a.), tha:

“*E solla te Ti, që Allahu t’i japë sevape.*”

Kur babai i Ebu Bekrit (r.a.), Ebu Kuhafe, ia zgjati dorën Profetit (a.s.), për t’i dhënë besën, Ebu Bekri (r.a.), i cili e donte shumë Profetin

8. Ibn-i Hisham, Siretu'n-Nebi, Bejrut 1937, Daru'l-Fikr, IV, 172; Vakudi, Megazi, Bejrut 1989, III, 994.

9. Buhari, Megazi, 78.

(a.s.), nuk mundi ta mbajë veten dhe filloi të qajë. I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti me habi Ebu Bekrin (r.a.), se përse po qante. Prandaj, Ebu Bekri (r.a.), me lot në sy i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ah sikur kjo dorë që po të zgjatet për të të dhënë besën të mos ishte dora e babait tim, por të ishte dora e xhaxhait tënd Ebu Talibit, dhe Allahu Teala të të gëzonte Ty në vendin tim; kush e di sa do të gëzohesha, sepse Ti e doje shumë atë dhe dëshiroje shumë që ai të besonte...” (Hejthemi, VI, 174; Ibn Sa’d, V, 451.)

Edhe ne, si ummeti i Profetit tonë (a.s.), duhet të përpiqemi të gjelbërojmë në zemrat tona këto ndjenja të veçanta për të Dërguarin e Allahut (a.s.), sepse dorëzimi dhe mbështetja me kuptimin e plotë të fjalës, varet nga zemra e mbushur me ëmbëlsinë e besimit. Vetëm në sajë të kësaj dashurie zemrat mund të ngrihen në nivele të larta dhe njeriu mund t’i drejtohet me gjithë qenien e vet Allahut të madhëruar, duke qenë i pavarur nga asgjë në këtë botë. Ja një shembull i bukur lidhur me këtë çështje:

Ebu Said (r.a.), ishte nga sahabët që lidhnin gurë në bark për shkak të urisë që vuanin. Nëna e tij i tha:

“Ngrihu! Shko te i Dërguari i Allahut dhe kërko diçka nga Ai. Filani ka shkuar te i Dërguari i Allahut dhe ai e ka ndihmuar. Edhe filanin që ka shkuar, e ka ndihmuar po ashtu. Shko edhe ti, ndoshta kthehesh me ndonjë të mirë!”

Ebu Said (r.a.), i tha nënës:

“Prit pak, le të përpiqemi të kërkojmë diçka vet; nëse nuk gjejmë do të shkoj.”

Megjithatë, të gjitha kërkimet dhe mundi i shkuan kot. Për këtë arsye, duke mos pasur asnjë rrugëzgjidhje, vendosi të shkojë te Profeti (a.s.). Kur hyri tek ai, e gjeti duke mbajtur hutbe dhe filloi të dëgjojë. I Dërguari i Allahut (a.s.), në hutben e tij po thoshte:

“Atë që shfaq istigna¹⁰ dhe e ruan nderin e tij, Allahu do ta bëjë që të mos ketë nevojë për botën...”

10. Isigna: Të ndihesh i panevojshëm për askënd përveç Allahut.



Pasi dëgjoi këto fjalë, Ebu Saidi (r.a.), nuk guxoi t'i kërkonte gjë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe u kthye në shtëpi duarbosh. Vet ai e përshkruan kështu gjendjen e tij të mëvonshme:

“Kur u ktheva në shtëpi pa mundur t'i kërkoja diçka Profetit (a.s.), Allahu na dërgoi rrizkun tonë. Punët tona u rregulluan aq mirë, saqë asnjë prej ensarëve nuk ishte më i pasur se ne.” (Shih. Ahmed, III, 449.)

Ky është një shembull i mirë, që tregon se pastrimi i zemrës nga streset dhe lakmitë e kësaj bote, duke u mbështetur vetëm tek Allahu, i hap rrugën kënaqësisë dhe mirësive hyjnore.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme që t'ia gëzojmë zemrën edhe atyre që i shfaqin nevojat e tyre. Lidhur me këtë, tregohet një ndodhi e tillë nga jeta e bashkëshortes së Profetit tonë (a.s.), Aishes (r.a.):

Një ditë, kur bashkëshortja e Profetit tonë (a.s.), Aishe (r.a.), ishte agjërueshëm, i erdhi një i varfër dhe i kërkoj diçka për të ngrënë. Në shtëpinë e Aishes (r.a.), nuk kishte gjë tjetër përveç një buke. Megjithatë, ajo i tha shërbyeses:

- Jepja bukën atij!

- Në mbrëmje do të çelim iftarin dhe nuk ka asgjë tjetër përveç kësaj buke! – Tha shërbyesja.

- Ti jepja bukën atij! – Këmbënguli Aisha (r.a.).

Shërbyesja e tregon kështu vazhdimin e ngjarjes:

Unë veprova siç më urdhëroi Aisha (r.a.) dhe ia dhashë bukën atij të varfëri. Kur erdhi mbrëmja dikush na dërgoi një copë mish deleje të pjekur. Atëherë, Aisha (r.a.), më thirri e më tha:

“Urdhëro, kjo është më e shijshme së buka jote!” (Muvatta, Sadaka, 5.)

Ndërsa shembulli i mëposhtëm na tregon delikatesën me të cilën duhet të jepet sadakaja dhe në të njëjtën kohë na kujton se sadakaja nuk është mirësi vetëm për atë që e merr, por edhe për atë që e jep.

Një lypës iu afrua Abdullah ibn Abbasit (r.a.) dhe i kërkoj diçka. Abdullahu (r.a.), e pyeti:

- A dëshmon se përveç Allahut s'ka Zot tjetër dhe se Muhamedi (a.s.), është i Dërguari i Tij?

- Po! – Tha lypësi.

- A e agjëron Ramazanin? – E pyeti përsëri Abdullahu (r.a.).

- Po! – Tha përsëri lypësi.

Pas kësaj, Abdullahu (r.a.), i tha:

“Ti kërkove diçka dhe ai që kërkon ka të drejta. Prandaj ne e kemi për borxh të të ndihmojmë.” Më pas i dha lypësit një rrobë dhe i tha këtë hadith:

“Nëse një mysliman i vesh një rrobë një myslimani tjetër, ai (dhënësi) do të jetë nën mbrojtjen e Allahut, derisa në trupin e vëllait të tij të ketë qoftë edhe një copë prej rrobës që i ka dhënë.” (Tirmidhi, Kiamet, 41/2448.)

Ndihma që bëhet ndaj një nevojtori, duke pasur për qëllim kënaqësinë e Allahut, siç shihet edhe në shembujt e mësipërm, është si një borxh që i jepet Allahut, i Cili ia shpërblen shumëfish atë të mirë me anë të një robi tjetër dhe e merr personalisht nën mbrojtjen e Vet. Ky është shpërblimi që Allahu i jep në këtë botë; ndërsa në botën tjetër, askush nuk e di shpërblimin e kësaj mirësie!..

Nga ky këndvështrim duhet të vlerësohen edhe të këqijat e bëra. Pra, edhe një padrejtësi e bërë ndaj një robi të Allahut, -në përgjithësi- pas njëfarë kohe i kthehet me të njëjtën monedhë atij që ka bërë padrejtësi nga një rob tjetër i Allahut. Shkurtimisht, edhe të mirat, edhe të këqijat janë si fara që mbillen në arën e kësaj bote dhe, krahas prodhimit të sigurt që të do merret në botën tjetër, ato japin frytet e veta edhe në këtë botë.



Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Kështu, Ne ju kemi bërë një popull mesatar (shembullor), që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju...” (Bekare, 143.)



Allahu i Madhëruar, e ka udhëzuar umetin Islam nën hijen e Profetit (a.s.), për të qenë të drejtë, të moralshëm, të ditur, të kulturuar, prijës dhe sundues të drejtë mes të gjithë njerëzimit.

Pra ne, që jemi ummeti i Muhamedit (a.s.), duhet t'i vlerësojmë sa më mirë ditët tona, me anë të adhurimeve, sjelljeve dhe jetesës sonë, me qëllim që nesër në ditën e gjykimit, të meritojmë dëshminë e bukur të Profetit tonë (a.s.). Lidhur me këtë çështje, udhëzuesit tanë më të mirë, duhet të jenë sahabët fisnikë, të cilët janë si një pasqyrë e kthjellët që pasqyrojnë në mënyrën më të mirë moralin profetik, sepse ata jetonin vazhdimisht me entuziazmin për të qenë dëshmitarët e Allahut në tokë dhe për të merituar dëshminë e mirë të Profetit (a.s.), në ditën e gjykimit.

Këta nxënës të zgjedhur të Profetit (a.s.), e gjenin përgjigjen e të gjitha pyetjeve tek i Dërguari i Allahut (a.s.), dhe në sajë të botëkuptimit që kishin përfituar nga ai, nuk shqetësoheshin tepër nga vështirësitë e jetës në këtë botë kalimtare. Kudo që shkonin, ata e bartnin me vete këtë botëkuptim profetik. Po ashtu, ata e mësonin, e lexonin, e ndjenin, e vendosnin në zemra dhe punonin seriozisht edhe me Kuranin Fisnik, që ishte edhe morali i të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Po ashtu, ata kishin fituar një shpirt aq fisnik, saqë e ndjenin veten përgjegjës për të gjitha problemet në shoqëri. Ata nuk u lodhën as nga udhëtimet e vështira në zona të largëta si Kina, Semerkandi dhe Stambolli, sepse në kraharorët e tyre, bartnin dritën e shpalljes hyjnore, e cila ua bënte të ëmbla të gjitha vështirësitë në rrugën e Allahut.

Gjatë gjithë jetës së tyre në rrugën e predikimit të fesë, sahabët janë përballur me ofendime dhe sulme të njerëzve të ndryshëm. Megjithatë, ata nuk u tërhoqën asnjëherë nga rruga e Allahut, sepse kishin arritur kënaqësinë e vërtetë të miqësisë dhe dashurisë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.). Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i ka bërë ata të jetojnë në zemrat e besimtarëve si miqtë e Profetit (a.s.).

Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!..

Allahu i Madhëruar na i ndriçoftë zemrat me dashurinë për



Profetin (a.s.), sahabët e tij dhe njerëzit e devotshëm që përpiqen të ndjekin gjurmët e tyre deri në kiamet! Allahu na bëftë bamiirës të singertë që frymëzohen prej shembujve të jashtëzakonshëm të muhaxhirëve dhe ensarëve, dhe na ringjalltë bashkë me ta në botën tjetër!..

Amin!..



*Entuziazmi i besimit
të sahabëve në hapat
e të Dërguarit të Allahut
- salallahu alejhi ve sel-lem -*



Kur në qendrën e miqësisë, në zemrat e tyre, zuri vend Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), një shoqëri gjysmë e egër, filloi të nxirrte personalitete monumentale që arritën majat e humanizmit, mëshirës dhe virtyteve të larta. Vëllazëria fetare ishte si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Luksi, shpërdorimi, grykësia dhe koprracia, ishte një stil jete që shoqëria e sahabëve nuk e njihnin, sepse ata nuk e harruan kurrë përkohshmërinë e tyre dhe jetuan me idenë se, “nësër, bujtina e egos do të jetë varri”.

ENTUZIAZMI I BESIMIT TË SAHABËVE NË HAPAT E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (A.S.).

Të njohësh më nga afër dritën e Islamit, bukuritë e pashoqe dhe në mënyrë të veçantë delikatesën e tij, është e mundur vetëm nëse hyhet në atmosferën shpirtërore të Epokës së Lumturisë, që është edhe periudha kur u zbrit Kurani Fisnik si udhëzim për njerizimin dhe kur jetoi Profeti i Zotit (a.s.), që u dërgua si mëshirë për botët. Po ashtu, në këtë periudhë, u edukua edhe brezi njerëzor që arriti kulmin në moral, mëshirë, virtyte dhe pjekuri shpirtërore dhe të cilët e përcollën dritën e shpalljes në vendet më të largëta dhe periudhat pasardhëse.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Njerëzit më të mirë, janë ata që kanë jetuar në kohën time.”

(Buhari, Ashabu'n-Nebi, 1.)

Nga ky aspekt, Epoka e Lumturisë është një periudhë e pashoqe, të cilën besimtarët e konsiderojnë kohën më ideale dhe për të cilën ndejnë mall dhe respekt.

Sahabët, të cilët u edukuan nga dora profetike, arritën një botëkuptim dhe orientim të ri, të drejtë dhe të pastër në lidhje me njeriun, egon, gjithësinë dhe Vet Allahun e Madhëruar. Predikimi i fesë, ndershmëria, besueshmëria, siguria, drejtësia dhe sakrifica e jetës dhe pasurisë, u



bën pjesë e natyrës së tyre. Në këtë mënyrë, ata arritën pikën më të lartë të moralit dhe personalitetit njerëzor.

Cilësia dalluese dhe mbizotëruese tek sahabët, ishte përpjekja për t'i dhënë formë jetës me besim, pasion dhe entuziazëm të madh. Në themel të këtij entuziazmi të besimit, qëndronte frymëzimi shpirtëror që kishin marrë prej të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Bota shpirtërore e sahabëve, që deri atëherë kishte mbetur larg besimit, të vërtetës dhe moralit të lartë, u brumos më pas me frytet e mëshirës dhe të begatisë shpirtërore të rrethit të ngushtë të Profetit (a.s.). Bota shpirtërore që u pasqyrua nga shpirti i të Dërguarit të Allahut (a.s.), në zemrat e umetit të tij, nxori në pah personalitete të larta që do bëheshin udhërrëfyes për njerëzimin deri në ditën e gjykimit. Një njeri i edukuar në errësirat e injorancës, i pashpirt e zemërgur, aq sa arrin të varrosë për së gjalli edhe vajzën e tij, një njeri i rëndomtë që s'nejh drejtësi, u bë një besimtar i ndjeshëm, sakrifikues, i kujdesshëm dhe i urtë.

Kështu, Omeri (r.a.), që para Islamit ishte njeri i egër e i pashpirt, pasi pranoi Islamin, u kthye në një njeri me zemër të mbushur me dashuri dhe butësi, aq sa nuk mund të shkelte as milingonat në tokë. Një Omer i tillë, që e konsideronte veten përgjegjës edhe për kafshët që mbyteshin në lum; një Omer që shëtiste natën me thes miell në shpinë, duke vizituar nevojtarët.

Një shembull tjetër, është edhe Abdullah ibn Mes'udi (r.a.), i cili në të shkuarën kishte qenë "bari devesh". Kur ai u bë mysliman dhe u edukua në shkollën e Profetit (a.s.), zemra e tij u mbush me dashuri për Allahun dhe Profetin (a.s.), u thellua në meditim dhe dije. Madje, siç shprehet vet ai, *"Profeti (a.s.), ndikoi aq shumë tek ne, saqë arritëm të dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave të bukës që kalonin në fytyrën tonë"*. (Buhari, Menakib, 25.)

Një nga veprat më kolosale të këtij sahabiu të madh, ishte edhe Shkolla e Kufes, ku u edukua edhe një nga juristët më të mëdhenj Islam, Ebu Hanife -Allahu e mëshiroftë-.



Në sajë të edukimit profetik, nga njerëzit që dikur nuk ishin askush, dolën në pah njerëz që i dhanë drejtim botës. Pra, nga të vdekurit dolën të gjallët, nga qymyri dolën diamantet. Në sytë e tyre u bë e dukshme me gjithë qartësinë e vet, bukuria e së vërtetës dhe të mirës dhe shëmtia e së kotës dhe së keqes. Të njëjtën frymë, ata ua përcollën edhe brezave pasardhës.

Ashtu siç reflekton dielli gjigand në një pasqyrë, ashtu edhe në zemrat e sahabëve gjendeshe shkëlqimi i së vërtetës dhe urtësisë së Profetit (a.s.). I dërguari i Allahut (a.s.), preferoi të jetonte me modesti dhe i përmbajtur nga kjo botë. Në të njëjtën mënyrë, luksi, shpërdorimi, grykësia dhe koprracia, ishte një stil jete që shoqëria e sahabëve nuk e njihnin, sepse ata nuk e harruan kurrë përkohshmërinë e tyre dhe jetuan me idenë se, “nesër, bujtina e egos do të jetë varri”. Ata që dje ishin njerëz të egër dhe nomadë, arritën majat e virtyteve dhe u bënë si melekë, të butë dhe mëshirshëm. Duke vendosur në zemrat e tyre dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.), edhe pse nuk dinin shkrim e këndim, ata morën dijen më të rëndësishme, pra, “njohjen e Allahut”. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Thuaj: «A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!» (Zumer, 9.)

Kështu, sahabët fisnikë u bënë një shoqëri që përbëhej nga njerëz që “e njihnin të vërtetën dhe urtësinë”, që përmendet në ajetin e mësipërm. Ndërkohë që në mendjet njerëzore Allahu konsiderohej aq larg sa nuk mund të imagjinohej, në zemrat e tyre zuri vend botëkuptimi se Allahu është më afër njeriut se vetja e tij dhe se Ai e vëzhgon atë në çdo çast.

Njerëzimi njohu delikatesën, mirësjelljen dhe moralin e bukur. Zemrat e tyre ishin të mbushura me shqetësime si, **“çfarë kërkon Allahu prej nesh, si mund ta arrijmë kënaqësinë e Tij, po Profeti (a.s.), çfarë pret prej nesh, si mund ta gëzojmë atë, etj.?”**. Për këtë arsye, edhe kërkesës më të vogël të Profetit (a.s.), ata i përgjigjeshin me shprehjet, **“të qofshin falë nëna, babai, jeta dhe pasuri ime o i Dërguari i Allahut!”**.

Kur në qendrën e miqësisë, në zemrat e tyre, zuri vend Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), një shoqëri gjysmë e egër, filloi të nxirrte personalitete monumentale që arritën majat e humanizmit, mëshirës dhe virtyteve të larta. Vëllazëria fetare ishte si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Po ashtu, ata shfaqën tablo të jashtëzakonshme bujarie dhe altruizmi, sepse sahabët ishin pajisur me moralin profetik:

Kur Profetit (a.s.), i dhurohej diçka për të ngrënë, ai nuk hante asnjëherë para se të ngopeshin sahabët nevojtarë, dhe thoshte se: *“Nuk është besimtar ai që fle i ngopur ndërkohë që fqinji i tij është i uritur!”* (Hakim, II, 15.)

Po ashtu, kur familja e Profetit (a.s.), bënte ndonjë kurban, ia ndante menjëherë mishin të varfërve. Njëherë, i Dërguari i Allahut (a.s.), pyeti:

- Çfarë ka ngelur prej kurbanit?

- Ka ngelur vetëm kocka e shpatullës! – I thanë. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Atëherë, përveç asaj kocke shpatulle, gjithçka na paska mbetur neve!” (Tirmidhi, Kiamet, 33/2470.)

Po kështu edhe sahabët e nderuar, të cilët u pajisën me të njëjtin moral të Profetit (a.s.), e kuptuan se pasuria e vërtetë që mund të zotëronin, ishte ajo që do ta dërgonin në botën tjetër sa ishin gjallë, duke bërë bamirësi dhe sakrifica në rrugën e Allahut.

Një kokë deleje që iu dhurua një sahabi të varfër, kaloi dorë më dorë, nga fqinji tek fqinji, sepse kushdo që e merrte, thoshte; *“fqinji imi duhet të ketë më tepër nevojë se unë”*. Më në fund, ajo arriti përsëri tek sahabi të cilit iu dhurua të parit. E në fakt, ai ishte edhe më nevojtar nga të gjithë. (shih. Hakim, II, 526.)

Tre sahabë që kishin marrë plagë vdekjeprurëse në betejën e Jermukut, gjendeshin të shtrirë mbi rërën e nxehtë në fushëbetejë duke pritur vdekjen. Kur u sollën ujë për të shuar sadopak etjen, ata thoshin, *“vëllai im besimtar që po rënkton ka më tepër nevojë për këtë ujë!”*. Kështu, këta tre sahabë vetëmohues, duke e dërguar ujin tek njëri-tjetri,



ia dorëzuan shpirtin Allahut me buzë të plasura nga etja. Ndërsa ena me ujë mbeti ashtu e mbushur plot mes këtyre tre dëshmorëve. (Shih. Hakim, III, 270.)

Më pas, Hudhejfe (r.a.), sahabiu që u përpoq t'u shuante etjen këtyre tre sahabëve të nderuar, e shpreh kështu gjendjen e tij shpirtërore në ato momente:

“Në jetën time kam parë shumë ngjarje, por asnjëra nuk më ka bërë të prekem dhe të emocionohem kaq shumë. Altruizmi, sakrifica dhe dhembshuria që treguan ata ndaj njëri-tjetrit ndërkohë që nuk kishin asnjë lidhje fafeshnore mes tyre, lanë gjurmë të thella në kujtesën time si një heroizëm i madh në besim, të cilin e admirova shumë...”



Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Thuaju (o Muhamed): «Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.»” (Al-i Imran, 31.)

E në fakt, ata që e ndoqën dhe iu bindën në mënyrën më të përpiktë të Dërguarit të Allahut (a.s.), padyshim që janë shokët e tij.

Abdullah ibn Omeri (r.a.), ka qenë një ndër sahabët që e ka dashur më shumë të Dërguarin e Allahut dhe i është bindur atij më gjithë zemër:

Pas vdekjes së Profetit (a.s.), Ibni Omeri (r.a.), mësoi vendet ku i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte falur namaz dhe, në shenjë të dashurisë që kishte për të, filloi të falej edhe vetë në ato vende. Përveç kësaj, ai ecte nëpër rrugët që kishte ecur Profeti (a.s.), qëndronte nën hijen e pemëve ku kishte qëndruar ai dhe i vadiste ato që të mos thaheshin. Madje, ai tregojë shumë rigoroz edhe në lidhje me urdhrat që Profeti (r.a.), ka dhënë në çështjen e dhënies së selamit. Kur nuk kishte punë për të bërë, ai dilte në rrugë vetëm për t’u përshëndetur me myslimanët dhe u jepte selam çdokujt që takonte, të vegjël apo të mëdhenj qofshin.¹¹

11. Ibn-i Sa’d, IV, 156.



Kur Abdullahu (r.a.), vuri re se Profeti ynë (a.s.), shkonte çdo të shtunë në xhaminë e Kubas, hipur apo në këmbë, edhe ai vet veproi kështu deri në fund të jetës. (shih. Haxh, 521.)

Një ditë, për Ibn Omerin (r.a.), ishte prerë një dash. Me këtë rast, Ibn Omeri (r.a.), i tha familjes:

- A i keni dhuruar ndonjë pjesë prej tij fqinjit tonë hebre?

- Jo! – Thanë ata. Atëherë Ibn Omeri (r.a.), tha:

- Këtej e tutje dërgojini edhe atij, sepse unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), të thotë:

“Xhebraili më këshillonte aq shumë në lidhje me sjelljen e mirë ndaj fqinjit, sa mendova se për pak sa nuk do të ma caktonte edhe si trashëgimtar.”¹²

Me pak fjalë, për çdo veprim që bënte dhe pyetej, “përse veprime ashtu?”, përgjigja e tij ishte po e njëjtë:

“Sepse e kam parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), të veprojë kështu!”¹³



Sahabët fisnikë, në qendër të mendimit dhe idealeve të tyre, kishin vendosur kënaqësinë e Allahut të Madhëruar dhe pëlqimin e Profetit (a.s.). Për rrjedhojë, jeta dhe pasuria e tyre ishin vetëm mjete për të arritur këto ideale:

Sahabët që ishin të rinj në moshë, me dashurinë dhe entuziazmin që u jepte besimi, garonin me njëri-tjetrin për të pasur nderin e bartjes së letrave të Profetit (a.s.), me të cilat ftonte në Islam sunduesit dhe prijësit e asaj kohe. Ata kërkonin të shërbenin me gjithë shpirt pa nxjerrë asnjë justifikim, vetëm e vetëm që të çonin në vend dëshirën e Profetit (a.s.). Kështu, ata kaluan male të thepisura dhe shkretëtira pa shfaqur

12. Ebu Daud, Edeb, 122-123/5152; Tirmidhi, Birr, 28/1943.

13. Buhari, Vudû 30; Haxh 16, 38, 149; Muslim, Haxh 25, 245, 521; El-faz 21; Tirmidhi, Haxh 39/864; Ebu Daud, Hatem 5/4227, 4228; Nesai, Haxh 174; Ibn-i Maxhe, Haxh 43; Muvatta, Haxh 31.



aspak lodhje e mërzi. Me një trimëri që ua jepte besimi, kaluan përmes xhelatëve dhe lexuan letrat e Profetit (r.a.), para mbretërve. Ata nuk ngurruan të jepnin edhe jetën për hir të kësaj detyre të bekuar.

Për të arritur ëmbëlsinë e vërtetë të besimit, ai brez i bekuar u thellua në dhembshuri dhe mëshirë, që janë edhe frytet më të mëdha të besimit. Për rrjedhojë, ensarët, të cilët i përqaftuan me vetëmohim muhaxhirët në kohët më të vështira, nuk ishin aspak të qetë derisa t'i rehatonin muhaxhirët që emigruan në Medinë duke lënë pas shtëpi e katandi. Madje, ata deklaruan edhe pasuritë e tyre me qëllim që t'i ndanin në mënyrë të barabartë me vëllezërit e tyre muhaxhirë. Ndërsa vet muhaxhirët, kishin zemra aq të pasura, saqë thoshin: "T'u begatoftë pasuria vëlla! Mjafton të më tregosh vetëm rrugën e tregut". (shih. Buhari, Buju, 1.)

Ai brez i bekuar, ia kushtoi jetën Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Ndërsa shërbimi në rrugë të Zotit, u bë kënaqësia dhe dëshira më e madhe e zemrës së tyre.

Në Epokën e Lumturisë, u edukua një brez besimtarësh që do të jetë shembull për të gjithë besimtarët e tjerë deri në ditën e kiametit. Si rezultat i kësaj u volën edhe frutat e begata të predikimit me vepra, po aq sa edhe frutat predikimit me fjalë.

Pas fitores së Hajberit, Profeti (a.s.), dërgoi atje Abdullah ibn Reuahan (r.a.), që të mblidhte taksat. Abdullahu (r.a.), llogariste me përpikëri të madhe sasinë e hurmave që duhej dhënë, dhe vilte taksën. Mirëpo, hebrenjtë që shfrytëzonin tokën e Hajberit, i shqetësoi kjo përpikëri e Abdullahut (r.a.), në llogaritjen e taksës. Prandaj, njëherë mblodhën disa stoli të grave dhe i thanë:

- Këto janë tuat! Por gjatë llogaritjes së taksës vepro në favorin tonë dhe mbylle njërin sy për ne!

- Për Allahun! Urrejtja që kam ndaj jush për shkak të shumë veprave tuaja të këqija, nuk më pengon të sillem me drejtësi ndaj jush! Por, kjo që po më ofroni është ryshfet, dhe ryshfeti është haram. Ne nuk e hamë atë!

Pas kësaj, hebrenjtë, të cilët e kuptuan se nuk mund ta bindnin dot Abdullahun (r.a.), filluan ta lavdëronin atë duke thënë:

“Ja, me këtë drejtësi qëndrojnë në këmbë dhe me rregull edhe qiejt e toka!” (Muvatta, Musakat, 2.)

Një shembull tjetër prej të mëdhenjve të tabiinëve, të cilët i kanë ndjekur me besnikëri hapat e sahabëve të Profetit (a.s.), është edhe ky:

Sipas një transmetimi, Ebu Hanifja i kishte dhënë borxh një zjarrputisti dhe shkoi në shtëpinë e tij për ta marrë. Tek dera e shtëpisë, iu ndy këmba me diçka të pistë. Kur u përpoq të shkundte këmbën, papastërtia ndoti murin e zjarrputistit. I hutuar, Ebu Hanifja tha me vete:

- Nëse e lë kështu, do bëhem shkaktar që muri i zjarrputistit të duket i shëmtuar. Por nëse mundohem ta pastroj, kam frikë se do të prishet suvaja e murit!

Ndërkohë, i ra derës, të cilën e hapi një shërbëtores.

- I thuaj pronarit tënde se Ebu Hanifja por pret tek dera! -Tha ai.

Pas kësaj, zjarrputisti doli tek dera dhe duke menduar se Ebu Hanifja do të kërkonte borxhin, filloi t'i kërkojë të falur.

- Kjo nuk është e rëndësishme tani! – Ia preu Ebu Hanifja, dhe i tregoi për murin.

- Si mund ta pastroj këtë mur? – Tha Ebu Hanifja.

Atë moment, zjarrputisti u prek aq shumë nga kjo ndershmëri me të cilën u përball, sa që tha:

“Unë po filloj më parë të pastroj veten time!”, dhe më pas pranoi Islamin. (shih. Razi, Tefsir-i Kebir, I, 192.)

Ky është një shembull i bukur që tregon se edhe sahabët arritën të edukonin breza me ndjenja të larta morale e fetare. Ata e kishin mësuar nga vet i Dërguari i Allahut (a.s.), se kur njeriu kalon nga jeta e përkohshme e kësaj bote në jetën tjetër të botës së përjetshme, pasuria më e dobishme që ka për të lënë pas, është një brez i miredukuar. Për këtë arsye, ata nuk mbetën e shkuar edhe pasi ikën nga kjo botë, por jetuan në zemrat e besimtarëve dhe gëzuan mirësinë që të përmendeshin përherë me dua.



Pas këtij brezi të ndritur, myslimanët arritën të përhapeshin kudo në sajë të entuziazmit të besimit. I tillë është edhe rasti i Tarik bin Zijadit, i cili me ushtrinë e tij prej vetëm 5 mijë trupash, arriti të mposhtë ushtrinë e Spanjës me 90 mijë trupa. Kur Tariku vuri këmbën mbi thesaret e mbretit, tha me vete:

“Tarik! Dje ishe një skllav me pranga; por, erdhi dita dhe Allahu të dha lirinë. Më pas u bërë komandant. Ndërsa sot, more Andaluzinë dhe tani gjendesh në pallatin e mbretit. Dije mirë dhe mos e harro kurrë se, nesër do të dalësh para Allahut!”

Çfarë edukimi duhet të jetë ky, që ndërton personalitetin e një skllavi dhe e ngre atë në majat e virtyteve!?. E më pas e bën atë të jetojë me ndjenjën e vetlllogarisë...

Sahabët fisnikë që u edukuan nën mbikëqyrjen shpirtërore të Profetit të Allahut (a.s.), ia kushtuan të gjitha energjitë përhapjes së fjalës së Allahut. Për ata, momentet më të kënaqshme dhe kuptimplotë të jetës, ishin ato kur u predikonin njerëzve mesazhin e teuhidit, sepse ata synonin të fitonin kënaqësinë hyjnore duke fituar mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Në Hutben e Lamtumirës, Profetin (a.s.), e kanë dëgjuar rreth 120 mijë sahabë. Nëse marrim parasysh se prej tyre vetëm 20 mijë janë varrosur në Mekë dhe Medinë, do të kuptojmë më mirë se çfarë entuziazmi besimi kanë pasur sahabët për të kryer detyrën e predikimit të fesë edhe në vendet më të largëta. Për rrjedhojë, sahabët që shkuan deri në Kinë, Stamboll, Afrikë dhe Kaukaz, kanë çuar udhëzimin dhe mëshirën, duke fituar kështu një pozitë të lartë në historinë Islame. Në këtë mënyrë, ftesën për udhëzim që filloi në Mekë, ata e përcollën në vendet dhe kohët më të largëta.

Përpjekjet e sinqerta të atyre njerëzve altruistë, i dhanë formë kohës dhe vendeve. Në sajë të entuziazmit të besimit, kufijtë e shtetit të vogël të Medinës, e cila në fillim ishte vetëm një km², pas dhjetë vitesh u zgjeruan deri në Palestinë e Irak.

Nëse sot, kur bota Islame ka arritur në një miliard e gjysmë mys-

limanë, përjetohen ende barbarizma si në kohën e injorancës, nëse numri i besimtarëve nuk shtohet me shpejtësi si në kohën e sahabëve, e mbi të gjitha, nëse ka humbje në aspektin e besimit, do thotë se nevoja jonë për pasionin dhe entuziazmin e sahabëve ka arritur në nivelet më të larta...

Kur ishte nevoja, sahabët kanë udhëtuar një muaj në kushtet e vështira të kohës, vetëm e vetëm për të marrë një hadith nga dikush. Ata nuk e merrnin hadithin nga dikush që e gënjente edhe kafshën e vet duke e ndjellë me ushqim, sepse e konsideronin si dobësi morale, që i ulte vlerën transmetuesit dhe vet transmetimit.

Duke u nisur nga përpjekjet dhe kujdesi i madh i sahabëve për të mësuar dhe predikuar fenë, duhet të pyesim veten se, sa arrijmë ne sot të shfaqim të njëjtin botëkuptim të Islamit!?. Sa arrijmë t'i falënderojmë ata për kryerjen me sukses të detyrës së përcjelljes së fesë tek brezat e mëpasshëm? Sa prej entuziazmit të besimit të tyre gjendet tek ne?.. A mundemi ta llogarisim mjaftueshëm gjendjen tonë në lidhje me këtë çështje?..

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë neve, robërve të Tij, të bëjmë një jetë në rrugën e drejtë duke marrë shembull jetën e Profetit (a.s.) dhe të shokëve të tij fisnikë, që janë si yjet në qiellin e Islamit!..

Amin!..



Paqja dhe ngushëllimi që të fal besimi



Allahu i Madhëruar e sprovon çdo rob të tij në mënyra të ndryshme. Ata që nuk arrijnë t'i deshifrojnë urtësitë dhe të fshehtat e këtyre sprovave dhe i ngrenë krye Allahut, në fund do të dështojnë. Kurse ata që strehohen tek Allahu me durim, dorëzim dhe mbështetje tek Ai, do të arrijnë shpërblime të mëdha. Suksesi në një çështje, është në përputhje me vështirësitë e kaluara për ta arritur atë.

PAQJA DHE NGUSHËLLIMI QË TË FAL BESIMI

Allahu i Madhëruar e ka sjellë njeriun në shkollën e kësaj bote për ta sprovuar dhe, ashtu siç i ka dhënë mundësi e mirësi, i ka dhënë edhe disa vështirësi. Por, sado të mëdha të jenë vështirësitë, një besimtar i vërtetë duhet të përpiqet t'i zgjidhë ato me durim, dorëzim dhe mbështetje tek Allahu, pa iu rebeluar Atij. Ai duhet të bëjë një jetë të devotshme në paqe dhe qetësi, duke iu dorëzuar dhe mbështetur vetëm Allahut.

Islami na urdhëron ta pranojmë jetën ashtu siç është, të durojmë ndaj fatkeqësive dhe të falënderojmë për mirësitë. Për shembull; si mund të ngushëllohet thjesht në aspektin logjik një person që ka lindur sakat ose në varfëri të thellë? Nëse ai lakmon vetëm mirësitë e kësaj bote, është e pamundur që të ngushëllohet. Por, nëse është një njeri që beson se kjo botë është e përkohshme dhe jeta pas vdekjes është e përjetshme, ai mendon se të gjitha vështirësitë e kësaj bote, do t'ia lehtësojnë përgjegjësitë në botën tjetër dhe për durimin ndaj tyre do të fitojë shpërblim. Kështu, atij do t'i mbushet zemra me paqe dhe qetësi, duke i kthyer vështirësitë e kësaj jete në mundësi fitimi. Kurse ata që nuk e kanë këtë pjekuri shpirtërore, nuk mund të shpëtojnë aspak nga problemet dhe vuajtjet.

Në të vërtetë, asgjë nuk duhet shikuar në mënyrë të prerë; ose fatkeqësi, ose mirësi. Ashtu si energjia elektrike, e cila në bazë të aparatit



që e përdor, mund të shërbejë ose për ngrohje, ose për ftohje, ashtu edhe mendja e njeriut; ndodhitë me të cilat përballlet, i kthen ose në mirësi, ose në fatkeqësi për veten. Një person që nuk e ka pastruar egon dhe zemrën e vet, vepron si një aparat i prishur dhe i kthen në fatkeqësi edhe mirësitë e Allahut. Kurse një njeri me zemër të pastër dhe moral të shëndoshë, në sajë të durimit, falënderimit, dorëzimit dhe mbështetjes tek Zoti, arrin t'i kthejë në mirësi edhe ato që duken si fatkeqësi.

Për shembull; kur një besimtar sëmuret ose e godet një fatkeqësi, ai bën durim dhe i dorëzohet Allahut duke thënë, “O Zot, kjo sprovë është prej Teje dhe unë jam i kënaqur prej Teje!”. Kështu, bazuar edhe në hadithet e Profetit (a.s.), ai person do të pastrohet nga gjynahet ashtu siç bien gjethet e pemës në vjeshtë. Por, nëse ai rebelohet dhe thotë, “pse më ranë mua këto fatkeqësi?”, padyshim se krahas vështirësisë që po vuan, do të përballlet edhe me një dënim shumë të madh për shkak të rebelimit.

Ja një ndodhi që e shpreh shumë bukur gjendjen e një besimtari i cili kënaqet me atë që i ka caktuar Allahu:

Ata Ibni Ebi Rebah (r.a.), ka thënë:

Abdullah Ibni Abbas (r.a.), më tha:

- A të tregoj një grua prej banorëve të Xhenetit?”

- Po, ma trego! -I thash unë. Ibn Abbasi (r.a.), tha:

- E sheh atë grua të zezë! Një ditë, ajo erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha:

- Mua më zë sëmundja e tokës dhe më zbulohet trupi. Lutuni Allahut që të shërohem! I Dërguari i Allahut (r.a.), tha:

- *Nëse mendon se mund të durosh, do të shpërblehesh me Xhenet. Por gjithësesi, nëse dëshiron, unë i lutem Allahut të të japë shërim!* Pas kësaj, gruaja tha:

- Unë do të duroj (sëmundjen). Por ju lutuni që kur të më zërë sëmundja, të mos më zbulohet trupi!



Më pas, i Dërguari i Allahut (a.s.), u lut për të. (Buhari, Merda, 6; Muslim, Birr, 54.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“E çuditshme është çështja e besimtarit, sepse çdo gjendje e tij është mirësi për të dhe kjo është e tillë vetëm për të. Nëse besimtarit i ndodh një gëzim, ai falënderon (Allahun) dhe kjo i sjell dobi. E nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), dhe po ashtu, edhe kjo i sjell dobi.” (Muslim, Zuhd, 64.)

Një person i cili vjen në këtë botë me një gjymtim trupor, mund të zotërojë shumë mundësi ngushëllimi vetëm në sajë të besimit të Allahut. Ai mendon se të mirat që ua favorizon Zoti robërve të Vet nuk realizohen si ndonjë detyrim i Tij ndaj robërve. Një besimtar i ditur dhe me pjekuri shpirtërore, gjen ngushëllim duke menduar për shpërblyemet që do të fitojë nga ato fatkeqësi që e kanë goditur. Po ashtu, për shkak se e di që caktimi i Allahut është i fshehtë, ai e qetëson shpirtin e tij duke ia lënë Allahut urtësinë e vuajtjeve dhe fatkeqësive dhe duke medituar mbi ajetin:

“...Ju mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju, e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini!” (Bekare, 216)

Pëlqimi apo mos mospëlqimi i diçkaje, është një ndjenjë që lind sipas kushtëzimeve. Për rrjedhojë, nisur nga këto ndjenja, nuk mund të përcaktohen e mira dhe e keqja, dobia dhe dëmi. E në fakt, nëse diçka është e mirë apo e keqe, mund të përcaktohet vetëm duke parë përfundimin e saj. Në një hadith fisnik thuhet:

“Vlera e vërtetë e punëve, matet në bazë të përfundimeve të tyre.” (Buhari, Kader, 5; Rikak, 33; Tirmidhi, Kader, 4.)

Mirëpo, dija e këtyre, i takon vetëm Allahut të Madhëruar, i Cili e di më së miri përfundimin e çdo gjëje.

Allahu i Madhëruar, i Cili ka krijuar dhe di çdo gjë, ka caktuar urdhra dhe ndalesa për njeriun dhe e sprovon atë në kohë dhe mënyra të ndryshme, me qëllim që ai të fitojë Xhenetin dhe mirësitë e

Tij në botën tjetër. Mirëpo shumë njerëz, për shkak të paditurisë dhe shkujdesjes, nuk arrijnë ta deshifrojnë urtësinë e ngjarjeve, gjë e cila i çon të mendojnë gjëra të gabuara. Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: «Zoti im më ka nderuar». Por, kur e sprovon atë, duke ia ngushtuar mjetet e jetesës, ai thotë: «Zoti im më ka poshtëruar.»” (Fexhr, 15-16.)

Njeriu që mposhtet nga egoja, e harron urtësinë e sprovës dhe ndjen kënaqësi e gëzim përballë mirësive të përkohshme të kësaj bote. Ai as që e sjell nëpër mend se për shkak të këtyre mund të pësojë fatkeqësi shpirtërore dhe se mirësia e vërtetë është në botën tjetër. Për rrjedhojë, pa i marrë fare parasysh përgjegjësitë, ai zhytet në kënaqësi e argëtime, në teprime dhe gjynahe, duke u treguar mosmirënjohës ndaj mirësive të Allahut.

Nëse Allahu do t’ia kishte ngushtuar rrizkun, ai do të mërzhitej, dhe pa menduar aspak mbi urtësinë e Allahut, do të thoshte: “Zoti im më nënçmoi!”. Mirëpo, ashtu si çdo gjë tjetër, edhe rrizku është shkak sprove për të cilin kërkohet falënderim. Mbase po t’i ishte shtuar rrizku, për të do të ishte fatkeqësi edhe më e madhe.

Allahu i Madhëruar na falur shumë mirësi për shumicën e të cilave as që nuk jemi të vetëdijshëm. Për t’i parë ato, duhet ta kthejmë shikimin tonë prej aspektit material, në atë shpirtëror. Për shembull, nëse një të sëmuri pashërim i thuhet; “do të shërohesh po të japësh gjithë pasurinë!”, ai do ta japë atë pa hezituat aspak, madje është gati të hyjë edhe në borxh. Po ashtu, edhe nëse një njeriu shumë lakmitar ndaj kësaj bote i thuhet; “na i jep të dy sytë, të të falim gjithë botën!”, ai do të refuzojë menjëherë. Por për fat të keq, shumica e njerëzve janë tepër indiferent ndaj mirësive të panumërta që u ka falur Allahu. Për shkak të kësaj indiference të thellë të robërve, Allahu i Madhëruar shprehet:

“...Megjithatë, pak nga robërit e Mi janë falënderues.” (Sebe,



Në përgjithësi, sprova e posedimit të mirësive, është më e rëndë se sprova e mungesës së tyre, sepse kontrolli i egos përball mirësive të shumta, është shumë më i vështirë. Në të njëjtën mënyrë, për shkak të forcës së kënaqësive të egos, edhe periudha e rinisë, është koha më e vështirë për t'u orientuar drejt së vërtetës dhe së mirës. Për rrjedhojë, udhëzimi dhe qëndrimi në rrugë të drejtë në moshë të re, ka një vlerë shumë të madhe tek Allahu.

Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na jep shembull Karunin, i cili pasi u mbyt në mirësi, i kaloi kufijtë dhe u rebelua:

“Kur ai dilte para popullit të vet me stolitë e tij, ata që lakmonin jetën e kësaj bote thanë: «Ah! Sikur të na ishte dhënë edhe neve si Karunit! Vërtet që ai është njeri me fat.» Ndërsa njerëzit e dijshtëm thoshin:

«Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është më i mirë për atë që beson dhe bën vepra të mira. Ai do t'u jepet vetëm të duruarve».

Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t'i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten. Të nesërmen, ata që më parë dëshironin të kishin qenë në vend të tij, thoshin:

«Është shumë e qartë se Allahu është Ai që i jep bollëk dhe ia pakëson kujt të dojë prej robërve të Tij. Sikur Allahu të mos kishte mëshirë për ne, me të vërtetë që do të na kishte bërë të na gëlltiste toka. Ububu! Është shumë e qartë se mohuesit nuk kanë shpëtim!»” (Kasas, 79-82.)

Ndër të tjera, nga këto ajete mund të kuptojmë edhe se:

Pasuria e kësaj bote që i jepet dikujt për t'u sprovuar, nuk tregon gradën dhe vlerën e tij tek Allahu. Lidhur me këtë, Profeti (a.s.), ka thënë:

“Nëse dynjaja do të kishte vlerë tek Allahun sa një krah i mushkonjës, Ai nuk do ta lejonte asnjë mohues të pinte qoftë edhe një gllënjë ujë.” (Tirmidhi, Zuhd, 13.)



Islami e ka deklaruar hapur vështirësinë në zbatimin e disa urdhrave dhe ndalesave. Por Allahu i Madhëruar ka fshehur urtësi të atilla brenda tyre, saqë vështirësitë e tyre mbeten të parëndësishme. Për shembull, vendimet e marra në Marrëveshjen e Paqes së Hudejbijes, në dukje ishin në disfavor të myslimanëve. Myslimanëve u dukej sikur po pranonin humbjen, ndërkohë që ishin më të fortë. Prandaj, sahabët nuk deshën ta pranonin këtë marrëveshje. Mirëpo, më vonë u kuptua se kjo marrëveshje, e cila në fillim u pandeh si humbje, në të vërtetë ishte një fitore e qartë...

Kështu, si rezultat i kësaj marrëveshjeje, myslimanëve iu hapën mundësi të reja për të predikuar Islamin dhe për t'u përhapur më shumë. Ata filluan të afroheshin me idhujtarët dhe t'u flisnin për Islamin. Ndërsa ata që e mbanin të fshehtë besimin e tyre, tashmë mund ta shpallnin hapur atë. Banorët e Mekës filluan të dëgjonin më shpesh për bëmat, mrekullitë, dhe moralin e lartë të Profetit tonë (a.s.). Si rezultat i kësaj, zemrat e tyre filluan të zbuteshin dhe të pranonin Islamin. Dy vjet pas marrëveshjes, numri i atyre që kishte pranuar Islamin, ishte shumëfish më tepër se numri i atyre që kishin pranuar Islamin për 19 vjet rresht. Kështu, ushtria islame, e cila doli në Hudejbije me 1400 veta, pas dy vitesh, hyri në Mekë me 10 mijë veta. E, sipas një versioni, bashkë me ata që iu bashkëngjitën rrugës, ishin 12 mijë. (Hejthem, VI, 170; Ibn-i Hisham, III, 372.)

Nëse besimtari i sheh me këtë sy të gjitha ngjarjet dhe ndjesitë përreth tij, do të shohë se gjykimi i tij sipërfaqësor lidhur me disa gjëra do të ndryshojë me kalimin e kohës, dhe ai do të marrë mësim prej kësaj. Historia e Musait (a.s.), me Hidrin, që Allahu i Madhëruar na e tregon në Kuran, është shembulli më i gjallë dhe më i qartë i kësaj të vërtete:

Në vend që t'i falënderonte marinarët e varfër që e morën në anijen e tyre, Hidri ua dëmtoi anijen, veprim ky, i cili në dukje ishte kryekëput një mosmirënjohje e vërtetë. Por pas njëfarë kohe, doli që ky veprim kishte një qëllim të mirë, i cili dha edhe rezultatet e veta kur një mbret pirat konfiskonte të gjitha anijet në gjendje të mirë. Kështu, në sajë të



dijes së Hidrit, anija e të varfërve shpëtoi nga piratët, sepse dukej e pavlefshme për ta. Më pas, pronarët e anijes e riparuan dëmin e vogël që u shkaktoi Hidri dhe vazhduan të siguronin jetesën me atë anije.

Gjatë udhëtimit, Hidrin me Musain (a.s.), takuan një djalë të vogël, të cilin Hidri e vrau sapo e pa. Atë moment, Musai (a.s.), u shokua dhe tha:

“Përse vrave një njeri të pafajshëm që nuk ka vrarë askënd?! Vërtet që ke bërë një punë të tmerrshme!” (Kehf, 74.)

Më vonë, Hidri i shpjegoi Musait (a.s.), urtësinë e atyre që kishte parë:

“Prindërit e tij ishin besimtarë. Ne e dinim se (dashuria për të) do t’i çonte ata në të keqe dhe mohim.” (Kehf, 80.)

Hidri donte t’i tregonte Musait (a.s.), se diçka që në aspektin e jashtëm mund të dukej si gjë e keq, në të vërtetë mund të ishte edhe diçka e mirë. Pra, ai fëmijë, kur të rritej do të bëhej njeri i keq, ndërkohë që prindërit e tij ishin njerëz të mirë e të devotshëm. E, si rezultat i dashurisë që kishin prindërit për të, ai do të bëhej shkak që prindërit të shndërroheshin në njerëz të këqij e t’i ngrinin krye Allahut. Prandaj, Allahu dëshiroi që në vend të tij, t’u falte një fëmijë tjetër më të pastër dhe më të mëshirshëm.

Një ngushëllim tjetër në lidhje me këtë çështje, na e ka dhënë edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), i cili i ka përgëzuar me Xhenet prindërit që e humbasin fëmijën në moshë të vogël:

Gjatë një ligjërate që po iu mbante grave, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Cilësdo prej ju grave që i vdesin tre fëmijë (që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë), ata (fëmijë) do të jenë mburojë për ju ndaj Xhehenemit.”

Një nga gratë pyeti:

- A vlen kjo edhe për ato që i vdesin dy fëmijë?

- *Po! Edhe për dy fëmijë është e njëjta gjë.* -Tha i Dërguari i Allahut (a.s.). (Buhari, Ilm, 36; Muslim, Birr, 152.)

Një tjetër hadith lidhur me këtë çështje është edhe ky:

I Dërguari i Allahut (a.s.), e tregon kështu shpërblimin e një besimtari që është i kënaqur me gjendjen e tij:

“Kur një robi i vdes fëmija, Allahu u thotë melekëve:

- A ia morët shpirtin fëmijës së robit Tim! Melekët thonë:

- Po o Zoti ynë!

Allahu Teala u thotë:

- A e këputët frutin e zemrës së tij? Melekët thonë:

- Po o Zoti ynë!

Allahu Teala u thotë:

- Mirë, por çfarë tha robi Im?

Melekët thonë:

- Ai të falënderoi Ty dhe u strehua vetëm te Ti duke thënë:

“...Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi.” (Bekare, 156.)

Pas kësaj Allahu Teala thotë:

- Ndërttoni një shtëpi në Xhenet për robin Tim dhe vërbani emrin, “Bejtu’l-Hamd: Shtëpia e falënderimit.” (Tirmidhi, Xhenaiz, 36/1021)

Ndërkohë që për dikë i cili nuk beson në botën tjetër, nuk ka mundësi ngushëllimi, për një besimtar të mirë, këto mundësi janë të shumta. Për shembull, një person që kishte humbur shikimin, qetësohet pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), e përgëzon me këto fjalë:

“Allahu i Madhëruar urdhëron: «Nëse robi Im bën durim kur e sprovoj duke ia verbuar të dy sytë, Unë do t’i jap Xhenetin në këmbim të syve.»” (Buhari, Merda, 7.)

Ndërsa atyre që e ndjenin veten të varfër apo të mangët në aspektin fizik, Profeti (a.s.), u ka thënë:

“Kur dikush prej jush ta shohë veten lart nga aspekti i pasurisë dhe i krijimit, le ta kthejë shikimin e tij te ai që është poshtë tij.”

(Buhari, Rikak, 30.)



“Shikoni ata që i kanë kushtet e jetës më të ulëta se tuajat dhe jo ata që i kanë më lart se tuajat! Kjo është një sjellje më e përshatshme për ju, me qëllim që të mos i nënçmoni mirësitë që ju ka dhënë Allahu.” (Muslim, Zuhd, 9.)

Po ashtu, Islami është një burim ngushëllimi i paçmueshëm në sajë të përgëzimit që u jep besimtarëve për faljen e gjynaheve ose ngritjen e gradave shpirtërore nëse ata i presin me durim vuajtjet dhe fatkeqësitë. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Allahu ia shlyen gjynahet besimtarit me çfarëdo që e godet atë, qoftë lodhje, sëmundje e vazhdueshme, brengë, hidhërim, vështirësi dhe fatkeqësi. Madje, edhe kur një gjemb hyn në këmbën e tij.” (Buhari, Merda, 1; Muslim, Birr, 49.)

“Besimtarit dhe besimtares nuk i ndalen problemet në veten e tyre, në fëmijë dhe në pasuri, derisa të takohen me Allahun pa asnjë gjynah.” (Tirmidhi, Zuhd, 57.)

“Nëse besimtarit i bie një sëmundje dhe më pas Allahu i jep shërim, kjo sëmundje është për të larje gjynahesh dhe një këshillë për pjesën tjetër të jetës së tij. Por nëse sëmuret një hipokrit, e më pas i jepet shërim, ai i ngjan një deveje e cila lidhet njëherë nga i zoti i saj, e më pas lirohet, ndërkohë që ajo nuk e di as përse është lidhur dhe as përse është liruar.” (Ebu Daud, Xhenaiz, 1/3089.)

Mirëpo, në një pikë duhet bërë shumë kujdes, sepse janë disa fjalë që mund të thuhet lehtësisht, por që është e vështirë t'i realizosh në jetë. Për shembull, disa njerëz mund të pretendojnë se mund t'i durojnë të gjitha sprovat dhe vuajtjet që u jep Allahu, gjë e cila i fut ata në sfidë përballë Allahut. Mirëpo, nëse Allahu i sprovon ata me të vërtetë për të vërtetuar sinqeritetin e tyre, është e mundur që shumica prej tyre nuk do të dalin me sukses. Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na jep shembull sprovën e besimit të magjistarëve të Faraonit, të cilët pranuan fjalët e Musait (a.s.):

“(Faraoni) tha: «Çfarë?! Ju e besuat atë, para se t’ju jap leje unë?! Në të vërtetë, ai është mjeshtri juaj, që ju ka mësuar magjitë.

Unë do t’jua këpus duart dhe këmbët tuaja të këmbëra dhe do t’ju var në trungjet e hurmave. Ju do ta merrni vesh, me siguri, se cili prej nesh është më i ashpër dhe më ngulmues në ndëshkim.»

(TaHa, 71.)

Mirëpo ata, duke bërë krahasimin e jetës së përkohshme me atë të jetës së përjetshme thanë:

“...Ne kurrë nuk do të të japim ty përparësi ndaj provave që na kanë ardhur neve dhe ndaj Atij që na ka krijuar ne. Prandaj, gjyko si të duash; ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote!” (TaHa, 72.)

Kur Faraoni filloi të zbatonte dënimin, magjistarët iu lutën Allahut që t’ua ruante besimin:

“...O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!” (A’raf, 126.)

Shpërblimi që u ka premtuar Allahu atyre që vdesin me besim, është ngushëllimi më i mirë për ta. Ata e përballuan me durimi fatkeqësinë që i goditi dhe e kthyen atë në një kapital të botës tjetër.

Nga ana tjetër, një person të cilin e godasin fatkeqësitë, mund të gjejë ngushëllim edhe duke lexuar historitë për vuajtjet e profetëve, të cilat na bëhen të ditura në Kuran. Krahas këtyre, duhet menduar se, vuajtjet dhe vështirësitë më të mëdha i ka kaluar vet Profeti ynë (a.s.), i cili është shembull për gjithë umetin. Abdullah Ibn Mes’udi (r.a.), tregon:

Shkova tek i Dërguari i Allahut (r.a.), të cilin e kishin kapur ethet dhe i thashë:

- O i Dërguari i Allahut! Vërtetë ju ka kapur një krizë e fortë e etheve.

- *Po, unë jam duke vuajtur aq sa mund të durojnë dy veta prej jush.* - Tha Profeti (a.s.).

- Patjetër që kjo është me qëllim që të fitoni dyfish shpërblim. -Thashë unë.

“Po, ashtu është! Allahu ia fal gjynahet myslimanit për shkak të një gjembi që i ngulet në këmbë, ose për shkak të ndonjë vësh-



tirësie më të madhe që e godet dhe, gjynahet e atij myslimani bien si gjethet e një peme.” (Buhari, Merda, 3, 13, 16; Muslim, Birr, 45.)

Nisur nga këto, kuptohet se sprovat më të mëdha godasin ata të cilët janë më afër Allahut. Këtë e vërteton edhe ky transmetim i Ebu Saidit (r.a.):

E pyeta të Dërguarin e Allahut (a.s.):

- O i Dërguari i Allahut! Kush janë njerëzit që goditen më shumë nga fatkeqësitë?

- *Profetët!* – Më tha ai.

- Pastaj kush? – E pyeta unë.

- *Pastaj njerëzit e mirë!* – Tha ai... (shih. Ibn Maxhe, Fiten, 23.)

Urtësia në faktin se fatkeqësitë godasin më tepër profetët, e më pas besimtarët e mirë sipas gradave, shpjegohet në këtë mënyrë:

Për shkak se detyrat e njerëzve me nivel të lart shpirtëror janë më të rënda, është e domosdoshme që ata të pajisen me rezistencë me qëllim që t'i kryejnë sa më mirë ato detyra. Vështirësitë dhe vuajtjet e bëjnë më të pjekur njeriun. Pra, ndërkohë që njerëzit durimtarë bëhen më të pjekur në sajë të fatkeqësive, ata fitojnë edhe gradë më të larta shpirtërore.

Sa shembull i shkëlqyer është kjo ngjarje e transmetuar nga Fedale bin Ubejd (r.a.) dhe që shpalos durimin e madh ndaj varfërisë dhe vuajtjeve që treguan sahabët fisnikë, të cilët ishin nxënësit e veçantë të të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), po u falte namazin sahabëve, për shkak të pafuqisë që u shkaktonte uria, disa prej tyre nuk mund të mbaheshin në këmbë dhe u binte të fikët. Këta ishin sahabët e Suffes. Beduinët që vinin nga shkretëtira, thoshin: «Këta janë të çmendur!»

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), mbaronte namazin, shkonte te ata që u kishte rënë të fikët nga uria dhe i ngushëllonte duke i thënë:

«Sikur ta dini se çfarë ka përgatitur Allahu Teala për ju, do të donit të ishit edhe më të varfër e më nevojtarë.» (Tirmidhi, Zuhd,

Me pak fjalë, Allahu i Madhëruar i sprovon robërit e Vet në forma të ndryshme. Lidhur me këtë fakt, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit!” (Bekare, 155.)

Megjithatë, Zoti ynë i Madhëruar nuk i lë pandihmë robërit e Vet që i sprovon dhe i ngushëllon me këto fjalë:

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.” (Bekare, 153.)

Kështu, kur Profeti ynë (a.s.) dhe profetët e tjerë hasnin në vështirësi, i kërkonin ndihmë dhe durim Allahut dhe falnin menjëherë namaz. (shih. Ebu Daud, Tatavvu, 22; Xhihad, 162; Ahmed, IV, 333.) Në të njëjtën mënyrë edhe sahabët; kur humbnin ndonjë të afërm ose binin në vështirësi, ata e gjenin ngushëllimin në namaz, me anë të të cilit kërkonin ndihmë dhe durim nga Allahu. (shih. Hakim, II, 296/3066.)

Nisur nga kjo, një mysliman i mirë nuk duhet të mërzitet as për mirësitë që i mungojnë, e as të gëzohet tepër për mirësitë që i posedon. Sa bukur shprehet Mevlana:

“Bota jote e brendshme është si një strehë mysafirësh. Gëzimet e hidhërimet hyjnë e dalin. Mos u mashtro nga gëzimet, e as mos u mërzit nga hidhërimet! Mos u mërzit nëse pikëllimet pengojnë lumturinë tënde! Sepse nëse duron pikëllimet sot, ata janë lajmëtarë të gëzimit dhe lumturisë së të ardhmes.

O udhëtar i rrugës së Zotit! Priti me buzëqeshje hidhërimet që të vijnë në zemër dhe lutu: «O Zoti im! Më mbro nga e keqja e fatkeqësisë, por mos më privo nga mirësia që mund të më vijë me anë të saj! O Zot më jep mundësinë të falënderojë për fatkeqësitë, që të mos më marrë malli kur të ikin e të them pse nuk falënderova!»”

O Allah! Na bashko me grupin e njerëzve të devotshëm e durimtarë, që në çdo rast thonë; “O Zot, jam i kënaqur prej Teje!”...

Amin!..



Kujtime nga Epoka e Lumturisë
Uhudi



Uhudi dhe dëshmorët që ranë atje, kishin zënë një vend aq të thellë në zemrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), sa që kur përmendej, ai shprehej me hidhërim: “Vallahi, sa do të desha që edhe unë të kisha rënë dëshmor së bashku me sahabët e mi dhe ta kaloja natën në rrëzë të Uhudit!”

(Ahmed, III, 375.)

Kjo është një shprehje e qartë e dashurisë dhe dhembshurisë që i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte për umetin e vet.

KUJTIME NGA EPOKA E LUMTURISË UHUDI

Njeriu është gatuar me ndjenja besimi. Për këtë arsye, besimi në Allahun ka filluar me njeriun e parë, Ademin (a.s.), i cili ishte edhe profeti i parë. Drita e besimit, që filloi me Ademin (a.s.), si rezultat i përforcimit nga ana profetëve që erdhën njëri pas tjetrit, arriti formën më të përsosur me Muhamedin (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për botët. Drita e profetësisë së tij që do të zgjasë deri në kiamet, është një nga mirësitë më të mëdha hyjnore që do të ndriçojë njerëzimin. Shumë prej njerëzve të periudhës së injorancës, u udhëzuan në sajë të predikimit të tij dhe u bënë personalitete të larta me edukimin dhe frymëzimin e tij shpirtëror. Për rrjedhojë, njerëz të tillë, arritën të shfaqnin sakrificë, butësi, mëshirë, dashuri dhe altruizëm të pashoq.

Njohja e Allahut, është shkak i një lumturie të madhe. Gjithësia, e cila është e mbushur plot me manifestime të madhështisë dhe fuqisë hyjnore, është krijuar me urtësinë e sprovës për njeriun.

Njohja e Allahu me zemër, mund të arrihet vetëm në sajë të dashurisë hyjnore. Ndërsa lumturia e vërtetë e njeriut, shfaqet në njohjen e Allahut dhe dashurinë hyjnore.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Nëse dikush dëshiron të takohet me Allahun, edhe Allahu dëshiron të takohet me të. Por, kujt nuk i pëlqen të takohet me Allahun, as Allahut nuk i pëlqen të takohet me të!”



Aisha (r.anha), (ose një nga gratë e tjera të Profetit -a.s.-), ka thënë:

- O i Dërguar i Allahut! Të gjithë ne e shohim të shëmtuar vdekjen dhe nuk na pëlqen. (pra a përfshihet këtu edhe mospëlqimi i vdekjes?)

“Jo, nuk është kështu! Por, kur besimtarit i vjen vdekja dhe ai përgëzohet me mëshirën e Allahut, kënaqësinë dhe Xhenetin e Tij, ai e dëshiron shumë takimin me Allahun. Gjithashtu, edhe Allahu e dëshiron takimin me të. Ndërsa, kur i vjen vdekja mohuesit, ai njoftohet me zemërimin dhe dënimin e Allahut. Për këtë arsye, ai nuk e pëlqen takimin me Allahun. Po ashtu, edhe Allahu nuk e do takimin me të.” (Buhari, Rikak, 41; Muslim, Dhikr, 14)

Ja pra, për të qenë një rob me nivel si rezultat i dashurisë ndaj Allahut dhe të përfitosh dashurinë e Allahut në këmbim të kësaj, duhet të bësh durim ndaj sprovave të jetës, të mos e prishësh ekuilibrin në rrugën e Allahut, të mbash në zemër teuhidin dhe të meditosh në mënyrë të vazhdueshme.

Besimtarët e përsosur që dëshirojnë takimin me Allahun, janë të detyruar të përparojnë në rrugën e njohjes së Allahut nën atmosferën shpirtërore të Kuranit dhe Sunnetit.

Manifestimet më të mrekullueshme të afrimit me Allahun, i shohim në jetët e sahabëve, sepse ata e kanë arritur këtë nivel kaq të lartë në sajë të energjisë pozitive që kanë marrë nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Në gjithë periudhën 23 vjeçare të profetësisë, Uhudi ishte një nga vendet e bekuara ku u manifestua ky entuziazëm fizik dhe shpirtëror. Ja disa prej këtyre manifestimeve të besimit që u dëshmuan në Uhud:

Pas luftës, kur idhujtarë e kishin braktisur plotësisht Uhudin, i Dërguari i Allahut (a.s.), zbriti në fushëbetejë për të varrosur dëshmorët. Myslimanët kishin dhënë shtatëdhjetë dëshmorë! Mes tyre kishte edhe trima të rrallë si Hamzai (r.a.) dhe Mus’ab bin Umejri (r.a.).

Mus’ab bin Umejri (r.a.), i cili kishte qenë flamurtari i mysliimanëve, kishte rënë dëshmor duke mbrojtur të Dërguarin e Allahut (a.s.). Pas kësaj, një melek që kishte marrë pamjen e Mus’abit, rroki flamurin për



të mos e lënë të bjerë në tokë. Ndërkohë, Profeti (a.s.), i cili ende nuk dinte gjë për vdekjen e Mus'abit, i kishte folur atij:

“Shko përpara, o Mus'ab!”

Kur meleku ktheu kokën, i Dërguari i Allahut (a.s.), e kuptoi se ai nuk ishte Mus'abi (r.a.), por një melek dhe se Mus'abi (r.a.), kishte rënë dëshmor. Më pas, kur gjetën trupin e bekuar të Mus'abit (r.a.), dhe deshën ta varrosnin, për të nuk u gjet një qefin i mjaftueshëm për ta mbështjellë.¹⁴ Rroba që u gjet, ishte aq e shkurtër, saqë por t'i mbuloje kokën, i mbeteshin zbuluar këmbët, e po t'i mbuloje këmbët, i mbetej zbuluar koka. Atëherë, sahabët iu drejtuan të Dërguarit të Allahut (a.s.) për ta pyetur se ç'duhej të bënin. I Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëroi që pjesa e sipërme e trupit të dëshmorit të mbulohej me rrobë, kurse këmbët, me barëra erëmira.¹⁵

Mus'abi (r.a.), ishte biri i njëres prej familjeve më fisnike dhe më të pasura të Mekës. Të gjithë të rinjtë e Mekës e kishin zili jetesën e tij. Madje, vajzat e reja shtronin trëndafila në rrugën nga kalonte ai. Kurse ai, pavarësisht të gjitha presioneve të familjes së vet idhujtare, parapëlqeu të qëndronte pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), duke refuzuar mundësitë dhe të mirat materiale të familjes, madje, edhe trashëgiminë që i përkiste! Ai u bë admirues i të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe u lidh me një dashuri aq të madhe pas tij, saqë bota dhe gjithçka në të u kthye në një “hiç” në sytë e tij.

Dhe me të vërtetë që, çmimi më i shtrenjtë që paguan njeriu në këtë botë, është ai për hir të dashurisë. Ndërsa dashuria më sublime për të cilën paguhet çmimi më i shtrenjtë, është ajo për hir të Allahut. Kështu, Mus'abi (r.a.), ishte ndër ata heronj të Islamit që e pagoi me gjithë shpirt çmimin e shtrenjtë të dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Aliu (r.a.), tregon:

Së bashku me Profetin (a.s.) po rrinim në mesxhid, kur befaz u shfaq Mus'abi. Mbi trup nuk kishte gjë tjetër veç një pelerine të arnuar me

14. Ibni Sa'd, III, 121-122.

15. shih. Buhari, Xhenaiz, 27.

copa qyrku. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e pa, mendoi për gjendjen dhe jetesën e tij mes të mirave në Mekë dhe gjendjen e tij aktuale, e më pas qau dhe tha:

“Nëse do të visheshit me rroba të bukura, në mëngjes ndryshe, pasdreke ndryshe, do t’ju viheshin përpara një pas një pjata me ushqime dhe do të banonit në shtëpi të mbuluar me mbulesa si Qabja, si do të ishte gjendja juaj?”

Sahabët i thanë:

“O i Dërguari i Allahut, natyrisht që atë ditë gjendja jonë do të ishte më e mirë se sot, sepse atëherë s’do të kishim shqetësime për jetesën dhe do t’ia kushtonim veten adhurimeve!”

I Dërguari i Allahut (a.s.) tha:

“Përkundrazi, sot jeni në gjendje më të mirë se ç’do ishit!”

(Tirmidhi, Kijamet, 35/2476.)

Përpjekjet Islame që bëhen me sinqeritet në kohë të vështira, janë shumë herë më të vlefshme dhe më të virtytshme se shumë shërbime që njerëzit i bëjnë në kohë rehatie dhe bollëku. Shpërblimi i një mirësie, është në përputhje me vështirësitë e kaluara në realizmin e saj.

Ngjarja më e rëndë në betejën e Uhudit, që e ka mbytur në hidhërim zemrën e Profetit (a.s.) dhe të gjithë myslimanëve, ishte padyshim martirizimi në mënyrë çnjerëzore i heroit të pashoq, Luanit të Allahut, Hamzait (r.a.).

Në fund të betejës, motra e Hamzait (r.a.), Safija (r.a.), deshi të shihte vëllain e saj dhe u drejtua tek vendi ku gjendeshin dëshmorët. Mirëpo, djali i saj Zubejri (r.a.), i doli para dhe i tha:

- I Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëron të kthehesh pas, oj nënë!

- Pse? A të mos e shoh tim vëlla? Fundja, unë e mora vesh se atë e kanë bërë copë-copë! Ai e pësoi kështu për hir të Allahut! Edhe ne nuk mund të na ngushëllojë gjë tjetër veç kësaj! Në dashtë Allahu, do të duroj dhe do ta pres shpërblimin nga Allahu! – Tha ajo.

Zubejri (r.a.), shkoi tek Profeti (a.s.) dhe i tha ç’i kishte thënë e ëma. Atëherë, Profeti (a.s.), i tha:



“Mirë pra, lëre ta shohë!”

Safija (r.a.), shkoi pranë trupit të bekuar të vëllait dhe u lut për të.
(shih. Ibni Hisham, III, 48; Ibni Haxher, el-Isabe, IV, 349)

Ndërsa Zubejr bin Avvami (r.a.), e tregon kështu një tablo vëllazërie fetare të pashoqe që u përjetua në Uhud:

Nëna ime Safije nxori dy robe që kishte sjellë me vete dhe tha:

- Iolla këto si qefin për vëllain tim, Hamzanë!

I morëm ato dhe shkua pranë trupit të Hamzait (r.a.). Përbri tij ndodhej edhe një dëshmor tjetër prej ensarëve, për të cilin ende nuk ishte gjetur qefin. Neve na erdhi turp t'ia mbështillnim të dyja rrobat Hamzait dhe ta linim pa qefin ensarin. Prandaj, thamë që njëra të bëhej qefin për Hamzanë, e tjetra për ensarin. Dhe, meqë rrobat ishin njëra e madhe, tjetra e vogël, hodhëm short. (Ahmed, I, 165.)

Siç e shprehin edhe këto skena prekëse, tashmë, në zemrat e besimtarëve, afërsia e gjakut po ia linte vendin vëllazërisë së besimit. Për të gjithë besimtarët gjer në kiamet, po shpalosej emocioni i përjetimit të vëllazërisë fetare.

Kur u fal namazi i xhenazes së dëshmorëve, u sollën dhjetë dëshmorë me në krye Hamzanë (r.a.). Pas namazit, nëntë dëshmorë u varrosën, dhe pranë Hamzait (r.a.), sollën nëntë dëshmorë të tjerë. Kështu, vazhdonte përsëri falja e namazit të xhenazes. Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka falur disa herë namazin e xhenazes së xhaxhait të tij të dashur.¹⁶ Kjo mjafton për të treguar vendin që kishte Hamzai (r.a.), në zemrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Këto tablo të hidhura në Uhud, u ngulitën thellë në zemrat e myslimanëve. Vite më vonë myslimanët fituan fuqi dhe pasuri. Në këtë periudhë, kur një nga myslimanët e pasur dhe falënderues ndaj Allahut, siç ishte Abdurrahman bin Aufi (r.a.), po bënte iftar pas një dite agjërimi, iu vunë para disa lloj gjellësh nga i biri. Kur i pa këto, ai u prek dhe tha:

16. Ibn Maxhe, Xhenaiz, 28.

“Mus’abi ra dëshmor në luftën e Uhudit. Ai ishte më i virtytshëm se unë, mirëpo për të s’u gjet qefin veç rrobës së vet që s’e mbulonte dot, sepse po t’i mbulohej koka, i zbuloheshin këmbët, e po t’i mbulohehin këmbët, i zbuloheshin koka. Pastaj neve u favorizuar me çdo të mirë materiale të kësaj bote dhe unë kam frikë se shpërblimi i mirësive tona na është dhënë në këtë botë!”

Më pas, Abdurrahmani (r.a.), filloi të qante, e la gjellën dhe u ngrit nga sofa. (Buhari, Xhenaiz, 27.)

Një nga tablotë mësimdhënëse të Uhudit, është edhe kjo:

Siç rrëfen Xhabiri (r.a.), Profeti (a.s.), i bashkoi dy e nga dy në nga një varr dëshmorët e rënë në luftën e Uhudit dhe pyeste:

“Cili prej tyre e kishte ditur më mirë Kuranin (e kishte jetuar më mirë Kur’anin)”

Më pas, atë që i tregoi, e vendoste nga ana e kiblës. (Buhari, Xhenaiz, 73, 75.)

Gratë e Medinës dolën jashtë qytetit me shpresën që të merrnin ndonjë lajm. Mes tyre ishte edhe nëna jonë Aisha (r.anha). Në vendin e quajtur Harre, ajo u takua me një grua të devotshme të quajtur Hind binti Amr (r.anha), e cila kishte ngarkuar mbi një deve trupat e vdekur të burrit të saj, Amr bin Xhemuh, djalit të saj, Halladit dhe të vëllait, Abdullahut. Aisha (r.a.), e pyeti:

- Ç’lajme kemi prej atje?

- Të mira! – I tha Hindi. I Dërguari i Allahut (a.s.), është mirë. Po qe gjallë ai, çdo fatkeqësi bëhet e lehtë!

Duke bërë shenjë kufomat mbi deve, Aisha (r.a.), e pyeti:

- Kush janë këta?

- Im vëlla Abdullahu, im bir Halladi dhe im shoq Amri! - Iu përgjigj gruaja e devotshme Hind.

- Ku po i çon ata? – Pyeti përsëri Aisha (r.a.).

- Në Medinë! Aty do t’i varros! – Iu përgjigj zonja Hind.



Më pas, kur u shtrëngua që ta shpejtonte pak ecjen, deveja u gjunjëzua në tokë. Aisha pyeti:

- A u gjunjëzua deveja nga barra e rëndë?

Hindi iu përgjigj:

- Nuk e di pse gjunjëzohet, por herët e tjera ka bartur edhe barrën e dy deveve. Kurse tani duket ndryshe!

E shtrënguar për t'u ngritur, deveja u ngrit, por, me t'u drejtuar nga Medina, prapë u ul. Pastaj, kur e drejtuan nga Uhudi, filloi të ecë me të shpejtë. Ata u kthyen në Uhud dhe kur u takuan me Profetin (a.s.), zonja Hind ia tregoi për çdo gjë. Profeti (a.s.). e pyeti:

- Deveja ka një detyrë. A la ndonjë amanet Amri?

Hindi tha:

- Kur do të vinte për në Uhud, Amri u kthye nga kibla dhe u lut: "O Allah! Mundësoma të bie dëshmor! Mos më kthe tek njerëzit e shtëpisë të pashpresë e të dëshpëruar!"

Atëherë, i Dërguari i Allahut (a.s.) tha:

"Ja pra përse nuk ecën deveja! O ensarë! Kushdo nga ju që i ka dhënë besën Allahu, t'i rrijë besnik fjalës!"

Oj Hind, yt shoq Amri, është nga besnikët! Qysh nga çasti kur ra dëshmor, melekët i bënë hije me krahët e tyre dhe panë se ku duhej varrosur. Oj Hind, yt shoq Amri, yt bir Halladi dhe yt vëlla Abdullahu, do të bashkohen në Xhenet dhe do të bëhen shokë!"

Përballë këtij lajmi të mirë, zonja Hind, duke dëshiruar të jetë edhe në jetën e amshuar bashkë me të shoqin besnik, iu lut Profetit (a.s.):

"O i Dërguari i Allahut! Lutu Allahut që të më bashkojë edhe mua me ta!"¹⁷

Një tablo tjetër mësimdhënëse nga Uhudi është edhe kjo:

Ditën e Uhudit, Medina u lëkund me një lajm të hidhur. Me t'u

17. Uakidi, I, 264-265; Ibni Haxher, Fet'hul Bari, III, 216; Ibni Abdilberr, III, 1168.

thënë se “Muhamedi u vra!”, në qytet shpërthyen klithmat dhe kuja u ngjit në qiell! Madje, zonja Sumejra nga ensarët, megjithëse kishte marrë lajmin e vdekjes së dy djemve, babait, burrit dhe vëllait, më parë pyeti për gjendjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.):

- A i ka ndodhur gjë atij?

Sahabët iu përgjigjën:

- Lavdi Zotit, është mirë! Ashtu siç dëshiron edhe ti, ai është gjallë!

- Tregomani ku është, ta shoh dhe të më qetësohet zemra! – Tha zonja Sumejra.

Kur ia treguan se ku ndodhej, i shkoi menjëherë pranë, e kapi pas kindit të rrobës dhe i tha:

- Të qofshin falë nëna dhe babai im, o i Dërguari i Allahut! Po që ti gjallë, nuk shqetësohem për gjë tjetër!¹⁸

Beshir bin Akrabe (r.a.), thotë:

Pasi im atë ra dëshmor ditën e Uhudit, shkova te Profeti (a.s.), duke qarë. Atë kohë isha fëmijë i vogël. Profeti (a.s.), më tha:

“O vogëlush i dashur! Pse po qan? Pusho, mos qaj! A nuk je i kënaqur që unë të bëhem babai yt dhe Aisha, nëna jote?”

- Të qofshin falë nëna dhe babai im, o i Dërguari i Allahut! Patjetër që jam i kënaqur! – I thashë unë.

Pas kësaj, Profeti (r.a.), më përkëdheli kokën me dorën e tij të bekuar. Madje, edhe sot kur flokët më janë thinjur, vendi ku ka prekur dora e bekuar e të Dërguarit të Allahut (a.s.), s’është thinjur ende!” (Buhari, et-Tarihu’l-Kebir, II, 78; Ali el-Muttaki, XIII, 298/36862)

Një tablo tjetër ku u shpalos entuziazmi i takimi me Zotin, është edhe kjo:

Xhabir (r.a.) e tregon:



Një natë para betejës së Uhudit, im atë më thirri pranë dhe më tha:

“Më duket se unë do të jem i pari nga sahabët e Profetit (a.s.) që do të bie dëshmor. Me përjashtim të të Dërguarit të Allahut (a.s.), ti je për mua personi më i çmuar që do të lë pas. Kam borxhe; paguaji ato. Dhe sillu gjithmonë mirë me vëllezërit!”

Sipas një transmetimi tjetër, ai i ka thënë kështu Xhabirit (r.a.):

“Xhabir! Nëse nuk do të kishim vajzat në shtëpi që kanë nevojë për mbrojtje, do të doja që edhe ti të biesh dëshmor!..”

Në mëngjes, im atë qe personi i parë që ra dëshmor. E varrosa atë në një varr me një dëshmor tjetër. Pastaj desha ta varros më vete në një vend tjetër. Prandaj, gjashtë muaj më vonë e nxora nga varri, por ç'të shihja! Përveç një pjese të njërit vesh, i gjithë trupi ishte si atë ditë kur e pata varrosur për herë të parë! Më pas e varrosa në një varr më vete!” (Buhari, Xhenaiz, 78.)

Në një transmetim tjetër, Xhabiri (r.a.), tregon:

“Njëherë, kur isha i hidhëruar, u takova me të Dërguarin e Allahut (a.s.), e ai më tha:

«Përse po të shoh kështu të hidhëruar?»

«Babai im ra dëshmor në Uhud. Pas vetes la një familje të madhe që ka nevojë për kujdes dhe një sasi të madhe borxhi.» -i thashë unë. Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut tha:

«Të të tregoj se si e ka pritur Allahu babanë tënd?»

«Po!» - i thashë unë dhe ai vazhdoi të tregojë:

«Allahu nuk flet me askënd ballë përballë, por gjithmonë pas një perdeje. Mirëpo, Ai e ringjalli babanë tënd dhe foli drejtpërdrejt me të pa perde, e i tha:

«O robi im! Kërko ç'të duash prej meje, se do ta jap!»¹⁹

19. Tirmidhi, Tefsir, 3/3010.

Babai yt tha:

«O Zot! Më ringjall, që të bie përsëri dëshmor në rrugën tënde!»
Allahu i Madhëruar tha:

«Unë kam vendosur më parë, që të vdekurit nuk do të kthehen pas në dynja.» Ndërsa babai yt tha:

«O Zot! Atëherë tregojua gjendjen time atyre që kam lënë pas meje!» Pas kësaj kërkesë, u zbrit ky ajet fisnik:

“Kurrësi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, ata janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë dëshmorë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).”

(Al-i Imran, 169-170.)” (Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 13/190.)

Uhudi dhe dëshmorët që ranë atje, kishin zënë një vend aq të thellë në zemrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), sa që kur përmendej, ai shprehej me hidhërim: “*Vallahi, sa do të desha që edhe unë të kisha rënë dëshmor së bashku me sahabët e mi dhe ta kaloja natën në rrëzë të Uhudit!*” (Ahmed, III, 375.)

Kjo është një shprehje e qartë e dashurisë dhe dhembshurisë që i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte për umetin e vet.

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi tek dëshmorët e Uhudit dhe tha:

“Dëshmoj për ta!”²⁰

Ebu Bekri (r.a.) i tha:

- O i Dërguari i Allahut, a nuk jemi ne vëllezërit e tyre? Siç u bënë ata myslimanë, edhe ne u bëmë myslimanë! Siç luftuan ata, luftuam edhe ne!

Profeti (a.s.), i dha këtë përgjigje:

20. Për besimin dhe besnikërinë e tyre



“Po, e drejtë, vetëm se unë s’e di se ç’gjëra do të sajoni²¹ pas meje!”

Ebu Bekri (r.a.), qau e qau dhe pastaj i tha i dëshpëruar:

“Domethënë, ne do të mbetemi pas teje o i Dërguar i Allahut?”

(Muvatta, Xhihad, 32.)

Ky qëndrim i Ebu Bekrit (r.a.), është një shembull i bukur që tregon gradën e afërsisë dhe dashurisë së tij të pashoqe për Profetin tonë të dashur dhe se ai ka qenë “i dyti ndër të dy vetët që kanë pasur për të tretë Allahun”!



Uhudi kishte një vend të veçantë në zemrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Profeti i pati vizituar shpesh gjatë gjithë jetës Uhudin dhe dëshmorët e Uhudit.

Vendi i dëshmorëve, Uhudi, si një mjedis i njomur me dashurinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe i mbushur me kujtime frymëzuese, zë një vend të veçantë tek myslimanët që do të vijnë gjer në kiamet. Sidomos për ata që bëjnë haxhin dhe umren, pas Medinës dhe Ravzas, ai është vendi më i vizituar.

Po ashtu, një ditë tjetër kur i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi në Uhud tha:

“Ne e duam Uhudin dhe Uhudi na do ne!”²²

Nga ana tjetër, fakti që Uhudi e njeh dhe e do Profetin (a.s.), është, në thelb një shembull i qartë i së vërtetës se i gjithë krijimi e njeh dhe e miraton atë. Kështu, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

21. Në origjinal është fjala bid’at që përbën edhe një term të së drejtës islame. Bid’at do të thotë sajese, sajese në kundërshtim me Kuranin dhe Traditën Profetike. Në mënyrë të natyrshme e të domosdoshme, feja si përmbajtje dhe institucion, po ashtu edhe shkencat islame, vazhduan të plotësohen dhe zhvillohen pandërprerje pas vdekjes së Profetit. Ndërkaq, risitë apo novatorizmat që binin tekstualisht ose parimisht në kundërshtim me Kuranin dhe Sunnetin, Traditën Profetike, u cilësuan bid’at që do të thotë sajese ose pseudonovatorizëm.

22. Buhari, Xhihad, 71; Muslim, Haxh, 504.



“Me përjashtim të kundërshtarëve ndër xhinët dhe njerëzit, çdo gjë që ekziston mes tokës e qiellit e di se unë jam i Dërguari i Allahut!” (Ahmed, III, 310.)

Gurët dhe bimët e njihnin Profetin (a.s.). Lidhur me këtë Aliu (r.a.) tregon:

“Ndodhesha në Mekë së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.), ku ashtu së bashku, shkuam në disa vende të Mekës. Kalonim mes kodrave e pemëve dhe të gjitha kodrat e pemët nga kalonte ai, e përshëndesnin: «es-Selamu alejke ja Rasulullah!» (Tirmidhi, Menakib, 6/3626.)

Një shfaqje tjetër e kësaj dashurie dhe e këtij pasioni të trupave jo të gjallë për të Dërguarin e Allahut (a.s.), është edhe kjo:

I Dërguari i Allahut (a.s.), ia kumtoi tevhidin, besimin monoteist Islam, një idhujtari që hasën në rrugë. Mirëpo, idhujtari i kërkoi një provë të profetësisë së tij. Kështu, Profeti (a.s.), ia bëri me shenjë një peme më tej dhe e thirri. Pema nisi menjëherë të lëvizë nga vendi sipas urdhrit profetik dhe u afrua tek ai duke çarë tokën. Kur u ndodh para Profetit (a.s.), tha “es-Selamu alejke ja Rasulullah!” dhe shqiptoi Dëshminë Islame. Më pas, me urdhrin e profetit u kthye përsëri në vend. (shih. Hejthemi, VIII, 292.)

Po ashtu, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), mbante hutbe, mbështetej mbi një trung hurme. Më vonë, u ngrit një minber dhe i Dërguari i Allahut (a.s.), filloi të mbajë hutbe në atë minber. Ndërkaq, trungun e hurmës ku më parë mbështetej i Dërguari i Allahut (a.s.), filloi të rënkonte e të qante me një zë që i përngjiste rënkimit të devesë. Atëherë, i Dërguari i Allahut (a.s.), zbriti nga minberi dhe e ledhatoi trungun, i cili pas kësaj, pushoi së rënkuari dhe u qetësua. (Buhari, Xhuma, 26; Tirmidhi, Menakib, 6/3627)

Krahas këtyre, edhe kafshët e njihnin të Dërguarin e Allahut (a.s.):

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi në kopshtin e një prej ensarëve dhe atje pa një deve. Sapo deveja e pa Profetin (a.s.), rën-



koi dhe nga sytë e saj rrodhën lot. Resulullahu shkoi pranë devesë, e përkëdheli pas veshëve me butësi dhe deveja u qetësua. Pas kësaj, Profeti, pyeti:

“E kujt është kjo deve?” Një i ri medinas, u afrua dhe tha:

“Kjo deve është e imja, o Resulullah!” Profeti (a.s.), tha:

“A nuk frikësohesh prej Allahut që ta fali këtë deve? Ajo po më ankohet se e ke lënë të uritur dhe e ke lodhur shumë.” (Ebu Daud, Xhihad, 44/2549.)

Sa i përket njerëzve:

Ata që e njohën në mënyrën më të thellë -sipas nivelit të zemrës- të Dërguarin e Allahut (a.s.), ishin sahabët e tij dhe njerëzit e devotshëm, të cilët e admiruan personalitetin dhe karakterin e tij të lartë dhe sakrifikuan jetën, pasurinë dhe çdo gjë që kishin për hir të kauzës së tij sublime.

Vetëm indiferentët dhe të fatzinjtë prej njerëzve dhe xhinëve u bënë të verbër e të shurdhër ndaj Profetit të Allahut (a.s.), i cili krahas së vërtetave lidhur me njeriun, e njohu njerëzimin edhe me të vërtetat në lidhje me individualitetin dhe cilësitë e Zotit të Madhëruar. Po ashtu, ai na njoftoi edhe për dhikrin e fshehtë të krijesave të tjera. Kështu, ndarja nga kjo botë me dashurinë ndaj tij në zemër, të çon drejt lumturisë në botën tjetër. Kjo dashuri e madhe ndaj tij, e çon drejt përsosjes edhe besimin.

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë që dashuria për Profetin (a.s.), të jetë thesari i pashterueshëm dhe ëmbëlsia e pafundme e zemrave tona!..

Amin!..

Kujtime nga Epoka e Lumturisë

Tebuku



Sprova me pasuri dhe jetë... Fushata e Tebukut... Stina e verës. Dielli është përvëlues. Rëra digjet flakë... Hurmat janë pjekur dhe hija është bërë e paçmueshme... Nga një anë mirësitë, e nga ana tjetër vështirësitë dhe privimet... Sikur të mos mjaftonte, gjatë kthimit nga kjo fushatë e vështirë, i Dërguari i Allahut (a.s.), u thotë besimtarëve; “Tani po kthehemi nga xhihadi i vogël, drejt xhihadit të madh!”. Po ne sot, vallë në cilin kryqëzim të Fushatës së Tebukut jemi në sprovën e besimit?..

KUJTIME NGA EPOKA E LUMTURISË

TEBUKU

Çdo njeri që vjen në bujtinën e kësaj bote, është i detyruar të shijojë “vdekjen” si një e vërtetë e paevitueshme. Vdekja është lamtumirë ndaj ditëve të përkohshme dhe pika e takimit me jetën e përjetshme. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Varri është ndalesa e parë e ahiretit. Nëse njeriu arrin të shpëtojë prej tij, të tjerat janë më të lehta. Nëse nuk arrin të shpëtojë prej tij, ndalesat e tjera do të jenë më të vështira dhe më të ashpra se varri... Asnjë prej skenave që kam parë, nuk është më e frikshme dhe më e tmerrshme se ajo e varrit!” (Tirmidhi, Zuhd, 5/2308; Ahmed, I, 63-64.)

Çdo njeri do ta shijojë vdekjen sikur është duke u zgjuar nga gjumi. Vdekja do t'i shfaqet njeriut ashtu siç ka jetuar në këtë botë.²³ Për dikë do të jetë lumturi e një mëngjesi feste, e për dikë një udhëtim i dhimbshëm i mbushur me ankthe...

Nisur nga kjo, ata që zotërojnë mendje dhe zemër të shëndoshë, përgatiten për udhëtimin në botën e vërtetë dhe të përjetshme para se t'i vijë ftesa e papritur dhe e paevitueshme e vdekjes, duke u zhveshur me dëshirën e vet nga dashuritë e përkohshme të kësaj bote. Ata janë

23. Shih. Hakim, I, 93-95; Ahmed, IV, 295; Hejthemi, II, 322, 324.



njerëz që përpiqen të arrijnë përsosmërinë shpirtërore, duke u munduar të deshifrojnë të fshehtën e thënies “*udisni para se t’u vijë vdekja!*”. Po ashtu, ata janë shembuj shpirtërorë të cilët përpiqen “të zbukurojnë vdekjen”, duke luftuar me egon e tyre në këtë botë.

Besimtarit që arrin pjekurinë shpirtërore, i largohen perdet e indifferencës mes tij dhe Krijuesit. Kur shpirti fillon të shijojë ëmbëlsinë e takimit të përrjetshëm me Zotin, kënaqësitë e përkohshme e humbasin rëndësinë në sytë e tij. Të gjitha mirësitë e kësaj bote, duke filluar prej jetës dhe pasurisë, shndërrohen thjesht në mjete që përdoren për të arritur takimin me Zotin, lumturinë dhe shpëtimin e përrjetshëm. Tashmë, sakrifica në rrugën e Zotit, kthehet në ëmbëlsi besimi.

Sakrifica është një zjarr që nuk shuhet kurrë në zemrën e një besimtari të përsosur. Sakrifica është esenca njerëzore më e rëndësishme që e orienton robin me zemër drejt Zotit të vet.

Morali njerëzor ka arritur pikën e kulminacionit me anë të Kuranit Fisnik. Në Kuran urdhërohet që, për të arritur kënaqësinë e Allahut, duhet të bëjmë sakrifica të singerta. Një besimtar sakrifikues, mbledh në vete të gjitha cilësitë e bukura. Një besimtar sakrifikues, është bujar, i mëshirshëm, modest, shërbyes dhe doktor i zemrave të vuajtura. Një besimtar sakrifikues, mendon për të tjerët edhe kur ka nevojë për vete. Po ashtu, një besimtar sakrifikues është burim shprese dhe besimi që kryen me dashuri dhe dhembshuri çdo shërbim në rrugën e Allahut. Ai gjendet në frontin e çdo përpjekjeje që i fal paqe shpirtave. Ai kërkon vazhdimisht kënaqësinë e Allahut me fjalët, sjelljet dhe moralin e tij shembullor. Ai është pranë të vuajturit dhe hallexhiut, pranë të vetmuarve dhe të pashpresëve, sepse frytet e para të besimit tek një besimtar, janë mëshira dhe sakrifica.

Cilësia e parë hyjnore që hasim në Kuran, është “Rahman” dhe “Rahim”. Allahu i Madhëruar jep sihariqin se është “më i mëshirshmi i të mëshirshmëve” dhe e urdhëron robin e Vet të pajiset me moralin hyjnor. Për rrjedhojë, zemra e një besimtari e mbushur plot dashuri për Zotin, duhet të përqafojë me mëshirë dhe dashuri të gjitha krijesat e Tij dhe të bëjë sakrifica në këtë rrugë.



Treguesi i dashurisë ndaj Allahut, është dashuria, mëshira dhe sakrificat ndaj krijesave të Tij, sepse ai që do, bën sakrificat në përputhje me dashurinë që ndjen, duke e konsideruar këtë, kënaqësi dhe detyrë. Sakrificat e bëra ndaj krijesave të Allahut, janë edhe treguesi më i qartë i dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ky vëzhgim i perëndimorit Corneille Le Bruyn është shumë i rëndësishëm për të treguar horizontin e mrekullueshëm të sakrificës dhe mëshirës së të parëve tanë:

“Bamirësia e turqve nuk ishte e posaçme vetëm për njerëzit, por përfshinte edhe kafshët. Disa prej tyre shkonin rregullisht në tregun e kafshëve, ku blinin zogjtë që shiteshin në kafaz dhe i lironin menjëherë. Shkaku i këtij veprimi, ishte besimi i tyre se në Ditën e Gjykimit ata zogj do të dalin para Allahut dhe do të dëshmojnë për mirësitë që kanë parë prej njerëzve.”

Kulmi i sakrificës, është të shpëtosh “shpirtin” prej robërisë së egos me nderin e besimit dhe ta flijosh atë në rrugën e Allahut. Nëse sakrificat që bëhen në jetë dhe pasuri, janë të sinqerta dhe me gjithë zemër, do të pranohen në mënyrën më të bukur nga Allahu, ashtu si dorëzimi dhe besnikëria e Ibrahimit dhe Ismailit (alejhima selam).

Shfaqjet më të mrekullueshme të afrimit me Allahun në sajë të sakrificave të bëra, i shohim në jetën e Profetit tonë (a.s.) dhe shokëve të tij fisnikë. Si shembull i kësaj të vërtete, po përmendim disa ndodhi të përjetuara në Fushatën e vështirë të Tebukut:

Kur po bëheshin përgatitjet për fushatën e Tebukut, i Dërguari i Allahut (a.s.), së pari i ftoi sahabët të kontribuonin për të përballuar nevojat e ushtrisë. Megjithatë në Medinë, në atë kohë po përjetohej një zi e madhe buke, të gjithë sahabët u vunë në garë kush e kusht të ndihmonte më shumë. Kështu, Ebu Bekri (r.a.), solli tërë pasurinë e vet. Dhe, kur Profeti (a.s.), tha se “nuk kishte përfituar nga pasuria e askujt më shumë se sa kishte përfituar nga pasuria e Ebu Bekrit”, ai, i përlotur i tha:

“O i Dërguari i Allahut! A s’jemi vetëm për ty unë dhe pasuria



ime?” (Ibni Maxhe, Mukaddime, 11) Me këto fjalë, ai pohonte se i ishte kush-tuar gjer në vetëmohim me gjithçka të Dërguarit të Allahut (a.s.). Kur Profeti (a.s.), e pyeti:

“Po fëmijëve dhe familjes çfarë u le, o Ebu Bekir?”

Ai iu përgjigj me një ndjenjë të thellë besimi:

“Allahun dhe të Dërguarin e Tij...” (Tirmidhi, Menakib, 16/3675.)

Omeri (r.a.), kishte sjellë gjysmën e pasurisë. Këtë herë kishte menduar se do t’ia kalonte Ebu Bekrit (r.a.). Por prapë nuk e kishte mbërritur dot atë.

Osmani (r.a.), i dhuroi ushtrisë 300 deve bashkë me të gjitha pajimet, si dhe 1000 dinarë. Edhe për të, Profeti (a.s.) shprehu konsideratën e tij të lartë duke thënë:

“Këtej e tutje, asgjë që do të bëjë Osmani nuk mund ta dëmtojë atë!” (Tirmidhi, Menakib, 18/3700); Ahmed, V, 63)

Krahas tij, edhe familja e Osmanit (r.a.) i dhuroi të gjitha sendet e çmuara në rrugën e Allahut.

Po kështu edhe gratë e vajzat myslimane i nxorën të gjitha stolitë që kishin dhe i vunë të gjitha para të Dërguarit të Allahut (a.s.). Ndërkohë, një vajzë e vogël, rreth 10-11 vjeç që nuk mundi t’i heqë lehtë vathët që i ishin vendosur që në vogëli, nga emocioni i madh i nxori ato duke përgjakur veshët. Më pas, ato vathë të përgjakura ia vuri para të Dërguarit të Allahut (a.s.)!

Madje edhe sahabët që nuk mund të gjenin gjë për të dhënë, përjetonin emocionet e dëshirës së madhe për të sakrifikuar prej jetës dhe pasurisë. Për shembull, Ebu Akili (r.a.), punoi një natë të tërë për të fituar dy masë hurma, nga të cilat njërien ua la njerëzve të shtëpisë, e tjetrën ia fali ushtrisë.²⁴



Kur po bëheshin përgatitjet për fushatën e Tebukut, sahabët ishin mbërthyer nga emocioni se do të dilnin së bashku me të Dërguarin

e Allahut (a.s.) për ta flijuar jetën në rrugën e Allahut. Kështu, shtatë sahabë të varfër që futeshin në kategorinë e të përjashtuarve nga lufta, iu drejtuan me lutje Profetit (a.s.), për t'u dhënë nga një kafshë me qëllim që të mund të merrnin pjesë në luftë. Por, kur morën përgjigjen se “nuk u gjetën deve”, u kthyen duke qarë. Atëherë, këta lot të derdhur në rrugën e Allahut, fituan pëlqimin hyjnor dhe Allahu urdhëroi në Kuran:

“(Nuk ka gjynah) as për ata të cilët, kur vijnë te ti për të kërkuar kafshë shalimi e ti u thua: ‘Unë nuk mund t’ju siguroj kafshë shalimi’, kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë (në rrugë të Allahut). (Teube, 92.)

Pas kësaj, Osmani, Ibni Jamini dhe Abbasi (r.a.), u siguruan deve dhe ushqime të shtatë këtyre sahabëve të varfër.²⁵ Më pas, edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), u siguroi kafshë dhe një sërë nevojash disa prej sahabëve të tjerë.²⁶ Këta sahabë që e kishin zemrën të mbushur me dashurinë për Allahun dhe u erdhi rëndë të qëndronin të ndarë nga i Dërguari i Tij (a.s.), edhe pse ishin të justifikuar, në sajë të dashurisë dhe dëshirës së flaktë që kishin, gëzuan mirësinë dhe nderin për të marrë pjesë në luftë.



Një ngjarje tejet mësimdhënëse nga Tebuku, e tregon edhe Vasile bin Eska (r.a.):

Në ditët kur do të dilnim për në fushatën e Tebukut, thirra kështu në Medinë:

“Kush më merr në kafshën e vet në këmbim të pjesës sime nga plaçka e luftës?”

Një person i moshuar nga ensarët më njoftoi se do të mund të më çonte në luftë me kusht që kafshës t'i hipnim me radhë. Sapo i thashë “dakord”, ai më tha:

25. Ibn-i Hisham, Siretu'n-Nebi, Bejrut 1937, Daru'l-Fikr, IV, 172; Vakidi, Megazi, Bejrut 1989, III, 994.

26. Buhari, Megazi, 78.



- Ec pra me bekimin e Allahut!

Kështu, dola në udhëtim me një shok të mirë e të mbarë. Allahu na e mundësoi të marrim plaçkë lufte dhe mua më ranë për pjesë disa deve. I mora para dhe ia çova ensarit. Ai më tha:

- Merri devetë dhe shko!

- Sipas marrëveshjes që bëmë në fillim, këto janë të tuat! – I thashë. Por ensari ma ktheu:

- O vëlla, merre plaçkën tënde të luftës se unë nuk dëshirova pjesën tënde! (Pra, të mora për të fituar shpërblimin nga Allahu!)” (Ebu Davud, Xhihad, 113/2676.)

Në këtë fushatë të jashtëzakonshme, po përjetohej në kulm emocion i mundësisë për ta blerë Xhenetin duke e shndërruar jetën dhe pasurinë në kapital të jetës së përjetshme të ahiretit. Aty po shpaloseshin tablo që do të ishin modele për umetin Islam gjer në kiamet! Sahabët vërtiteshin përreth Profetit (a.s.), si fluturat rreth dritës, me qëllim që t’i shërbenin atij dhe, sakrificën në rrugën e Allahut që e kishin treguar me gjithçka kishin, e shprehnin me thirrjen **“Të qofshin falë nëna dhe babai o i Dërguari i Allahut!”**



Ushtria kishte dalë për udhë dhe kishte përparuar shumë. Pas njëfarë kohe, edhe Ebu Dherri (r.a.), e arrin ushtrinë. Në fakt, ai kishte mbetur pas, sepse kishte një kafshë të dobët që nuk e përballonte dot udhëtimin. Kështu, ai e kishte braktisur atë dhe me njëmijenjë vuajtje kishte mundur të arrinte ushtrinë! Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e pa këtë, tha me buzëqeshje:

“Allahu e mëshiroftë! Ebu Dherri jeton vetëm, vdes vetëm dhe do të ringjallet i vetëm!”

Kjo thënie e të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte një mrekulli që u vërtetua plotësisht kur i erdhi koha. Ebu Dheri (r.a.), jetoi i vetëm dhe vdiq i vetëm! (Vakidi, III, 1000.)



Një tjetër nga ata që iu bashkuan ushtrisë kur arritën në Tebuk, ishte edhe Ebu Hajthème (r.a.). Në fillim, për shkak të vështirësive të përgatitjes së fushatës, ai nuk mundi të bashkohej me ushtrinë dhe mbeti në Medinë. Një ditë, gratë i kishin shtruar një sofër të mirë në çardak dhe e kishin ftuar të hante. Kur e pa këtë tablo, për një çast Ebu Hajthème (r.a.), mendoi se si mund të ishte gjendja e të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe e sahabëve të tij. Aty ndjeu një dhimbje në zemër dhe tha me vete:

“A është e drejtë kjo që po bëj unë ndërkohë që ata po përballen me vështirësi në rrugën e Allahut nën këtë të nxehtë?!”

Nën presionin e këtyre mendimeve, ai doli menjëherë për udhë pa e prekur fare sofrën dhe e arriti ushtrinë Islame në Tebuk. Kur Resulullahu (a.s.), pa se kishte mbërritur Ebu Hajthème (r.a.), u gëzua shumë nga ky veprim i tij dhe tha:

“O Ebu Hajthème! Për pak do të shkatërroheshe!..”

Më pas, iu lut Allahut të Madhëruar që ta falë atë. (Ibni 260 Hisham, IV, 174; Vakidi, III, 998.)

Allahu i Madhëruar nuk i ngarkon robërit e Tij me diçka përtej mundësive të tyre. Ai u jep përgjegjësi vetëm për punët që ata kanë mundësi t'i kryejnë. Pra, edhe kjo që bëri Ebu Hajthème (r.a.), buroi nga ndjenja e përgjegjësisë për diçka që kishte mundësi ta bënte.

Këto ndodhi janë shembuj të gjallë për ne. Në sajë të tyre ne mund të matim sakrificat tona në rrugën e Allahut dhe të meditojmë rreth përgjegjësive që kemi si besimtar myslimanë.



Në fushatën e Tebukut ra dëshmor vetëm një sahab i quajtur Abdullah el-Muzeni (r.a.), i cili u nderua me Islam mes një fisi idhujtar. Ky sahab tejet i varfër, pasi pranoi Islamin mbeti plotësisht i pambrojtur në fisin e vet. Idhujtarët u frikësuan se mos ikte në Medinë dhe bëhej shembull për të rinjtë e tjerë. Për këtë arsye, ata i morën gjithçka atij, përfshirë edhe rrobat e trupit. Më pas e futën në një thes të thurur me qime të ashpra dhe e lanë ashtu. Në këtë mënyrë, sipas mendimit të



tyre, ky besimtar do të mbyllej brenda shtëpisë së tij dhe më në fund do të detyrohej të kthehej në fenë e fisit të vet.

Mirëpo Abdullahu (r.a.), ishte i vendosur dhe donte të shkonte sa më parë tek i Dërguari i Allahut (a.s.), në Medinë. Për këtë arsye, të gjitha pengesat i dukeshin të papërfillshme. Ai nuk duroi më gjatë dhe një natë doli fshehurazi rrugës për në Medinë. Pas një udhëtimi të gjatë e të vështirë, iu afrua Medinës i rraskapitur, me duar të çara dhe i këputur nga uria e etja. Megjithatë, emocionet kishin arritur kulmin. Për një moment iu kujtua se s'mund të dilte para të Dërguarit të Allahut (a.s.), me atë thes të shëmtuar. Prandaj ai e ndau thesin më dysh dhe një copë e lidhi në mes për të mbuluar pjesën e poshtme të trupit, ndërsa copën tjetër e hodhi mbi supe. Më pas, ky djalosh, i cili ishte aq i emocionuar për takimin me Profetin e Allahut (a.s.), e mbajti frymën drejt e tek Xhamia e Profetit (a.s.), mes syve të habitur të njerëzve përreth.

Më në fund, ai kishte arritur tek Profeti i mëshirës, streha e të vetmuarve dhe të shtypurve, ku u prit me dashuri dhe dhembshuri të jashtëzakonshme. Gjendja e atij sahabi atë ditë, nuk u harruar edhe pas shumë kohësh. E, për shkak se erdhi i veshur me dy copa thesi si qilima, prej asaj kohe u njoh me emrin “Dhu’l-Bixhadejn”.

Ky sahab i sinqertë u lidh me dashuri pas të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe vraponte përkrah tij nga lufta në luftë, duke dëshiruar të sakrifikonte edhe jetën në rrugën e Allahut. Kur po bëheshin gati për Fushatën e Tebukut, ai i kërkoi Profetit (a.s.), të lutej për të që të binte dëshmor. I Dërguari i Allahut (a.s.) i tha:

“Nëse del në luftë në rrugën e Allahut dhe të zënë ethet e vdes, je dëshmor!..”

Dhe me të vërtetë që vdekja e tij ngjau ashtu siç kishte thënë i Dërguari i Allahut (a.s.). Kështu, një natë, kur ushtria po merrej me përgatitjet e kthimit, tre vetë, njëri prej të cilëve ishte vet Profeti Muhamed (a.s.), e dy të tjerët ishin miqtë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij (a.s.), Ebu Bekri dhe Omeri (r.anhuma), po bartnin një të vdekur nën dritën e pishtarëve. Ai që po bartnin, ishte Abdullah Dhulbixhadejni (r.a.)!



Abdullah bin Mes'udi (r.a.), që e shihte me zili atë pamje, thotë:

“Në errësirën e natës, në një skaj të fushës ku luftëtarët kishin ngritur çadrat, pashë një dritë që lëvizte. U ngrita dhe e ndoqa. Kur ç'të shoh? I Dërguari i Allahut (a.s.), Ebu Bekri dhe Omeri (r.anhuma), po bartnin trupin e Abdullah Dhulbixhadejnit (r.a.). Arritën në një vend, qëndruan dhe nisën të hapin varrin. I Dërguari i Allahut (a.s.), zbriti në varrin e hapur, kurse Ebu Bekri dhe Omeri (r.anhuma), e përgatitën trupin për t'ia dhënë Profetit.

I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Afromani vëllain tuaj!”

Dhe ata ia afruan. I Dërguari i Allahut (a.s.), e mori trupin në prehër dhe, pasi e vendosi ashtu siç duhej në varr, u ngrit dhe u lut kështu:

“O Zot! Unë jam i kënaqur me të, prandaj edhe Ti ji i kënaqur me të!..”

Abdullah bin Mes'udi (r.a.), vazhdon e thotë:

“Unë u preka shumë përballë kësaj pamjeje dhe më erdhi zili për Dhulbixhadejnin! Prandaj, atë çast dëshirova shumë të isha vet në atë varr dhe të gëzoja varrimin me lëvdatat e Profetit (a.s.)!”²⁷

Të gjithë këto shembuj, e shprehin shumë bukur faktin se dorëzimi me gjithë zemër tek Allahu dhe përpjekjet e singerta në rrugën e Tij, do të begatohen nga Ai. Asnjë shërbim në rrugën e së vërtetës nuk do të harrohet dhe të gjitha sakrificat do të fitojnë vlerë shumë të madhe tek Allahu i Madhëruar.



Një mëngjes, i Dërguari i Allahut (a.s.) mbajti një hutbe i mbështetur tek një dru hurme. Pasi e lavdëroi dhe e falënderoi Allahun, tha:

“Njeriu më i mirë e i dobishëm, është ai që lufton gjer në vdekje në rrugën e Allahut në shpinë të devesë ose më këmbë. Kurse njeriu më i keq, është gjynahqari i paturp, i cili e lexon librin e Allahut dhe nuk përfiton asgjë prej tij!

27. Ibni Hisham, IV, 183; Vakidi, III, 1013-1014; Ibni Ethir, Usdu'l-Gabe, III, 227.



Dijeni mirë se, fjalët më të drejta janë Libri i Allahut! Vega më e sigurt pas së cilës mund të kapeshe, është devocioni! Feja më e mirë, është Islami, feja e Ibrahimit! Sunneti (tradita) më i mirë është sunneti i Muhammedit. Fjala më fisnike është përmendja e emrit të Allahut! Rrëfimet më të bukura janë ato të Kuranit!²⁸ Vepra më e mirë dhe më e dobishme, është farzi që ka kërkuar Allahu! Kurse vepra më e keqe është risia në fe (bid'ati). Rruga më e mirë, është rruga e Profetit (a.s.)! Vdekja më fisnike është rënia dëshmor!

Verbëria më e keqe, është shmangia nga rruga e drejtë pasi e ke gjetur njëherë! Gjëja e pakët dhe e mjaftueshme, është më e dobishme se ajo e shumta që të pengon nga bindja ndaj Allahut! Kërkesa më e keqe për falje, është ajo që bëhet në çastin e vdekjes. Pendimi më i keq është ai në ditën e kiametit. Më i mbrapshti i njerëzve, është ai që shkon i fundit në namazin e xhumasë dhe e kujton Allahun me një gjuhë të keqe! Ai që bën më shumë gabime, është ai që thotë shumë gënjeshtra!

Pasuria më e mirë, është pasuria e zemrës. Furnizimi më i mirë, është furnizimi me devotshmëri. Kreu i urtësisë, është frika nga Allahu. Fjalët dhe poezitë pa urtësi, janë punë të Iblisit (shejtanit). Alkooli është e keqja që i mbledh në një vend të gjitha të këqijat. Femrat gjynahqare, janë kurthe të shejtanit. Rinia (e paedukuar) është një lloj çmendurie. Kamata është fitimi më i keq. Ngrënia më e keqe, është ngrënia e pasurisë së jetimit. Njeri i lumtur është ai që merr mësim nga gjendja e tjetrit.

Secili prej jush do të shkojë në varr. Kurse llogaria e punëve mbetet për në ditën e gjykimit. Esenciale në vepra është rezultati i

28. Më se një e treta e Kuranit përbëhet nga rrëfimet. Duke na e njoftuar rëndësinë e rrëfimeve të Kuranit, Zoti na urdhëron të meditojmë mbi të vërtetat e shprehura në to, të marrim mësimet e duhura dhe t'i krahasojmë ato me gjendjen tonë. Në ajetet kuranore urdhërohet:

“Ne të tregojmë ty (Muhamed) historinë më të bukur përmes shpalljes së këtij Kurani...” (Jusuf, 3.)

“...Tregojua rrëfimin, ndoshta mendojnë.” (A'raf, 176.)

“Pa dyshim, Ne kemi dhënë për njerëzit në këtë Kuran shembuj nga më të ndryshmit që të marrin këshillë.” (Zumer, 27.)



tyre. Mendimet më të këqija, janë mendimet e gabuara dhe gënjeshttrat. Ofendimi i besimtarit është gjynah. Vrasja e besimtarit është mohim dhe herezi. Ndërsa ngrënia e mishit të besimtarit (përgojimi i tij) është kundërshtim i urdhrave të Allahut!

Ai që betohet rrejtshëm me emrin e Allahut, përgënjeshtrohet. Ai që lutet për falje, falet nga Allahu. Kush e mposht zemërimin, Allahu e shpërblen. Kush duron dëmin që ka pësuar, Allahu do ta shpërblejë. Kush duron vështirësitë, Allahu e shpërblen shumëfish. Kush e kundërshton Allahun, Ai e ndëshkon rëndë!

O Allah! Më fal mua dhe umetin tim!

O Allah! Më fal mua dhe umetin tim!

O Allah! Më fal mua dhe umetin tim!

Kërkoj falje nga Allahu për vete dhe për ju!”²⁹



Fushata e Tebukut ishte beteja e fundit ku i Dërguari i Allahut (a.s.), mori pjesë. Ajo ishte një fushatë plot vështirësi dhe mundime. Ushtria Islame kishte përshkuar njëmijë kilometra vajtje-ardhje. Kur po afroreshin në Medinë, njerëzit dukeshin sikur kishin ndërruar trajtë. Ata ishin dobësuar shumë dhe flokët e mjekrat u ishin ngatërruar me njëra-tjetrën. Në një situatë të tillë, Profeti (a.s.) u tha:

“Tani po kthehemi nga xhihadi i vogël në xhihadin e madh!..”

Shokët e pyetën me habi:

- O i Dërguari i Allahut! Gjendja jonë duket sheshit! A mund të ketë xhihad më të madh se ky?

Profeti (a.s.), u tha:

“Tani po kthehemi në xhihadin e madh, në luftën e robit me veten!” (Sujuti, II, 73.)

Xhihadi ose lufta me vetveten (egon), është një edukim i zemrës dhe i shpirtit. Qëllimi i kësaj lufte, është lartësimi moral dhe përsosja e

29. Vakidi, III, 1016-1017; Ahmed, III, 37; Ibni Kethir, el-Bidaje, V, 13-14.



personalitetit. Dhe, mënyra e kësaj, është ta brumosësh mendjen me të vërtetat hyjnore, ta zbukurosh zemrën me besim dhe moral të bukur dhe t'i kurorëzosh ato me vepra të mira bazuar në Kuran dhe Sunnet.

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë të marrim shembull prej sahabëve, të cilët sakrifikuan jetët dhe pasuritë e tyre në rrugën e Tij. Allahu i mbushtë zemrat tona me frymëzimin shpirtëror të Kuranit dhe Sunetit!..

Amin!..



Pajisja me moralin profetik



Profeti ynë (a.s.), u bë mëshirë për gjithë njerëzimin, madje edhe për të gjitha krijesat. Po ashtu, ai Profet mëshire, na hapi faqet e librit të heshtur të gjithësisë. Ai u bë përkthyesi i dhikrit të fshehtë të krijesave. Modelin e përsosur njerëzor që dëshiron, Allahu i Madhëruar e ka personifikuar tek i Dërguari i Tij (a.s.), duke e bërë atë personalitet shembullor për të gjithë njerëzimin.

PAJISJA ME MORALIN PROFETIK

Në aspektin e krijimit, vlera e vërtetë e njeriut, i cili është më i nderuari ndër të gjitha krijesat, më tepër se në strukturën fizike, është e fshehur në botën e tij shpirtërore, pra në moralin e tij. Historia e moralit dhe virtytit njerëzor, në të njëjtën kohë është edhe historia e feve qiellore, sepse morali i bukur, është rezultat i përvetësimit, pjekurisë dhe përsosmërisë së fesë në zemër. Nga ky aspekt, morali Islam, është vet thelbi dhe esenca e fesë sonë.

Mendimet dhe perceptimet e njerëzve, s'mund të jenë kriteret i një sistemi moral. Vlera e një sistemi moral, varet nga përqindja e burimit hyjnor tek i cili bazohet, sepse Ai që e njuh më mirë natyrën e njeriut, është Vet Krijuesi i tij, Allahu i Madhëruar. Nisur nga kjo, morali i botës njerëzore, është përsosur nga Profeti ynë (a.s.), i cili nuk fliste nga vetja, dhe nga Kurani Fisnik që u zbrit në zemrën e Tij.

Në Kuran urdhërohet:

“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë.” (Shuara, 193-194.)

Morali i bukur që përbëhet nga karakteri dhe sjelljet me të cilat kënaqet Allahu, i është bërë e ditur njerëzimit me anë të gjuhës dhe zbatimeve të Profetit tonë (a.s.).

Kur e pyetën Aishen (r.a.), për moralin e tij, ajo tha: *“Morali i Tij*



*ishte Kurani*³⁰ Dhe me të vërtetë që, i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte si një Kuran i gjallë që ecte mbi tokë, i cili me veprat, sjelljet dhe fjalët e tij kryente edhe rolin e shpjeguesit të Kuranit.

Modelin e përsosur njerëzor që dëshiron, Allahu i Madhëruar e ka personifikuar tek i Dërguari i Tij (a.s.), duke e bërë atë personalitet shembullor për të gjithë njerëzimin. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Pa dyshim, ti do të jesh përherë i shpërblyer, sepse ti je me virtyte madhore.” (Kalem, 3-4.)

Për të kuptuar vlerën që ka morali i bukur tek Allahu, mjafton të shohësh Fjalën e Tij, Kuranin Fisnik. Morali është një nga çështjet më të rëndësishme dhe më thelbësore që zë vend në Kuran. Madje edhe historitë që zënë një vend të konsiderueshëm në Kuran, në një farë kuptimi përmbajnë pikat themelore të moralit.

Duke dashur të përshkruajë misionin e vet, I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Unë nuk jam dërguar për asnjë qëllim tjetër, përveçse si plotësues i moralit të bukur.” (Muvatta, Husnu'l-Hulk, 8.)

Dhe me të vërtetë që, me ardhjen e Profetit tonë (a.s.), horizonti i errësuar i botës u mbyt në dritë, erdhi mëngjesi i lumturisë që njerëzimi po priste, u ndriçuan zemrat, u hapën mendjet dhe rrjedha e turbullt e jetës u kthjellua. Në sajë të begatisë shpirtërore të atij Profeti të lartë, bota arriti pranverën e saj dhe njerëzimi rifitoi dinjitetin dhe nderin vet.

Ai Profet i lartë, u rrit në një shoqëri analfabete. Mirëpo, në sajë të librit që i zbriti nga Allahu, u bë burimi i dritës së bibliotekave të botës. Ai i mbushi zemrat me urtësi dhe dije. Me ardhjen e atij Libri, minberet dhe podiumet filluan të jepnin mësimet e të vërtetave hyjnore.

Profeti ynë (a.s.), u bë mëshirë për gjithë njerëzimin, madje edhe për të gjitha krijesat. Po ashtu, ai Profeti mëshire, na hapi faqet e



librit të heshtur të gjithësisë. Ai u bë përkthyesi i dhikrit të fshehtë të krijesave. Zemrat që kishin humbur ndjenjat njerëzore dhe ishin zhytur në një jetë shtazore, i ngriti në nivelin e vërtetë të dinjitetit dhe nderit njerëzor, duke u bërë sulltani i sarajit të dashurisë në zemra.

Arritja e dashurisë së Profetit (a.s.), është thesar i një lumturie të përjetshme, vizë për në Xhenet dhe dokument i pranimit në audiencën hyjnore. Padyshim se dashuria e tij sublime, është për ata që e pasojnë atë me gjithë zemër. Dhe pasuesit më të mirë të Profetit tonë (a.s.), janë shokët e tij fisnikë dhe njerëzit e devotshëm.

Sahabët e kishin mbushur zemrën me dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.) dhe i bindeshin atyre në çdo çështje. Për këtë arsye, ata merituan edhe lavdërimin e Allahut, i Cili urdhëron:

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe en-sarëve, Allahu është i kënaqur me ata dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Teube, 100.)

Ne, tashmë nuk e kemi më mundësinë të jemi sahabë. Por, siç urdhërohet edhe në ajet, ne mund të bëhemi prej atyre **“që i pasuan me vendosmëri e përkushtim”** dhe të arrijmë kështu kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Në shekujt e mëvonshëm pas sahabëve, ata që e kanë reflektuar më së miri moralin profetik, kanë qenë miqtë e Allahut, të cilët po ashtu janë shembuj për ne. Ata gëzojnë pozita të larta tek Allahu i Madhëruar, i Cili urdhëron:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar.” (Junus, 62.)

Nisur nga kjo, mund të thuhet lehtësisht se, për të gëzuar këtë garanci hyjnore, duhet të marrim shembull ata miq të Allahut.

Sahabët e nderuar janë nxënësit e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilët u edukuan me moralin profetik dhe arritën të bëheshin yje virtytesh në qiellin e njerëzimit.



Ja disa prej shembujve të virtytshëm që reflektojnë moralin profetik tek sahabët e nderuar:

Kur Ebu Duxhane (r.a.), ishte sëmurë, dikush që i erdhi për vizitë, vuri re se fytyra e tij ndriste dhe e pyeti:

- Përse të shndrit kështu fytyra?

Ebu Duxhane (r.a.), u përgjigj:

“Unë kam dy vepra:

1. Hesht në çështjet që s’më takojnë.

2. Zemra ime është e pastër nga mendimet e këqija për besimtarët dhe mendoj mirë për çdo besimtar.” (Ibn Sa’d, III, 557.)

Ibn Burejde el-Eslemi, tregon:

Dikush e ofendon Ibn Abbasin (r.a.). Ndërsa Ibn Abbasi (r.a.), heshti. I habitur, ofenduesi e pyet Ibn Abbasin (r.a.), se përse nuk iu kundërpërgjigj edhe ai. Ibn Abbasi i tha:

- Unë kam tre cilësi të cilat më pengojnë të të kundërpërgjigjem. Dhe filloi t’i radhisë ato:

“E para; Kur lexoj një ajet nga Libri i Allahut, dëshiroj që të gjithë njerëzit të dinë atë që ndjej unë.

E dyta; Gëzohem shumë kur dëgjoj se një gjykatës mysliman përhap drejtësi, ndërkohë që me atë gjykatës nuk më lidh asgjë. (Unë gëzohem për arsye se përhapen bukuritë e Islamit dhe drejtësia.)

E treta; Gëzohem shumë edhe kur bie shi në vendbanimet e myslimanëve, ndërkohë që në atë vend nuk kam as kafshë që kullot dhe as ndonjë tokë. (Mua më mjafton që vëllezërit e mi të fesë janë të gëzuar).” (Hejthemi, IX, 284.)

Ja pra një shembull i bukur prej sahabëve që e kishin zemrën të mbushur me dashurinë për vëllezërit e tyre. Për rrjedhojë, zemrat e besimtarëve që marrin shembull sahabët dhe i pasojnë ata në mënyrën më të bukur, duhet të bashkohen e të bëhen një zemër e vetme. Altruizmi duhet të jetë pjesë e natyrës së çdo besimtari.



Aliu (r.a.), tregon:

“Janë dy mirësi që nuk e di se cila prej tyre më gëzon më shumë. E para, kur një njeri vjen tek unë (më zgjedh mua) duke shpresuar se unë mund t’ia plotësojë nevojën dhe më kërkon ndihmë me sinqeritet të plotë. Ndërsa e dyta, kur Allahu Teala ia plotëson kërkesën këtij personi ose ia lehtëson çështjen në sajën tim. Për mua është më mirë t’i plotësojë nevojën një myslimani, se sa të kem një botë të tërë me ar e argjend.” (Ali el-Muttaki, Kenzu’l-Ummal, VI, 598/17049.)

Lidhur me këtë çështje, shumë domethënës është edhe shembulli i këtij sahabi të nderuar që ishte brumosur me edukatën profetike, kishte shpëtuar nga egoizmi “vetja ime, vetja ime” dhe kishte arritur altruizmin “populli im, populli im”:

Një ditë, kur Abdullah bin Abbas (r.a.), ishte ngujuar në itikaf, në xhaminë e Profetit (a.s.), vjen një person, i jep selam dhe ulet. Ibn Abbasi (r.a.), i thotë:

- O vëlla! Po të shoh të trishtuar e të mërzhitur.

- Po o djali i xhaxhait të Profetit, jam i trishtuar! I kam borxh filan personi dhe për hir të së vërtetës së këtij që prehet në këtë varr (Profetit -a.s.-), unë nuk mund ta paguaj dot këtë borxh. – Tha personi.

- A të flas unë me të?

- Nëse dëshiron, fol.

Ibn Abbasi (r.a.), veshi këpucët dhe doli nga xhamia. Personi në hall i thërret dhe i thotë:

- Harrove që je në itikaf, pse dole nga xhamia?

Ibn Abbasi (r.a.), i tha:

- Jo! Por nga ky njeri i nderuar që prehet në këtë varr dhe që sapo është ndarë nga ne (duke thënë këto fjalë i rrodhën lot nga sytë), kam dëgjuar se:

“Kushdo që mundohet t’ia plotësojë nevojën një vëllai mysliman dhe ia plotëson atë, kjo është më e mirë për të se dhjetë vjet qëndrim në itikaf. Ndërsa kush hyn një ditë në itikaf për hir të



Allahut, Ai krijon tri hendeqe mes tij dhe Xhehenemit; gjerësia e çdo hendeku është sa largësia ndërmjet lindjes dhe perëndimit.”

(Bejhaki, Shuab III, 424-425.)

Ajo që i bënte sahabët kaq altruistë, të butë dhe të mëshirshëm, ishte dashuria e pafund që ndjenin për Profetin (a.s.) dhe entuziazmi që kishin për të pasuar hapat e tij. Kjo ishte aq e theksuar, saqë ata preferonin më shumë ato që donte i Dërguari i Allahut (a.s.), se sa ato që donin vet. Madje, kur ishte e nevojshme hiqnin dorë prej dëshirave të tyre.

Njëherë, Omeri (r.a.), kishte caktuar tremijepesëqind derhemë për Usame ibn Zejdin. Kurse djalit të vet, Abdullahut, i dha tremijë derhemë. Për këtë arsye, Abdullahu e kundërshtoi të atin për këtë ndarje dhe e pyeti për shkakun e kësaj:

- Pse e mban më shumë Usamen se unë? Ai nuk ka marrë pjesë në beteja më shumë se unë!

Omeri (r.a.), i dha këtë përgjigje të shkëlqyer e cila krahas drejtësisë së pashoqe, tregonte edhe pasurinë e zemrës dhe modestinë e tij të lartë:

“O biri im! I Dërguari i Allahut e donte babanë e Usames më shumë se babanë tënd. Edhe Usamen e donte më shumë se sa ty. Ja, për këtë shkak e mbaj më shumë atë që donte i Dërguari i Allahut (a.s.), se sa atë që dua unë.” (Tirmidhi, Menakib, 39/3813.)



Edhe ne sot, jemi të detyruar të mbushemi me dashurinë për Profetin (a.s.) dhe të kërkojmë të edukohemi me moralin e lartë profetik. Ne duhet të përpiqemi të jetojmë dhe t'i japim jetë bukurive të tyre që nuk do të vyshken e vjetërsohen pavarësisht shekujve që kalojnë, sepse ky është edhe çmimi që duhet të paguajmë për të merituar nderin dhe fatin e të qenit umeti i vërtetë i të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ky hadith i transmetuar nga Omer bin Hattab (r.a.), është një lajm shumë i bukur për ata që kanë ardhur pas sahabëve dhe kanë bërë një jetë në rrugën e drejtë:



Një ditë, kur ishim ulur bashkë me Profetin (a.s.), ai pyeti:

“Më thoni! Kush posedon besimin më të lartë ndër të gjithë besimtarët?”

Sahabët, në fillim përmendën melekët, pastaj profetët dhe më pas dëshmorët në rrugën e Allahut. Mirëpo për çdo kategori që përmendej, Profeti (a.s.), thoshte:

“Po, ata janë të tillë dhe kjo është e drejta e tyre. E çfarë mund t’i pengojë ata t’u jepet kjo pozitë kur Allahu i ka ngritur në atë pozitë? Por unë nuk po pyes për këta.”

Sahabët thanë:

- Atëherë na e thoni kush janë këta, o i Dërguar i Allahut!

Pas kësaj, Profeti (a.s.), u tha:

“Ata janë njerëz që tani janë të fshehur tek baballarët dhe gjy-shërit e tyre dhe do të vijnë pas meje. Ata do të më besojnë dhe do të më aprovojnë edhe pse nuk më kanë parë. Do të lexojnë Kuran dhe do të punojnë sipas tij. Ja, këta janë ata që posedojnë besimin më të lartë ndër të gjithë besimtarët!” (Hakim, IV, 96/6993; Hejthemi, X, 65.)

Kuptimi i drejtë i sihariqit në këtë hadith dhe bërja e një jete në përputhje me Kuranin dhe Sunnetin, është detyra e çdo besimtari. Përndryshe, ndërkohë që presim ndërmjetësimin e të Dërguarit të Allahut në botën tjetër, ka mundësi që ai të ankohet ndaj nesh, gjë që do të ishte një disfatë shumë e madhe. Kështu, lidhur me ata që bëjnë një jetë në kundërshtim me Kuranin Fisnik, Allahu në bën të ditur se i Dërguari i Tij (a.s.), do të ankohet ndaj tyre në ditën e kiametit:

“Dhe i Dërguari do të thotë: «O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer»”. (Furkan, 30.)

Prandaj, për të mos qenë prej këtyre njerëzve për të cilët flitet në ajet, duhet të bëjmë një jetë të atillë, që të mund ta meritojmë të quhemi umeti i Muhamedit (a.s.). Ndërsa kjo arrihet duke e lexuar Kuranin sipas rregullave, duke kuptuar domethëniet e tij dhe duke zbatuar me përpikëri mësimet hyjnore.



Për ata që jetojnë në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut (a.s.), do të hapë krahët e dashurisë në të dyja botët. Kurse ata që e braktisin Kuranin dhe Sunnetin dhe devijojnë në rrugë të gabuara, në botën tjetër do të përjetojnë një pendesë dhe rrënim të papërshkrueshëm.

Ebu Hurejre (r.a.), transmeton se një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), shkoi tek varrezat bashkë me sahabët dhe tha:

“Selam ju qoftë o banorët myslimanë të këtij vendi! InshaAllah, një ditë edhe ne do të vijmë pranë jush.” (Pasi përshëndeti banorët e varreve) Tha:

“Sa kisha dashur t’i shihja vëllezërit e mi!” Sahabët pyetën të habitur:

“A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“Ju jeni shokët e mi të ngushtë, vëllezërit e mi akoma nuk kanë ardhur në jetë.”

Sahabët pyetën përsëri:

“Si do t’i njihni Ditën e Gjykimit ata që akoma nuk kanë ardhur në këtë jetë, o i Dërguari i Allahut?”

Profeti (a.s.), i pyeti:

“Mendoni një njeri që ka një kalë me ballë dhe këmbë të bardha! A nuk e njeh ky njeri kalin e tij në mesin e një tufe me kuaj të zinj?”

Sahabët pohuan:

“Po o i Dërguari i Allahut, e njeh!”

Pas kësaj, Profeti (a.s.), vazhdoi:

“Ja pra, Ditën e Gjykimit, vëllezërit e mi do të vijnë me fytyrë, duar dhe këmbë të shndritshme, për shkak se kanë marrë abdest. Unë do të shkoj para tyre në krye të hauzit (të Keutherit) dhe do t’i pres që t’u jap ujë!

Kini kujdes! Disa njerëz do të dëbohen nga hauzi im, ashtu



siç dëbohen devetë e huaja nga tufa. Kurse unë do t'i thërras ata: «Ejani këtu!». E mua do të më thuhet:

«Ata devijuan nga rruga jote dhe morën rrugë të tjera!»

Për këtë arsye, unë do të them:

«Qofshin larg, qofshin larg!» (Muslim, Taharet, 39.)

Në një transmetim tjetër thuhet:

“...Mua më thuhet:

«Pasi u ndave prej tyre, ata u kthyen pas mbi thembrat e tyre dhe që prej asaj dite vazhduan në irtidad (herezi)!» (Muslim, Xhennet, 58.)



Falënderimet e pafundme i takojnë Allahut të Madhëruar, i Cili na nderoi duke na bërë pjesë të umetit të Profetit të Tij të dashur (a.s.). Për rrjedhojë, ne e kemi për detyrë ta meritojmë këtë nder dhe të fitojmë dashurinë e Profetit tonë (a.s.), i cili na ka quajtur “vëllezër”, duke u kapur fort pas sunnetit të tij dhe duke u pajisur me moralin e tij.

O Allah! Dhuroju zemrave tona pjesë prej moralit të lartë të Profetit tonë (a.s.) dhe entuziazmit të tij shpirtëror! Gjallëroji zemrat tona me ndjenjat shpirtërore të atyre që thoshin; “të qofshin falë nëna dhe babai im o i Dërguar i Allahut!”...

Amin!..



Edukimi i Kuranit Fisnik



Kurani Fisnik është një letër udhëzimi e dërguar prej Allahut për të gjithë njerëzimin. Me anë të kësaj letre, Allahu i Madhëruar i fton robërit e Tij në Xhenet. Dhe, për t'iu përgjigjur kësaj ftese, njeriu duhet ta lexojë Kuranin me sytë e zemrës, duhet të thellohet në përmbajtjen e tij, duhet të bëjë një jetë të gjallë Kuranore dhe të shkojë tek Allahu me zemër të pastër.

Sot, puna kryesore që do t'i sigurojë të gjithë umetit Islam një shkundje të fortë dhe kthim në identitetin e vet, është kthimi tek Libri i Allahut, Kurani Fisnik.

EDUKIMI I KURANIT FISNIK

“Kurani është si një litar, njëri skaj i të cilit është tek Allahu dhe skaji tjetër në duart tuaja. Kapuni fort pas tij, në mënyrë që të mos devijoni nga rruga e drejtë, e të mos shkoni drejt shkatërrimit.”

(Hejthemi, IX, 164.)

Biri i njeriut, i cili përballet me njëmijenjë sprova gjatë jetës, është i detyruar të hyjë në një atmosferë meditimi në botën e tij të brendshme. Dëshifrimi vetëm me anë të mendjes së kufizuar i enigmës së udhëtimit të përjetësisë, që është përtej perceptimit njerëzor, duket qartë se është i pamundur. Për këtë arsye, mendja njerëzore ka nevojë të padiskutueshme për udhëzimin hyjnor në këtë udhëtim të jetës të mbushur me sprova komplekse.

Ashtu si çdo gjë që i nënshtrohet ligjit të ushqyerjes dhe edukimit, edhe mendja dhe ndjenjat janë të detyruara të ushqehen me vetëdije fetare dhe frymëzimin e besimit, duke kaluar nëpër edukimin hyjnor. Përndryshe, në vend që mendja dhe ndjenjat të bëhen udhëzues, rrënohen dhe e çojnë të zotin drejt shkatërrimit. Kurani Fisnik, është i vetmi libër hyjnor që i bën të njohura misteret e udhëtimit të jetës, u përgjigjet pyetjeve të saj, ndriçon errësirat e saj dhe përmban argumente të kënaqshme në çdo aspekt, si për mendjen, ashtu edhe për zemrën.

Si fillim, Kurani e porositi kështu birin e njeriut; “Ti je rob i Zotit. Jeto me argumentet e qarta të Kuranit dhe vdis me to!”. Dhe me të



vërtetë që, Kurani është një libër hyjnor i zbritur në zemrën e pastër të Muhamedit (a.s.), për t'i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë, rrëfen rrugën e arritjes së paqes së përvetshme dhe na njeh me gjuhën e tokës dhe qiejve.

Profeti ynë (a.s.) dhe Kurani Fisnik, që i është shpalosur botës prej zemrës së tij, janë dy burimet më të rëndësishme të dritës për njerëzimin. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Ju kam lënë dy amanete që, nëse kapeni fort pas tyre, nuk do të devijoni: Librin e Allahut, Kuranin, dhe sunnetin tim...” (Tirmidhi, Menakib, 31/3788.)

Kurani Fisnik është një urdhër hyjnor që na njeh me qëllimin e krijimit të gjithësisë dhe urtësinë e ekzistencës së njeriut dhe na mëson të jetojmë një jetë në përputhje me ligjet hyjnore në gjithësi. Allahu i Madhëruar e shpreh kështu ekuilibrin hyjnor mes njeriut, Kuranit dhe gjithësisë:

“I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.” (Rahman, 1-4.)

Allahu i Madhëruar, pikësëpari ka folur rreth mësimit të Kuranit, e më pas rreth krijimit të njeriut. Kjo shprehje njofton se qëllimi që e dallon krijimin e njeriut nga krijesat e tjera, është “adhurimi” dhe në të njëjtën kohë, na kujton përgjegjësinë që kemi karshi Kuranit Fisnik. Kjo, sepse dinjiteti dhe nderi i vërtetë i njeriut, është aq sa ai jeton me Kuranin dhe aq sa ai pajiset me moralin e tij. Në një hadith fisnik thuhet:

“Nëse ka dikush prej jush që dëshiron të flasë me Allahun, le të lexojë Kuran me qetësi shpirtërore!” (Sujuti, I, 13/360.)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar i ka dhënë njeriut aftësinë për ta kuptuar Kuranin, i cili është udhërrëfyes drejt udhëzimit. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar, Bimët dhe pemët i përulen (Allahut). Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën



(për çdo gjë), **që ju të mos e shkelni atë. Prandaj matni drejt e mos hani në peshë!**” (Rahman, 5-9.)

“Ai ka krijuar shtatë qiej nërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.” (Mulk, 3-4.)

Allahu i Madhëruar, në këto ajete fisnike shpalos “për njerëzit e mençur” fuqinë e Tij jashtëzakonshme që manifestohet në gjithësi. Duhet menduar se, nëse me miliarda trupa qiellorë që lëvizin në hapësirë me shpejtësi, masë dhe trajektore të ndryshme, nuk do t’u nënshtroheshin ligjeve hyjnore, a mund të vazhdonte ekzistenca e kësaj gjithësie?

Pasi ka vendosur ligjet në qiej e në tokë, Allahu i Madhëruar i shpall njeriut ligjet e Kuranit, në sajë të të cilave do të jetë i lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër. Ai na e ka dhuruar Kuranin si udhëzues dhe shërues. Për rrjedhojë, mirësia më e madhe e një njeriu, duhet të jetë përpjekja për të bërë një jetë në përputhje me Kuranin Fisnik dhe Sunnetin profetik. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Ai është veçse këshillë për botët; për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë.” (Tekuir, 27-28.)

Ndërsa në hadithet fisnike thuhet:

“Lexoni Kur’an, sepse ditën e kijametit, ai do të ndërmjetësojë për ata të cilët janë angazhuar me të!” (Muslim, Musafirin, 252; Ahmed, V, 249, 251.)

“Ditën e kiametit, do të sillen Kurani dhe ata që kanë jetuar në jetën e kësaj bote sipas Kuranit. Para Kuranit qëndrojnë suret Bekare dhe Al-i Imran. Që të dyja garojnë me njëra-tjetrën për të mbrojtur ata që i kanë lexuar.” (Muslim, Musafirin, 253.)

“Kush e lexon Kur’anin Fisnik dhe vepron me të, ditën e gjykimit prindërve të tij u vihet një kurorë, drita e së cilës është më e bukur se sa drita e diellit kur bie në një shtëpi të kësaj bote. Atëherë, a mund ta mendoni se si mund të jetë drita e atij që vepron vetë me Kur’anin Fisnik?” (Ebu Davud, Vitir, 14/1453.)

Krahas këtyre, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka qenë një shembull i përsosur në përpjekjen për mësimin e Kuranit. Ai i ka nxitur myslimanët ta mësojnë atë dhe t'ua mësojnë të tjerëve duke thënë se; *“Më i miri prej jush, është ai që e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve”*.³¹

Enesi (r.a.), tregon:

*“Një ditë, pashë të Dërguarin e Allahut (a.s.), që kishte lidhur gur në bark nga uria dhe u mësonte Kuran sahabëve të suffes në këmbë.”*³²

Ndërsa Ebu Umame (r.a.), tregon:

Një njeri erdhi tek Profeti (a.s.) dhe tha:

“O Resulallah! Mora pjesën e bijve të filanit, e shita dhe fitova kaq e aq.”

I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha:

“A të të njoftoj për diçka më fitimprurëse se ajo (që ke shitur)?”

Njeriu tha:

“A ka diçka të tillë?”

Profeti i nderuar (a.s.), tha:

“Kush mëson dhjetë ajete prej Kuranit, është më i fituar se ti!”

Pas kësaj, njeriu iku, mësoi dhjetë ajete dhe erdhi ia tregoi Profetit (a.s.). (Hejthemi, VII, 165.)

Sahabët e dinin se fitimet e kësaj bote as që mund të krahasohen me fitimet e botës tjetër, dhe për këtë arsye, ata përpiqeshin vazhdimisht të shtonin kapitalin e lumturisë për botën tjetër. Kjo, sepse i Dërguari i Allahut (a.s.), kishte thënë:

“Kushdo që shtron një gosti, dëshiron dhe kënaqet që njerëzit

31. Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21.

32. Ebu Nuajm, Hiljetu'l-evlija, Bejrut 1967, I, 342.



të vijnë në atë gosti. Kështu, edhe Kurani është gostia e Allahut. Prandaj mos qëndroni larg tij.” (Darimi, Fedailu'l-Kuran, 1.)

Abdullah Ibn Mes'udi (r.a.), i mësonte dikujt një ajet dhe thoshte:

“Ky ajet është më i mirë se çdo gjë mbi të cilën lind dielli dhe se çdo gjë tjetër që gjendet në tokë.” Pastaj këtë fjalë e përsëriste për çdo ajet të Kuranit Kerim. (Hejthemi, VII, 166.)



Për ta studiuar siç duhet Kuranin Fisnik, duhen pasur kujdes këto tre gjëra:

1. Leximi i saktë sipas rregullave të texhvidit.

Lidhur me këtë, në Kuran urdhërohet:

“...Lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë!” (Muzzemmil, 4.)

Ndërsa në një hadith fisnik thuhet:

“Ai që e lexon Kuranin bukur dhe siç duhet, është bashkë me melekët fisnikë dhe të bindur, që u janë dërguar profetëve. Kush e lexon Kuranin me vështirësi, duke belbëzuar, ka dyfish shpërblim.” (Buhari, Teuhid, 52.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Padyshim që ka prej njerëzve të cilët janë të afërt me Allahun!”

Sahabët fisnikë e pyetën:

“Kush janë ata, o i Dërguar i Allahut!?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“Ata janë zotëruesit e Kuranit dhe robërit e mirë të Allahut!”

(Ibën Maxhe, Mukaddime, 16.)

Kulejb Bin Shihab, tregon:

Njëherë, Aliu (r.a.), dëgjoi të vinin zëra nga Mesxhidi i Kufes dhe pyeti se ç'kishte ndodhur. Atij i thanë:



- Disa persona po lexojnë dhe mësojnë Kuran.

Aliu (r.a.), tha:

- Lum si ata! Ata ishin njerëzit më të dashur tek Profeti (a.s.)!
(Hejthemi, VII, 162.)

Siç shihet, mësimi i Kuranit dhe mësimdhënia e tij, është një nga arsytet më të mëdha të fitimit të dashurisë së Profetit tonë (a.s.). Një shembull tjetër i nderit dhe vlerës që kishin njerëzit e Kuranit tek Profeti (a.s.), është edhe ky:

Në fund të betejës së Uhudit, sahabët iu drejtuan Profetit (a.s.) dhe e pyetën:

- O i Dërguari i Allahut! Në radhët tona ka shumë dëshmorë. Si na urdhëron të veprojmë?

I Dërguari i Allahut (a.s.), urdhëroi të hapeshin varre të thellë dhe të gjerë dhe të varroseshin nga dy e nga tre. Kur sahabët pyetën:

- Cilët prej dëshmorëve të varrosnin më parë? Profeti (a.s.), urdhëroi e tha:

“Varrosni më parë atë që dinte më shumë Kuran!” (Nesai, Xhenaiz, 86, 87, 90, 91.)

2. Të kuptosh Kuranin Fisnik

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Pa dyshim, Ne kemi dhënë për njerëzit në këtë Kuran shembuj nga më të ndryshmit që të marrin këshillë.” (Zumer, 27.)

“Vërtet, Ne e kemi bërë Kuranin të lehtë për t’u kuptuar dhe kujtuar, prandaj, a ka ndonjë që të marrë këshillë?!” (Kamer, 17.)

“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!” (Muhammed, 24.)

Allahu i Madhëruar urdhëron që Kurani të kuptohet siç duhet dhe që ndodhitë të mendohen në përputhje me logjikën e Kuranit. Për këtë arsye, është kusht që mendja, e cila mund të bëhet edhe shkak lumturie, edhe mjerimi, të orientohet drejt shpalljes hyjnore.



Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni.” (A'raf, 204.)

Pra, për të fituar mëshirën hyjnore, duhet t'i afroresh Kuranit me edukatë, ta dëgjosh me përkushtim dhe ta zbatosh me përpikëri.

Sipas një transmetimi, Ebu Hamza (r.a.), i thotë kështu Abdullah Ibn Abbasit (r.a.):

- Unë e lexoj shumë shpejt Kuranin dhe e përfundoj për tre ditë.

Ndërsa Ibn Abbasi (r.a.), i jep këtë përgjigje shumë domethënëse:

- Mua më duket më e mirë ta lexoj suren Bekare me rregull dhe duke medituar për një natë, sesa ta lexojë ashtu siç lexon ti.³³

Sulejman Darani i shpreh me këto fjalë ndjenjat e thella që kishte për Kuranin Fisnik:

“Unë mendoj katër-pesë net mbi një ajet dhe nuk kaloj në ajetin tjetër pa e kuptuar mirë atë.”³⁴

Kurse Ijas bin Muavije shprehet kështu në lidhje me ata që e lexojnë Kuranin pa medituar:

“Kush e lexon Kuranin dhe nuk e njeh kuptimin e tij ose nuk mendon për hollësitë e tij, është si ai të cilit një natë të errët i vjen një letër prej mbretit, por ngaqë nuk e lexon dhe nuk e mëson se çfarë shkruhet në atë letër, e kap frika dhe paniku. Por kush arrin në kuptimin dhe hollësitë e Kuranit, është si ai që e sjell një dritë, e ndriçon vendin dhe lexon ato që shkruhen në letë.” (Kurtubi, el-Xhami, I, 26.)

I Dërguari i Allahut, u jep këtë sihariq besimtarëve që e lexojnë Kuranin duke e kuptuar dhe zbatuar:

“Kur një grup njerëzish mbledhen në një prej shtëpive të Allahut, lexojnë Librin e Tij dhe bisedojnë mes tyre për të, mbi ta zbret qetësia e prehja, i mbulon mëshira e Allahut, rrethohen nga

33. Bejhaki, es-Sunenu'l-kubrâ, Daru'l-fikr, ts., II, 396.

34. Gazali, Ihjau ulumi'd-din, Bejrut 1990, I, 374.

melekët dhe Allahu i përmend ata duke i lavdëruar midis atyre që ka pranë!” (Muslim, Dhikr, 38-39.)

“Kush e lexon Kuranin, e mëson mirë përmendësh, i pranon hallallet si hallall, haramet si haram dhe i zbaton ato, Allahu e vendos atë në Xhenet. Po ashtu, i jep edhe të drejtën të ndërmjetësorë për dhjetë persona të familjes që kanë merituar Xhehenemin.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 13/ 2905; Ahmed, I, 148.)

Kurani Fisnik është një letër udhëzimi e dërguar prej Allahut për të gjithë njerëzimin. Me anë të kësaj letre, Allahu i Madhëruar i fton robërit e Tij në Xhenet. Dhe, për t'iu përgjigjur kësaj ftese, njeriu duhet ta lexojë Kuranin me sytë e zemrës, duhet të thellohet në përmbajtjen e tij, duhet të bëjë një jetë të gjallë Kuranore dhe të shkojë tek Allahu me zemër të pastër. Allahu i Madhëruar e shpreh kështu domosdoshmërinë e përvetësimit të kuptimit të Kuranit:

“Ky (Kuran) është një libër i bekuar, që Ne ta kemi zbritur ty (Muhamed), për të përsiatur mbi vargjet e tij dhe për t'u këshilluar me të mendarët.” (Sad, 29.)

Po ashtu, Kurani Fisnik dëshiron që ne të angazhohemi me të në mënyrë të veçantë. Dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të mirë me të, është e domosdoshme që krahas pastërtisë fizike, të zotërojmë edhe pastërtinë e zemrës:

“Ata, që kur paralajmërohen nga shpalljet e Zotit të tyre, nuk bëhen as të shurdhër, as të verbër” (Furkan, 73.)

Sëmundjet e zemrës e pengojnë njeriun të ndërtojë një marrëdhënie të bukur dhe të drejtë. Ata që nuk arrijnë të takohen me mëshirën, shërimin dhe udhëzimin e Kuranit, jo vetëm që nuk kanë përfituar prej begatisë dhe frymëzimit të tij, por do të pësojnë edhe një dështim të madh. Prandaj, është e domosdoshme që ne të përpiqemi të pastrohemi nga sëmundjet e zemrës me qëllim që të ndërtojmë një marrëdhënie të saktë me Kuranin Fisnik.

Një tjetër ajet që tregon qartë se Kurani është zbritur për t'u kuptuar dhe për t'u zbatuar nga njerëzit, është edhe ky:



“Betohem në Librin e qartë! Në të vërtetë, Ne e kemi shpallur Kuranin në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju.” (Zuhruf, 2-3.)

Nëse Kurani kuptohet dhe përjetohet siç na mësohet në këto ajete, meditimi i tij lehtësohet. Pra, Kurani na udhëzon drejt meditimit dhe na e bën të dashur atë. Për shkak se Kurani flet për misteret dhe urtësitë e krijesave, ai ka një rol të veçantë në dije dhe zhvillim. Me anë të kësaj veçorie, ai arrin ta shpëtojë mendjen njerëzore nga plogështia dhe ta motivojë atë drejt të vërtetave sublime.

Kurani Fisnik, i cili i zbriti para 14 shekujsh një profeti që nuk dinte shkrim e këndim dhe përmbante të vërteta shkencore, ka ardhur duke u vërtetuar vazhdimisht bashkë me zbulimet shkencore. Edhe enciklopeditë e përgatitura nga shkencëtarët më të zgjedhur e seriozë, kanë nevojë të korrigjohen vazhdimisht për shkak të zhvillimit të pandërprerë të dijes dhe shkencës. Kurse Kurani Fisnik, përveçse nuk është përgënjeshtuar në asnjë aspekt shkencor përgjatë gjithë këtyre shekujve, ai vazhdon të vërtetohet përditë e më shumë nga zbulimet e reja shkencore. Pra, dija njerëzore, vjen gjithmonë pas dijes hyjnore dhe Kurani i paraprin vazhdimisht dijes njerëzore.

Nëse gjatë edukimit të Kuranit mësohen edhe këto çështje, njerëzit në kohën tonë do ta mësojnë dhe kuptojnë më mirë dhe më drejtë Islamin. Kjo sepse në ditët tona, mendja e shumë njerëzve është e kushtëzuar në atë masë, sa nuk besojnë asgjë që nuk vërtetohet nga shkenca.

3. Të jetosh nën udhëzimin e Kuranit Fisnik

Sahabët e lexonin Kuranin, e kuptonin, e përpunonin në botën e tyre të zemrës dhe e zbatonin në jetën e përditshme. Për shembull, Omeri (r.a.), ka thënë:

*“Suren Bekare e kam përfunduar për 12 vjet dhe si falënderim për këtë, bëra kurban një deve.”*³⁵ Pra, Omerit (r.a.), i janë dashur plot

35. Shih. Kurtubi, I, 40.

12 vite për ta përvetësuar dhe zbatuar plotësisht këtë sure në jetën e tij. Dhe ky është vetëm një prej shumë shembujve në mesin e sahabëve. Nga kjo kuptohet se, sahabët nuk mjaftoheshin vetëm me leximin e Kuranit, por përpiqeshin seriozisht ta kuptonin dhe ta jetonin. Për ta, leximi i Kuranit nuk ishte ashtu siç veprohet në ditët tona, që lexohet pa u kuptuar, vetëm për të kaluar radhën dhe për të vdekurit.

Ja si e përkufizon Ebu Omeri “hafizin e Kuranit”:

“Hafiza të Kuranit, janë ata që i njohin mirë gjykimet, hallallet dhe haramet që ndodhen në Kuran dhe punojnë me to.” (Kurtubi, I, 26.)

Ndërsa Abdullah Ibn Mes’udi (r.a.), e shpreh kështu mendimin e tij, se si duhet të ndikohen hafizat e Kuranit nga fjala e Allahut të Madhëruar:

“Një njeri që e ka mësuar përmendësh Kuranin, duhet të njihet për adhurimin e natës kur të tjerët flenë, për agjërimin kur të tjerët hanë, për meditimin rreth fundit të vet kur të tjerët gëzohen e argëtohen, për të qarët nga dobësia në devotshmëri kur të tjerët qeshin, për heshtjen kur njerëzit flasin me njëri-tjetrin dhe për modestinë kur njerëzit mburren. Ai që e ka mësuar përmendësh Kuranin, duhet të jetë dinjitoz, i ditur dhe fjalëpakë. Po ashtu, zotëruesi i Kuranit nuk duhet të jetë zemërgur dhe indiferent, nuk duhet të ngrejë zërin dhe të jetë gjaknxehët.” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 130.)

Për t’u bërë një rob me të cilin do të kënaqet Allahu, është e domosdoshme që Kurani të zërë vend në zemër, sepse Profeti ynë (a.s.), ditën e gjykimit do të ankohet për ta që janë indiferent ndaj Kuranit dhe jetës nën udhëzimin e tij:

“Dhe i Dërguari do të thotë: «O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer!»”. (Furkan, 30.)

Ndërsa në një hadith fisnik, lajmërohem se ditën e gjykimit, Kurani do të ankohet në këtë mënyrë:

“Kushdo që e mëson Kuranin dhe nuk angazhohet me të, ose nuk vepron sipas tij, ditën e kijametit, Kurani do ta kapë për fyti dhe do të thotë:



«O Zot! Ky robi yt më burgosi, më braktisi, qëndroi larg meje dhe nuk punoi me mua! Prandaj gjyko Ti midis meje dhe këtij!»³⁶

Dashuria dhe pasioni që kishin sahabët për Kuranin, duhet të jetë shembull i mirë për ne. Ata u pajisën me moralin e Kuranit dhe jetuan në Xhenetin e të vërtetave të tij. Për këtë arsye, ata flijuan edhe jetën dhe pasurinë e tyre për ta përhapur Fjalën e Allahun, Kuranin, në të katër anët e botës. Leximi i tyre i Kuranit, nuk përbëhej vetëm nga shqiptimi i fjalëve. Përkundrazi, leximi i tyre ishte përvetësim i plotë i urtësive dhe enigmave të Kuranit dhe zbatim i tyre në jetën e përditshme. Lidhur me këtë të vërtetë, transmetohet një ndodhi shumë domethënëse:

Enesi (r.a.), tregon:

Disa persona erdhën tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i thanë:

“Na dërgoni disa njerëz që të na mësojnë Kuranin dhe fenë!”

Profeti (a.s.), u dërgoi atyre disa persona prej ensarëve, që quheshin “kurra” ndër të cilët ishte dhe daja im. Këta mysliman lexonin Kuran natën, diskutonin në lidhje me të dhe mësonin. Ndërsa ditën sillnin ujë në xhami, mbledhnin dru, i shisnin dhe me fitimin e tyre u siguronin ushqim myslimanëve të varfër të suffes. Ja pra, këta persona u dërgoi Profeti (a.s.).

Mirëpo, pa mbërritur ende në vendin e caktuar, atyre u prenë rrugën dhe i martirizuan të gjithë. (Para se të vdisnin) Ata thanë:

“O Allah! Lajmëroje Profetin se ne arritëm tek Ti, jemi të kënaqur prej Teje dhe Tij je i kënaqur prej nesh!”

Një person iu afrua dajës tim nga pas dhe i nguli heshtën, sa që i doli nga ana tjetër e trupit. Pas kësaj, daja im tha:

“Betohem në Zotin e Qabes se fitova!”

Kur mori vesh për këtë ndodhi, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“S’ka dyshim se vëllezërit tuaj të fesë u martirizuan. Madje

36. Alusi, Ruhu'l-meani, Bejrut, XIX, 14.

ata thanë: «O Allah! Lajmëroje Profetin se ne arritëm tek Ti, jemi të kënaqur prej Teje dhe Tij je i kënaqur prej nesh!» (Buhari, Xhihad, 9; Muslim, Imare, 147.)

Këta sahabë të dashuruar pas Kuranit, arritën kënaqësinë e Allahut dhe mirësi hyjnore të paimagjinueshme. Një nga tablotë e këtyre mirësive hyjnore është edhe kjo:

Një ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha Ubej bin Ka'bit (r.a.), i cili ishte i dashuruar me Kur'anin:

“Allahu Teala më urdhëroi të të lexoj ty suren «Lem jekuni'l-ledhine keferu!»”

Ubej bin Ka'b (r.a.), tha:

“E ka përmendur Allahu emrin tim?”

“Po!” – Tha i Dërguari i Allahut (a.s.)

Ubej bin Ka'b (r.a.), u prek shumë përballë kësaj mirësie hyjnore dhe filloi të qajë. (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 16, Tefsir, 98/1, 3; Muslim, Musafirin 246.)

Në sajë të këtij urdhri të Zotit, Ubej bin Ka'bi (r.a.), jo vetëm që u shpërblye për dashurinë dhe pasionin e tij për leximin e Kuranit, por u motivuan edhe sahabët e tjerë që të mësonin Kuranin prej tij.

Ja pra, ky ishte respekti, dashuria dhe ndjesia e myslimanëve të parë ndaj Kuranit, të cilët arritën majat e botës shpirtërore. Mirëpo për fat të keq, në ditët tona ekzistojnë njerëz që përpiqen t'i japin formë Kuranit sipas interesave dhe mendimeve të tyre të cekëta. Gjendja e këtyre njerëzve përshkruhet qartë në Kuranin Fisnik:

“Ata i shesin fjalët e Allahut për një vlerë të vogël dhe i pengojnë njerëzit nga Rrugja e Tij. Vërtet të shëmtuara janë veprat e tyre!” (Teube, 9.)

Mirëpo, në të vërtetë, Kurani është një libër madhështor dhe i bekuar të cilin ata s'mund ta kuptojnë. Allahu i Madhëruar e shpreh kështu madhështinë e Kuranit Fisnik:

“Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe ruajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni!” (En'am, 155.)



Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), shprehet:

“Lexoni Kuran.... sepse Allahu nuk e dënon një zemër brenda së cilës ndodhet Kurani...” (shih. Darimi, Fezau'l-Kuran, 1.)

Kurse në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), na paralajmëron në këtë mënyrë:

“Ai, brenda të cilit nuk gjendet diçka prej Kuranit, është si një shhtëpi e rrënuar.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kuran, 18/2913.)

Me qëllim që zemrat tona të mos kthehen në një shkretëtirë ku s'ka asnjë shenjë jete, ne duhet ta lexojmë Kurantin, ta kuptojmë dhe ta vëmë në jetë atë. Neglizhimi i përgjegjësive tona ndaj tij dhe mospërfillja e tij, janë shkaqe të një dështimi të tmerrshëm dhe të përjetshëm.

Përpjekja në shërbim të Kuranit Fisnik, është receta më e mirë e shpëtimit në të dyja botët. Në kohën tonë, përpjekje të tilla kanë rëndësi jetike, sepse ky është edhe shërbimi kryesor që do të sigurojë shkundjen dhe rikthimin në identitetet të umetit Islam në ditët tona.

Të bësh njëmijenjë sakrifica vetëm e vetëm që fëmija të mësojë një gjuhë të huaj, duke përzgjedhur dhe bërë krahasime mes kolegjeve ndërkohë që nënvleftëson Kurset e Kuranit, duke i privuar fëmijët nga fjala hyjnore, është një vetëmashtim shumë i hidhur. Mirëpo, suksemi më i madh, është siguri i të mirave për jetën tonë pas vdekjes, duke lënë pas vetes një brez të mirë që lutet për ne.

Në kohën tonë, kur shumica e njerëzve janë të dhënë pas materializmit, është e domosdoshme që shkollat ku mësohet Kurani, të reformojnë veten me qëllim që të mos mbeten vende ku mësohet vetëm leximi i Kuranit. Kjo, sepse sot është shumë e nevojshme të përfordhet entuziazmi i besimit, duke trajtuar më tepër kuptimet e përmbajtjes së Kuranit dhe të merren mesazhet hyjnore që gjenden sidomos në historitë e profetëve. Krahas kësaj, është shumë e domosdoshme të fokusohemi edhe më shumë në historinë e jetës së Profetit tonë (a.s.), jeta shembullore e të cilit ishte një interpretim i gjallë i Kuranit Fisnik.

Në ditët tona, fëmijët tanë i mësojnë përmendësh historitë e jetëve të sportistëve apo artistëve të famshëm, duke i marrë edhe si modele

shembullore për jetën e tyre. Kurse në lidhje me profetët e Zotit, të cilët kanë qenë udhëzuesit tanë në rrugën e së vërtetës dhe lumturisë së përjetshme, nuk njohin as emrat e tyre, e jo më të marrin mësim nga mesazhet hyjnore në jetët e tyre.

Mësuesit e Kuranit -sidomos në ditët tona-, duhet t'i japin më tepër rëndësi nxënësve të tyre. Ata duhet t'i bëjnë nxënësit të dashurohen pas mësimit, sepse një edukim pa dije dhe dashuri, është vetëm lodhje dhe mërzë.

Përveç kësaj, për shkak se Kurani Fisnik mbledh në vete edhe urtësinë e të gjitha dijeve, mësuesit e Kuranit në ditët tona, duhet të kenë njohuri edhe në lidhje me shkencat natyrore e shoqërore.

Allahu i Madhëruar na e mundësoftë ta mësojmë Kuranin, që është udhërrëfyeti i lumturisë dhe udhëzimit tonë të përjetshëm, të punojmë me gjykimet e tij, të jetojmë si besimtarë të devotshëm me frymëzimin e tij dhe të arrijmë ndërmjetësimin e tij në ditën e gjykimit!..

Amin!..



Dashuria dhe shërbimi ndaj Kuranit Fisnik



*Thesari më i madh dhe dhurata më e çmuar që mund t'i japin
prindërit fëmijës së tyre, është ta zbukurojnë atë me moralin
e Kuranit Fisnik. Profeti ynë (a.s.), ka thënë:*

*“Kurani është një pasuri, pas së cilës nuk ka varfëri (kush e
zotëron atë, zotëron thesarin më të madh) dhe që përveç tij
nuk ka pasuri tjetër (nuk ka të krahasuar me asnjë pasuri
tjetër).” (Hejthemi VII, 158.)*

DASHURIA DHE SHËRBIMI NDAJ KURANIT FISNIK

Kurani Fisnik është një qendër e madhe respekti dhe dashurie për besimtarët, sepse ai është vet Fjala e Zotit tonë dhe në të njëjtën kohë “udhërrëfyesi i udhëzimit”. Për këtë arsye, Kurani Fisnik është një çështje dashurie në çdo zemër që “e njeh Zotin e vet dhe shkon drejt Tij me dashuri”. E në fakt, mirësia më e madhe hyjnore për umetin e Muhamedit (a.s.), është nderimi me Kuranin Fisnik. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Ne të kemi shpallur Librin, i cili është përkujtesë për ju. Vallë, a nuk po kuptoni?” (Enbija, 10.)

Horizonti që i dha Kurani Islamit, i cili ka filluar me Ademin (a.s.) dhe arriti përsosmërinë me Profetin tonë (a.s.), përbën shkallën më të lartë të nderit dhe virtytit për birin e njeriut. Kështu, horizonti shpirtëror që mund të arrijnë zemrat e brumosura siç duhet me këtë libër hyjnor madhështor, përfshin edhe hapësirat përtej mendjes dhe imagjinatës. E në fakt, pa u takuar me dritën e Kuranit Fisnik, është e pamundur të kuptosh të vërtetat e cilësive të Krijuesit, enigmën e ekzistencës dhe fundit të njeriut.

Prandaj, në çdo aspekt, Kurani është drita e syrit, gëzimi i zemrës dhe burim i frymëzimit tonë. Është ky Kuran, që si udhërrëfyes shpëtimi dhe diell shpirtëror, e shndërroi armiqësinë fisnore, gjakmarrjen, pa-



drejtësinë dhe grindjet, në atmosferë vëllazërie, paqeje, mirëkuptimi, solidariteti dhe ndihme reciproke, duke ndërtuar në këtë mënyrë Qyte-tërimin e Virtyteve. Ai është një yll i tillë udhëzimi, që shoqëritë të cilat e pasojnë siç duhet atë, i ngre në majat e paqes dhe lumturisë në çdo kohë dhe vend. Diçka e tillë kaq ndikuese si Kurani, i cili e shndërron në Xhenet jetën e kësaj bote, është një pasuri e paçmueshme në dorën e njeriut që ia di vlerën...

E thënë ndryshe, Kurani Fisnik është e tërë gjithësia e pasqyruar në fjalë. Shkencëtarët e fushave të mjekësisë, botanikës, astrofizikës, embrionologjisë, etj., kanë studiuar dhe zbuluar shumë të vërteta të fshehura në këtë gjithësi, të cilat përkojnë me të vërtetat e fshehura në Kuranin Fisnik. Dhe kjo do të vazhdojë në këtë mënyrë deri në ditën e kiametit, kur do të zbulohen plotësisht të gjitha të vërtetat e Kuranit, sepse ai nuk përmban dijen e një krijese të dobët, por dijet hyjnore të Allahut të Madhëruar, i Cili na lejon të zbulojmë dhe kuptojmë aq sa na bën dobi në kohë dhe vende të ndryshme.

Për këtë arsye, edhe dijetarët e fushës së tefsirit, pasi kanë dhënë mendimin e tyre në bazë të dijes dhe aftësive shpirtërore, thonë, “Allahu e di më mirë të saktën!”. Po ashtu, në çdo kohë, me mijëra e miliona myslimanë e kanë mësuar përmendësh Kuranin Fisnik, gjë e cila i ka detyruar edhe vet orientalistët të pohojnë se diçka e tillë nuk ka ndodhur me asnjë libër tjetër në botë. Në shumë raste, vet Profeti ynë (a.s.), i ka motivuar besimtarët në këtë çështje. Kështu, në një hadith fisnik, ai ka thënë:

“Më të nderuarit e umetit tim janë hafizat e Kuranit dhe ata që gjallërojnë netët.” (Sujuti, I, 36/1063.)

Prandaj ne, si njerëz dhe myslimanë, e kemi për detyrë që ta mësojmë këtë Libër madhështor, ta kuptojmë dhe ta vëmë atë në jetë me aq sa kemi mundësi. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kurani është një pasuri, pas së cilës nuk ka varfëri (kush e zotëron atë, zotëron thesarin më të madh) dhe që përveç tij nuk ka pasuri tjetër (nuk ka të krahasuar me asnjë pasuri tjetër).” (Hejthemi VII, 158.)

Po ashtu, në një hadith kudsi, Allahu i Madhëruar ka thënë:



“Kush angazhohet me leximin e Kuranit dhe përmendjen Time, e nuk gjen kohë për të më kërkuar diçka, Unë i jap më tepër se ata që më kërkojnë.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 25/2926.)

Dashuria dhe respekti ndaj Kuranit

Përgjegjësinë e madhe që sahabët dhe dijetarët e devotshëm kanë ndjerë ndaj Kuranit Fisnik, e tregon fakti se sa ka ndikuar ai në jetët e tyre. Respekti dhe dashuria që kishin ata ndaj Kuranit, është shembull i bukur për ne në çdo aspekt. Dhe kjo, padyshim se ka ardhur si rezultat i pasimit të moralit profetik nga ana e tyre. Për shembull:

Kur Omeri dhe Osmani (r.anhuma), ngriheshin në mëngjes, e kishin zakon ta puthnin Kuranin. Po ashtu edhe Abdullah Ibn Omeri (r.a.), çdo mëngjes e merrte në dorë Kuranin, e puthte dhe, me ndjenja të larta, shprehte dashurinë ndaj tij duke thënë: *“Premtimi i Zotit tim! Urdhri i qartë i Zotit tim!”*³⁷ Në të njëjtën mënyrë edhe Ikrimë (r.a.), e merrte Kuranin, vendoste fytyrën e tij në të dhe duke qarë, shprehte dashurinë dhe respektin ndaj Allahut duke thënë: *“Fjala e Zotit tim! Libri i Zotit tim!”*³⁸

Në kohën e sahabëve, kur lindte nevoja për të fshirë shkrimin e shkruar me bojë, përdorej uji. Kështu, Enesi (r.a.), na bën të ditur se në kohën e Hulefa-i Rashidinëve, nxënësit, ujin me të cilin lahashin ajetet e Kuranit, nuk e hidhnin sa andej këndeje, por përkundrazi, e mblidhnin atë në enë të veçanta dhe e derdhnin në anë të varreve, ose në vendet ku nuk shkelte këmba e njeriut.

Krahas respektit dhe dashurisë që kishin për Kuranin, sahabët e lexonin aq shumë atë, saqë nuk mund ta mendonin që t'u ikte ndonjë ditë pa e lexuar dhe pa i parë faqet e tij. Ata e fillonin ditën e tyre me Kuran. Madje, edhe atyre që kishin probleme me sytë, u këshillohej të shihnin Kuranin.³⁹

Faktin që Kurani është shërim, i Dërguari i Allahut (a.s.), e shpreh me këto fjalë:

37. Shih. Kettani, II, 196-197.

38. Shih. Hakim, el-Mustedrek, III, 272.

39. Shih. Hejthemi, VII, 165.

“Kurani është shërimi më i mirë!” (Ibn Maxhe, Tib, 28.)

Po ashtu, Osmani (r.a.), i cili për shkak të shërbimeve të mëdha që ka kryer për Kuranin ka marrë titullin, “Xhami-i Kuran / Mbledhësi i Kuranit”, ka vjetërsuar dy kopje të Kuranit ngaqë e lexonte shumë shpesh.⁴⁰

Kur skllavi i liruar i Abdullah Ibn Omerit (r.a.), Nafi, u pyet:

“Çfarë bënte Abdullahu në shtëpinë e tij?”, ai u përgjigj:

“Njerëzit nuk mund ta bëjnë atë që bënte ai! Ai merrte abdes të ri për çdo namaz dhe ndërmjet dy kohëve (të namazit) hapte Kuranin dhe vazhdimisht e lexonte.” (Ibn Sa’d, IV, 170.)

Një shembull i bukur i dashurisë dhe respektit ndaj Kuranit, është edhe veprimi i themeluesit të Shtetit Osman, Osman Gazit. Siç rrëfëhet, një natë, kur ai qëndroi si mysafir në shtëpinë e Shejh Edebalit, i erdhi rëndë të shtrihej e të zgjaste këmbët, sepse në murin e dhomës ku u vendos për të fjetur ishte varur një Kuran. Për rrjedhojë, atë e zuri gjumi ulur dhe, pikërisht atë natë, pa edhe ëndrrën e famshme që është interpretuar si myzhde e sundimit të botës. Sipas mendimit të përgjithshëm, shteti i madh, themelet e të cilit i hodhi ai personatit të lartë, arriti të qëndronte për një kohë shumë të gjatë në këmbë për shkak të begatisë të respektit dhe dashurisë që ishte treguar ndaj Kuranit Fisnik.

Respektin dhe dashurinë që Orhan Gazi kishte ndaj Kuranit, e tregojnë edhe këto këshilla që ai ia ka lënë djali të tij Muradit:

“O bir, mos u shman nga urdhri i Kur’anit të Shenjtë! Sundo me drejtësi! Kujdesu për veteranët! Ushqeji të varfrit! Konsideroje si nder shërbimin personalisht ndaj atyre që i shërbejnë fesë! Mos vono t’i ndëshkosh të padrejtët, sepse drejtësia më e keqe është ajo që shfaqet me vonesë! Sado që në fund vendimi të jetë i drejtë, edhe drejtësia e vonuar është një lloj padrejtësie!”

Siç shihet qartë edhe nga këto shembuj të çmuar, thelbi i këshillave dhe porosive është “respekti ndaj Kuranit dhe bindja ndaj urdhrave të

40. Shih. Kettani, II, 197.



tij”. Për rrjedhojë, thesari më i madh dhe dhurata më e çmuar që mund t’i japin prindërit fëmijës së tyre, është ta zbukurojnë atë me moralin e Kuranit Fisnik.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Allahu nuk dëgjon asgjë aq sa dëgjon një rob i cili fal dy rekatë namaz natën (dhe lexon Kur’an). Mëshira e Allahut bie mbi kokën e robit derisa ai është në namaz. Njerëzit kurrë nuk mund të jenë më afër Allahut se sa kur janë duke u angazhuar me Kur’anin.”

(Tirmidhi, Fedailu’l-Kur’an, 17/2911.)

Ebu Dheri (r.a.), tregon:

I thash të Dërguarit të Allahut:

“Këshillomë, o Resulullah!”

“Lexo Kuran dhe përmend Allahun, sepse për ty, Kurani është dritë në tokë dhe furnizim në qiell.” – tha ai. (Ibn-i Hibban, Sahih, II, 78.)

Kurani Fisnik është doktori i zemrave tona, ushqimi i shpirtrave tanë dhe burim i shërimit për ne. Aq sa është dashuria dhe besnikëria jonë ndaj Kuranit, në atë masë do të shfaqet edhe shërimi i tij tek ne, sepse Allahu na e ka dhuruar atë si “shërim dhe mëshirë”:

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...” (Isra, 82.)

**Leximi i Kurani duke e kuptuar,
duke e ndjerë dhe duke marrë frymëzim prej tij.**

Lumturia e vërtetë, është të jetosh në Xhenetin e të vërtetave të Kuranit, sepse ai është një dritë që pastron botën e brendshme dhe të jashtme të individit, një libër që i jep zemrave mësim dhe këshilla, shërim për sëmundjet shoqërore dhe individuale, rruga më e sigurt që të çon drejt Allahut, ndriçues i errësirave, udhërrëfyes drejt të panjohurave të jetës dhe një fjalë hyjnore që siguron lumturinë dhe harmoninë e pafundme.

Për të përfutur prej këtyre mirësive të Kuranit, është e domosdo-



shme që ai të lexohet duke u ndjerë thellë në zemër dhe duke u frymëzuar prej tij. Kjo ndodhi shumë mësimdhënëse e transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a.), tregon qartë se Kurani Fisnik ka zbritur për t'u lexuar duke u kuptuar dhe për të punuar me të sipas udhëzimeve të tij:

Një herë, Profeti ynë i nderuar (a.s.), do të niste me mision një njësi të madhe ushtarake. Para se të niseshin, Profeti (a.s.), i urdhëroi të lexojnë Kuran; dhe secili lexoi atë që kishte mësuar përmendësh. Më pas, Profeti (a.s.), shkoi pranë sahabit që ishte më i riu në moshë dhe i tha:

- O ti filan! Çfarë di përmendësh? Ai tha:

- Unë di përmendësh filan sure dhe suren Bekare! – Tha ai. Profeti (a.s.), e pyeti përsëri:

- E di përmendësh suren Bekare?

Kur i riu i tha:

“Po!”, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Shko, ti je komandanti i tyre, sepse kjo sure e përmbledh pothuajse të gjithë fenë.”

Njëri nga prijësit e xhematit tha:

- O i Dërguari i Allahut! Frika se nuk do të mund ta vë në jetë përmbajtjen e saj, më ka penguar ta mësoj atë sure!

Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Mësojeni Kuranin, lexojeni, mësojuani të tjerëve dhe punoni me të, sepse ai që e mëson Kuranin, e lexon dhe punon me të, është si një çantë e mbushur me misk, aroma e të cilit shpërndahet në çdo anë. Kurse ai që e mëson Kuranin dhe fle (e lë shërbimin e Kuranit), është si një çantë e mbushur me misk, por që i është lidhur gryka.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 2/2876.)

Fjalët e Profetit (a.s.), në këtë ngjarje, tregojnë nivelin e edukimit që do të arrijë dikush që e lexon dhe e vë në jetë suren Bekare.

Synimi i përgjithshëm dhe i vetëm i Kuranit, është shpëtimi i



zemrave nga angazhimi me dëshirat dhe lakmitë e padobishme, që i degradojnë në indiferencë mendjet dhe mendimet, orientimi i tyre (zemrave) drejt njohjes së Allahut dhe afrimit me Të. Prandaj, për ta arritur këtë synim, është e domosdoshme angazhimi i vazhdueshëm me Kuranin.

Çdo besimtar duhet ta kuptojë dhe ta zbatojë Kuranin në jetën e tij të përditshme, gjë që është domosdoshmëri e besimit dhe kriter i devotshmërisë. Për rrjedhojë, edhe sahabët fisnikë, kur i mësonin dhjetë ajete nga i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk kalonin në mësimin e dhjetë ajeteve të tjera, pa i kuptuar dhe pa i zbatuar mirë dhjetë ajetet e para.⁴¹ Për shembull, Abdullah Ibn Omeri (r.a.), ka rritur ta përvetësojë suren Bekare për tetë vjet.⁴²

Po ashtu, edhe Aliu (r.a.), duke dashur të na tregojë mënyrën se si mund të përfitojmë nga Kurani Fisnik, na këshillon:

“Mësojeni Librin e Allahut, sepse Libri i Allahut është fjala më e çmuar. Mundohuni të jeni të informuar në lidhje me Kuranin, sepse Kurani është pranvera e shpirtrave. Kërkoni shërim nga drita e Kuranit, sepse Kurani është shërim për sëmundjet e zemrës. Lexojeni bukur Kuranin, sepse Kurani është shprehja më e lartë. Kur lexohet Kuran afër jush, heshtni dhe dëgjojeni me vëmendje, në mënyrë që të mëshiroheni. Kur ju mësohet diçka nga Kurani, punoni me të në mënyrë që të udhëzoheni, sepse dijetari që nuk jeton në bazë të diturisë që ka, nuk ka ndryshim nga i padituri që ka devijuar për shkak të mosdijes së tij.” (Ibn Kethir, Bidaje, 7/30)

Ndërsa Abdulkadir Gejlani shprehet:

“O bir! Të punosh sipas Kuranit, të lartëson dhe të vendos në pozitën e Kuranit. Ndërsa, të punosh sipas sunnetit, të afron tek i Dërguari i Allahut (a.s.).”

Po ashtu, edhe Muhjiddin Arabi, ka këshilluar kështu në lidhje me Kurani:

“Duhet ta lexosh shumë Kuranin dhe të mendosh për kuptimin

41. Shih. Ahmed, V, 410.

42. Shih. Muvatta, Kuran, 11.



e tij. Gjatë leximit, bëj kujdes në cilësitë me të cilat Allahu Teala ka cilësuar robërit e Tij të dashur! Shih edhe ato vepra të këqija, të cilat Kurani i gorton dhe Allahu i ka cilësuar si të humbura; e ruaju prej tyre. Të gjitha këto, Allahu i ka zbritur dhe i ka përmendur në librin e Vet, vetëm që ti të punosh me to dhe të bësh atë që kërkohet. Për këtë arsye, kur të lexohet Kurani, bëhu njësh me Kuranin, që të kuptosh brendësinë e tij!”

“Kur të lexosh Librin e Allahut, që është fjala më e bukur, medito mirë rreth gjykimeve dhe historive të tij! Kështu, Allahu do të të falë një botëkuptim të thellë. Xhibrili e zbriti Kuranin në zemrën e Profetit (a.s.), me lejen e Allahut. Ndërsa Kurani i frymëzon zemrat e njerëzve të devotshëm që e lexojnë, sikur të jetë duke u zbritur rishtazi. Nëse ia mëson Kuranin edhe të tjerëve, bëhesh ndihmësi i Allahut.”

“Duhet bërë shumë kujdes që ajetet e Allahut të mos lexohen me pavetëdihe. Ato duhen lexuar me zemër të ndjeshme, duke u përpjekur të kuptohen e të zbatohen. Shumë hafiza dhe dijetarë nuk kanë përfituar gjë prej leximit të Kuranit për shkak se e kanë lexuar në mënyrë të pavetëdijshme.”

Ndërsa Ibrahim Desuki, fton pasuesit e Kuranit drejt moralit dhe maturisë për të përfituar plotësisht nga mirësia e Kuranit. Ja si shprehet ai:

“Njeriu i cili dëshiron të lexojë Kuran, në fillim duhet të pastrojë gjuhën nga fjalët e këqija e të shëmtuara. Nuk duhet ta teprojë në asnjë çështje dhe duhet të qëndrojë i vendosur përballë gjërave të dyshimta dhe të ndaluara. Nëse nuk tregohet i kujdesshëm ndaj këtyre çështjeve, atëherë nuk është treguar i ndershëm ndaj Kuranit...”

“Biri im! Nëse dëshiron të kuptosh të fshehtat e Kuranit pastroje egon tënde dhe përpiku të përfitosh nga mirësia e Kuranit. Lëri fjalët e kota, merru me punë të dobishme! Vendose faqen në tokë (bëhu modest), mos harro se ke ardhur nga toka dhe përsëri tek ajo do të kthehesh. Frikësohu nga tërësia e mëkateve dhe përplasja me to



Ditën e Kiametit. Llogarite mirë nëse veprat do të të pranohen apo jo. Nëse vepron kështu, atëherë do të mund të kuptosh mesazhet e fshehta të fjalës së Zotit tënd. Nëse nuk vepron kështu kjo derë hyjnore nuk hapet për ty.”

Nisur nga kjo, mund të themi se, ata që e lexojnë Kuranin pa shpirt, qoftë edhe me një zë të bukur, nuk mund të quhen pasues të Kuranit nëse nuk i kuptojnë urtësitë e tij dhe nuk punojnë me të. E në fakt, ajo që është thelbësore për myslimanët, është qëllimi, mendimi dhe përpjekja për t'u brumosur me Kuranin.

Në të njëjtën mënyrë, edhe ata besimtarë që duan të matin dashurinë që kanë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), duhet të shohin se sa kanë përvetësuar prej diturive të Kuranit dhe sa reflektohet ai në jetët e tyre.

Edukimi i fëmijëve tanë me Kuranin Fisnik

Nëse u mësojmë Kuranin fëmijëve tanë, do t'u kemi falur atyre thesarin më të madh. Kështu, në sajë të këtij amaneti të paçmueshëm që do të bartin, do të bëhen njerëz të dashur të Allahut dhe të Profetit (a.s.). Edhe Profeti ynë (a.s.), në çdo çështje u jepte më përparësi zotëruesve të Kuranit. Kur ishte duke u përgatitur për fushatën e Tebukut, sanxhakun e bijve të Nexharit, ia dha Umare bin Hazmit (r.a.). Mirëpo, kur pa Zejd bin Thabitin (r.a.), e mori sanxhakun prej Umares dhe ia dha atij. Umare (r.a.), pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Mos u hidhërove gjë me mua? (Bëra ndonjë gjë të papëlqyeshme?)”

Profeti (a.s.), iu përgjigj:

“Jo! Vallahi nuk jam hidhëruar! Por edhe ju merruni më shumë me Kuran! Zejdi ka mësuar më shumë Kuran se ty. Njeriut që di më shumë Kuran, i jepet më tepër përparësi se të tjerët, edhe nëse mund të jetë një skllav me hundë të prerë!” (Uakidi, Megazi, Bejrut 1989, III, 1003.)

Më pas urdhëroi fiset Evs dhe Hazrexh që flamurët të mbahen



nga personat që kishin mësuar më shumë Kuran. Për shkak të këtij urdhri, flamurin e Bijve të Aufit e mbajti Ebu Zejdi, ndërsa atë të Bijve të Selimes, e mbajti Muadhi (r.a.).

Një tjetër shembull lidhur me virtytet e zotëruesve të Kuranit, është edhe ky:

Nafi bin Abdi'l-Haris u takua në Usfan me Omerin (r.a.). Mirëpo, për shkak se Omeri (r.a.), e kishte emëruar atë si vali në Mekë, e pyeti:

- Kë ke lënë (si zëvendës) në krye të mekasve?
- Ibn Ebzan! -U përgjigj ai.
- Kush është Ibën Ebza? - Pyeti Omeri (r.a.).
- Një nga skllëvërit që kemi liruar. - U përgjigj Nafiu.

Kur Omeri (r.a.), i tha:

- Ti ke lënë një skllav të liruar në vendin tënd? - Nafiu i dha një përgjigje shumë të bukur dhe mbresëlënëse:

- Ai e lexon Librin e Allahut (e jeton dhe e zbaton) dhe i njeh mirë farzet.

Pas kësaj, Omeri (r.a.), i mahnitur thotë:

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Me këtë Kuran, Allahu ua rrit vlerën disave dhe i poshtëron disa të tjerë!” (Muslim, Musafirin, 269.)

Kjo qasje e Profetit tonë (a.s.), ndaj atyre që dinin Kuran dhe punonin me të, duhet të na motivojë të gjithëve që të përpiqemi sa më shumë në mësimin e Kuranit dhe zbatimin e tij në jetën tonë. Nuk duhet të harrojmë se, asgjë tjetër nuk e nxin jetën shpirtërore të njeriut më shumë se sa neglizhenca e treguar ndaj Kuranit.

Për rrjedhojë, për të arritur nivelin e një umeti me të cilin do të kënaqej Allahu dhe i Dërguari i Tij (a.s.), duhet të edukojmë veten dhe fëmijët tanë me kulturën e Kuranit Fisnik, sepse ai është udhëzuesi ynë për çdo fazë të jetës. Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Pa dyshim se, në këtë Kuran, Ne kemi dhënë shembuj nga



më të ndryshmit për njerëzit, me qëllim që të marrin këshillë.”

(Zumer, 27.)

Më tepër se një e treta e Kuranit, përmban historitë mësimdhënëse të profetëve. Prandaj, zemra e çdo myslimani duhet të jetë me Kuranin, tek i cili duhet të kërkojë zgjidhjen e çdo problemi në jetën e vet.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i përgëzon me këto fjalë prindërit që udhëzohen në rrugë të drejtë me dijen dhe urtësinë e Kuranit, përvetësojnë moralin e tij dhe ua mësojnë Kuranin edhe fëmijët e tyre:

“Edukojini fëmijët tuaj në tri çështje: Në dashurinë ndaj Profetit, në dashurinë ndaj Ehl-i Bejtit dhe në leximin e Kuranit..., sepse shërbyesit e Kuranit (ai që mëson Kuran, ua mëson të tjerëve dhe shërben në këtë rrugë), do të jenë së bashku me profetët dhe të dashurit e Allahut nën hijen e Arshit, në ditën e kijametit kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit.” (Munavi, I, 226.)

Edukimi i Kuranit, është një detyrë që duhet të realizohet me kujdes që në moshë të vogël, sepse veshët e fëmijës duhet të mësohen me zërin e Kuranit dhe zemra e tij duhet të futet në botën e tij. Kur një fëmijë prej bijve të Abdulmutalibit fillonte të fliste, Profeti (a.s.), i mësonte ajetin 111. së sures el-Isra, duke ia lexuar atë shtatë herë: **“Thuaj: «Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmës” dhe madhëroje Atë, duke ngritur lart madhësitinë Tij!”** (Abdurrezak, IV, 334; Ibn-i Ebi Shejbe, I, 348.)

Fëmijët, të cilët janë vazhdimësia e ekzistencës sonë, janë stolia e kësaj jete. Ata janë krijuar me natyrë të pastër Islame dhe i janë lënë amanet prindërve të tyre. Për këtë arsye, zhvillimi dhe orientimi i duhur i jetës së tyre shpirtërore krahason asaj materiale, është detyra më e rëndësishme e prindërve dhe përgjegjësia që kanë para Allahut të Madhëruar.

Trashëgimia më e çmuar dhe më e vërtetë që mund t'i lërë një besimtar fëmijës së tij, është pasuria e përjetshme. Fëmijëve nuk u duhen treguar kënaqësitë e përkohshme, por rruga e një lumturie të përjetshme, e cila nuk vyshket, nuk vjetrohet dhe nuk prishet. Dhe



kushti i parë i kësaj, është t'i ndihmohet ata të familjarizohen fizikisht dhe mendërisht me Kuranin Fisnik. Për të shprehur këtë të vërtetë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Më i miri prej jush, është ai që e mëson Kuranin dhe ia mëson atë të tjerëve.”*⁴³ Prandaj, një besimtar e ka për detyrë që gjatë gjithë jetës të jetë në të njëjtën kohë edhe nxënësi i Kuranit, edhe mësuesi i atyre që di.

Historia është dëshmitare se, individët, familjet dhe kombet, kanë mundur të zhvillohen aq sa i janë bindur, e kanë respektuar dhe i kanë shërbyer amanetit hyjnor, Kuranit Fisnik. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), në Haxhin e Lamtumirës është shprehur:

“...Po ju lë një amanet të tillë, që po të kapeni fort pas tij, nuk keni për ta humbur rrugën. Ky amanet është Libri i Allahut dhe Sunneti i Profetit të Tij...” (Hakim, I, 171/318.)

Shërbimet dhe sakrificat në fushën e Kuranit, kanë rëndësi shumë të madhe në kohën tonë, kur edukimi moralo-shpirtëror nuk zhvillohet mjaftueshëm, si rezultat i së cilës është shtuar së tepërmi edhe amoraliteti, narkotizmi, vjedhja dhe vrasja, duke dobësuar kështu edhe ndjenjat e atdhedashurisë. Neglizhenca në këtë çështje, na ngarkon me një faj të rëndë për shkak të rrezikimit të vetes, të brezave të rinj dhe të gjithë umetit Islam.

Edhe pse nuk mund të mendohet ndonjë mjerim më i madh se armiqësia ndaj Kuranit, neglizhimi që tregohet në çështjen e shërbimit ndaj tij, bart një gjynah thuajse të ngjashëm me të. Në ditët tona, kur njerëzit janë kapluar nga modat negative të kohës, duke u tërhequr zvarrë si trungjet nëpër përrenj, për t'u ruajtur nga rryma e mohimit, pafesisë dhe indiferencës, duhet që t'u mësojmë Kuranin të afërmve, familjes dhe njerëzve që na rrethojnë, duke u përpjekur të përhapim dritën, frymëzimin dhe begatinë e tij. Nuk duhet të harrojmë kurrë se ne kemi nevojë për Kuranin në të dyja botët. Duke qenë vazhdimisht të angazhuar me Kuranin, do t'i zbatojmë më mirë urdhrat dhe ndalesat e tij dhe do të përvetësojmë ashtu siç duhet moralin që predikon ai. Në



të kundërtën, do të pësojmë një dështim të madh, duke i shkatërruar të dyja botët.

Shekulli në të cilin që po jetojmë, është një kohë kur indiferenca e ka përfshirë familjen aq shumë, saqë brezat e rinj po humbasin orientimin e duhur. Dhe në fakt, shpërdorimi më i keq, është shpërdorimi që i bëhet njeriut.

Nga ana tjetër, mbrojtja e fesë, jetës, nderit, pasurisë dhe brezit të ardhshëm, është e detyrueshme. Dhe kjo arrihet vetëm në sajë të mbrojtjes së atdheut. Prandaj, është e domosdoshme që brezin e ri, ta edukojmë me vetëdijen e dashurisë ndaj Allahut, Kuranit dhe atdheut.



Nëse dashuria për Kuranin Fisnik nuk bie në zemrat tona të shkretuara si shirat e begata të prillit, nuk mund ta arrijmë stinën profetike. Kopshtet e zemrave, si një tokë e përmalluar për shi, presin shirat e veprave të mira të bëra me frymëzimin e Kuranit Fisnik, sepse këto shira mëshire, gjelbërojnë filizat e mëshirës, shërbimit, dashurisë dhe dhembshurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Kështu, njeriu arrin të bëhet thelbi i librit të gjithësisë dhe Allahu bëhet syri i tij me të cilin sheh, veshi me të cilin dëgjon, dora me të cilën mban, këmba me të cilën ecën dhe zemra me të cilën ndjen. E për rrjedhojë, prej gjuhës dhe zemrës së tij përfitojnë të gjitha krijesat e tjera.

Të parët tanë të nderuar, i kanë dhënë rëndësi të jashtëzakonshëm përpjekjeve për punë të mira, të cilat përbëjnë pasurinë më të mirë që duhet fituar në këtë botë, dhe njëkohësisht, janë kapitali më i mirë në botën tjetër. Për këtë arsye, ata e kanë përhapur shërbimin e tyre në të katër anët e botës. Në mënyrë të veçantë; për shkak se e kishin kuptuar mirë se lumturia e të dyja botëve mund të arrihen duke shërbyer me gjithë shpirt në rrugën e Kuranit, ata e kanë përcjellë dashurinë, respektin dhe shërbimin ndaj tij tek çdo brez për shekuj me radhë. Kështu edhe ne; me qëllim që pasi të japim frymën e fundit, varri ynë të mos mbetet i shkretë dhe i pavizituar dhe që të përfitojmë prej ndihmës shpirtërore që do të na vijë prej njerëzve në formën e



sadakasë së pandërprerë nga bota që i dhamë lamtumirën, duhet ta zbukurojmë shpirtin tonë duke e përcjellë entuziazmin e besimit dhe frymëzimin shpirtëror të Kuranit në jetën tonë dhe tek fëmijët tanë.

NËSE DËSHIROJMË QË FËMIJËT TANË TË JENË TË PËRSOSUR, DUHET TË PËRPIQEMI TË BËHEMI PRINDËR TË PËRSOSUR.

Nuk duhet harruar se, në krye të veprave të pranuara tek Allahu, vjen “Emr bi’l-maruf ue nehj ani’l-munker”, pra, “urdhërimi në punë të mira dhe ndalimi nga të këqijat”. Dhe kjo, mund të realizohet vetëm nëse e kuptojmë Kuranin në mënyrën e duhur dhe ua mësojmë këtë njerëzve. E në fakt, burimi i moralit, mirësisë, paqes dhe lumturisë që ka nevojë njerëzimi, është pikërisht Kurani Fisnik.

Zoti ynë! Na stolis me dijen e Kuranit! Gjallëroi zemrat tona në atmosferën e meditimit të pafund të Kuranit dhe bahçen e trëndafilave të dashurisë së Profetit tonë (a.s.); në mënyrë që të vijmë tek Tij me dëshminë e Kuranit në favorin tonë!

Lum ata që e kryejnë një detyrë të tillë kaq të rëndësishme ndaj fëmijëve të tyre dhe brezave të rinj, duke marrë kështu dëshminë e çuarjes në vend të përgjegjësisë ndaj Kuranit... O Zot! Na bëj edhe neve prej këtyre njerëzve të mirë!..

O Zot! Ruaje atdheun dhe kombin tonë nga largimi prej Kuranit, besimit dhe moralit! Na e bëj të mundur vazhdimësinë e brezave të frymëzuar me Kuranin Fisnik dhe që në këtë botë të përkohshme, të bëjmë një jetë Xheneti, duke u përfshirë prej madhështisë së vërtetë të Kuranit Fisnik!..

Amin!..



Ramazani i bekuar



Mëshira, si dëshmitarja e humanes tek ne në këtë botë, është një aftësi hyjnore që na afron shpirtërisht me Allahun e Madhëruar. Dhe, adhurimi që e ushqen më mirë mëshirën tek ne, duke na trajnuar për të, është agjërimi. Egoja jonë duhet edukuar me uri, me qëllim që zemra jonë të mbushet me ndjenjën e mëshirës, që dora e ndihmës sonë të zgjatet tek nevojtarët, që zemra jonë të qajë hallet e tyre dhe të zërë vend pranë të vuajturve.

Tek ai që agjëron, fillon një çlirim shpirtëror i shpirtit, i cili shpëton prej hegjemonisë së egos, dhe shpirtrat ngjiten në qiejt e shpëtimit. Mëshira që na mëson dhe na bën të përjetojmë agjërimi, është një hapësirë aq e gjerë, saqë në të janë fshehur misteret e shumë botëve.

RAMAZANI I BEKUAR

Muaji i Ramazanit, së bashku me adhurimin e agjërimit, namazit, sadakasë dhe luftës me egon, është një stinë përfitimesh të veçanta për të arritur moralin e bukur. Po ashtu, për shkak se na bën të përjetojmë një jetë Kuranore të mbushur me frymëzim dhe begati shpirtërore, ai bart një vlerë shumë të veçantë. Muaji i Ramazanit, është si një lloj ure virtyesh që shtrihet prej përkohësisë drejt përjetësisë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), vlerën e këtij muaji dhe mënyrën e përfitimit prej begatisë së tij, na e ka bërë të ditur me këto fjalë në ditën e fundit të një muaji Shaban:

“O njerëz! Ju mori nën hije një muaj i madhërishëm e i begatë! Muaj në të cilin gjendet një natë që është më e vlefshme se njëmijë muaj. Allahu, agjërimin e tij e bëri obligim, ndërsa faljen e namazit gjatë netëve të tij e bëri vullnetar (nafile). Ai, i cili në këtë muaj i afrohet Allahut me një vepër të mirë, është njësoj sikur ta ketë kryer një obligim fetar (farz) në muajt e tjerë. Ai, i cili e kryen një obligim fetar, është njësoj sikur t’i ketë kryer shtatëdhjetë obligime fetare në muajt e tjerë. Ky është muaji i durimit, dhe shpërblimi për durimin, është Xheneti. Është muaji i solidarizimit. Muaji në të cilin shtohet furnizimi i besimtarit. Kushdo që i jep iftar një agjëruesi, kjo vepër do t’ia shlyejë gjynahet, do t’ia lirojë qafën nga zjarri, si dhe do të ketë shpërblimin e njëjtë me agjëruesin, pa iu pakësuar atij (agjëruesit) asgjë nga shpërblimi i tij.” Sahabët thanë:



“Jo të gjithë ne kemi mundësi t’u japim iftar agjëruesve!” Profeti (a.s.), tha:

“Allahu këtë shpërblim ia dhuron çdokujt që i dhuron iftar një agjëruesi, qoftë edhe një hurmë, një gllënjë ujë, apo qumësht të përzier me ujë. Ai është një muaj, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi falje dhe fundi lirim nga zjarri.

Ai i cili ia lehtëson robit të tij, Allahu do t’ia shlyejë gjynahet dhe do ta lirojë nga zjarri. Në këtë muaj, shtoni sa më shumë katër prej veprave të mira; me dy prej tyre e kënaqni Zotin tuaj dhe për dy të tjerat nuk do të keni gjithmonë nevojë. Sa i përket dy veprave me të cilat e kënaqni Zotin tuaj, ato janë: Thënia «Nuk ka Zot përveç Allahut / La ilahe il-la Allah» dhe kërkimi i faljes prej Tij. Ndërsa dy veprat për të cilat do të keni gjithmonë nevojë, janë: T’i kërkoni Allahut Xhenetin dhe t’ju mbrojnë nga zjarri. Atij që ngop një agjërues, Allahu do t’i japë të pijë prej hauzit tim një gllënjë, pas së cilës kurrë nuk do ta marrë etja deri sa të hyjë në Xhenet.”

(Ali el-Muttaki, VIII, 477/23714.)

Siç shihet, në përmbajtjen e këtij hadithi, gjenden shumë përgëzime të cilat përbëjnë kapitalin e lumturisë së përjetshme. Për t’i merituar këto përgëzime, çdo besimtar, pikësëpari duhet ta njohë mirë vlerën e këtyre dhe të përpiqet seriozisht në zbatimin e tyre. Duke u nisur nga rëndësia që bart ky hadith, e shohim të dobishme të ndalemi pak mbi disa prej pikave që përmenden në të:

Një nga arsyet më të rëndësishme që e bën Ramazanin muajin e mirësive, është se brenda tij gjendet një prej dhuratave hyjnore më madhështore, që është “Nata e Kadrit”. Ajo është një natë në të cilën mëshira hyjnore rrjedh si lum dhe umetit të Muhamedit (a.s.), i falen thesare të panumërta. Për shkak të madhësisë së asaj nate, lidhur me të është zbritur një sure e veçantë. Kjo natë është ndriçuar me zbritjen e Kuranit dhe është mbushur me përshpirtshmërinë e uljes së Xhibrilit (a.s.) dhe melekëve të tjerë në faqen e tokës.

Ajo është një natë e mbushur me frymëzim dhe begati shpirtërore, ku besimtarëve u jepet selam nga melekët e Allahut; ajo është një natë



mëshire e Zotit për robërit e Tij dhe stina e pranverës së Ramazanit. Po ashtu, edhe ky hadith lidhur me vlerën e asaj nate, i freskon zemrën e besimtarit:

“Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe vetllogari, i falen gjynahet e mëparshme!” (Buhari, Iman, 28; Muslim, Musafirin, 175.)

Nata e Kadrit, është një natë shumë e veçantë mirësie, falje dhe mëshire, që i është falur vetëm umetit të Muhamedit (a.s.). Atij që e kalon këtë natë me adhurime, Allahu i Madhëruar i jep shpërblimin e njëmijë muajve, pra sa për 83 vite, gjë e cila mjafton për të shprehur madhështinë e mirësive të Allahut në këtë muaj ndaj robërve të Tij besimtarë.

Nëna e besimtarëve, Aisha (r.anha), e pyeti Profetin (a.s.):

“O i Dërguar i Allahut! Nëse do ta dija se kur është Nata e Kadrit, si duhet të lutem atë natë?” Profeti ynë (a.s.), u përgjigj:

“Thuaj: «اللَّهُمَّ إِنَّكَ عَفُوٌّ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي» / O Allah! Ti je falës, më fal mua!” (Tirmidhi, Deauat, 84; Ibn-i Maxhe, Dua, 5.)



Lidhur me këtë muaj të bekuar, Mevlana Xhelaledin Rumi, në veprën e tij *“Divani Kebir”*, ka thënë:

“Erdhi Ramazani! Tashmë largohuni nga ushqimet materiale, që t’ju vijnë nga qielli furnizimet shpirtërore. Ky është muaji kur shtrohet sofra e zemrës. Muaji kur zemra shpëton prej gjynaheve të trupit dhe mbushet me dashuri e besim.”

Nëse zemrat nuk largohen nga dëshirat e përkohshme, s’mund ta arrijnë ëmbëlsinë e përrjetshme. Njësoj si fëmijët që nuk i shijojnë ushqimet dhe shijet më të mira nëse nuk shkëputen prej qumështit të gjirit. Agjërimi është një adhurim që na kujton se sa duhet të ruhem prej haramëve dhe të dyshimtave, duke na larguar prej disa hallalleve brenda një pjese të caktuar të ditës. Në një hadith fisnik thuhet:

“...Për agjëruenin ka dy gëzime: Njëri është kur të bëjë iftar dhe tjetri kur ta takojë Allahun, e Ai ta shpërblejë. Pasha Atë, në duart



e të cilit është shpirti i Muhammedit, era e gojës së agjëruesit, është më e dashur për Allahun se era e miskut.” (Muslim, Sijam, 164.)

Në duanë e iftarit, që e bëjmë para se të çelim agjërimin, themi:

اللَّهُمَّ لَكَ صُيِّمْتُ وَبِكَ أُمْنَعْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ

“O Allah, për Ty agjërova, Ty të besova, tek Ti jam mbështetur dhe me begatitë e Tua po bëj iftar!”

Kjo dua, e shpjegon më së miri edhe anën shpirtërore të agjërit. Pra, na bën të ditur se me cilën gjendjen shpirtërore duhet të mbahet agjërimi. Nisur nga kjo:

Kur themi, “اللَّهُمَّ لَكَ صُيِّمْتُ / O Allah, për Ty agjërova!”, kemi theksuar qëllimin tonë, duke e mbajtur zemrën larg syfaqësisë.

Kur themi, “وَبِكَ أُمْنَعْتُ / Ty të besova”, bëjmë të ditur themelin e të gjitha adhurimeve tona. Pra, adhurimet fizike, si namazin dhe agjërimin, nuk i bëjmë me qëllim që të përfitojmë prej të mirave shëndetësore, por vetëm sepse besojmë se është domosdoshmëri e besimi tonë. Kjo, sepse grada shpirtërore e adhurimeve dhe devotshmërisë ndaj Allahut, është në proporcion të drejtë me forcën e besimit.

Kur themi, “وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ / tek Ti jam mbështetur!”, kemi pohuar dobësinë tonë dhe kemi shprehur dorëzimin ndaj fuqisë dhe madhështisë së pafundme të Allahut të Madhëruar. Kjo do të thotë që ne duhet t’u japim adhurimeve tona një pjekuri të veçantë shpirtërore, duke i forcuar ndjenjat tona të mbështetjes tek Allahu dhe jo tek krijesat.

Ndërsa kur themi, “وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ / me begatitë e Tua po bëj iftar!”, e pohojmë me gjithë zemër se jetojmë në pronën e Allahut dhe se çdo furnizim na vjen prej tij, duke u fokusuar më tepër tek Furnizuesi, se sa tek furnizimi.

Për të realizuar një agjërim të pranueshëm, çështja më e rëndësishme për të cilën duhet të bëjmë kujdes, është të ruhem nga syfaqësia. Një agjërim i bërë larg syfaqësisë, është manifestimi më i virtytshëm i devotshmërisë. Kurse për agjërimet dhe namazet e turbulluara me



qëllime të tjera dhe të përziera me syfaqësi e indiferencë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Sa e sa agjërues nuk përfitojnë gjë nga agjërimi i tyre, përveç qëndrimit me barkun bosh. Sa e sa besimtar që i kalojnë netët duke falur namaz, nuk përfitojnë gjë nga namazet e tyre, përveç pagjumësisë.” (Ibn Maxhe, Sijam, 21.)

Disa nga njerëzit e devotshëm, i kanë ndarë agjëruesit sipas pjekurisë së zemrës së tyre:

Agjërim, është ndalimi i vetes nga ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet seksuale, prej agimit deri në namazin e akshamit. Ky është agjërimi i njerëzve të zakonshëm. Ndërsa agjërimi i njerëzve të ditur dhe të devotshëm, është ndalimi i vetes nga çdo gjë që është e ndaluar.

Po ashtu, sipas tyre, në Sheriat, shpërdorim është të hash edhe pasi të jesh ngopur. Në Tasavuf, shpërdorim është të hash derisa të ngopesh. Në Hakikat, shpërdorim është të hash sasinë e mjaftuar por i pakujdesshëm ndaj prezencës së Allahut. Ndërsa në Marifet, shpërdorim është të hash pa menduar bukuritë hyjnore në mirësitë që ka dhuruar Allahu Teala.

Sa mësimdhënëse është ky kujtim që Shejh Sadi e ka shkruar në librin e tij me titull “Gylistani”:

“Në fëmijëri isha shumë i dhënë pas jetës askete dhe namazit të natës. Një natë, kur po qëndroja me babanë duke lexuar Kuran, përreth kishte njerëz që po flinin. I thashë babait:

- Baba! Të gjithë po flenë, askush nuk ngrihet për të falur namaz nate, por flenë si të vdekur.

Babai u vërejt dhe tha:

- Biri im! Do ishte më mirë të flije edhe ti si ata, në vend që t'i përgojoje. Ata mund jenë të privuar nga mëshira hyjnore në këto momente, por në të njëjtën kohë në librin e tyre nuk shkruhen gjynahe. Kurse në librin tënd tashmë u shkrua një gjynah.”

Sa i përket namazit të pakujdesshëm, Allahu i Madhëruar na para-



lajmëron duke na thënë, **“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm e veprojnë vetëm sa për sy e faqe (para botës)”** (Maun, 4-6.). Nisur nga kjo, edhe agjërimi duhet të gëzojë të njëjtin kujdes nga ana jonë, me qëllim që jetë i pranueshëm tek Allahu i Madhëruar. As namazi nuk duhet bërë si një lloj ushtrimi fizik për të ndihmuar tretjen dhe as agjërimi nuk duhet të kthehet në dietë të thjeshtë për të rënë nga pesha. Për këtë arsye, ashtu siç ndodh me namazin, edhe agjërimi ka hollësitë e tij të veçanta që e orientojnë robin drejt kujdesit dhe sinqeritetit. Kjo, sepse agjërimi dhe namazi, mund të arrijnë gradën e përsosur vetëm në sajë të harmonisë shpirtërore ku nuk bën pjesë vetëm trupi, por edhe zemra.

Po ashtu, që agjërimi të jetë i pranuar tek Allahu, përveç stomakut, duhen ruajtur nga gjynahet edhe gjuha, syri, veshi dhe organet e tjera. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Agjërimi është mburojë, derisa të cenohet me gjëra që nuk i kanë hije agjëruesi”

“Si cenohet, o i Dërguari i Allahut?” -Pyetën sahabët.

“Me gënjeshtra dhe përgojime...” – U përgjigj Profeti (a.s.). (Nesai, Sijam, 43.)

Pra, duhet të ruhem nga veprat që e cenojnë agjërimin, siç janë përgojimi, tallja e vëllait mysliman me shenja apo me aludime, siç e përmend edhe Kurani kur thotë, **“Mjerë për çdo përqeshës – shpifës!”** (Humeze, 1.)

Sklavi i liruar i të Dërguarit të Allahut (a.s), Ubejdi (r.a), rrëfen:

“Dy gra kishin agjëruar. Aty nga koha e drekës erdhi një person i cili tha:

«O Dërguarit të Allahut! Aty janë dy gra që agjërojnë. Pothuajse janë duke vdekur nga etja. (Jepini leje ta prishin agjërimin.)»

I Dërguari i Allahut (a.s.), i ktheu shpinën dhe nuk i dha përgjigje.

Personi e përsëriti sërish të njëjtën gjë:

«O Profet i Allahut! Për Zotin, pothuajse janë duke vdekur!»



Profeti (a.s.), urdhëroi:

«*Thirri ato!*» Gratë erdhën dhe Profeti (a.s.), kërkoi t'i sillnin një enë. Më pas ai ia dha enën njërës prej grave dhe i tha:

«*Nxirre jashtë atë që ke brenda!*» Gruaja volli gjak, copëza mishi dhe qelbi aq sa e mbushi gjysmën e enës. Kur Profeti (a.s.), e urdhëroi edhe gruan tjetër të bënte të njëjtën gjë, ajo volli nga goja gjak dhe mish të freskët. Pas kësaj Profeti (a.s.), tha:

“Këto gra e përmbajtën veten nga gjërat që Allahu i ka bërë hallall në jetën e përditshme duke mbajtur agjërim. Por, kur erdhi koha ta prishin agjërimin, ato e prishën atë me gjërat që Allahu ua ka ndaluar. Ato u ulën pranë njëra-tjetrës dhe filluan të përgojnë njerëzit.” (Ahmed, V, 431; Hejthemi, III, 171.)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“*Allahut nuk i duhet lënia e ushqimit dhe e pijes së atij që nuk heq dorë nga gënjeshtria dhe të vepruarit me të.*” (Buhari, Saum, 8.)

Ashtu siç ruhemi prej haramëve shpirtërore, si përgojimi, gënjeshtria dhe mashtrimi, ashtu duhet të ruhemi edhe nga haramet materiale dhe gjërat e dyshimta, sepse statusi i një kafshate, ndikon shumë në gjendjen shpirtërore të njeriut. Afrimi me Allahun, varet nga largimi prej të dyshimtave dhe urrejtja ndaj haramëve. Po ashtu, edhe pastrimi i egos dhe purifikimi i zemrës mund të realizohen vetëm me kafshatën hallall. Lidhur me këtë, Sufjan Theuri ka thënë:

“*Devotshmëria e njeriut varet nga kafshata hallall.*”

Po ashtu, si shembull për këtë, mund të japim edhe përpikërinë që tregonin të parët tanë ndaj kafshatës hallall:

Kur Sulltan Javuz Selim Hani po shkonte në fushatën e Egjiptit, e fushoi ushtrinë në Gebze, në një vend që ishte përplot me vreshta dhe bahçe. Mirëpo, para se të niseshin përsëri, Sulltan Javuz Selimin e shqetësonte një mendim:

“Vallë, mos ndokush prej ushtarëve të mi ka këputur rrush ose mollë pa lejen e të zotit?!..”



Për këtë arsye, ai thirri Agait e Jeniçerëve dhe e urdhëroi:

“Aga, ky është fermi (urdhri) im! Të kontrollohen të gjitha çantat e jeniçerëve, kalorësve dhe këmbësorisë! Nëse në çantën e dikujt prej tyre gjendet rrush apo mollë, silleni menjëherë para meje!”

Agai i Jeniçerëve veproi menjëherë dhe i kontrolloi të gjitha çantat. Më pas, doli para sulltanit dhe i tha:

“Sulltan! Nuk gjeta asnjë vesh rrush apo mollë të këputur!..”

Javuzi u gëzua shumë nga ky lajm. Dukej sikur ishte çliruar nga ndonjë ngarkesë. Më pas hapi duart dhe falënderoi Allahun duke thënë:

“O Allah! Qofsh pafundësisht i falënderuar dhe i lavdëruar, sepse Ti më ke falur një ushtri që nuk ha prej haramit!..”

Pastaj i drejtohet Agait dhe i thotë:

“Nëse ushtarët e mi do të kishin këputur ndonjë frut pa leje, do të kisha hequr dorë nga fushata e Egjiptit, sepse vendet nuk mund të çlirohen me një ushtri që ha prej haramit!..”

Muaji i Ramazanit, është i mbushur me adhurime të veçanta si agjërimi, namazet e teravive, namazet e natës, etj. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Allahu i Madhëruar e bëri të detyrueshëm agjërimin e ramazanit; ndërsa unë e bëra sunnet namazin.” (Ibni Maxhe, Salat, 173.)

Dhe me të vërtetë që ditë dhe netët e këtij muaji kanë një ndjesi shpirtërore shumë të veçantë. Në fakt, çfarëdo ditë e vitit të jetë, kohët para agimit kanë rëndësi të jashtëzakonshme për njerëzit e devotshëm, sepse ato janë kohët kur Allahu e fton robin e Vet drejt faljes dhe mëshirës. Madje, lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar urdhëron:

وَالضُّحَىٰ وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَىٰ

“Betohem në shkëlqimin e paradites dhe në natën kur erret e qetësohet!” (Duha, 1-2)



تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا
وَمِمَّا رَزَقْنَاهُمْ يُنفِقُونَ

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.” (Sexhde, 16.)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar na bën të ditur cilësitë e robërve të devotshëm, të cilët u ka premtuar mirësitë e Xhenetit:

وَالَّذِينَ يَسْتُونَ لِرَبِّهِمْ سُجَّدًا وَقِيَامًا

“Ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë.” (Furkan, 64.)

كَانُوا قَلِيلًا مِّنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu).” (Dharijat, 17-18.)

Zemrat mund të zgjohen vetëm në sajë të afërsisë me Allahun e Madhëruar. Dhe, mënyra më e mirë e realizimit të kësaj, është me anët të dhikrit që bëhet në kohën para agimit. E në fakt, për të shlyer dëmet që lindin prej “harresës” dhe “pakujdesisë”, që gjenden në natyrën e njeriut, duhet që njeriu ta mbajë gjithmonë të gjallë vetëdijen e devotshmërisë ndaj Allahut. Prandaj ka nevojë edhe për dhikrin, sepse përsëritja e diçkaje në mënyrë të vazhdueshme, e forcon vendin e saj në mendje dhe në zemër.

Allahu nuk e sheh robin në strukturën e jashtme (në pamje), por në zemër. Prandaj, çdo besimtar, duke e mbrojtur nga indiferentizmi zemrën, ku shfaqen vështirimet hyjnore, duhet ta dijë për detyrë që ta preokupojë atë me dhikr. Për shkak të kësaj rëndësie që ka dhikri mes detyrave të adhurimit, ai përmendet në më shumë se dyqind vende në Kuran. Adhurimi i Allahut në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale dhe, në

këtë mënyrë, afrimi te Allahu, realizohen në përpjesëtim të drejtë me pozitën dhe thellësinë e dhikrit në zemër. Në një pjesë të ajeteve mbi çështjen e dhikrit, me qëllim që njerëzit të mos mbeten të privuar nga fryma shpirtërore e dhikrit, Zoti ka urdhëruar:

أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ الْحَقِّ

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur..?” (Hadid, 16.)

Ja pra, për besimtarët që dëshirojnë të zhvillojnë aftësitë e zemrave të tyre, agimet që gjallërohen me përmendjen e Allahut -njësoj si toka në pranverë që pret me mall shiun që të çelë bukuritë e saj-, janë kohë të veçanta të mbushura me frymëzim shpirtëror. Një i dashuruar pas dhikrit, shprehet:

“...Zërat që vijnë thellë nga ndërgjegjja, e thërrasin besimtarin në adhurim në kohën e agimit. Ky zë, është zëri i ezanit shpirtëror që thërret myezini i dashurisë. Ky zë, duket sikur i thotë besimtarit: «Zgjohu nga gjumi, sepse dashuria ndaj Allahut është më e mirë se gjumi!» Kur besimtari e përmend Zotin e vet në kohën para agimit, në zemrën e tij do të shfaqet e vërteta dhe njohja e Zotit. Ndërsa namazet do të bëhen miraxh për të. Të flesh gjumë në këtë kohë kur gufon mëshira e Zotit, është një fatkeqësi e madhe. Ashtu siç ndër të gjithë muajt e tjerë, Ramazani ka ardhur si mëshirë për besimtarët, edhe koha para agimit është e begatë mes 24 orët e tjera të ditës. Në këtë kohë të bekuar, robërit e mirë të Allahut zgjohen dhe gjejnë dashurinë e tyre të vërtetë.”

Në kohën para agimit, hapen dyert e mëshirës, dhe zemrave që janë zgjuar, u thuhet; “urdhëroni!”. Mbi të gjitha, nëse kjo ftesë bëhet në para-agimet e kurorëzuara me frymëzim shpirtëror të Ramazanit të Bekuar, sigurisht që edhe shpërblimet dhe arritjet do të jenë ashtu siç i ka hije madhështisë së atij muaji të begatë.

Ramazani i Bekuar, është një stinë adhurimi. Siç transmetohet prej



nënës së besimtarëve, Aishas (r.anha.), i Dërguari i Allahut (a.s.), përpiqej të kryente më shumë adhurime në këtë muaj. Ndërsa në dhjetë ditët e fundit të këtij muaji, i shtonte edhe më tepër adhurimet. (shih. Muslim, Itikaf, 8; Ibn Maxhe, Sijam, 57.)

Muaji i Ramazanit, është një si një tokë e begatë edhe në aspektin e adhurimeve të tjera. Për shembull, lidhur me Umren e Ramazanit, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Umreja e bërë në muajin e ramazanit, ka shpërblimin e një haxhi (të vërtetë), ose konsiderohet si një haxh i kryer së bashku me mua!” (Buhari, Umre, 4; Muslim, Haxh, 221.)

Një emër tjetër i Ramazanit të Bekuar, është edhe “Shehru’s-Sabr”, pra, “Muaji i Durimit”. Durimi është qendra e peshës së moralit të bukur, gjysma e besimit dhe çelësi i harmonisë dhe lumturisë. Po ashtu, durimi është një virtut madhështor që të çon drejt mirësive të Xhenetit. Durim, do të thotë të qëndrosh i qetë, pa e prishur ekuilibrin përballë ndodhive të papëlqyeshme dhe t’i dorëzohesh Allahut. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Askush nga ju të mos thotë ndonjë fjalë të pahijshme apo të grindet me kënd ditën që të jetë agjërueshëm. Nëse dikush e fyen apo kërkon të zihet me të, atëherë le t’i thotë: «Sot jam agjërueshëm!»” (Buhari, Saum, 9.)

Gjatë muajit të Ramazanit, në mënyrë të veçantë duhet të ruheni shumë nga zemërimi, sepse nga një aspekt, agjërimi është mbajtja nën kontroll i sjelljeve dhe disiplinimi i tyre. Agjërimi është një adhurim që i fal agjëruesit virtutet e durimit, qëndresës dhe vullnetit. Agjërimi që mbahet duke respektuar rregullat në mënyrën e duhur, e shpëton shpirtin nga robëria e prirjeve të egos. Agjërimi është një disiplinë shpirtërore që e bën zapt egërsirën e egos brenda nesh, dhe në këtë mënyrë, i siguron njeriut zhvillimin e ndjenjave të mëshirës dhe dhembshurisë që ndodhen në thellësi të natyrës së tij. Pra, agjërimi është adhurimi më i mirë që na mëson dhe na ushqen mëshirën. Egoja jonë duhet edukuar me uri, me qëllim që zemra jonë të mbushet me ndjenjën e mëshirës, që dora e ndihmës sonë të zgjatet tek nevojtarët, që zemra jonë të qajë



hallet e tyre dhe të zërë vend pranë të vuajturve. Kjo, sepse mëshira, si dëshmitarja e humanes tek ne në këtë botë, është një aftësi hyjnore që na afron shpirtërisht me Allahun e Madhëruar.

Tek ai që agjëron, fillon një çlirim shpirtëror i shpirtit, që shpëton prej hegjemonisë së egos dhe shpirtrat ngjiten në qiejt e shpëtimit. Mëshira që na mëson dhe na bën të përjetojmë agjërimi, është një hapësirë aq e gjerë, saqë në të janë fshehur misteret e shumë botëve. Kurse njeriu i pamëshirshëm, për shkak se e sheh botën nga horizonti i tij i ngushtë egoist, e çon dëm jetën e tij brenda një indiference të vazhdueshme.

Kështu, në sajë të mirësisë hyjnore, zemrat tona duhet të stolisen me cilësi të bukura si falja, butësia, dinjiteti, dhembshuria, mëshira, delikatesa dhe toleranca, me qëllim që prej kopshtit të këtyre zemrave të përhapen aromat e Xhenetit.

T'u bëhesh ortak halleve dhe vuajtjeve të besimtarëve, bart një rëndësi edhe më të madhe gjatë muajit të Ramazanit, sepse në këtë muaj të bekuar forcohen edhe më tepër ndjenjat e vëllazërisë. Vëllazëria në Islam, është si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Lidhur me vëllazërinë Islame, Ebu'l Hasan el-Harakani i ka shprehur kështu ndjenjat e veta:

“Gjembi që ka shpuar gishtin e dikujt, diku prej Turkistanit, e deri në Sham, ka shpuar gishtin tim; një gur që ka vrarë këmbën e dikujt, ka vrarë këmbën time; e nëse në një zemër ka trishtim, ajo zemër është e imja.”

Gjithashtu, agjërimi i Ramazanit, në sajë të privimit nga disa të mira dhe trajnimit me uri, e forcon ndjenjën e vlerësimit dhe falënderimit të mirësive. Duke na bërë të mendojmë për gjendjen e nevojtarëve, zgjon tek ne prirjen për t'i gëzuar zemrat e tyre. Nga ky këndvështrim, Ramazani është një muaj i volitshëm për të dhuruar. Për rrjedhojë, në sajë të sadakave vullnetare që bëhen në këtë muaj, është e mundur të fitohet shpërblimi i adhurimeve farz. Lidhur me këtë, Abdullah ibn Abbas (r.a.), na e tregon kështu entuziazmin e dhurimit që përjetonte Profeti ynë (a.s.), në këtë muaj të bekuar:



“I Dërguari i Allahut ishte më bujari i njerëzve. Kurse në muajin e Ramazanit, bujaria e tij shtohet edhe më shumë! Çdo vit në Ramazan, te ai vinte Xhebraili (a.s.) dhe atë muaj e kalonin së bashku gjer në fund. (Gjatë kësaj kohe) Profeti i këndonte Kuran Xhebrailit (a.s.). Ja pra, në ato ditë, i Dërguari i Allahut (a.s.), bëhej më bujar se erërat mbarështuese!” (Muslim, Fedail, 50.)

Ndërsa Halid Bagdadi bën këtë përkufizim mbi bujarinë e të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“Ç’bujari e bukur është ajo që, si rrjedhojë e qenies së tij nga e cila shpërthen bujari, nga deti del margaritar, nga guri i fortë del smerald dhe nga gjembi del trëndafil! Nëse në një lulishte bisedohet mbi moralin e tij të bukur, nuk mund të shohësh gonxhe që të mos hapet e të qeshë nga gëzimi, domethënë, gonxhe që të mos çelë!” (Divan, f. 65-66)

Pasuria më e mirë, është ajo prej së cilës dhurohet sa gëzon shëndet dhe shkon në botën tjetër para të zotit të saj. Jeta më e mirë, është ajo që kalohet në rrugën e Allahut. Kur njeriu të jetë duke mbyllur sytë në këtë botë, do të varroset me kujtimet e kësaj jete të përkohshme. Në një hadith fisnik thuhet:

“Kur vdes një besimtar, namazi i qëndron tek koka, zekati në të djathtë dhe agjërimi në të majtë.” (shih. Hejthemi, III, 51.)

Nga ana tjetër:

Kur njeriu vdes, melekët pyesin: “Çfarë solli?”. Kurse njerëzit pyesin: “Çfarë la?”. Kjo na bën të kuptojmë se njeriu duhet të mendojë për të ardhmen dhe ato që lë pas, sepse një njeri i mençur, është ai që e mendon të nesërmen sa është ende gjallë.

Ramazani është një shkollë devotshmërie, ndërsa Bajrami, është diploma shpirtërore e saj. Bajramet nuk janë ditë pushimi, por ditë të begata adhurimi, falënderimi, vizitash tek të afërmit dhe kohë kur përjetohet vëllazëria e besimit në planin shoqëror. Po ashtu, në mënyrë të veçantë, në këtë ditë, duhet të gëzojmë zemrat e nevojtarëve dhe të vuajturve, sepse ai që mëshiron, mëshirohet. E kush gëzon dikë për hir të Allahut, edhe Allahu e gëzon atë.



Gjithashtu, edhe netët e Bajramit që pasojnë pas netëve të Ramazanit, janë të mbushura me begati shpirtërore të cilat mund t'i perceptojnë vetëm shpirtat e ndjeshëm. Në një hadith fisnik, thuhet:

“Zemrat e atyre që i shfrytëzojnë netët e Ramazanit dhe të Bajramit duke bërë adhurime e duke shpresuar në shpërblimin e Zotit të madhëruar, nuk do të vdesin atë ditë kur të gjithë zemrat do të vdesin.” (Ibn Maxhe, Sijam, 68.)

Nga ky aspekt, edhe netët e Bajramit duhet të konsiderohen si mirësi më vete. Nuk duhet harruar se, Bajrami i vërtetë, do të jetë atë ditë kur besimtarët të dalin para Allahut pasi ta kenë kaluar me sukses sprovën e devotshmërisë. Për këtë arsye, të urtët kanë thënë:

لَيْسَ الْعِيدُ لِمَنْ لَبَسَ الْجَدِيدَ إِنَّمَا الْعِيدُ لِمَنْ أَمِنَ الْوَعِيدَ

“Bajrami i vërtetë nuk është për ata që veshin rroba të reja, por për ata që janë të sigurt nga dënimi i Allahut.”

Me pak fjalë, gjatë Ramazanit të Bekuar, ne duhet të përvetësojmë virtytin e agjërit dhe, në mënyrë të veçantë, duhet t'i gjallërojmë zemrat tona me namazet e natës. Në këtë muaj të bekuar, duhet t'i shtojmë adhurimet tona, duke lexuar sa më shumë Kuran dhe me përkushtim të thellë, duke u angazhuar më tepër me përmendjen e Allahut (dhikr) dhe duke arritur paqen shpirtërore me anë të zekatit, dhurimeve dhe sadakave. Po ashtu, në këtë muaj të bekuar, në të cilin është zbritur Kurani Fisnik në qiellin e kësaj bote, duhet ta rishikojmë devotshmërinë tonë nën dritën e Kuranit, duke e llogaritur vazhdimisht veten tonë.

Allahu na e bëftë të mundur të bëjmë një jetë brenda një atmosfere shpirtërore të frymëzuar nga Ramazani i Bekuar! Allahu i bëftë ditët e Ramazanit dhe të Bajramit burim lumturie dhe paqeje për atdheun, popullin tonë dhe gjithë botën Islame!..

Amin!..



Haxhi i pranuar dhe Umreja



Në haxh, njeriu kupton më mirë dobësinë e vet përballë madhësisë hyjnore dhe në sajë të ihramit që vesh, përjeton një atmosferë të veçantë meditimi sikur të ishte i mbështjellë me qefin. Nga ky këndvështrim, mbase përfitimi më i madh prej haxhit, është mbajtja gjallë e zemrës duke përjetuar herë pas here misterin e vdekjes dhe entuziazmin e ftesës hyjnore,

“Kthehu tek Zoti yt!..” (Fexhr, 28.).

HAXHI I PRANUAR DHE UMREJA

Familja e parë njerëzore, që filloi me Ademin (a.s) dhe Havanë, e përvetësuan vendin që sot është Qabeja në Meke si vend-adhurimin e parë në tokë, për jetuar fenë në atmosferën e paqes dhe qetësisë. Si rezultat i kushteve sociale dhe jetësore, pasardhësit e tyre u përhapën në vende të ndryshme. Më vonë, me kalimin e kohës dhe ndryshimin e gjeneratave, njerëzimi u largua nga feja e vërtetë dhe ky vend-adhurim i shenjtë humbi. Shekuj më vonë, me urdhrin e Allahut të Madhëruar, Ibrahim (a.s.), e ndërtoi përsëri atë vend adhurimi dhe u lut që ajo zonë të begatohej. Lidhur me këtë, Allahu (xh.sh.), urdhëron:

“(Kujtoje) kur Ibrahim tha: «O Zoti im! Bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve! O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga ruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë. O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbi-llet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashamirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë!»” (Ibrahim, 35-37.)

Më në fund, erdhi Epoka e Lumturisë, e cila ngjan me ikandinë e ditës së kësaj bote dhe Profeti Muhamed (a.s.), shfaqti për herë të fundit majat e përsosmërisë në atë vend ku filloi për herë të parë jeta fetare. Ai jetoi dhe ndërtoi një Epokë Lumturie me qendër Mekën dhe



Medinën. Në këtë mënyrë, ato qytete u bënë vende të shenjta që vizi-tohen vazhdimisht dhe qendrat ku rreh dhe do të rrahë pulsi i Islamit dhe myslimanëve deri në kiamet.

Allahu i madhëruar urdhëron:

فِيهِ آيَاتٌ بَيِّنَاتٌ مَقَامُ إِبْرَاهِيمَ وَمَنْ دَخَلَهُ كَانَ آمِنًا
وَعَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلًا
وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ

“Në të ka shenja të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); (fakti që) kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.” (Al-i Imran, 97.)

Adhurimi i haxhit, i cili është një detyrë fetare për robërit e Allahut, duhet të bëhet pa u vonuar dhe me entuziazëm të madh. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush dëshiron të bëjë Haxhin, le të nxitojë!” (Ebu Daud, Menasik, 5/1732.)

Po ashtu, edhe shprehja “Lebbejke Allahumme”, pra, “të përgjigjem Ty o Allah”, në njëfarë mënyre e tregon më së miri këtë entuziazëm të madh.

Nuk duhet të harrojmë se jeta i dhurohet njeriut vetëm një herë. Prandaj, ata që janë të obliguar për haxh, duhet t’i mendojnë mirë këto të vërteta dhe të bëjnë kujdes të veçantë që të mos tregojnë shkujdesje e neglizhencë ndaj këtij adhurimi të madh, sepse kur t’i vijë fundi jetës, nuk ka më vlerë pendimi.

Çdo mysliman që ka mundësi (financiare dhe shëndetësore) e ka për detyrë ta bëjë haxhin një herë në jetën e tij. Ndërsa përsëritja e tij është e pëlqyeshme dhe, për të ka shpërblime prej Allahut. Në haxh, ashtu siç në çdo adhurim tjetër, kryesore është kënaqësia e Allahut.



Krahas kësaj, aty shfaqet dashuria dhe dashamirësia mes myslimanëve që vijnë nga të katër anët e botës. Edhe pse gjuhët, ngjyrat, zakonet dhe traditat janë të ndryshme, ndjenjat e dashurisë në zemra, i kapërcejnë këto dallime dhe i bëjnë myslimanët si një zemër e vetme që rreh në të njëjtin moment. Aty përjetohet një vëllazëri fetare shumë e bukur në paqen dhe lumturinë e unitetit të zemrave. Ata që e kryejnë haxhin me përkushtim dhe modesti, e ndjejnë veten sikur janë vazhdimisht para Allahut të Madhëruar. Ndjesia e mbikëqyrjes hyjnore dhe ihsanit, zë vend në zemrat e tyre dhe, nëse e ruajnë edukatën e tyre, u shtohet edhe aftësia e meditimit dhe ndjesisë. Allahu i Madhëruar, u jep gjerësi dhe pasuri zemrave të atyre që bëjnë haxhin. Kështu, tek ata zhvillohet ëmbëlsia e besimit dhe, mundësitë materiale e shpirtërore, fillojnë të vihen edhe më tepër në dispozicion të këtyre ëmbëlsive hyjnore.

Edhe pse Imam Ebu Hanifja kishte shumë nxënës dhe angazhime, ai i kushtonte haxhit afërsisht një të tretën e kohës së vet. Duhet të kemi parasysh se në kushtet e asaj kohe, udhëtimi nga Bagdadi për në Mekë e Medinë me deve, ka qenë shumë i vështirë. Mirëpo, njerëzit e devotshëm, e konsideronin Mekën dhe Medinën si dy vende të shenjta, atmosfera shpirtërore e të cilave nuk mund të gjendet në asnjë vend tjetër. Për këtë arsye, ata e konsideronin si fat dhe mirësi të madhe mundësinë për të shkuar në haxh dhe për të vizituar varrin e Profetit tonë (a.s.).

Vendet e haxhit janë begatuar me kujtimet e profetëve, janë ushqyer me shpirtin zemrave besimtare dhe janë ujitur me lotët e haxhinjve nga Ademi (a.s.), e deri në ditët e sotme. Ato që bëjnë haxhin me përkushtim shpirtëror i kushtojnë kujdes faktit të mësipërm; ata kërkojnë gjurmët shpirtërore të profetëve aty dhe, duke kujtuar këto, pajisen me një kënaqësi të thellë. Në haxh, njeriu kupton më mirë dobësinë e vet përballë madhësisë hyjnore, dhe në sajë të ihramit që vesh, përjeton një atmosferë të veçantë meditimi sikur të ishte i mbështjellë me qefin. Nga ky këndvështrim, mbase përfitimi më i madh prej haxhit, është mbajtja gjallë e zemrës duke përjetuar herë pas here misterin e vdekjes dhe entuziazmin e ftesës hyjnore, **“Kthehu tek Zoti yt!..”** (Fexhr, 28.).



Po ashtu, ata që veshin ihramin, për shkak të ndalimit edhe prej disa hallalleve për një kohë të caktuar, kuptojnë edhe se sa e rëndësishme është të qëndrosh larg prej të dyshimtave dhe haremeve. Gjithashtu, për shkak edhe të ndalesës së disa veprimeve, si cenimi i gjelbërimit, gjuetisë, etj., ndërkohë që janë në ihram, ata arrijnë ndjesinë e një besimi të mbushur me mëshirë, dhembshuri dhe delikatesë.

Ashtu si të gjitha adhurimet, edhe kryerja e haxhit dhe umres në mënyrë që të jenë të pranueshme tek Allahu, varet nga horizonti i besimit. Të arrish të bësh një haxh ideal, pra, të pranuar tek Zoti, të pastron prej gjynaheve dhe të bën të fitosh kënaqësinë e Allahut. Pra, arritja e rezultateve të dëshiruara prej adhurimeve, është e mundur vetëm nëse bëhen ashtu siç dëshiron Allahu i Madhëruar.

Në këtë kontekst, fjalët e mëposhtme që Shibli ia pat thënë një personi që kishte shkuar në Qabe, duke aluduar në aspektin shpirtëror të haxhit, janë një vërejtje mësimdhënëse dhe udhëzuese për të gjithë udhëtarët e haxhit:

“Kur të bësh nijetin për haxh, nuk do të numëroresh se e ke bërë atë me të vërtetë, në qoftë se nuk je penduar për të gjitha gjynahet e bëra dhe nëse nuk je drejtuar për në udhën e drejtë. Nëse nuk je zhveshur nga të gjitha gjynahet në momentin kur heq rrobat e tua dhe vesh ihramin, nuk të numërohet se e ke veshur atë me të vërtetë. Nëse uji i guslit, që merr para se të nisësh haxhin, nuk i pastron edhe papastërtitë shpirtërore dhe sëmundjet e zemrës, nuk quhet se ke marrë gusl me të vërtetë.

Nëse nuk zotohesh se do të braktisësh të gjitha haramet dhe çdo lloj fjale e sjelljeje që të largon nga Allahu, ndërsa hyn në Harem (Qabe), nuk do të quhesh se ke hyrë me të vërtetë aty, ndonëse këmba jote e ka shkelur atë tokë. Nëse nuk i ke shkrirë në kënaqësi hyjnore, dëshirat dhe vullnetet e tua epshore të tejskajshme, kur pret kurbanin, nuk do të quhesh se e ke prerë atë me të vërtetë.

Nëse nuk e ke përzënë me gurë injorancën e tundimin që ke përbrenda, si dhe nëse nuk kanë zënë vend tek ti dituria dhe kultura shpirtërore, atëherë, kur gjuan me gurë shejtanin, nuk do të quhet se e ke gjuajtur me të vërtetë.



A u shtuan darovitjet hyjnore tek ti me rastin e vizitës së Qabes, a u mbush shpirti yt me prehje dhe ngazëllim? Në hadithin fisnik thuhet:

“Ata që bëjnë haxhin dhe umren, janë të ftuarit e Allahut. Darovitja që i vizituari i bën vizituesit, është një e drejtë e pashmangshme.” Po qe se ti nuk e ke perceptuar këtë favor, nuk numëroresh nga vizitorët e vërtetë...” (Shih Ibn Arabi, el-Futuhatu'l-Mekkiye, sakt. Uthman Jahja, Kajro 1986, X, 133-1 38.)

Shkurtimisht, veçoria rreth së cilës Shibli kërkoi të tërheqë vëmendjen, ishte zbatimi i shpalljes hyjnore:

“Kryejini siç duhet haxhin dhe umren për hir të Allahut” (Bekare, 196.)

Për të kryer një haxh dhe umre të pranuar tek Allahu i Madhëruar, duhen respektuar disa kushte:

1. Të nisesh në haxh me qëllim të pastër vetëm për hir të Allahut dhe të ruhesh nga çdo veprim që e cenon qëllimin

Për të arritur kënaqësinë e Allahut dhe për të përfituar prej mirësive hyjnore, qëllimi për kryerjen e adhurimit të haxhit duhet të jetë i sinqertë, dhe ndërkohë që i premtojmë Allahut në këtë çështje, duhet të anulojmë çdo qëllim egoist dhe dobësi njerëzore që zë vend brenda nesh. Vetëm kështu mund të bëhemi mysafirët e sarajit të mistereve hyjnore. Në ato vende të shenjta, duhet të zhvishesh plotësisht prej egos. Ja pra, ata që shkojnë në haxh dhe umre me këtë gjendje shpirtërore, do të kenë mundësinë të kalojnë prej derës së mëshirës dhe begatisë hyjnore. Pas kësaj, ajo që duhet të bëjnë ata është që:

2. Ndërkohë që heqin rrobën e trupit për të veshur ihramin, duhet të heqin edhe rrobën e çdo dashurie dhe interesi tjetër jashtë Allahut

Ihrami është si një dokument i marrëveshjes shpirtërore që bëhet

për haxhin dhe umren në rrugën e kënaqësisë së Allahut dhe një manifestim i sinqeritetit dhe përzemërsisë në këtë çështje. Prandaj, për të veshur ihramin, nuk duhet të zhvishesh vetëm nga veshja materiale, por edhe nga veshja e lakmive brenda nesh, si ajo për pasurinë, pozitën, gradën etj., duke veshur kështu rrobën e devotshmërisë, në mënyrë që zemrat të përfitojnë siç duhet prej të fshehtave dhe manifestimeve hyjnore. Allahu i Madhëruar urdhëron:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّيْهَا

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë!” (Shems, 9.)

Në atë ambient dhe atmosferë të shenjtë, duhet ta lidhësh zemrën pas Allahut dhe përveç gjërave të nevojshme, duhet të qëndrosh larg angazhimit me çështjet e kësaj bote. Kjo, sepse sa më shumë të zhytesh në këto çështje, aq më shumë shtohet pakujdesia dhe plogështia në zemër. E në këtë mënyrë, vështirësohet edhe përfitimi shpirtëror prej atyre vendeve dhe kohëve të bekuara. Për këtë arsye, edhe Omeri (r.a.), ka këshilluar që, ata të cilët e përfundojnë adhurimin e haxhit dhe umres, duhet të kthehen menjëherë në vendet e tyre me qëllim që të mos cenohen përfitimet shpirtërore të atyre adhurimeve.

Në atë vend të bekuar, duhet kërkuar Allahu dhe duhet kuptuar e vërteta se **“Ai është më afër robërve të Vet, se damari i qafës së tyre.”**⁴⁴ Po ashtu, duhet arritur vetëdija se, **“Allahu ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij”** dhe se prej Tij nuk mund të fshihet asgjë. Pra, duhet bërë kujdes që të zhvishemi prej dashurive kalimtare të kësaj bote dhe ta fokusojmë zemrën tek Allahu i Madhëruar, sepse thelbi i haxhit dhe i umres është:

3. Pastrimi fizik dhe shpirtëror

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut (a.s.), shpjegon rezultatin që mund të përfitohet prej punëve të mira e të sinqerta gjatë adhurimit të haxhit

44. shih. Kaf, 16.



dhe umres, në një farë mënyre na njofton edhe për qëllimin e këtyre adhurimeve të shenjta:

“Kryejini në një kohë Haxhin dhe umren, sepse këto adhurime i pastrojnë gjynahet ashtu siç e pastron gjyryku ndryshkun e hekurit.”

(Nesai, Menasik, 6; Ibn Maxhe, Menasik, 3)

“Pranimi i fesë Islame, kryerja e hixhretit dhe shkuarja në haxh, fshijnë gjynahet e mëparshme.” (Muslim, Iman, 192.)

E kur bëhet fjalë për një pastrim të tillë, një çështjet tjetër për të cilën duhet të bëjnë kujdes haxhinjtë, është edhe kjo:

4. Të hyjnë në vendet e shenjta me edukatë, duke braktisur haramet dhe të dyshimtat dhe duke respektuar simbolet e fesë

Si fillim, të gjitha adhurimet dhe mirësitë, duhet të bëhen me pasuri hallall, sepse përfitimi shpirtëror prej këtyre adhurimeve, arrihet vetëm në sajë të ushqimit hallall me të cilin ushqehet trupi. Ky hadith fisnik, na e shpjegon shumë qartë rëndësinë e pasurisë hallall në kryerjen e adhurimit të haxhit:

“Kush e viziton këtë Shtëpi (Qaben) me paratë që i ka fituar në mënyrë të ndaluar, ka devijuar nga nënshtrimi ndaj Allahut. Kur një njeri i tillë vendos të bëjë haxhin, të veshë ihramin, të hipë, të lëvizë devenë e tij dhe të thotë: “Lebbejk Allahumme lebbejk”⁴⁵, nga lart i vjen një zë që i thotë:

«Për ty nuk ka as lebbejk e as sa'dejk! Sepse ti e ke fitimin haram, furnizimin haram dhe kafshën haram. Kthehu mbrapsht pa marrë asnjë sevap! Mërzitu ngaqë do përballesh me diçka që nuk do të pëlqejë!»

Ndërsa ai që nis rrugën e haxhit me para hallall; kur hip në kafshë, bën të lëvizë devenë e tij dhe thotë: “Lebbejk Allahumme lebbejk”, nga lart, një zë i përgjigjet:

“Lebbejk dhe sa'dejk! Ty po të përgjigjem, sepse ti e ke hallall

45. Lebbejk Allahumme lebbejk: “Allahu im, Ty t'u nënshtrova!” ose “Urdhëro, Allahu im!”

kafshën, rrobën dhe furnizimin. Kthehu plot me sevape të mëdha dhe si të mos kesh bërë gjynahe fare. Gëzohu, pasi do takohesh me gjëra që do të kënaqin e do të gëzojnë.” (Hejthemi, III, 209-210.)

Gjithashtu, edhe gjatë kryerjes së haxhit janë disa ndalesa ndaj të cilave duhet bërë kujdes. Allahu i Madhëruar urdhëron:

الْحَجَّ أَشْهَرُ مَعْلُومَاتٍ فَمَنْ فَرَضَ فِيهِنَّ الْحَجَّ فَلَا رَفَثَ
وَلَا فُسُوقَ وَلَا جِدَالَ فِي الْحَجِّ وَمَا تَفَعَّلُوا مِنْ خَيْرٍ يَعْلَمُهُ اللَّهُ
وَتَزَوَّدُوا فَإِنَّ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَى وَاتَّقُونِ يَا أُولِيَ الْأَلْبَابِ

“Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!” (Bekare, 197.)

Nisur nga kjo, krahas ndalesave që përmenden në ajetin e mësipërm, duhet pasur kujdes edhe në çështjen e të drejtave të njerëzve, sepse për shkak të numrit të madh të njerëzve që kryejnë haxhin, ekziston gjithmonë rreziku i cenimit të ndonjë personi. Kështu, për t’u ruajtur nga kjo gjë, është e nevojshme të tregohet kujdes i madh sidomos gjatë kryerjes së ritit të tavafit. Po ashtu, duhet ruajtur shumë edhe përzierja burra me gra nëpër hotele, hyrje-daljet nëpër xhami etj. Madje, nuk duhet harruar për asnjë çast, se atje është e ndaluar të këputet qoftë edhe një fije bari. Kjo, na afron edhe më tepër tek Allahu, bën të mbizotërojë dashuria, mëshira, respekti, delikatesa dhe mirësjellja.

Këto çështje, janë disa nga pikat të cilave Profeti ynë (a.s.), u jepte rëndësi të madhe. Një herë, i Dërguari i Allahut (a.s.), duke e këshilluar Omerin (r.a.), që të vepronte me delikatesë gjatë kryerjes së tavafit, e urdhëron kështu:



“O Omer! Ti je një njeri i fuqishëm. Mos i shtyp njerëzit duke i ngucur për të arritur tek guri i zi! As mos u shqetëso, e as mos shqetëso kurrkënd. Nëse gjen vend bosh fërkoje dhe puthe gurin e zi, e nëse jo, atëherë “fërkoje dhe puthe” nga larg duke bërë me shenjë dhe kalo duke thënë Kelimej Teuhid’in dhe tekbirë!” (Hejthemi, III, 241; Ahmed, I, 28.)

Në këtë mënyrë, duke i respektuar të drejtat e njerëzve, duhet bërë shumë kujdes ndaj edukatës në ato vende të bekuara, sepse një nga synimet e haxhit, është edhe frymëzimi dhe ngritja e nivelit shpirtëror me anë të respektit dhe kujtimet e atyre vendeve të shenjta. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

ذَلِكَ وَمَنْ يُعِظْ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ

“...Kushdo që madhëron simbolet e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij.” (Haxh, 32.)

Sipas kësaj, namazi, Kurani Famëlartë, ezani, shumë amanete dhe vende të shenjta si Qabja, kodrinat Safa dhe Merve, janë simbole të Allahut. Në haxh dhe në umre, këto duhen respektuar ashtu siç u ka hije. Po ashtu, duhet ruajtur edhe nga sjelljet jo të hijshme, fjalët e kota, leximi i Kuranit Famëlartë në mënyrë të paedukatë dhe mos-respektimi i tij.

Nga ana tjetër, ne na duhet të përpiqemi t’u zgjidhim problemet dhe të kuptojmë gjendjen e vëllezërve tanë besimtarë që janë të sëmurë, të mbetur në rrugë, apo që nuk kanë mundësi të ndryshme, që kanë humbur të afërmit etj... Pra, të gjithë ata që janë në gjendje të vështirë. Këto virtyte të larta, si mëshira dhe altruizmi, në të njëjtën kohë, janë cilësi që duhet t’i ketë çdo zemër besimtari. Përsëri duhet menduar se, aty është vendi i vështrimit hyjnor. Për këtë arsye, duhet të mos ua thejpmë zemrën të tjerëve, përkundrazi, brenda mundësive, të përpiqemi t’ua ngrohim ato.

Tek besimtarët e vërtetë nuk duhet të ekzistojë ndjenja e mospërfilljes, e nënvleftësimit dhe e turpërimit të vëllait të tij në besim. Aty



nuk njihen njerëzit. Pra, ne si njerëz, nuk mund t'i shohim gradët e zemrave të të tjerëve. Këtë mund ta bëjë vetëm Allahu i Madhëruar. Puna më e rëndësishme si në haxh, ashtu edhe në umre, është të shfrytëzosh në maksimum kohën e kufizuar për të realizuar të gjitha detyrat e rëndësishme. Kështu që, duhet të kujdesemi në veçanti të shmangim hulumtimet e panevojshme, pra, të mos analizojmë jetën e njerëzve duke shpenzuar kohën kot me fjalë boshe, sepse gjendja jonë në haxh dhe në umre, shpreh edhe delikatesën e zemrës, edhe thellësinë e ndjenjave tona shpirtërore.

Këtu dëshiroj të përmend edhe këto këshilla të babait tim, pastë rahmet, Musa Efendiut:

“Kam një këshillë për ata që ikin (në haxh apo umre); mos e neglizhoni prehjen shpirtërore atje. Merruni me botën tuaj shpirtërore, mos u merrni me punë të kota. Përpiquni të përfitoni nga pasqyrimi shpirtëror i atij vendi!

Natyrisht se sa herë që njeriu shkon në haxh, ai zhvillohet shpirtërisht në mënyrë të pavarëdijshme. Ata që bëjnë bamirësi të mëdha, në përgjithësi bëjnë haxh në mënyrë të përsëritur. Me reflektimin shpirtëror të haxhit, shtohet bujaria, mëshira dhe dhembshuria. Këtyre njerëzve u zgjerohet zemra dhe dora me kënaqësinë dhe emocionin e besimit, dhurojnë për hir të Allahut, dhurojnë me lehtësi dhe me dëshirë çdo gjë të tyre.”

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ
وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ شَيْءٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Al-i Imran, 92.)

Shkurtimisht, e gjithë çështja është:



5. Ta bësh vullnetin kurban për hir të Allahut.

E në fakt, edhe qëllimi kryesor i prerjes së kurbanit gjatë kryerjes së haxhit, është përkujtimi i dorëzimit të plotë të Ibrahimit e Ismailit (a.s.) ndaj Allahu, kuptimi i urtësisë hyjnore në atë çështje dhe forcimi i zemrave me devotshmëri të sinqertë ndaj Allahut. Pra, në haxh duhet të zhvishesh prej çdo iluzioni të egos dhe t'i dorëzohesh plotësisht Allahut të madhëruar. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

لَنْ يَنَالَ اللَّهُ لُحُومَهَا وَلَا دِمَاؤُهَا وَلَكِنْ يَنَالُهُ التَّقْوَىٰ مِنْكُمْ

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj...” (Haxh, 37.)

Duhet të mendojmë se; Ibrahim (a.s.), ishte gati të sakrifikonte birin e vet, kurse Ismaili (a.s.), ishte gati të sakrifikonte jetën e vet për hir të Allahut. Po ne, sa arrijmë ta sakrifikojmë veten dhe pasurinë tonë në rrugë të Allahut? Sa i plotësojmë ne cilësitë që shprehen në këtë ajet kuranor: **“Besimtarët e vërtetë janë ata që blejnë xhenetin në këmbim të pasurisë dhe vetes së tyre.”** (Teube, 111.)

Dhe pikërisht për këto sakrifica, neve kemi një detyrë për gjithë jetën:

6. Të gurëzojmë shejtanin dhe egon tonë

Në të vërtetë, gurëzimi i shejtanit, fillon me gurëzimin e shejtanit brenda nesh. Ky veprim, është përkujtimi i gurëzimit të shejtanit nga Ibrahim, Ismaili dhe Haxherja, si pasojë e tundimit që përpiquej të nxiste ai. Në njëfarë aspekti, gurëzimi bart kuptimi e mallkimit. E në fakt, në ato kohë, mallkimi bëhej duke gurëzuar. Po ashtu, edhe fjala “raxhim / i gurëzuar”, që përdoret për shejtanin, është në kuptimin “i mallkuar”.

Gjithnjë duhet të pyesim vetveten se, sa arrijmë ne t'i gurëzojmë vesveset, dyshimet dhe gabimet që mbajmë brenda. A pasqyrohet tek ne devotshmëria dhe sinqeriteti që shoqëronte Ibrahimin, Haxheren



dhe Ismailin gjatë gurëzimit të shejtanit? A e kemi menduar ndonjëherë një gjë të tillë?

Niveli dhe pjekuria shpirtërore që kërkohet të arrihet nga robi me anë të këtyre fazave, është:

7. Përmendja e Allahut dhe lutja e vazhdueshme

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Nuk është gjynah të kërkoni nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur!” (Bekare, 198.)

فَإِذَا قَضَيْتُمْ مَنَاسِكَكُمْ فَادْكُرُوا اللَّهَ كَذِكْرِكُمْ
أَبَاءَكُمْ أَوْ أَشَدَّ ذِكْرًا فَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ
رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا وَمَا لَهُ فِي الْآخِرَةِ مِنْ خَلَقٍ

“Pasi t’i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: «Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!» Por, për këta, s’ka asnjë të mirë në botën tjetër.” (Bekare, 200.)

Nga këto ajete kuptojmë se besimtari që kryen haxhin dhe umren duhet ta përmendë dhe t’i lutet sa më shumë Allahut. Lidhur me këtë, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Nuk ka mysliman, që të bëjë “telbije”⁴⁶, e që bashkë me të të mos bëjnë telbije edhe gurët, drurët dhe toka e fortë që ndodhet në të djathtë dhe në të majtë të tij. Ky bashkim vazhdon në këto drejtime (duke treguar të djathtën dhe të majtën), deri në kufirin e fundit të tokës.” (Tirmidhi, Haxh 7/828.)

46. Telbije: Fjalët e haxhinje kur shkojnë në haxh: “Lebbejke Allahume lebbejk...”



Këndimi i telbijeve është aq i rëndësishëm për të siguruar që në zemrën e besimtarit të zërë vend përmendja dhe lutja ndaj Allahut, saqë edhe pse adhurimet individuale kryhen pa zë, telbijet janë urdhëruar të bëhen me zë. Në këtë mënyrë, besimtari hyn në një ndërthurje të larmishme mes trupit, zemrës dhe çdo gjëje që e rrethon. Profeti (a.s.) thotë:

“Xhebraili (a.s.), erdhi tek unë dhe më urdhëroi që t’u thosha sahabëve dhe të gjithë atyre që ishin me mua, që të ngrinin zërin kur të bënin telbijet.” (Ebu Davud, Menasik 26/1814)

Po ashtu, kur Profeti (a.s.), u pyet se cili haxh ishte më i mirë, ai u përgjigj duke thënë:

“Haxhi në të cilin bëhen telbije me zë të lartë dhe derdhet shumë gjak duke bërë kurbanë!” (Tirmidhi, haxh, 14/827.)

Përveç këtyre, me qëllimin e ruajtjes të gjendjes së dhikrit dhe lutjeve, Profeti ynë (a.s.), na ka mësuar edhe si duhet të jetë e folura jonë në vendet e shenjta gjatë adhurimeve jashtë namazit.

“Tavafi rreth Qabes, është njësoj si namazi, vetëm se këtu mund të flisni. Prandaj, kush flet gjatë tavafit, le të flasë mirë.” (Tirmidhi, Haxh, 112/960.)

Synimi i të gjitha parimeve që përmendëm deri më tani, është që:

8. Zemra të shijojë faljen, frymëzimin dhe shpërblimin hyjnor

Në një hadith fisnik thuhet:

“Një umre, është shpagim për gjynahet që do të bëhen deri në umren tjetër. Ndërsa shpërblimi i një haxhi të pranuar, është vetëm Xheneti.” (Buhari, Umre, 1; Muslim, Haxh, 437.)

Ja pra, dëshira e zemrës së çdo besimtari që vjen në këto vende të shenjta, është ta përfundojë haxhin dhe umren me këto sihariqe dhe të arrijë ndjenjat e larta që i ofrohen nga këto sihariqe.



Vizita e Medinës së përndritshme

Nuk duhet harruar se Medina e përndritshme e cila vizitohet para ose pas adhurimit të haxhit dhe umres, bart në gjirin e vet xhevahirin më të çmuar të gjithësisë. Prandaj, në ato vende duhet treguar një respekt dhe edukatë e veçantë, duke qenë të vetëdijshëm se jemi umeti i atij Profeti të madh. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“...Ashtu sikurse Ibrahim (a.s.), e caktoi zonë të mbrojtur (të sigurt) Meken dhe u lut për të, ashtu edhe unë e kam caktuar zonë të mbrojtur (të sigurt) Medinën e Përndritshme...” (Buhari, Fedailu'l-Medine, 6; Muslim, Haxh, 462.)

Për këtë arsye, ndaj Medinës së përndritshme duhet të tregohet respekt njësoj si për Mekën e nderuar, sepse aty gjendet trupi i bekuar i Profetit tonë (a.s.), i cili u dërgua si mëshirë për botët dhe si shembull më i mirë për të gjithë njerëzit deri në ditën e kiametit.

Për shkak të dashurisë dhe respektit të madh që kishte për Profetin (a.s.), Imam Maliku, i cili ka qenë edhe imam i Xhamisë së Profetit, nuk hynte në Medinë as hipur mbi kafshë, e as me këmbë të mbathura. Ai tregonte një edukatë aq të jashtëzakonshme, saqë edhe abdesin e rinovonte duke dalë jashtë Medinës së përndritur.

Kështu pra, ata që kryejnë haxhin dhe umren, duhet të tregojnë respekt dhe edukatë ndaj atyre vendeve të shenjta, me qëllim që të përfitojnë siç duhet prej kujtimeve të bekuar të asaj atmosfere.

Me pak fjalë, haxhi dhe umreja ideale dhe e pranuar, i falin zemrave besimtare dhunti të panumërta. Por, nëse edukata e haxhit dhe umres nuk respektohet siç duhet, dhe në ato vende veprohet në mënyrë moskokëçarëse, është e pamundur të përfitohet gjë prej atyre adhurimeve. Lidhur me këtë, këto fjalë të Muhamed Ikbalit, janë shumë kuptimplote:

Një ditë, arkitekti shpirtëror i Pakistanit, Muhamed Ikbali, vizitoi haxhilerët që ishin kthyer nga Medina dhe u drejtoi një pyetje që ekspozonte horizontin e tij shpirtëror prej besimtari të vërtetë:

“E vizituat Medine Muneveren! Me çfarë dhuratash e mbushët



shpirtin tuaj nga tregu shpirtëror i Medinës? Dhuratat materiale që keni sjellë, taket, tesbihët e sexhadet pas ca kohësh do të vjetërsohen, do të vyshken dhe do të marrin fund. A na keni sjellë nga dhuratat e Medinës që nuk fishken kurrë, e që i japin jetë shpirtrave?..

A ka mes dhuratave tuaja dorëzim dhe besnikëri si të Ebu Bekrit (r.a.), drejtësi si ajo Omerit (r.a.), ndjenjë turpi dhe bujari si të Osmanit (r.a.), klimë shpirtërore dhe zjarr të xhihadit si të Aliut (r.a.)? A do të mund t'i falni botës Islame, që sot përpëlitet në mijëra halle, emocionet e Epokës së Lumturisë?”

O Allah! Ne ndero me vizitën e dy Haremeve Fisnike dhe na i prano adhurimet që do të bëjmë në haxh dhe në umre!..

Amin!..



Jehona shpirtërore e Mevlanës



“Për sa kohë që ky shpirt të jetë në këtë trup, unë jam rob, skllavi i Kuranit dhe pluhuri i rrugës së Muhamed Mustafait (a.s.)... Nëse dikush përcjell fjalë të tjetra nga fjalët e mia përveç kësaj, unë jam i mërzitur edhe prej tij, edhe prej asaj fjale...”

“O Zoti im! Nëse mëshirën Tënde duhet ta shpresojnë vetëm njerëzit e mirë, po gjynahqarët ku të shkojnë të strehohen?..”

“O Allahu im Madhështor! Nëse Ti pranon vetëm robërit e Tu të mirë, gjynahqarët ku të shkojnë të përgjërohen?..”

JEHONA SHPIRTËRORE E MEVLANËS

Ka njerëz që janë bërë e shkuar ndërkohë që kanë qenë ende gjallë. Por, ka edhe njerëz që, edhe pse kanë jetuar shekuj më parë, frymët e tyre që u falin jetë zemrave, janë plotë jetë edhe sot. Pra, ata që nuk bëhen e shkuar, edhe po të kalojnë me qindra vite.

Ata janë njerëzit e devotshëm, të cilët ia kanë kushtuar gjithë ekzistencën e tyre Allahut të Madhëruar dhe varret e tyre janë në gjirin besimtarëve. Edhe pse trupat e tyre të përkohshëm, ndodhen prej shekujsh nën tokë, frymëzimi i tyre shpirtëror ka arritur deri në ditët tona në sajë të veprave të tyre dhe do të vazhdojë të qëndrojë i gjallë në sajë të begatisë që u ka dhënë Allahu.

Ja pra, një njeri i tillë i veçantë, që ka qenë i përkushtuar në udhëzimin e njerëzve në rrugën e Allahut, si rezultat i së cilës i është dhënë edhe begati e frymëzimit shpirtëror, është edhe Mevlana Xhelaledin Rumi (Allahu e mëshiroftë).

Ai ishte një thirrës besimi dhe doktor i zemrave... Jehona e tij shpirtërore do të jetë shërim për zemrat e njerëzve deri në ditën e kiametit... Këto bejte që i ka shkruar në veprën e tij të famshme Mesnevi, e shprehin shumë bukur urtësinë se pse thirrja e tij shpirtërore nuk do të shuhet kurrë:

“Kur ta shohësh lumin e jetës së pasosur, ujin që ke në enë, domethënë këtë jetë të shkurtër e të vdekshme, bashkoje me lumin e pavdekësisë! A ikën uji nga lumi?”



Kur uji në enë të përzihet me ujin e lumit, shpëton nga qenia e vet dhe bëhet ujë lumi! Atëherë, cilësitë e ujit të enës zhduken, por vetë mbetet dhe, pas kësaj, as pakësohet, as ndotet, e as merr erë!”

Ja pra, edhe jehona e shpirtave të atyre që zhvishen nga ekzistenca e tyre e përkohshme dhe shndërrohen në një esencë që kthehet në origjinën e vet, as nuk pakësohen, as ndoten dhe as marrin erë, edhe nëse kalojnë shekuj të tërë... Dhe, me të vërtetë që ata janë si lumenjtë që zhvishen nga ngjyra, shija dhe cilësitë e tjera dhe bashkohen me detet.

Në veprat e tij, të cilat ishin produkt i zemrës, Rumi ka hedhur dritë mbi të vërtetat e qenies njerëzore, përtej kohës dhe hapësirës, duke i parë prej horizontit të përjetësisë. Për këtë arsye, edhe pse mund të kalojnë me shekuj, ato jo vetëm që nuk humbasin asgjë prej freskisë dhe gjallërisë së tyre në aspektin e përmbajtjes dhe metodës, por përhapin edhe aroma xheneti në kopshtet e zemrave, si filladet e pranverës që falin jetë.

Njerëz të tillë, i shohin ngjarjet prej dritares së zemrës dhe me syrin e dashurisë hyjnore. Për këtë arsye, ata kanë qenë udhërrëfyes për shoqërinë ku janë gjendur, për njerëzit që kanë dashur të udhëzohen, e madje edhe për sunduesit e mbretërive. Kjo, sepse ata e kishin larguar perden e misterit që mbulon dijet natyrore dhe logjike, duke gëzuar kështu manifestimet frymëzuese të dashurisë hyjnore.

Për shkak se Mevlana e të tjerë si ai, që kanë një zemër të gatuar e të ardhur në atë konsistencë shpirtërore, i kanë të gjitha ndjenjat dhe mendimet të kthyera e të prira ndaj urtësisë hyjnore, Zoti u bëhet pothuaj syri i tyre që u sheh, e dora që u zë. Në këtë mënyrë, ata kthehen në qendra të tërheqjes shpirtërore dhe njerëzit i duan e i respektojnë. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.” (Merjem, 96.)

Ndërsa Profeti ynë (a.s.), ka thënë:



“Kur Allahu i Madhëruar e do një rob, e urdhëron Xhibrilin:

«Unë e dua filanin, prandaj dua je edhe ti!» Kështu, edhe Xhibrili e do, e më pas thërret banorët e qiellit:

«Allahu e do filanin, prandaj duajeni edhe ju!» Edhe banorët e qiellit e duan. Pastaj, dashuria për atë njeri përhapet edhe tek banorët e tokës!» (Muslim, Birr 157.)

Ndërsa në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë se Allahu i Madhëruar ka urdhëruar:

“Unë e trajtoj robin Tim sipas pandehmës së tij për Mua. Kur ai më përmend, Unë jam bashkë me të. Nëse se ai më përmend brenda vetes, edhe Unë e përmend. Nëse ai më përmend midis një grupi njerëzish, Unë e përmend atë midis një grupi më të mirë se ai!” (Buhari, Teuhid, 15; Muslim, Dhikr, 2, 19, 50.)

Mevlana thotë:

“Zemrat e mbytura në varfëri, ngjasojnë me një shtëpi që e ka mbytur tymi. Në qoftë se dëshiron që t’ia dëgjosh hallin që kanë, atëherë hap një dritare që të dal tymi dhe shpirti yt të zbutet.”

Zemra e butë dhe altruiste e Mevlanës, i lutet kështu Krijuesit të gjithësisë për ata që kanë rënë në batakun e gjynaheve dhe përpëlitën në jetën e tyre të mjerë në mënyrë të pavetëdijshme:

“O Zoti im! Nëse mëshirën Tënde duhet ta shpresojnë vetëm njerëzit e mirë, po gjynahqarët ku të shkojnë të strehohen?..”

“O Allahu im Madhështor! Nëse Ti pranon vetëm robërit e Tu të mirë, gjynahqarët ku të shkojnë të përgjërohen?..”

Tek njerëzit e devotshëm e të sinqertë, mëshira dhe dhembshuria bëhet natyrë e tyre. Në këtë mënyrë, ata bëjnë një jetë altruiste dhe, në vend që të mendojnë vetëm për veten, mendojnë më tepër për të tjerët. Kështu, shembulli i tyre zgjat me shekuj edhe pas vdekjes së trupave të tyre. Ata janë mësuesit e njerëzve që presin shpëtimin, janë heronjtë shpirtërorë që ndjejnë se janë përgjegjës për të tjerët para Allahut të Madhëruar.

Njëherë, një të urtë e pyesin:

“Si i dallon njerëzit e devotshëm të Allahut, nga njerëzit e tjerë?”

Ai u përgjigj:

“Nga gjuha e ëmbël, morali i bukur, fytyra e buzëqeshur dhe përgëzuese, sjelljet delikate, bujaria, toleranca dhe dhembshuria ndaj të gjithëve...”

Këto parime të Mevlanës, të cilat ai i ka zbatuar dhe ua ka këshilluar edhe të tjerëve, tregojnë më së miri botën e tij të zemrës:

Bëhu si dielli në zemërgjerësi dhe mëshirë!

Bëhu si nata në mbulimin e mangësive të tjetrit!

Bëhu si i vdekuri në hidhërim dhe kërcënim!

Bëhu si dheu në modesti!

Si do që të bëhesh!

Ose duku ashtu si je!

Ose bëhu ashtu si dukesh!..



Miqtë e Allahut, janë njerëzit fatlumë, të cilët janë plotësuar shpirtërisht, duke përsosur sjelljet e tyre dhe duke pasur nderin të jenë prej trashëgimtarëve të profetëve. Ata janë majat më të larta të udhëzimit profetik dhe përsosmërisë morale, të cilët janë shtrirë përgjatë gjithë kohës. Pra, ata janë udhëzuesit konkretë të atyre që nuk kanë arritur të shohin Profetin (a.s.) dhe sahabët e tij. Në një hadith fisnik urdhërohet:

“Dijetarët e vërtetë janë trashëgimtarë të profetëve!” (Ebu Davud, Ilm, 1.)

Këshillat dhe porositë e dijetarëve, janë shfaqje të frymëzimit dhe begatisë shpirtërore që reflektohen prej fjalëve të Profetit tonë (a.s.), i cili është edhe qendra e përfitimit shpirtëror. Bisedat dhe këshillat plot të vërteta hyjnore dhe emocione shpirtërore, janë rreze që transmetohen gjithmonë prej qendrës në mënyrë zinxhir. Prandaj, këto lloj kuvende dijetarësh duhen konsideruar mirësi të mëdha, sepse ata janë personalitete të larta që e kanë pasqyruar jetën profetike 23 vjeçare të



Profetit tonë (a.s.), me fjalë, vepra dhe ndjenja. Për rrjedhojë, këshillat e tyre janë burim shërimi për zemrat e besimtarëve.

Mevlana ka thënë:

“Allahu i Madhëruar i ka dërguar profetët dhe dijetarët si mëshirë për botët. Për këtë arsye, ata këshillojnë popullin e tyre pa u mërzhitur asnjëherë. Ndërsa për ata që nuk ua vënë veshin këshillave të tyre, bëjnë dua vazhdimisht duke thënë: «O Zoti ynë! Ji i dhembshur ndaj tyre, mos ua mbyll dyert e mëshirës Tënde!».

Vërja gishtin kokës, bëji veshët katër e përqendrohu ndaj këshillave të dijetarëve të vërtetë! Dëgjoji që të shpëtosh nga mërzia e frika dhe të arrish sigurinë e lumturinë shpirtërore!

Pa e humbur rastin dhe pa rënë në dyshime, lidhu pas një njeriu të plotësuar që është shkëputur nga mashtrimet e kësaj bote të fundme e që i është dorëzuar tërësisht Zotit, dhe kështu përpiqu të shpëtosh nga intrigat e kësaj bote!

Fjalët e dijetarëve të vërtetë janë të mbushura me ujë jete, të pastër si përrenjtë e kulluar. Sa e ke mundësinë, pi nga uji i tyre deri sa të ngopesh, që në zemrën tënde të çelin lule e trëndafila!”



Besimtarët e pajisur me vetëdijen e shërbimit, janë si një lumë i begatë, që teksa rrjedh në rrugën e tij të gjatë, u jep jetë e gjallëri një mijë e një gjallesave, si njeriut, tokës, pemës, trëndafilit, zymbylit, bilbilit etj. Caku përfundimtar i këtij lumi është deti i takimit të përjetshëm me Allahun.

Jetët e tyre përbëjnë majën më të lartë në shkallën njerëzore. Ndërsa vdekjet e tyre janë të mbushura me mësim dhe urtësi të veçanta. Kjo, sepse ata kanë jetuar në këtë botë sipas ligjeve të Allahut duke qenë gjithmonë të vetëdijshëm për realitetin e botës tjetër dhe sepse në sytë e tyre, vdekja nuk ishte më një ankth i errët, por kushti i vetëm për arritjen e përjetësisë. Mevlana ka thënë:

“Biri im! Vdekja e gjithsecilit është në ngjyrën e tij. Atyre që e urrejnë vdekjen dhe janë armiq të saj, për shkak se nuk mendojnë



që vdekja është takim me Allahun, ajo ka për t'iu dukur si një armik i frikshëm. Ndërsa atyre që janë miqësuar me të, ajo iu shfaqet si mik."

Për këtë arsye, realiteti i vdekjes, që i shkakton drithërima të ftohta dhe ankthe shumicës së njerëzve, për miqtë e Allahut do të jetë si një natë dasme. Për shkak se në jetën e kësaj bote nuk kanë pasur frikë nga asgjë tjetër përveç kundërshtimit të Allahut, në botën tjetër do të jenë të sigurt nga të gjitha shqetësimet. Këtë e vërtetojnë edhe ajetet e Kuranit në të cilat urdhërohet:

الَّا اِنَّ اَوْلِيَاءَ اللّٰهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar dhe as për t'u dëshpëruar.” (Junus, 62.)

لَهُمُ الْبُشْرٰى فِي الْحَيٰوةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ

“Për ata ka sihariq në këtë jetë dhe në tjetrën.” (Junus, 64.)



Ashtu si çdo profet ka disa veçori dalluese të vetat, ashtu edhe miqtë e Allahut kanë disa veçori dalluese. Në botën e tyre shpirtërore, këta njerëz e perceptojnë Allahun ndryshe nga njerëzit e thjeshtë dhe përpiqen me gjithë qenien e tyre që të afrohen sa më shumë me Allahun, duke u shkëputur shpirtërisht prej të gjitha dashurive të kësaj bote. Po ashtu, ata janë vazhdimisht të vetëdijshëm për dobësinë e tyre në hapësirën e pafundme të njohjes së Allahut. Megjithatë, ata nuk janë të gjithë të një grade dhe nuk kanë të njëjtat detyra.

Disa prej tyre janë të angazhuar vazhdimisht me edukimin shpirtëror të vetes, me adhurim dhe meditimin e manifestimeve të fuqisë hyjnore në gjithësi. Ndërsa disa të tjerë, pasi e përfundojnë edukimin shpirtëror, fillojnë detyrën e thirrjes Islame. Kështu, prej gjuhës dhe zemrës së këtyre miqve të Zotit, që e ndajnë veten përgjegjës për njerëzimin, fillon të rrjedhë urtësia dhe dija që u ka falur Allahu.



Një mendimtar i dashuruar pas Mevlanës, duke shprehur faktin që shumica e njerëzve janë të paafte për t'i kuptuar përjetimet e tij shpirtërore, thotë:

“Ne i kemi dëgjuar vajtimet shpirtërore të Mevlana Xhelaledin-it, por s’është e mundur t’i shohim thellësitë e detit të kënaqësisë dhe prehjes ku është zhytur. Ne shohim vetëm atë çka ai nxjerr në sipërfaqe nga fundi i detit. Ne rrokëm jo pasionin e Mevlanës, por vetëm vajtimet me fjalë të atij pasioni. Kjo është gjithçka që u përpoqëm të shprehim me gjuhën tonë thuthuqe. Vetëm ai u kredh në detin e kënaqësisë dhe prehjes. Kurse neve na mbetën zërat e dala nga furtuna e pasionit të tij!”⁴⁷

Nisur nga kjo, ne duhet të pyesim veten se, sa arrijmë ne ta kuptojmë Mevlanën, atë doktor shpirtrash? Sa arrijmë të përfitojmë prej recetave të tij që e shpëtojnë njeriun prej indiferencës dhe sëmundjeve të zemrës?

Për fat të keq, sot, disa njerëz -në mënyrë të qëllimshme- po na prezantojnë një Mevlanë të gabuar, të zhveshur prej planit shpirtëror dhe të orientuar më tepër drejt botës materiale.

Për shembull, në botëkuptimin e thellë shpirtëror, **“neji”**,⁴⁸ në vepërën Mesnevi të Mevlanës, përfaqëson njeriun e përsosur. Mirëpo, në disa qarqe, ai shihet vetëm si një instrument muzikor. Po ashtu, edhe rituali **“sema”** që ka një rëndësi të madhe në botëkuptimin shpirtëror të Mevlanës, përpiqet të prezantohet vetëm si një element folklorik.

Mirëpo, jeta e Mevlana Xhelaledin Rumiut, është një jetë shpirtërore e kurorëzuar me besnikëri ndaj Kuranit dhe Sunetit. Ja si e shpreh ai faktin se Kurani Fisnik është një oqean i gjerë dhe pa brigje i të vërtetave hyjnore:

“Fjalët e Kuranit Fisnik, mund të shkruhen edhe me një shishe bojë. Por për të shprehur të gjitha misteret që përmban ai, nuk do të mjaftonte edhe sikur të kishim gjithë detet pa brigje si bojë dhe të gjitha pemët e tokës si lapsa.”

47. Nurettin Topçu, Mevlana ve Tasavvuf, s. 139.

48. Nej: Lloj fyelli

Ndërsa ata të cilët pretendojnë se Mevlana nuk ka qenë një besimtar i rrugës së Kuranit, duke u përpjekur ta paraqesin si dikë me besim tjetër, ose në frontin e filozofisë, do të përballen me këtë përgjigje të tij të prerë:

“Për sa kohë që ky shpirt të jetë në këtë trup, unë jam robi, skllavi i Kuranit dhe pluhuri i rrugës së Muhamed Muhtarit (a.s.)... Nëse dikush përcjell fjalë të tjetra nga fjalët e mia përveç kësaj, unë jam i mërzitur edhe prej tij, edhe prej asaj fjale...”

Po ashtu, edhe kjo gjendje e Mevlanës, e shpreh më së miri dashurinë që ndjente ai ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“Kur vinte në shtëpi, pyeste “Çfarë ka sot në shtëpi?” dhe merrte përgjigjen; “Nuk ka asgjë!”, gëzohej e thoshte: “Falënderimi i takon Allahut, sepse sot shtëpia jonë i ngjan shtëpisë së Profetit sal-lallahu alejhi ue sel-lem! Ashtu siç nuk pranonte në mënyrë të prerë dhuratë apo lëmoshë, Mevlana i ndalonte edhe nxënësit e tij nga kjo, duke i nxitur që të punonin.”⁴⁹

Dhe me të vërtetë, ai është një udhëzues shpirtëror që i tregon njerëzimit rrugën sublime të Kuranit Fisnik, gjë që është e mundur ta shohim edhe në shprehjet në veprat e tij:

“Mesnevia, është një rrugë për ata që dëshirojnë të njohin të vërtetën dhe urtësitë hyjnore. Mesnevia është shërim për zemrat e njerëzve të pastër. Ai largon trishtimin, ndihmon në kuptimin më të qartë të Kuranit dhe zbukuron sjelljet.”

Me pak fjalë, thelbi i punës udhëzuese që Mevlana ia ka kushtuar gjithë njerëzimit deri në ditën e kiametit, është:

- Që besimi të bëhet i ëmbël për zemrat e njerëzve,
- Që zemrat të përfitojnë prej mesazheve të thella Kuranore dhe frymëzimit shpirtëror të Profeti (a.s.),
- Që vëllazëria fetare të forcohet me dashuri, mëshirë dhe shërbim,



- Të fitohet ndjenja e shikimit të krijesave me mëshirë dhe dhembshuri për hir të Krijuesit,

- Që njeriu të njohë realitetin e ekzistencës së vet dhe dhuntitë hyjnore që gëzon dhe të kuptojë urtësitë dhe misteret në faqet e librit të gjithësisë.

- Që njeriu, i cili është krijuar si krijesa më e nderuar, të kuptojë se është ndryshe nga krijesat e tjera dhe jetojë e veprojë brenda këtij botëkuptim, duke ruajtur nderin dhe dinjitetin njerëzor.

Mevlana i nderuar, duke përmbledhur jetën e vet, për gjendjen e tij kur ishte në majë të dijeve në Medresenë e Selçukëve, tha: “isha i papjekur”. Kur arriti të kuptojë urtësitë e shfaqjeve hyjnore dhe të lexonte të fshehtat hyjnore duke shfletuar faqet e librit të gjithësisë, tha: “u poqa”. Por kur u shkri në dashurinë për Allahun, atëherë tha: “u dogja”.



Shkurtimisht, mund të themi se, është shumë e hidhur të shohësh njerëzit, të cilët janë dërguar në këtë botë për të kaluar sprovën e devotshmërisë ndaj Allahut, të bien në indiferencë duke u mashtruar pas bukurive të kësaj bote. Vdekja, e cila do t'i mbështjellë të gjithë si një vorbull zjarri, është fatkeqësia më e jashtëzakonshme që të gjithë do ta shijojnë. Humbja e rrugëve të jetës në horizontin e vdekjes, i hidhëron thellësisht zemrat e tyre. Për të gjallët, nuk ka asnjë ndodhi më të madhe se vdekja. Nisur nga kjo, mendjet që e kuptojnë këtë realitet, nuk merren shumë me mirësitë e përkohshme por përkushtohen më tepër në jetën e devotshme. Për këtë arsye, njerëzit duhet të meditojnë mbi misteret dhe urtësitë në faqet e librit të gjithësisë, duke u mahnitur me manifestimet e fuqisë dhe madhështisë hyjnore. Njeriu nuk duhet të harrojë kurrë se prej gjirit të vdekjes, do të agojë drita e së vërtetës dhe ai do të japë llogari për kasetën e jetës së vet para gjykatës hyjnore.

O Allah! Na e bëj të mundur të gjithëve që ta shohim gjithësinë me syrin e urtësisë dhe dashurisë ashtu siç e kanë parë miqtë e Tu, duke u zhytur në thellësitë e ndjenjave dhe entuziazmin e besimit dhe duke derdhur lot pendese për të dalë para Teje faqebardhë dhe



me paqe shpirtërore! O Zot! Udhëzoi zemrat tona me frymëzimin shpirtëror të dijetarëve dhe robërve të Tu të devotshëm që janë trashëgimtarët e vërtetë të Profeti tonë (a.s.)!..

Amin!..



Vetëdija e amanetit dhe përgjegjësisë në udhëheqje



Drejtuesit, udhëzuesit dhe prijësit, duhet të jenë të aftë t'i ndajnë njerëzit që e duartrokasën për hir të interesit, nga njerëzit që e kritikojnë me nderitet, dhe nuk duhet të mbyten në vorbullën e lavdeve që i pëlqejnë egos së tyre.

Një nga problemet më të mëdha të pozitës së udhëheqjes, është sëmundja e përçmimit të njerëzve me mendjemadhësi dhe mburrje. Ndërsa mënyra për të shpëtuar nga kjo, është të kuptosh se faktori i vërtetë i suksesit në punë dhe shërbim, është Allahu i Madhëruar, ndërkohë që të gjitha gabimet dhe të metat ia atribuon vetëm vetes.

VETËDIJA E AMANETIT DHE PËRGJEGJËSISË NË UDHËHEQJE

Allahu i Madhëruar, këtë botë dhe gjithçka ka në të, ia ka lënë amanet njeriut, duke e bërë atë përgjegjës për menaxhimin e saj. Të gjitha dhuntitë, si fëmijët, shëndeti, pozitat, gradat, etj., janë amanete që i janë besuar njeriut. Prandaj, njeriu është i detyruar t'i respektojë këto amanete në mënyrë rigorozë. Respektimi siç duhet i këtyre amaneteve dhe menaxhimi i tyre në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, i Cili është edhe pronari i tyre i vërtetë, është një nga shkaqet kryesore të përfitimit të mëshirës, faljes dhe begatisë hyjnore.

Në këtë botë, që është një vend i provës hyjnore, të gjithë do të arrijnë një pozitë sipas aftësive të tyre dhe pjekurisë fizike e shpirtërore dhe do të japin provimin e tyre në këtë rrugë, duke u shërbyer robërve të Allahut. Dhe, mes të gjitha këtyre, sprova që ka përgjegjësinë më të madhe, është udhëheqja, pra, të jesh në krye. Kjo, sepse udhëheqja është një përgjegjësi që shpërblehet pamasë nëse realizohet siç duhet, por që ka edhe dënimin më të madh nëse nuk realizohet në mënyrën e duhur.

Paqja, qetësia, mirëqenia dhe lumturia e një shoqërie, krahas shumë faktorëve të tjerë, është e mundur më tepër në sajë të udhëheqësve që e kanë kuptuar më së miri përgjegjësinë e amanetit. Nisur nga kjo, edukimi i çdo individi në bazë të aftësive të tij dhe dhënia e pozitës së merituar, është një nga detyrat më të rëndësishme të një shoqërie. Në të kundërtën, për shkak të personave të vendosur në pozita të pamerituara, punët do të dështojnë dhe jeta shpirtërore e shoqërisë do të pësojë degradim. Lidhur me këtë çështje, në Kuranin Fisnik urdhërohet:



إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا
وَإِذَا حَكَمْتُمْ بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ

**“Allahu ju urdhëron që amanetet t’jua ktheni atyre që u përka-
sin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni drejt...”** (Nisa, 58.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka respektuar me rigorozitet të madh këtë parim kuranor, duke i dhënë çdo njeriu pozitën e merituar sipas aftësive. Kështu, një sahab të dhënë pas adhurimit, nuk e caktonte kurrë komandant ushtrie, dhe një njeri me aftësi të larta ushtarake, nuk e caktonte gjykatës.

Po ashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), tradhtinë ndaj amanetit, e ka konsideruar si shkak shkatërrimi, i cili e kthen jetën e kësaj bote në një skenë kiameti. Një ditë, kur ishte duke biseduar me shokët e tij, dikush e pyeti:

“Kur do të bëhet kiameti?”

“Kur të humbasë amaneti, prite kiametin!”, u përgjigj ai.

“Si do të humbë amaneti?”, pyeti ai përsëri.

“Kur punët t’u besohen njerëzve të paaftë, prite kiametin!”

(Buhari, Ilm, 2; Ahmed, II, 361.)

Për këtë arsye, është e domosdoshme që amanetet t’u besohen të zotëve në çdo aspekt të jetës, materiale apo shpirtërore qoftë dhe, kur të gjendet dikush më i aftë, detyra t’i lihet atij.

Mendimtarët Islamë, kanë përcaktuar disa parime themelore në lidhje me rregullat e udhëheqjes që duhet të zbatohen prej xhematit më të vogël, e deri tek institucionet shtetërore. Tre më të rëndësishmet prej tyre janë:

1. Drejtuesit duhet të jenë njerëz vepërmirë,
2. Detyrat apo postet duhet të shpërndahen në bazë të meritave,
3. Aplikimi i konsultimit të përbashkët.



Parimet e tjera jashtë këtyre të triave, i janë lënë gjykimit të autoriteteve përkatëse të cilët mund t'i formulojnë ato sipas kushteve të kohës dhe vendit.

Nga ana tjetër, ata që marrin një pozitë drejtuese në fushën materiale apo shpirtërore me qëllim që të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe t'i shërbejnë shoqërisë, duhet të jenë të vetëdijshëm se ajo pozitë është një amanet dhe se aty ndodhen për një kohë të caktuar. Këtë botëkuptim e shpreh shumë bukur edhe thënia se, **“Gjykata nuk është pronë e gjykatësit”**.

Ata që e marrin përsipër një amanet/detyrë, duhet të bëjnë një jetë të devotshme në përputhje me Kuranin dhe Sunnetin, në mënyrë që të jenë të suksesshëm në realizimin e detyrës në mënyrën e duhur. Ata që ndodhen në krye të popullit, duhet që çdo veprim dhe aktivitet ta kryejnë me vetëdijen se ndodhen para kamerave hyjnore, duke shfaqur një personalitet të vërtetë Islam. Një drejtues i pjekur, ndërkohë që përpiqet të kryejë siç duhet detyrën që ka marrë përsipër, duhet të bëjë një jetë të kujdesshme duke qenë i vetëdijshëm se ndodhet nën kontrollin e Allahut, i Cili urdhëron:

“Pa dyshim, Allahut nuk i fshihet asgjë në Tokë dhe as në qiell!” (Al-i Imran, 5.)

“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.” (Kaf, 16.)

Ky ferman që Sulltan Sulejman Kanuni i ka dërguar Gazi Bali Beut, i cili kishte korrur fitore të shumta, e shpreh më së miri vetëdijen e të parëve tanë në lidhje me përgjegjësinë e udhëheqjes dhe detyrës:

“...Ke marrë tetëmbëdhjetë kala. Ke dërguar tridhjetë mijë slita në kantierin e anijeve. Qofsh i nderuar! T'u zbardhtë fytyra në të dyja botët dhe të qoftë hallall buka ime.

...Të gjitha sukseset atribuoja Allahut dhe në asnjë mënyrë mos u mburr, duke i konsideruar si të tuat! Mos u lavdëro duke thënë «Kam marrë kaq vende me shpatën time!»

Të jesh Bej, është një peshore me dy pjata, njëra prej të cilave është Xhenet, e tjera Xhehenem. Bëhu prej atyre që i kanë zemrat

vigilente edhe kur ju flenë sytë! Drejtësia është kreu i të gjitha punëve. Vepro me drejtësi, sepse edhe kjo konsiderohet adhurim! Allahu i Madhëruar na bëftë prej njerëzve të drejtë. Nëse në ditën e gjykimit na kërkohet llogari për padrejtësitë që bëhen në vendet që ndodhen nën drejtimin tënd, do të ngjitem për fyti. Kujdes, mos u turpëro në atë ditë, që të shpëtosh!

Kur të caktosh dikë në ndonjë detyrë, kujdes, mos i beso asaj që sheh nga jashtë! Ka shumë njerëz që të tregojnë fytyrën e qeshur ngaqë nuk kanë mundësi. Por, sapo të gjejnë mundësinë, kthehen në Nemrud kundër teje!

Me pak fjalë, njihi njerëzit më mirë duke i provuar, që më vonë të mos pendohesh! Hapi mirë sytë dhe veshët! Nëse bejlerët dhe zëvendësit janë të mirë, edhe populli është i mirë.

Ka njerëz që ditën janë me agjërim, e natën me adhurim. Mirëpo, janë si idhujtarët, sepse ushqejnë dashuri të madhe për pasurinë. Nuk ka asnjë fatkeqësi më të madhe që e harbon popullin, më shumë se dashuria për pasuri.

Bëj kujdes, mos ushqe dashuri për të përkohshmen! Jepu njerëzve me bollëk prej mirësive të Allahut! Hape dorën e bujarisë! Ruaju shumë prej smirës! Mos u shqetëso duke menduar se prodhimi ynë s'mjafton për nevojtarët tanë! Nëse je në vështirësi në plotësimin e nevojave, na thuaj! Nuk jam i pafuqishëm të të japë shpenzimet e nevojave prej thesarit të shtetit. Një pjesë prej pasurisë dhe rezervave ushqimore të fituara prej kalave, merri për thesarin e shtetit. Pjesa tjetër është e drejta e ushtarëve Islamë. Trajtoji mirë ushtarët!

Të moshuarit konsideroju si babanë tënd, bashkëmoshatarët si vëllezërit e tu dhe më të vegjlit si fëmijët e tu! Fëmijët mëshiroju, vëllezërit gostiti dhe baballarët respektoji! Ushtarët Islamë mos i lër asnjëherë në vështirësi dhe kujdesu për fukarenjtë e atyre vendeve! Sadakanë për nevojtarët, veshjet dhe ushqimet siguroju prej thesarit, sepse fukaraja është robi i Allahut dhe thesari i shtetit është e drejta e robërve të Allahut.



Nëse në ato vende ka prej sojit të Profetit (a.s.), më njofto për emrat e tyre, që bijtë e të Dërguarit të Allahut (a.s.), të mos ndjejnë vështirësi në asnjë mënyrë.

Nuk e aprovoj aspak që fukarenjtë e popullit tim të denigrohen! Çdokush të bëjë një jetë të rehatshme, që jomyslimanët ta kenë zili popullin tonë, të afrohen me myslimanët dhe t'u shtohet dashuria për Islamin.

Ke kërkuar që disa fshatra t'i dhurosh si vakëf. Për Allahun e Madhëruar, e pranoj sikur t'i dhurosh si vakëf të gjithë fshatrat dhe kasabatë e çliruara deri më sot. Na dërgo regjistrin e fshatrave që dëshiron t'i bësh vakëf, me qëllim që nëse ndonjë prej padishahëve e vezirët prej sojit të Osmanëve që do vijnë pas nesh... apo çdonjëri prej myslimanëve nuk i respekton kushtet e vakëfit tënd, ta padis në ditën e gjykimit dhe ta mbaj mëri.

Tani o Gazi Bali Bej, edhe ti përpigu me aq sa ke mundësi për hir të fesë dhe shtetit...

Kapu fort pas ajetit, «ادْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً» dhe mos e lësho kurrë. Allahu i Madhëruar ta priftë mbarë dhe të dhëntë gjithmonë fitore me ushtarët Islamë kundër armiqve të fesë!”

Ky ferman që lexuam, mjafton për të shprehur kujdesin që tregonin të parët tanë në këshillimin e atyre që i ngarkonin me detyra. Po ashtu, këto këshilla dhe porosi që tregojnë se sa shumë e ndjenin ata përgjegjësinë ndaj amanetit të drejtimit dhe se sa mendonin ata për popullin e tyre, janë shembull shumë i bukur për ne.

Drejtuesit, udhëzuesit dhe prijësit, duhet të jenë të aftë t'i ndajnë njerëzit që e duartrokasën për hir të interesit nga njerëzit që e kritikojnë me sinjeritet dhe nuk duhet të mbyten në vorbullën e lavdeve që i pëlqejnë egos së tyre. Ata duhet të jenë të verbër ndaj atyre që i duartrokasën dhe të shurdhër ndaj atyre që u bëjnë lajka për interes. Në të njëjtën kohë, ata nuk duhet të tregohen indiferent ndaj të vërtetës dhe të drejtës.

Po ashtu, ata që ndodhen në poste drejtuese, është shumë e rë-

ndësishme që kur të zgjedhin ndihmësit dhe këshilltarët e tyre, të respektojnë rreptësishtë parimin e meritës. Lidhur me këtë, ky hadith fisnik tregon shumë qartë se sa i rëndësishëm është një ndihmës për drejtuesin në orientimin e tij në rrugën e drejtësisë apo në të kundërtën e saj:

“Nëse Allahu i Madhëruar dëshiron mirësi për një udhëheqës, i fal atij një ndihmës fjaldrejtë, i cili e kujton kur harron dhe e ndihmon kur e kujton. E nëse Allahu i Madhëruar nuk dëshiron mirësi për një udhëheqës, i vë pas një ndihmës të keq, i cili nuk ia kujton atë që harron dhe nuk e ndihmon kur e kujton.” (Ebu Daud, Haraxh, 4/2932; Nesai, Bej’at, 33.)

Një besimtar që është i vetëdijshëm ndaj kësaj të vërtete dhe bota e zemrës së të cilit ka arritur njëfarë niveli, nuk mashtrohet aspak prej lavdërimeve të pasinqerta që burojnë prej interesit.

Po ashtu, një person që ndodhet në pozitën e drejtuesit, nuk duhet t’i shkatërrojë shpërblimet e punëve të mira duke rënë në mendjemadhësi dhe mburrje si pasojë lavdërimeve të lajkatarëve. Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.), i ka ndaluar lavdërimet e tilla që mund të shkaktojnë fryrje të egos duke thënë:

“Hidhini dhé fytyrës së atij që ju lavdëron (për interes)!” (Ahmed, VI, 5.)

Lidhur me këtë temë, një shembull i bukur është edhe Sulltan Javuz Selimi. Kur ai u kthye nga fushata e Egjiptit me një fitore të madhe, arriti në Yskydar gjatë ditës. Mirëpo, për shkak se u njoftua që populli i Stambollit po e priste me ceremoni madhështore, i drejtohet shokut të vet, Hasan Xhanit, dhe i thotë:

“Unë do të hyj në Stamboll pasi të jetë errur dhe të jenë zbrazur rrugët, në mënyrë që duartrokitjet e njerëzve, kurorat e fitores dhe laudet të mos na bëjnë krenarë e të na i çojnë dëm punët tonal!”

Sulltan Javuz Selimin, e shohim një luan në shkretëtirën e frikshme të Sinait; një besimtar kokulur, sypërlotur dhe falënderues duke hyrë në Egjipt; dhe një dervish të kredhur në kënaqësi hyjnore dhe shpirtërore që e orientojnë për larje llogarish me vetveten, në Yskydar.



Ky sundimtar i madh, mbretërimin e kësaj bote e mbante gjithmonë jashtë zemrës. Kur ndodhej në çastet e fundit të jetës, shoku i tij Hasan Xhani i thotë:

“Padishahu im! Mesa duket ka ardhur koha të jeni bashkë me Allahun!”

Sulltani e pa i habitur dhe tha:

“Hasan, Hasan! Më kë kujton ti se kam qenë deri tani?! A mos ke parë ndonjë të metë në lidhjen time me Allahun e Madhëruar?”

Edhe sot, ne kemi shumë nevojë për udhëheqës si Javuzi, të përkushtuar edhe në botën materiale, edhe në atë shpirtërore; që zotërojnë ekuilibrin trup-shpirt, që janë të zellshëm, të moralshëm dhe me ideale të larta.

Ashtu si dikush që shëtit në një kopsht trëndafilash dhe është gjithmonë i buzëqeshur si pasojë e bukurisë që reflektojnë tek ai lulet që e rrethojnë, edhe ata që janë në krye të shoqërisë, duhet të zotërojnë këtë gjendje shpirtërore, duke qenë të durueshëm, të buzëqeshur dhe të fortë në bartjen mbi supe të halleve të njerëzve. Kjo, sepse parasëgjithash, ata duhet ta dinë se udhëheqja dhe drejtimi, është e mundur duke fituar zemra dhe duke u falur atyre paqe dhe lumturi. Sa bukur shprehet Rumi:

“Nëse je i mençur bëj tavaf Qaben e zemrës. Kuptimi i vërtetë i Qabes që ti pandeh se është bërë prej dheut, është zemra!.. Ta dish mirë se, nëse lëndon, prek dhe thyen një zemër e cila është vendvështrimi i Allahut, mirësia që do të fitosh nuk e mbulon gjynahun e thyerjes së një zemre, edhe sikur të shkosh në këmbë në Qabel!”

Në çfarëdolloj fushe të shërbejë, një drejtues duhet të ketë zellin fizik, shpirtëror dhe mendor që kërkon detyra dhe duhet ta stolisë zemrën me virtyte shpirtërore. Zemra e tij duhet të jetë e ngopur me dashurinë për Allahun, Profetin dhe vëllezërit në fe. Ai duhet të bartë ndjesinë shpirtërore me të cilën mund t'i shohë krijesat me mëshirë, dashuri dhe dhembshuri për hir të Krijuesit. Po ashtu, ai duhet të zo-



tërojë cilësi si sinqeriteti, modestia, orientimi në rrugën e drejtë, falja dhe vendimarrja me këshillim. Krahës këtyre, ai duhet ta zhvillojë vazhdimisht veten me dije dhe moral të bukur. Ndërsa të metat e atyre që ndodhen pranë tij, duhet t'i atribuojë vetes dhe, ndërkohë që qorton veten, të tjerët duhet t'i trajtojë me tolerancë. Ai duhet t'i bëjë parim të jetës urdhrat hyjnorë dhe profetikë, të cilët bëjnë të ditur rëndësinë e dorëzimit tek Allahu dhe mjaftueshmërinë me mundësitë që ka falur Ai, duke bërë kështu një jetë modeste në rrugën e Allahut.

Mendjemadhësia, që është e kundërta e modestisë, nënkupton pretendim për madhësi. Kurse fama, është një nga fatkeqësinë më të mëdha të egos për njeriun. Një person që bie pre e mendjemadhësisë dhe kaplohet nga dashuria për famë, kryen shumë padrejtësi, për të cilat as që është i vetëdijshëm. Si përfundim, ai e ul, e poshtëron veten dhe bëhet prej të padrejtëve. Lidhur me këtë, Mevlana ka thënë:

“A gjelbëron një shkëmb në stinën e pranverës? Bëhu modest si toka, që prej teje të çelin trëndafila dhe lule ngjyra-ngjyra!..”

Pra, vetëm toka është ajo që përfiton me të vërtetë prej begatisë së pranverës. Edhe një copë shkëmbi a guri e sheh pranverën, por nuk përfitojnë asgjë prej saj. Kështu janë edhe ata që kaplohen nga mendjemadhësia dhe dëshira për famë. Shirat e begatshme të prillit bien edhe mbi ta, por ata nuk përfitojnë asgjë. Ata që nuk mund ta kapërcejnë pengesën e egos, fatkeqësi të tilla, u duken si rrugë e drejtë. Ndërkohë, Allahu i Madhëruar, i përkufizon kështu njerëzit modest e të devotshëm:

وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا ...

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër tokë...” (Furkan, 63.)

Për të eliminuar cilësitë negative që e denigrojnë dinjitetin njerëzor, është e domosdoshme të bëjmë një jetë të devotshme të bazuar në adhurime dhe vepra të mira. Një shembull i bukur i kësaj, është Shah Nakshibendi, i cili edhe pse ishte një nga njerëzit më të ditur të kohës së



tij, në vitet e para të rrugëtimit shpirtëror ka pastruar rrugët ku kalonin njerëzit, u ka shërbyer të sëmurëve, nevojtarëve, madje edhe kafshëve që kishin nevojë për mbikëqyrje. Kështu ai u pajis me një modesti dhe me një vetëdije përulësie e hiçi. Shprehja e mëposhtme tregon më së miri gjendjen e tij të përkorë:

*Bota grurë e unë kashtë,
Bota bukur e unë shëmtaraq!..*

Nisur nga kjo, ata që ndodhen në krye të shoqërisë, njerëzit ndaj të cilëve bartin përgjegjësi, nuk duhet t'i konsiderojnë si shërbëtorët e vet, por përkundrazi, veten duhet ta konsiderojnë si shërbëtorë të tyre, duke u sjellë me ta në mënyrë modeste, buzagaz dhe me butësi. Ata duhet t'i kontrollojnë veprimet e tyre dhe duhet të ruhen nga sjelljet e ashpra dhe të pahijshme. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Më i keqi prej udhëheqësve, është i pashpirti dhe zemërguri.”
(Muslim, Imare, 23.)

“O Zot! Jepi vështirësi atij që merr përsipër një punë të umetit dhe i vë në vështirësi ata, dhe trajtoje me mëshirë atë që merr përsipër një punë të umetit dhe i trajton me mëshirë ata!” (Muslim, Imare 19; Ahmed, VI, 93, 258.)

Mëshira, që është edhe manifestimi më i bukur i besimit, i duhet më tepër njerëzve me pushtet. E fryti i mëshirës, është shërbimi ndaj robërve të Allahut. Nisur nga rëndësia që ka kjo, në ditën e vështirë të kiametit, udhëheqësit e drejtë do të jenë nën hijen e Arshit të Allahut. (shih. Buhari, Ezan, 36; Muslim, Zekat, 91.)

Një tjetër prej shembujve të bukur të sjelljes me mëshirë dhe dashuri ndaj njerëzve në historinë e të parëve tanë, është edhe kjo:

Sulltan Abdulhamidi II, kërkonte që ta zgjonin në çfarëdo ore të natës nëse shfaqej ndonjë ngjarje urgjente, dhe nuk i pëlqente që çështja të lihej për të nesërmen. Në lidhje me këtë specifikë, kryesekretari i paradhomës, Esad Bej, thotë kështu në kujtimet e tij:

“Një mesnatë trokita në derën e sulltanit për të firmosur një lajm shumë të rëndësishëm; por dera nuk mu hap. Pasi prita pak, trokita

përsëri, por përsëri nuk mu hap. Fillova të shqetësohem se; “mos vallë sulltanit i erdhi vdekja?” Pas pak trokita përsëri dhe, kësaj radhe, dera u hap dhe u duk aty sulltani me një peshqir në dorë. Ai po e fshinte fytyrën, buzëqeshi dhe më tha:

«Biri im! E kuptova se në këtë orë kishit ardhur për një punë me shumë rëndësi! U zgjova qysh në trokitjen e parë, por u vonova sepse mora abdest, prandaj mos ma vini re! Deri më sot, nuk kam firmosur pa abdest asnjë dokument të popullit tim!.. Ma jep ta firmos!»

Më pas, e firmosi shkresën duke thënë “Bismilah”.

Po ashtu, edhe ky hadith fisnik, na e bën shumë të qartë pozitën që ka udhëheqësi i drejtë tek Allahu i Madhëruar:

“Ditën e kijametit, njeriu më i dashur për Allahun e Madhëruar dhe ai i cili do të gjendet më afër Atij, është drejtuesi (ose pushetari) i drejtë. Ndërsa njeriu më i urreyer për Allahun dhe ai i cili do të jetë më larg Atij, është drejtuesi zullumqar.” (Tirmidhi, Ahkam, 4/1329; Nesai, Zekat, 77.)

Lidhur me këtë çështje, shumë kuptimplote është edhe kjo thënie e Omerit (r.a.):

النَّاسُ عَلَى سُلُوكِ مُلُوكِهِمْ

“Njerëzit janë në rrugën e udhëheqësve të tyre”

Nisur nga kjo, mund të thuhet se populli merr formë sipas udhëheqësve dhe ndjek rrugën e tyre. Ndërsa një thënie e urtë popullore, thotë: “Peshku qelbet nga koka.” Krahës këtyre, lidhur me këtë çështje, po japim edhe këto shembuj:

Një prej kalifëve Emevit, Uelid bin Abdulmelik, ishte shumë i dhënë pas ndërtesave të bukura. Po ashtu, edhe populli e ndoqi atë në këtë pasion. Madje, nëpër mbledhje diskutohej vazhdimisht për çështjet e ndërtimit.

Ndërsa Sulejman bin Abdulmeliku ishte shumë i dhënë pas ushqi-



meve. Për rrjedhojë, edhe njerëzit në kohën e tij e shpërdoronin kohën duke folur për ushqimet dhe pijet.

Kurse Omer bin Abdulazizi, ishte njeri i devotshëm dhe asket. Në kohën e tij, populli hyri në rrugën e adhurimeve dhe bindjes ndaj Allahut. Madje, ata vazhdimisht e pyesnin njëri-tjetrin në formë këshille: *“Çfarë lutjesh ke bërë këtë natë? Sa ajete ke mësuar përmendësh prej Kur’anit Fisnik? Sa ditë ke agjëruar këtë muaj? Sa të varfërve, të sëmurëve apo jetimëve u ke gëzuar zemrat?”*⁵⁰

Pra, në histori, ashtu siç shohim tablo plot vuajtje dhe dhimbje të shkaktuara nga mizorët dhe egoistët dhe përfundimin e hidhur të tyre si mësim, shohim me admirim edhe tablotë plotë madhështi dhe nder të dhembshurisë, mëshirës dhe altruizmit të udhëheqësve të drejtë e të devotshëm. Ja pra, një prej këtyre ishte edhe Omer bin Abdulazizi, i cili me sjelljet e tij të bukura dhe madhështore, i fali popullit të vet paqe dhe lumturi, duke zënë kështu vendin e tij të veçantë në faqet e nderit të historisë. Një prej shembujve të virtytshëm që e pasqyron më së miri vetëdijen e tij ndaj amanetit dhe përgjegjësisë që bartte, e tregon edhe bashkëshortja e tij, Fatimja:

“Një ditë, shkova pranë tij dhe e gjeta të ulur në faltore me dorë të mbështetur mbi ballë, ku qante pa pushim, e lotët i lagnin faqet.

E pyeta se çfarë kishte?

Ktheu kokën lehtë dhe tha:

«Fatime! Kam marrë mbi vete barrën më të madhe të këtij umeti. Ka njerëz që janë të uritur, të varfër, të sëmurë, nevojtar, jetimë, gra të veja, njerëz që iu është bërë padrejtësi, robër lufte në vendet armike, të moshuar dhe shumë të tjerë të cilët kur i mendoj më shtyp presioni i barrës së madhe që kam mbi vete. Ndërgjegjja nuk më gjen qetësi. Si do të përgjigjem unë nëse Allahu më merr në llogari në ditën e gjykimit dhe nëse Profeti (a.s.), më qorton për këtë?!» (Ibn-i Kethir, el-Bidaje, IX, 208.)

Në një transmetim tjetër, bashkëshortja e tij Fatimja thotë:

50. shih. Ahmed Xhevdet Pasha, *Kisas-i Enbija ue Teuarih-i Hulefa*, İstanbul 1976, V. 1, fq. 717; Taberi, *Tarihu'l-Umem ue'l-Muluk*, Kahire 1939, V, 266-267.

“Adhurimi i tij ishte aq sa i juaji. Vetëm se natën në shtrat, kishte një gjendje të atillë që, për shkak të meditimimit rreth frikës ndaj Allahut dhe llogarisë në ditën e gjykimit, zemra fillonte t’i rrihte fort. Ai përpëltej si një zog që ka rënë në ujë, ose që mbahet në dorë. Unë nuk i rezistoj dot kësaj gjendjeje të tij. Andaj ia hidhja jorganin sipër dhe thosha me vete: «Ah sikur mos të na ishte dhënë neve përgjegjësia e udhëheqjes! Ah sikur largësia ndërmjet nesh dhe kësaj detyre të ishte sa largësia ndërmjet diellit dhe tokës!»”

Po ashtu, edhe Amr bin Asi (r.a.), nga fundi i jetës së vet ka shprehur pendesë të madhe për shkak se ka marrë pjesë në disa poste udhëheqëse dhe ngjarje politike. Kur ndodhej në shtratin e vdekjes, kthehet me fytyrë nga muri dhe fillon të qajë gjatë duke menduar se si do të ishte fundi i tij.⁵¹ Më pas, duke vështuar pasurinë që kishte mbledhur, tha:

“Ah sikur ti të ishe një jashtëqitje deveje, ose sikur unë të kisha vdekur që në betejën e Dhatu’t-Thelathil”

Edhe kjo ngjarje që tregon vetëdijen e përgjegjësisë së udhëheqjes që bartte Omeri (r.a.), është shumë mësimdhënëse:

Kur iu bë atentat dhe ishte plagosur rëndë, njerëzit i thanë:

“Sikur të na caktoni dikë në vendin tuaj!” Mirëpo, Omeri (r.a.), u përgjigj:

“A ta bart përgjegjësinë e këtij umeti edhe pas vdekjes, ashtu siç e barta kur isha gjallë?.. Unë nuk pres ndonjë shpërblim për çfarë kam bërë në pozitën e kalifit. Mjafton që të mos më kërkohet llogari!”⁵²

Po ashtu, edhe kur disa persona i kërkuan Omerit (r.a.), të linte testament që postin e kalifit ta merrte djali i tij, Abdullahu (r.a.), ai u tha në mënyrë të prerë:

“Mjafton një kurban nga kjo familje!”

51. shih. Muslim, Iman, 192.

52. shih. Muslim, Imaret, 12



Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

أَنَا عَرْضْنَا الْأَمَانَةَ عَلَى السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَالْجِبَالِ
فَأَبَيْنَ أَنْ يَحْمِلْنَهَا وَأَشْفَقْنَ مِنْهَا وَحَمَلَهَا الْإِنْسَانُ
إِنَّهُ كَانَ ظَلُومًا جَهُولًا

“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).” (Ahzab, 72.)

Nga ky ajet fisnik, mësojmë se qenies njerëzore i është dhënë një amanet. Prandaj, përgjegjësia nuk është vetëm në çështjen amaneteve të popullit, por edhe të Allahut. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete). Imami është çoban dhe përgjegjës për tufën e tij. Burri është çobani i familjes së tij dhe përgjegjës për tufën e tij. Gruaja është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj. Shërbyesi është përgjegjës për pasurinë e pronarit të vet dhe për tufën e vet.” (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20.)

Padyshim se edhe në jetën individuale, është e domosdoshme që mirësitë e Allahut të përdoren ashtu siç duhet dhe me zgjuarsi. Mirëpo, ndërkohë që paaftësia në çështjet individuale shkakton vetëm dëme individuale, paaftësia në çështjet e udhëheqjes, shkakton dëme edhe në shoqëri.

Nisur nga kjo, edhe ata që do bëhen prijës dhe shembull, sidomos në fushën e fesë, është e domosdoshme të përmirësojnë më parë veten e tyre. Kjo sepse, udhëzimi në rrugën e drejtë, duhet të jetë pikësëpari cilësie e tyre. Ata që nuk janë të devotshëm për vete, nuk mund të përmirësojnë dot të tjerët.

Një ditë, Ebu Hanife has një fëmijë që po ecte përmes baltës. Duke i buzëqeshur me mëshirë dhe dhembshuri, i tha:

- O bir, ki kujdes se mos rrëzohesh!

Me sytë që i shndrisnin nga zgjuarsia, fëmija u kthye nga imami dhe i dha këtë përgjigje befasuese:

- O imam! Në fakt, ti duhet të ruhesh se mos rrëzohesh, sepse rrëzimi i një dijetari, do të thotë rrëzim i gjithë botës. Nëse rrëzohem unë, është e kollaj, sepse vetëm unë dëmtohem! Por, nëse ju rrëshqet këmba juve, ka për t'u rrëshqitur edhe atyre që vijnë pas jush, të cilët do të rrëzohen, e më pas do të jetë shumë e vështirë t'i ngresh të gjithë në këmbë!..

Imami u prek shumë nga fjalët e fëmijës dhe e përqafoi. Prej asaj dite, ai jepte vendim/fetva për një çështje, vetëm pasi e kishte diskutuar një muaj rresht me nxënësit e tij. Më pas, ai i këshillonte kështu nxënësit e tij:

“Nëse në një çështje ju vjen ndonjë argument më i fuqishëm, mos më pasoni mua në atë çështje. Ky është treguesi i përsosmërisë në Islam! Vetëm kështu mund të kuptohet edhe dashuria, edhe besnikëria që keni ndaj meje!..”⁵³

Udhëheqësit dhe drejtuesit, duhet t'i japin shumë rëndësi kësaj vërejtjeje të Profetit tonë (a.s.) dhe nuk duhet të përdorin metoda jolejitime për qëllime legjitime. Në hadithin fisnik thuhet:

“Kush i hap rrugën një pune të dobishme në Islam, ai do të ketë shpërblim për këtë; atij do t'i jepet shpërblim edhe prej shpërblimit të atyre që ecin në atë rrugë, pa iu pakësuar shpërblimi atyre që ecin në të. (Po ashtu), kush i hap rrugën një pune të keqe në Islam, ai do të ketë gjynah për këtë; ai do të ketë pjesë edhe prej gjynaheve të atyre që ecin në atë rrugë, pa iu pakësuar gjynahu as atyre që ecin në të.” (Muslim, Zekat, 69; Nesai, Zekat, 64.)

Duhet ditur se ashtu siç ndikojnë në shoqëri sjelljet e virtytshme të udhëheqësve, ashtu imitohen edhe sjelljet e tyre të gabuara. Për këtë arsye, udhëheqësi duhet të bëhet i drejt dhe shembull i mirë, duke i

mposhtur dëshirat e egos së tij. Përndryshe, ai do të ngarkojë mbi supe edhe gjynahun e atyre për të cilët është bërë shembull negativ. Po ashtu, një udhëheqës, nuk duhet ta harrojë kurrë këtë vërejtje që i ka bërë Allahu i Madhëruar, të dërguarit të Tij, Daudit (a.s.):

يَا دَاوُدُ إِنَّا جَعَلْنَاكَ خَلِيفَةً فِي الْأَرْضِ فَاحْكُم بَيْنَ النَّاسِ
بِالْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعِ الْهَوَىٰ فَيُضِلَّكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ

“O Daud, Ne të kemi bërë mëkëmbës në Tokë, prandaj gjyko ndërmjet njerëzve me drejtësi dhe mos shko pas dëshirave dhe tekave, se ato të largojnë nga rruga e Allahut! Me të vërtetë, për ata që largohen nga rruga e Allahut, ka dënim të ashpër, ngaqë e kanë harruar Ditën e llogarisë.” (Sad, 26.)

Kurse Profeti ynë (a.s.), i ka paralajmëruar kështu sahabët e ndërruar:

“Personi të cilin e caktojmë për mbledhjen e pasurisë dhe pasi e mbledh atë na fsheh ndonjë gjilpërë, madje edhe diçka më të vogël se ajo, e tradhton besimin tonë, dhe ditën e gjykimit, ka për të na e paguar atë që ka fshehur.”

Pasi profeti tha këto fjalë, u ngrit në këmbë një person nga ensarët dhe tha:

- O i Dërguari Allahut! Kërkoj që të më hiqni detyrën që më keni ngarkuar!

- Çfarë pate? – e pyeti Profeti.

- Më tronditën fjalët që sapo thatë!

Më pas Profeti (a.s.), tha:

“Unë po ua përsëris prapë ato fjalë. Këdo që ta caktojmë me detyrën për të mbledhur të ardhurat, të dorëzoj çdo gjë që mbledh, qoftë ajo me vlerë të madhe apo edhe shumë të vogël. Ai do të marr atë që do ti jepet nga ana jonë për punën që ka bërë, ndërsa prej asaj që e ka të ndaluar, duhet të largohet.” (Muslim, Imare, 30, Ebu Davud, Akdije, 5.)

Shkurtimisht, që prej drejtuesve të nivelit më të lartë, e deri tek kryefamiljarët, të gjithë duhet ta respektojnë amanetin dhe të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë mbi supe. Nisur nga kjo, nuk mjafton që një mësues apo një drejtues të jetë i plotësuar vetëm në aspektin e dijes. Tek ata duhet të mbizotërojnë ndjenjat e mëshirës dhe altruizmit, duhet të kenë zgjuarsinë e zgjidhjes së problemeve dhe të zotërojnë aftësinë e diplomacisë dhe të komunikimit me publikun. Në çdo situatë, ata duhet të ruajnë maturinë, duhet të përpiqen të jenë shembull dhe të bartin entuziazmin në shërbim. Kjo, sepse aftësia e një drejtuesi, shihet tek njerëzit të cilëve u jep përgjegjësi dhe detyra.

Nuk duhet harruar se, një nga problemet më të mëdha të pozitës së udhëheqjes, është sëmundja e përçmimit të njerëzve, me mendjemadhësi dhe mburrje. Ndërsa mënyra për të shpëtuar nga kjo, është të kuptosh se faktori i vërtetë i suksesit në punë dhe shërbim, është Allahu i Madhëruar, ndërkohë që të gjitha gabimet dhe të metat ia atribuon vetëm vetes. Po ashtu, ata që vendosen në poste të larta, duhet të jenë të vetëdijshëm se pa lejen e Allahut nuk do të kishin mundësi të arrinin në ato detyra vetëm me përpjekjet dhe meritat personale dhe nuk duhet të harrojnë se pushteti që zotërojnë është vetëm një derë shërbimi që u është hapur atyre për të fituar kënaqësinë e Allahut. Krahës këtyre, ata duhet të strehohen gjithmonë tek Allahu, t'i luten Atij që të mos e dëmtojnë askënd për shkak të gabimeve dhe të metave që kanë dhe të dëshirojnë me sinqeritet që në ato pozita shërbimi, të vendosen njerëz më të mirë dhe më të aftë.

I lutemi Allahut të Madhëruar, të na bëjë meritore ndaj amaneteve që na ka ngarkuar, t'u dalim për zot atyre amaneteve, të jetojmë me dëshirën dhe vetëdijen e shërbimit ndaj Allahut dhe njerëzve dhe, duke shfaqur karakterin e bukur të një besimtari, të arrijmë kënaqësinë e Tij në të dyja botët!..

Amin!..



Dashuria për pushtet dhe përgjegjësia e udhëheqjes



Dashuria për pozitë dhe ambicia për të qenë në krye, është një lakmi e jashtëzakonshme për famë. Është dëshira egoiste që e braktis më e fundit dhe më vështirë njeriun. Ata që ndodhen në poste drejtuese, duhet të bëjnë një jetë modeste në harmoni me jetën materiale e shpirtërorë të shtresave më të ulëta të shoqërisë që janë nën përgjegjësinë e tij. E nga ana tjetër, duhet të bëjnë një vetllogari e t'i thonë vetes: "Vallë a jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë e drejtimit dhe kushtet e rënda që ka, apo mos vallë më ka kapluar dashuria për pozitë dhe po helmoj shpirtin tim?!"

DASHURIA PËR PUSHTET DHE PËRGJEGJËSIA E UDHËHEQJES

Biri i njeriut është dërguar në këtë botë për t'u sprovuar. Dhe, për shkak të urtësisë së kësaj sprove, atij i është dhënë liria që të zgjedhë të zbatojë urdhrat e Allahut apo të ndjekë dëshirat e egos së vet. Për këtë arsye, bota e brendshme e njeriut, është një fushëbetejë e ndjenjave sublime dhe të ulëta që fshihen tek ai.

Paqja dhe lumturia e vërtetë e njeriut, është e mundur duke eliminuar vrazhdësitë që torturojnë shpirtin, duke u pajisur me ndjenja sublime dhe duke bërë një jetë në përputhje me besimin. Dhe për këtë, duhet patjetër të pastrohesh prej cilësive egoiste që pengojnë lumturinë e përjetshme dhe helmojnë shpirtrat. Një prej këtyre cilësive, është edhe “dashuria për pushtetin”, pra ambicia për të qenë në krye, apo lakmia për pozitë e famë.

Shënimi i përparimit në aspektin shpirtëror, realizohet në sajë të filtrimit të dëshirave të egos. Mirëpo, në kryerjen e këtij procesi, dëshira e fundit dhe më e vështira, që e braktis njeriun, është “dashuria për pushtet dhe ambicia për të qenë në krye”. E në fakt, kjo cilësi, është prirja më rrënjësore e egos, prej së cilës burojnë edhe shumë cilësi të tjera, si mendjemadhësia, mburrja, pangopësia, lakmia, etj. Për këtë arsye, shkulja e asaj cilësie prej zemrës, është shumë e vështirë. E për rrjedhojë, pastrimi i kësaj cilësi, është e fundit që trajtohet gjatë edukimit shpirtëror.

Një njeri i dhënë pas pasurisë, famës dhe pozitës, që mund të bëjë çdo gjë për t'i arritur këto, padyshim se nuk do të njohë asnjë kriter



shpirtëror dhe moral. Një njeri i tillë, i verbuar nga lakmia për pozitë, mund të bëhet më i rrezikshëm se një kafshë grabitqare. Profeti ynë (a.s.), na e ka bërë të ditur se sa shkatërruese mund të jetë kjo cilësi për njeriun:

“Dy ujë të uritur që bien ndër dele, nuk bëjnë më tepër dëm sesa lakmia e njeriut për pasuri dhe pozitë, fesë së tij.” (Tirmidhi, Zuhd, 43/2376.)

Dhe me të vërtetë që, një person, të cilit ia ka zënë sytë lakmia për këtë botë dhe i është robëruar zemra nga dëshira për pozitë dhe pushtet, është sikur të jetë zhveshur prej cilësive njerëzore. Mirëpo, dijetarët e vërtetë, lakminë për pasuri dhe pozitë, e konsiderojnë si burimin e të gjitha cilësive të këqija. Një i urtë ka thënë:

“Nëse dëshiron të jesh i singertë, së pari nxirre nga zemra dashurinë për të qenë në krye. Më pas, mos e shih veten më lartë se askush!”

Zotërimi i një pozite drejtuese, sjell me vete edhe përgjegjësi shumë të mëdha. Prandaj, kërkimi i një pozite të tillë nga dikush që nuk e zotëron aftësinë, meritën dhe forcën e domosdoshme, është shumë rrezikshme. Lidhur me këtë, Mevlana Xhelaledin Rumi ka thënë:

“Njeriu që ngrihet në pozita të larta pa meritë, i ngjan një kufome të ngarkuar në supet e popullit. Pra, në të vërtetë, ai nuk ndodhet në një pozitë të lartë, por është si një kufomë që të gjithë duan ta hedhin nga supet një orë e më parë.”

Një ditë, Ebu Dherri (r.a.), i thotë të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguar i Allahut! A mund të më caktoni guvernator/vali?”

Mirëpo, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha:

“O Ebu Dherr! Ti je njeri i pafuqishëm. Detyra që kërkon, është një amanet i madh. Përveçse për ata që e marrin me meritë dhe bëjnë atë që duhet, kjo detyrë është poshtërim dhe pishmanllëk Ditën e Kiametit!” (Muslim, Imare, 16.)



Pra, megjithëse i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë se: “Nën këtë qiell dhe mbi këtë tokë, nuk ka njeri më fjaldrejtë dhe besnik se Ebu Dherri!”⁵⁴, e krahas kësaj, e njëjtte mirë edhe moralin, karakterin dhe asketizmin e tij, ai nuk e caktoi Ebu Dherrin (r.a.), në asnjë detyrë drejtuese. Kjo, sepse “virtyti moral” dhe “aftësia drejtuese”, janë gjëra të ndryshme. Ka shumë njerëz të virtytshëm, të cilët nuk kanë aftësi drejtimi.

Që një njeri të admirohet dhe të ndiqet nga shoqëria, pikësëpari, ai duhet të ketë një karakter dhe moral të mahnitshëm. Një jetë, lartësohet dhe bëhet e admirueshme në sajë të një besimi të bashkuar me dashuri, adhurimeve të kryera me pasion dhe përkushtim dhe në sajë të shërbimeve që bëhen sjellje të bukura. Shumë njerëz mund të dinë të flasin bukur dhe mund të jenë të suksesshëm në çështje personale. Por këta duhet të vlerësohen mirë nëse munden apo jo të marrin përsipër përgjegjësinë e drejtimit të shoqërisë, sepse drejtimi është një detyrë e vështirë që duhet kryer ashtu siç duhet. Ata që kërkojnë të marrin përsipër drejtimin e popullit pa i zotëruar aftësitë e duhura material dhe shpirtërore, gjenden përballë një rreziku të madh që do t’u kushtojë rëndë në të dyja botët.

Dashuria për pushtet, pra lakmia për të qenë në krye, është një fatkeqësi që hap plagë të thella në sistemin shoqëror dhe jetën fetare, të cilat janë të vështira të kurohen. Faqet e historisë janë të mbushura me tablo mizorish dhe torturash fizike e shpirtërore të njerëzve të pa-aftë dhe lakmitarë që i kanë çuar drejt shkatërrimit popujt e tyre për hir të dashurisë së pushtetit. Për hir të kësaj dashurie, janë shkatërruar shumë ushtri me njëra-tjetrën, është derdhur gjaku i të pafajshmëve, janë çuar dëm shumë pasuri dhe është shkelur me këmbë nderi dhe dinjiteti njerëzor. Si shembull i kësaj, po përmendim këtë shprehje të Kuranit Fisnik në lidhje me Faraonin:

يَقْدُمُ قَوْمَهُ يَوْمَ الْقِيَمَةِ فَأَوْرَدَهُمُ النَّارَ وَبِئْسَ الْوَرْدُ الْمَوْرُودُ

54. Shih. Tirmidhi, Menakib, 35/3802.

“Ai (Faraoni) do ta udhëheqë popullin e tij në Ditën e Kiametit e do ta çojë në zjarr. Eh, sa vend i shëmtuar është ai, ku do të sillen ata!” (Hud, 98.)

Lidhur me lakminë e njerëzve ndaj pushtetit dhe qëndrimit që i Dërguari i Allahut (a.s.), mbante në këtë çështje, Ebu Musa el-Esh'ari (r.a.), tregon:

“Shkova tek i Dërguari i Allahut bashkë me dy prej djemve të xhaxhit tim, ku njëri prej tyre tha:

«O i Dërguar i Allahut! Na cakto si drejtues të ndonjë prej vendeve që të ka dhënë Allahu i Madhëruar!» Edhe tjetri, tha pak a shumë diçka të ngjashme. Por i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Për Allahun, ne nuk e bëjmë drejtues atë që e kërkon, apo lakmon këtë detyrë!” (Buhari, Ahkam, 7; Muslim, Imare, 15.)

Më pas, i Dërguari i Allahut (a.s.), e caktoi Ebu Musa el-Esh'ariun (r.a.), si guvernator të Jemenit, ai nuk kërkoi asnjë detyrë dhe Profeti (a.s.), vuri re se tek ai kishte aftësi të mira drejtuese.

Kur Ebu Bekri (r.a.), u bë prijësi i besimtarëve dhe populli i dha besën, ai doli në minber dhe tha:

“Unë nuk e kam kërkuar asnjëherë të jem kalif dhe as që i jam lutur Allahut për këtë, qoftë hapur, qoftë fshehtas, sepse unë nuk ndjehem i qetë si kalif.”

Këto fjalë, janë shprehja më e bukur e mënyrës së qasjes së një besimtari ndaj pozitave drejtuese, duke qenë i vetëdijshëm se ato pozita nuk janë për të bërë qejf dhe për të jetuar në luks, por për t'i shërbyer popullit.

Padyshim se rendja me lakmi pas pushtetit pa e menduar se e meriton apo jo, duke e thurur iluzione dhe duke e shkatërruar veten, sjell me vete edhe gjynahe të rënda. Mirëpo, edhe qeverisja e popullit është shumë e rëndësishme. Për këtë arsye, as ata që kanë aftësitë e duhura për të qeverisur, nuk kanë të drejtë të tërhiqen prej përgjegjësisë dhe t'i lënë punët pa zot. Nëse një personi të tillë i ofrohet një detyrë dhe ai e di se përveç tij nuk ka kush tjetër më të aftë në atë çështje, ai



nuk mund ta refuzojë detyrën. Nëse ai e refuzon, s'mund t'i shpëtojë gjynahut, sepse marrja përsipër e amanetit të popullit, në disa raste mund të bëhet i domosdoshëm. Kjo i ka hije besimtarit. Pra, për besimtarin është e rëndësishme që në sajë të jetës së tij shembullore, moralit të bukur, diplomacisë, urtësisë, largpamësisë, aftësisë dhe zgjuarsisë, të mos jetë kërkuesi por i kërkuari i pushtetit.

Nisur nga kjo, mes të gjithë kalifëve Islamë, pas katër kalifëve të parë, më i virtytshmi dhe më i afti është konsideruar Omer Bin Abdulazizi, të cilit kur i është ofruar detyra e kalifit, ai në fillim e refuzoi. Mirëpo, më vonë, kur këshilli i dijetarëve evidentuan se nuk mund të gjendej dikush tjetër më i aftë se ai, e lajmëruan se nëse do të vazhdonte ta refuzonte detyrën, do të hynte në gjynah. Për rrjedhojë, Omer Bin Abdulazizi u detyrua ta pranojë detyrën e udhëheqjes. Ai formoi një grup këshilltarësh, të cilët kishin për detyrë ta këshillonin gjithmonë në të vërtetën dhe të drejtën.

Allahu i Madhëruar i ndihmon ata që e kryejnë një detyrë me sinqeritet dhe përpjekje të dobishme, pa qenë kërkues të asaj detyre. Njëherë, i Dërguari i Allahut (a.s.), e këshilloi kështu Abdurrahman bin Semuren (r.a.):

“O Abdurrahman! Mos e kërko udhëheqjen! Nëse të jepet udhëheqja me kërkesën tënde, të ngarkohet përgjegjësia e asaj që kërkon. Por, nëse të jepet udhëheqja pa e kërkuar, atëherë do të ndihmohesh në atë çështje.” (Buhari, Ejman, 1; Muslim, Imaret, 19.)

Po ashtu, nga Profeti ynë (a.s.), mësojmë edhe se kërkimi me lakmi i një detyre për të cilën është i paaftë, e çon atë drejt një fatkeqësie të hidhur në botën tjetër:

“Ju do të tregoheni ambiciozë në marrjen e një detyre. Por ajo detyrë për të cilën përpiqeni, do të jetë shkak pendese në ditën e kiametit.” (Buhari, Ahkam, 7; Nesai, Bej'at, 39, Kudat, 5.)

“Nëse një person, të cilin Allahu i Madhëruar e ka bërë drejtues, udes duke mashtruar njerëzit që drejton, Ai nuk do t'ia tregojë Xhenetin” (Buhari, Ahkam 8; Muslim, Iman 227-228, Imaret, 21.)

Në këtë çështje, i gjithë populli ka përgjegjësinë e vet. Kjo, është rritja dhe edukimi i njerëzve të aftë, të cilëve mund t'u besohen amanetet e popullit dhe caktimi i tyre në postet më të përshtatshme. Edhe pse kërkimi i posteve drejtuese nuk konsiderohet i përshtatshëm për arsyet e lartpërmendura, nëse e lind nevoja, personat me kualifikimin e duhur, duhet të ofrohen vullnetarisht në detyrat e kërkuara dhe jo të qëndrojnë mënjane. Shembullin më të bukur të kësaj, e gjejmë tek Jusufi (a.s.). Ai, pasi doli nga burgu dhe u bë një prej njerëzve më të rëndësishëm të mbretit të Egjiptit, e dinte se ishte më i afti në menaxhimin e situatës së zisë së bukës që po afronte dhe e kërkoi vet këtë detyrë. Siç na e bën të ditur edhe Kurani, ai i thotë mbretit të Egjiptit:

قَالَ اجْعَلْنِي عَلَى خَزَائِنِ الْأَرْضِ إِنِّي حَفِيظٌ عَلَيْهَا

“...Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, sepse unë jam ruajtës dhe njohës (i mirë i këtyre punëve)” (Jusuf, 55.)

Nga ky ajet fisnik, e kuptojmë qartë se është e lejuar që një person i drejtë dhe i aftë, të kërkojë poste drejtuese. Krahës kësaj, ajeti aludon edhe në domosdoshmërinë e marrjes së drejtimit, atëherë kur nuk ka rrugëzgjidhje tjetër për të vendosur drejtësinë dhe eliminuar të tiraninë. Kështu, për shkak se Jusufi (a.s.), i kishte të gjitha cilësitë për të kryer siç duhet detyrën e kërkuar, ai e kërkoi detyrën e ministrit të ekonomisë si rrjedhojë e domosdoshmërisë dhe ndjenjës së përgjegjësisë. Një nga shembujt e panumërt që tregojnë devotshmërinë dhe aftësinë e Jusufit (a.s.), në këtë çështje, është edhe ky:

Gjatë kohës së zisë, dikush e pyeti Jusufin (a.s.):

“Ti je përgjegjësi dhe menaxheri i thesarit. Përse e lë veten të uritur dhe nuk ha sa të ngopesh?” Jusufi (a.s.), u përgjigj:

“Nëse ngopem, kam frikë se i harroj të uriturit dhe nuk i kuptoj hallet e tyre!”

Në këtë aspekt, ata që ndodhen në poste drejtuese, duhet të bëjnë një jetë modeste në harmoni me jetën materiale e shpirtërore të shtresave më të ulëta të shoqërisë që janë nën përgjegjësinë e tij.



Shembujt më të bukur të aftësive shpirtërore që duhet të zotërojnë drejtuesit, mund t'i vërejmë në jetën e Profetit tonë (a.s.). Ai jetonte gjithmonë në kufirin e nevojave, e madje, në të shumtën e kohës jetonte si nevojtar dhe nuk e ngopte asnjëherë barkun e vet pa ngopur atë të sahabëve. Ai i jepte më tepër përparësi gëzimit të popullit se sa gëzimit të vet. Po ashtu, gjatë ndërtimit të xhamisë, ai bartte gurë në shpinën e tij të bekuar. Ndërsa kur dilnin për udhëtime, ai mbledhte dru për të gatuar ushqimin, duke dhënë kështu një shembull shumë të bukur për drejtuesit dhe udhëheqësit që do vinin pas tij. Në një hadith fisnik thuhet:

“Zotëria i një populli, është ai që u shërben atyre!” (Dejlemi, Musned, II, 324.)

Një ditë, të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ofruan prej hurmave që bëhen të parat. Mirëpo, fytyra e Profetit (a.s.), që deri në atë moment ishte e qeshur, u pre menjëherë. Më pas, ai pyeti sahabët nëse edhe ata hanin apo jo hurma të tilla të sapo pjekura. Kur mori përgjigje negative, ai tha:

“Largomini këto hurma! Le t'i hanë fëmijët! Unë nuk ha prej asaj që nuk ha populli im! I lutem Allahut të mos më bëjë prej atyre priësve që hanë çfarë nuk mund ta hajë populli dhe vishen me çfarë nuk mund të vishet populli...”

Po kështu, edhe Omeri (r.a.), i cili ishte një nga njerëzit më të përpiktë në ndjekjen e moralit profetik, u gjendej gjithmonë pranë të varfërve, duke shëtitur netëve nëpër lagjet e tyre me thasë mielli në shpinë. Lidhur me kujdesin e tij në këtë çështje, Utbe bin Ferkad (r.a.), tregon:

Njëherë i dërgova Omerit (r.a.), disa shporta me hallvë të bërë me hurma e vaj. Më pyeti se çfarë kishte në shporta dhe unë i thashë:

“Brenda tyre ka ushqim. Ta solla ty, sepse nga mëngjesi, deri në mbrëmje preokupohesh me punët e njerëzve. Doja që kur të vije në shtëpi, të haje një ushqim të mirë e të ruaje fuqinë.”

Omeri (r.a.), i hoqi mbulesën njëres prej shportave dhe pyeti:



“O Utbe, më thuaj për hir të Zotit, a i ke dhënë nga një shportë prej këtyre edhe myslimanëve të tjerë?”

“O prijësi i myslimanëve! Sikur të harxhoj të gjithë pasurinë e fisit Kajs, përsëri nuk mund t’i jap secilit prej myslimanëve nga një shportë si kjo.”, i thashë.

Nisur nga kjo Omeri (r.a.), më tha:

“Atëherë as unë s’kam ç’e bëj!”

Më pas, solli një pjatë me qull të bërë nga buka e thatë dhe mish i fortë dhe më tha se pjesën e mirë të mishit ua shërbente mysafirëve që vinin nga larg, kurse pjesën e fortë e hante vetë...” (Ali el-Muttaki, XII, 627/35936.)

Gjatë një beteje me Romakët në zonën e Sirisë, ushtarët myslimanë u ulën në një vend për të pushuar dhe filluan të hanë bukë të thatë dhe hurma. Kurse komandantit të tyre, Halid Bin Uelidit (r.a.), i sollën bukë të butë dhe ujë të ftohtë. Kur e pa këtë, Halidi i pyeti se si ishte e mundur që bukët nuk ishin tharë nën atë diell të nxehtë dhe ku e kishin gjetur atë ujë të ftohtë. Ati i thanë:

“Këtë bukë e ujë, e kemi ruajtur nëpër gropa të lagështa. Prandaj edhe buka është e butë, e uji i ftohtë.”

Pas kësaj, Halid bin Uelidi tha:

“Po ushtarët e mi, a po hanë prej kësaj buke të butë dhe a po pinë prej këtij uji të ftohtë?”

“Jo, ata kanë bukë të thatë dhe ujë të ngrohtë!” – u përgjigjën.

Kësaj here, Halidi (r.a.), u tha:

“Atëherë ma hiqni këtë bukë të butë, e ujë të ftohtë! Më sillni nga buka e thatë që po hanë ushtarët e mi dhe uji i ngrohtë që po pinë! I lutem Allahut të mos më bëjë prej komandantëve që në luftë janë bashkë me ushtarët dhe në sofër ndahen prej tyre! Ata që marrim ne shembull, nuk kanë vepruar kështu. Prandaj, edhe ne nuk do të bëhemi!..”

Nga ana tjetër, i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka dhënë sihariqin se udhëheqësit e drejtë, do të jenë një prej shtatë kategorive të aty-



re njerëzve që do të strehohen nën hijen e Arshit të Allahut ditën e gjykimit.⁵⁵

Ata që marrin përsipër një post drejtues, duhet të dinë të vënë në radhë të parë nevojën e atyre që kanë nën vete, para nevojave personale. Ndërsa ata që këmbëngulin vazhdimisht që t'i bëjnë të gjitha punët vet, do të lodhen shpejt, do t'u ngushtohet shpirti dhe do t'u ndryshojnë mendimet. Më pas, vjen një kohë kur përçmojnë çdokënd dhe kaplohen nga mendjemadhësia, duke u bërë kështu robër të dashurisë për pushtet. Atëherë, pozita dhe pushteti, i cili është mjet për të fituar kënaqësinë e Allahut, duke i shërbyer shoqërisë, kthehet në një mjet që i shërben ndjenjës për famë dhe kënaqësi individuale.

Drejtuesit e drejtë dhe të matur, ia kushtojnë veten paqes dhe lumturisë së shoqërisë, duke u zhveshur nga interesat vetjake. Ata janë njerëz të zemrës që me modestinë e tyre, kanë pranuar të qëndrojnë në fund të karvanit të shërbimit. Ata e kanë bërë parim të jetës së tyre ajetin e Kuranit: **“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë...”** (Furkan, 63.)

Lidhur me këtë çështje, edhe këto fjalë që zënë vend në një letër që Aliu (r.a.), ia ka dërguar një guvernatori në kohën kur ka qenë kalif, tregojnë se sa e rëndësishme është edhe dëshmia e popullit në lidhje me drejtuesit e vet:

“...Ti, ke vëzhguar punët e guvernatorëve që kanë qenë para teje; tani, populli do të shohë punën tënde. Ato që ti ke thënë atëherë në lidhje me ata, populli do t'i thotë tani në lidhje me ty. Për rrjedhojë, se kush është udhëheqës i drejtë, do të kuptohet vetëm në sajë të fjalëve që Allahu i nxjerr nga gjuha e robërve të Vet.”

Nisur nga kjo, mund të thuhet se në njëfarë mënyre, që Allahu të jetë i kënaqur me udhëheqësit, varet nga sa janë të kënaqur populli me të. Në vazhdim të këshillave të tij ndaj guvernatorit, Aliu (r.a.), thotë:

“Mos thuaj asnjëherë, «Unë jam i fuqishëm, urdhëroj, më binden!», sepse kjo do të thotë t'ia dorëzosh zemrën së keqes, të dobësosh fenë dhe t'i afroresh shkatërrimit!”

55. Shih. Buhari, Zekat, 16, Rikak, 24; Muslim, Zekat, 91.

Drejtesit e aftë dhe të drejtë, ashtu siç i kryejnë me përpikëri detyrat që kanë marrë përsipër, nëse është e nevojshme, ata dinë edhe të sakrifikojnë për hir të popullit, duke ia dorëzuar me gjithë dëshirë detyrën që bartin, një njeriu tjetër edhe më të aftë.

Një shembull të tillë, ka treguar edhe nipi i Profetit tonë (a.s.), Hasani (r.a.), i cili pasi e ka kryer për gjashtë muaj detyrën e kalifit, ia ka dorëzuar atë Muavijes, me qëllim që populli të mos përçahet. Në këtë mënyrë, ai është munduar t'i paraprijë përplasjes së masave të mëdha të popullit dhe të pengojë derdhjen e gjakut të myslimanëve.

Madje, Ebu Bekri (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), na e ka bërë të ditur këtë situatë që më herët në formë profecie:

“E pashë Profetin (a.s) në minber, ndërkohë që pranë kishte Hasanin. Nganjëherë drejtohej nga njerëzit, nganjëherë nga Hasani dhe tha:

«Allahu, me këtë nipin tim do të pajtojë dy ushtri të mëdha Islame.»” (Buhari, Menakib 25, Fedailu'l-Ashab 22)

Një tjetër shembull i sakrificës në këtë çështje, është edhe ky:

Me vdekjen e Osman Gazit, i biri i tij, Alaaddini, i cili mbështetej nga paria e shtetit në lidhje me kalimin e postit sipas traditës, i dha përparësi vëllait të tij, Orhanit të cilit i tha:

“O Vëllai im! Lutja dhe bekimi i babait tonë është me ty. Kur ishte gjallë, komandën e ushtrisë ta pati dhënë ty. Prandaj edhe shteti të përket ty.”

Alaaddini, i cili shfaqti zemërgjerësi dhe sakrificë të madhe, u bë mbështetësi më i madh i vëllait të tij dhe shërbeu si veziri/zëvendësi i tij.⁵⁶

Një prej shembujve më madhështorë lidhur me unitetin ka shfaqur edhe Idris Bitlisi, lideri i një fisi të madh në Anadollin lindor. Duke e mbështetur me gjithë shpirt projektin e Bashkimit Islam të Sulltanit Javuz Selim, ai pranoi t'i bashkojë të gjitha tokat me Shtetin Osman.



Në të njëjtën mënyrë, edhe Barbaros Hajreddin Pasha, i cili zotëronte Afrikën e Veriut, e bashkoi atë me Shtetin Osman me idenë “Unitetit islam”. Në këmbim të kësaj, Sulltan Sulejman Kanuni i dha atij postin e komandantit të Forcave Detare Osmane.

Një nga çështjet më të rëndësishme për të cilën duhet të bëjë kujdes një udhëheqës apo drejtues, është shoqërimi dhe këshillimi i vazhdueshëm me njerëz besnikë dhe të sinqertë dhe largimi prej njerëzve negativë. Siç shprehet edhe Imam Gazaliu, nëse ndjehet afërsi me mendimet e gjynahqarëve, me kalimin e kohës njeriu fillon e mendon si ata. E në njëfarë mënyre, Allahu na ruajt, mund të kthehet edhe në “afërsi shpirtërore”. Për rrjedhojë, kjo gjendje nënkupton falimentimin e personalitetit dhe jetës shpirtërore.

Edebali ka thënë:

“Mos harro, se ata që ndodhen lart, nuk janë të sigurt aq sa ata që ndodhen poshtë!”

Nisur nga kjo, ata që ndodhen në poste drejtuese, duhet të jenë më të kujdesshëm. Ashtu si dikush që ngjitet në majën e një mali të lartë e të thepisur, ata duhet të tregojnë kujdes shumë të madh se ku e vënë këmbën dhe dorën e tyre. Një njeri që pengohet dhe rrëzohet në rrugë të drejtë, mund të ngrihet përsëri lehtësisht. Por nëse hidhet qoftë edhe një hap i gabuar gjatë ngjitjes në një majë të lartë, kjo e rrëzon njeriun në humnerë, pre nga nuk mund të ngrihet më. Mbi të gjitha, kjo fatkeqësi nuk kufizohet vetëm me atë person. Ai merr me vete edhe të gjithë shoqërinë. Një tregtar që gabon, fundos kapitalin dhe veten e tij. Por një lider që gabon, fundos gjithë popullin. Për këtë arsye, ai merr mbi vete edhe gjynahet e tyre.

Shkurtimisht, besimtari duhet të llogarisë gjithmonë se si mund t'i përdorë mundësitë materiale e shpirtërore që i ka dhënë Allahu, në mënyrën më të dobishme të mundshme për shoqërinë. E kur ta ndjejë se nuk do të mund ta kryejë siç duhet detyrën, duhet t'ia dorëzojë atë një tjetri më të aftë, pa rënë pre e ndjenjave egoiste. Po ashtu, ai duhet të qëndrojë larg famës dhe madhështisë, e nëse është e nevojshme, duhet të preferojë të jetojë pa u njohur, duke u ruajtur kështu prej da-

shurisë për pushtet dhe famë. Ata që ndodhen në postin e drejtuesit, duhet patjetër t'i vënë veshin fjalëve të fundit të Profetit tonë (a.s.), në shtratin e vdekjes, ku tha: *“Kujdes namazin dhe kini frikë nga Allahu në lidhje me ata që keni nën vete!”* (Ebu Daud, Edeb, 123-124/5156.)

Krahas kësaj, ata duhet të bëjnë një vetllogari e t'i thonë vetes: “Vallë a jam i vetëdijshëm për përgjegjësinë e drejtimit dhe kushtet e rënda që ka, apo mos vallë më ka kapluar dashuria për pozitë dhe po helmoj shpirtin tim?!”

I lutemi Allahut të Madhëruar që të gjithë besimtarët të cilët kanë marrë përsipër një detyrë, sado e vogël qoftë, t'i ruajë nga çdo gjë negative, si dashuria për pasuri, famë, pozitë, etj. Allahu na bëftë të gjithëve prej robërve të Tij të devotshëm, prej dorës, gjuhës dhe zemrës së cilëve kanë dobi të gjithë myslimanët!..

Amin!..



Mbrojtja e brezit -1-



Në jetën familjare, duhet bërë një kujdes i jashtëzakonshëm në lidhje me kufijtë delikatë ndërmjet maturisë dhe mendjemadhësisë, modestisë dhe përçmimit, singëritetit dhe mos seriozitetit.

Edukimi i një brezi fisnik, është një ndjenjë e lartë njerëzore. Për këtë arsye, ne duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me dashuri ndaj adhurimeve. Në mënyrë të veçantë, nuk duhet të kursejmë asgjë në lidhje me edukimin e tyre sipas normave Islame. Nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të jenë të përsosur, duhet të përpiqemi të bëhemi prindër të përsosur.

MBROJTJA E BREZIT -1-

Që prej Ademit (a.s.), të gjithë profetët kanë treguar seriozitet të madh në çështjen e martesës, për shpëtimin e njerëzimit, sepse mbrojtja e tij, është e mundur në sajë të një institucioni të shëndetshëm familjar. Brezat e krijuar jashtë martesës, të cilët nuk edukohen në familje, e prishin harmoninë e jetës shoqërore dhe e tronditin nga themelet rendin shoqëror. E në fakt, nuk ka injorancë dhe marrëzi më të madhe se ta ndërrosh lumturinë e martesës me papastërtinë e amoralitetit!..

Natën e Miraxhit, Resulullahu (a.s.), me Xhibrilin (a.s.), kanë takuar disa njerëz duke vuajtur. Para tyre kishte mish të shijshëm të pjekur mirë dhe cofëtina të papjekura e të kalbura. Mirëpo, ata e linin mënjatë mishin e pjekur aq mirë dhe hanin mishin e cofëtinave. I Dërguari i Allahut (a.s.), i habitur pyeti se kush ishin ata. Xhibrili u, iu përgjigj:

“Ata janë meshkujt prej umetit tënd, të cilët kanë lënë gratë e tyre hallall dhe kanë shkuar me gratë që i kanë pasur haram dhe gratë që kanë lënë burrat e tyre dhe kanë shkuar me burrat që i kanë pasur haram.” (Hajthemi, I, 67 - 68.)

Ditët e lumtura të shokëve të jetës, kujtimet e bukura dhe të thella, gëzimet e sinqerta, rehatia, paqja dhe mirësia arrihen gjithmonë nën hijen e kritereve hyjnore. Dhe kjo, vjen në sajë të besnikërisë dhe sinqeritetit ndaj njëri-tjetrit të të dyja palëve si robër të Allahut. E në fakt, Allahu i Madhëruar, i ka krijuar ata të nevojshëm ndaj njëri-tjetrit, si



shpirtërisht, ashtu edhe fizikisht. Ndërsa fakti që njerëzit janë krijuar në dy gjini, mashkull-femër, që plotësojnë njëra-tjetrën, është një element shumë i rëndësishëm që siguron ekuilibrin dhe lumturinë e jetës. Nëse ky ekuilibër priset për shkaqe të tilla, si luftërat e mëdha, ai rregullohet përsëri në sajë të ligjeve hyjnore pa kaluar as një çerek shekulli.

Si rrjedhojë e bashkimit legjitim të çifteve, formohet familja, e cila është një prej gurëve themelorë të shoqërisë. Familja është një institucion esencial dhe i domosdoshëm që siguron përsosjen e sistemit shoqëror dhe mbushjen e shtëpive me gëzim e lumturi.

Kur formohet një familje, burri dhe gruaja i japin fjalën njëri-tjetrit në mënyrë të prerë dhe ndërtojnë një bashkim që mbështet në parimet e dashurisë, sinqeritetit dhe besimit. Kështu, si manifestim i fuqisë dhe madhësisë hyjnore, dy njerëz të huaj ndaj njëri-tjetrit, bëhen njerëzit më të afërt për njëri-tjetrin. Mbi të gjitha, çerdhja familjare që kanë ndërtuar, bëhet edhe më e ngrohtë se shtëpia e babait prej së cilës janë ndarë. Allahu i Madhëruar, në Kuran na e bën të ditur se bashkëshortët janë mirësi hyjnore për njëri-tjetrin:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا
وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.” (Rum, 21)

Në jetën familjare, duhet bërë një kujdes i jashtëzakonshëm në lidhje me kufijtë delikatë ndërmjet maturisë dhe mendjemadhësisë, modestisë dhe përçmimit, sinqeritetit dhe mos seriozitetit. Lumturia në familje, është fryti i pjekurisë dhe i mirëkuptimit reciprok mes bashkëshortëve dhe duhet ruajtur me kujdes të madh. Të dyja palët duhet të jenë dashamirëse ndaj njëri-tjetrit, pa e humbur seriozitetin. Në jetën familjare, duhet bërë një kujdes i jashtëzakonshëm në lidhje me kufijtë



delikatë ndërmjet maturisë dhe mendjemadhësisë, modestisë dhe përçmimit, sinqeritetit dhe mos seriozitetit.

Shtëpia nuk përbëhet vetëm nga katër mure të ndërtuara vetëm për të banuar. Kujdesi ndaj situatave intime që përjetohen në të dhe mospublikimi i çështjeve familjare, është një nga kushtet themelore të vazhdimit të lumturisë dhe harmonisë.

Nëse Islami kuptohet dhe përvetësohet në mënyrë të drejtë dhe serioze, familja kthehet në një “Xhenet”. Për këtë arsye, është thënë se, “Xheneti i burrit është shtëpia e tij”.



Qëllimi i krijimit të njeriut, është njohja e Krijuesit të tij. Kur kjo njohje kapërcen nivelin intelektual dhe fiton cilësi shpirtërore, atëherë lind dashuria e vërtetë, pra “dashuria për Allahun”, që është edhe veprimtaria më me vlerë e zemrës. Kjo e vërtetë, shprehet kështu Kuranin Fisnik:

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”

(Ra'd, 28.)

Mirëpo, që zemra të arrijë pjekurin e duhur për të qenë e gatshme për dashurin e Allahut, është e mundur vetëm nëse kalon nga disa faza. Sipas Islamit, dashuria për familjen dhe fëmijët, është faza fillestare që i shërben zemrës për të fituar përgatitjen e duhur për dashurinë e Allahut. Kjo është edhe urtësia e fjalës së Mexhnunit, kur thoshte: “E gjeta Zotin duke shkuar pas dashurisë për Lejlën.”

Heroizmi i personazhit të Mexhnunit, nuk ka mbetur i kufizuar vetëm me këtë botë, por ka kaluar prej “dashurisë metaforike” në “dashurinë e vërtetë”, pra, prej dashurisë së kalimtare e njerëzore, në dashurinë e përjetshme hyjnore. Lejla, të cilën në fillim e dashuronte aq sa jepte edhe jetën për të, në fund u bë një shkallë drejt dashurisë hyjnore. Kur Mexhnuni gjeti në botën e dashurisë hyjnore të vërtetën që kërkonte, përfundoi edhe roli i Lejlës në jetën e tij.

Nga ky aspekt, nëse aventura e dashurisë që fillon me Lejlatë gjen



paqen tek Allahu, atëherë dashuria ka arritur qëllimin e saj të vërtetë. Kështu, edhe ne si Mexhnuni, duhet t'i bëjmë shkallë dashuritë kalimtare për të arritur tek dashuria hyjnore dhe, pasi të kemi kuptuar se çfarë kërkojmë në të vërtetë, pra, ditën kur të kemi shikuar ëmbëlsinë e dashurisë së vërtetë dhe hyjnore, nga zemra jonë do të shpërthejë thirrja e gëzimit:

“Zoti im! Ndërkohë që të kërkoja larg, të gjeta në zemrën tim!..”

Siç mund të kuptohet, në përgatitjen e zemrës ndaj manifestimeve të dashurisë hyjnore, një rol të rëndësishëm në arritjen e nivelit të kërkuar, luan edhe trajnimi i saj me dashuritë njerëzore. Dhe një nga hapat më të mëdhenj që duhet të hidhet në këtë drejtim, është një dashuri legjitime e pjekur nën hijen e martesës. Kjo, sepse dashuria për gjininë e kundërt, është e natyrshme. E në fakt, Allahu e krijoi nënën tonë Havanë, prej Ademit (a.s.) dhe formoi mes tyre një lidhje të fortë zemre.

Nëse afërsia mes bashkëshortëve realizohet në formë legjitime dhe synojnë arritjen e kënaqësisë së Allahut, fryti më i rëndësishëm i kësaj afërsie, është lindja e një fëmije. Dhe, një tjetër prej trajnimeve të zemrës në rrugën e dashurisë hyjnore, është dashuria për fëmijët. Në përgjithësi, dashuria e prindërve për fëmijët e vet, është aq e madhe, sa nuk mund të krahasohet as me dashurinë që kanë ata (prindërit) për prindërit e vet. Por, nëse kjo dashuri e madhe vazhdon vetëm në planin njerëzor, merr cilësinë e “sprovës”, për të cilën bëhet fjalë në Kuran, në lidhje me pasurinë dhe fëmijët:

وَأَعْلَمُوا أَنَّمَا أَمْوَالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ فِتْنَةٌ وَأَنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ أَجْرٌ عَظِيمٌ

“Ta dini se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë dhe se vetëm tek Allahu është shpërblimi i madh.” (Enfal, 28.)

Nëse fëmijët nuk edukohen siç duhet, familja e tij i ngarkon vetes një gjynah të madh. Padyshim se shpërdorimi është haram dhe, shpërdorimi më i keq, është ai qenies njerëzore. Prandaj, të tregosh kujdes të madh në lidhje me edukimin e fëmijëve tanë me ndjenja shpirtërore, është një nga detyrat më të rëndësishme të devotshmërisë ndaj Allahut.



Nëse qasja jonë ndaj pasurisë dhe fëmijëve, është në përputhje me kënaqësinë e Allahut dhe bëhet shkak i arritjes së ëmbëlsisë së besimit, atëherë ato janë “stoli” për ne. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik thuhet:

الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَالْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ
عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا

“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim).” (Kehf, 46.)

Fakti që pasuria dhe fëmijët në një ajet përmenden si “sprovë” dhe në një ajet tjetër si “stoli”, është shumë interesant. Kjo, sepse ato mirësi kthehen në sprovë, nëse hedhin rrënjë në zemër, duke shkaktuar indiferencën e robit ndaj Allahut të Madhëruar. Por, ato marrin cilësinë e një stolie, nëse ngrenë nivelin e besimit në zemër dhe kthehen në sadaka rrjedhëse, e cila i bën dobi robit edhe pasi të ketë ndërruar jetë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Pas vdekjes (një) robit i ngrihet grada (në Xhenet), e ai pyet:

«O Zoti im! Nga erdhi ky shpërblim?» Allahu i Madhëruar përgjigjet:

«Fëmija i mirë e i devotshëm (që ke lënë pas), u lut dhe kërkoi falje për ty.»» (Ibn-i Maxhe, Edeb, 1; Ahmed, II, 509.)

“Kur biri i njeriut vdes, atij i priten të gjitha veprat, përveç këtyre të triave: Sadakaja xharije (e rrjedhshme), dija e dobishme dhe fëmija i mirë që lutet për të.” (Muslim, Vasijjet, 14; Tirmidhi, Ahkam, 36.)

Detyra më e rëndësishme e prindërve, është që fëmijët, të cilët u dorëzohen me natyrshmërinë e pastër islame, t’i pajisin me virtyte të larta dhe t’i edukojë në mënyrën më të mirë. Të kesh fëmijë të dobishëm, është shkak paqeje dhe lumturie në të dyja botët. Dhe edukimi

më i mirë që mund t'u jepet, është i mundur vetëm në atmosferën shpirtërore të familjes. Kurse detyra më e rëndësishme në familje, i takon nënës.

Zemra dhe prehri i një nëne, është shkolla e jashtëzakonshme ku zhvillohet edukimi i fëmijës, sepse çdo fjalë që i thuhet fëmijës në mos-hë të vogël, është si një tullë që ndërton personalitetin e tij. Fëmijët që marrin edukim të mirë nga nënat që janë burim dhembshurie, bëjnë më pak gabime në jetën e tyre. Ata që arrijnë ta ruajnë besimin tek jeta, pavarësisht mospasësive dhe fatkeqësive, në përgjithësi, janë njerëz të edukuar nga nëna të devotshme. Prandaj, për sa kohë të ekzistojnë nëna të mençura dhe të devotshme, bota do të ketë më shumë paqe dhe lumturi.

Me fjalë të tjera, çdo gjë që i duhet lidhur me të drejtën dhe të mirën, pikësëpari, fëmija i mëson në institucionin familjar. Më pas, kësaj i shtohen edhe institucionet e tjera. Megjithatë, ndikimi i familjes është thelbësor. Për këtë arsye, edukimi i mirë dhe cilësor i fëmijëve, është një përgjegjësi shumë e madhe për prindërit. Në të njëjtën kohë, kjo është edhe e drejta më themelore e fëmijëve mbi prindërit e tyre. Pikat më të rëndësishme për të cilat duhet të bëjnë më shumë kujdes prindërit në lidhje me edukimin e fëmijëve, janë këto:

a. Emërtimi i fëmijës me emër të bukur.

b. Ushqimi i tyre me hallall.

c. Duke e ditur se fëmijët janë më të prirë të imitojnë, ne duhet të bëhemi shembull për ta me sjelljet dhe fjalët tona, sepse nuk ka asgjë më ndikuese sesa shembulli.

ç. Fëmijët duhet ta ndjejnë veten të lirë dhe jo nën kontrollin e rreptë të prindërve. Në të kundërtën, gabimet që nuk i bëjnë hapur, do t'i bëjnë fshehurazi. Krahas kësaj, kjo ua dobëson karakterin dhe rrezikon që të zhvillojnë personalitet të dyfishtë. Treguesi i parë i kësaj gjendjeje, është gënjeshtria. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَالْقِيْتُ عَلَيْكَ مَحَبَّةً مِنِّي وَلِتُصْنَعَ عَلَى عَيْنِي



“...Unë kam hedhur në ty dashurinë Time, që të rritesh nën Syrin (kujdesin) Tim.” (Ta-Ha, 39.)

Siç kuptohet qartë edhe nga ajeti i mësipërm, fëmijët duhet t'i ruajmë nga rreziqet fizike dhe shpirtërore, duke i edukuar me dashuri dhe mëshirë. Dhe kjo, nuk duhet bërë duke ushtruar presion dhe forcë, por duke u falur ngrohtësinë e dashurisë, në mënyrë që për ta të krijohet një ambient dashurie. Për rrjedhojë, fëmijët tanë duhet të edukohen vazhdimisht nën kujdesin dhe mbrojtjen tonë, pa i neglizhuar asnjëherë.

d. Sjelljet dhe veprimet e mira të fëmijëve duhen shpërblyer, kurse gabimet nuk duhen anashkaluar. Në sajë të shpërblimit të sjelljeve të mira, ato do të zënë vend më lehtë dhe më gjatë në karakterin e tij. Përkundër kësaj, gabimet të cilat nuk qortohen në kohën e duhur, me kalimin e kohës do të përsëriten vazhdimisht dhe do të bëhen pjesë e karakterit të fëmijës. Në mënyrë të veçantë, gabimet e vajzave tona në moshë të vogël në lidhje me veshjet, nuk duhet të anashkalohen aspak, sepse gjërat me të cilat njeriu mësohet njëherë, me kalimin e kohës kthehen në zakon, apo edhe varësi.

dh. Fëmijët nuk duhet të dënohen në mënyrë të shpeshtë, sepse vjen një kohë që ai mësohet me dënimin dhe tregohet moskokëçarës.

e. Kur fëmijëve u jepen urdhra, u tregohen ndalesa apo u jepen porosi, duhet t'u shpjegohen në mënyrë që të arrijnë t'i kuptojnë dhe të binden për to.

ë. Fëmijëve u duhen mësuar edukata dhe sjellja morale. Në mënyrë të veçantë, familjet e pasura duhet t'i edukojnë fëmijët e tyre që të sillen me modesti dhe mirësjellje ndaj bashkëmoshatarëve të tyre.

f. Fëmijët duhen lejuar të jetojnë fëmijërinë e tyre, brenda mundësive të arsyeshme. Mirëpo, nuk duhen lënë as shumë të lirë, e as t'u bëhet shumë presion, sepse liria e tepërt, i lazdron dhe i bën dembelë, ndërsa presioni i tepërt, bëhet shkak që fëmija të zhvillojë karakter të dobët, të humbasë guximin dhe besimin tek vetja.



g. Atyre u duhen kujtuar mirësitë e Allahut dhe u duhet mësuar falënderimi dhe mirënjohja ndaj Tij. Po ashtu, me anë të shembujve nga jeta e Profetit tonë (a.s.), duhet bërë përpjekje për ta brumosur botën e tyre të brendshme në një atmosferë shpirtërore.

gj. Fëmijët duhet të mësohen me adhurime dhe shërbime sa janë ende të vegjël, duke ua treguar rëndësinë dhe përgjegjësinë e tyre në mënyrë që t'u bëhen të dashura. Edukimi i një brezi fisnik, është një detyrë sublime. Vështirësitë dhe vuajtjet që kalohen gjatë edukimit të fëmijëve, bëhen shkak i faljes së gjynaheve. Lidhur me edukimin e mirë të fëmijëve, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Asnjë baba nuk mund t'i lërë fëmijë trashëgimi më të mirë se morali i bukur.” (Tirmidhi, Birr, 33/1952.)

Për këtë arsye, ne duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me dashuri ndaj adhurimeve. Në mënyrë të veçantë, nuk duhet të kursejmë asgjë në lidhje me edukimin e tyre sipas normave Islame. Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik urdhëron:

“...Urdhëro familjen tënde të falë namaz, edhe ti vetë zbatoje atë!..” (Ta-Ha, 132.)

Pra, sipas këtij ajeti fisnik, ne duhet t'i edukojmë fëmijët që të bëhen të vetëdijshëm ndaj namazit. Po ashtu, ne duhet t'i ruajmë fëmijët nga çdo lloj sjellje negative që ua dobëson botën shpirtërore, si shëtitjet e panevojshme, sorollatjet e kota, vonesa në shtëpi, shoqëria e keqe, etj. Krahës këtyre, ne nuk duhet të lejojmë që mes fëmijëve të shfaqet smirë dhe duhet t'i këshillojmë të mbajnë gjithmonë drejtësinë.

Kur të rriten e të kenë arritur pjekurinë dhe seriozitetin e duhur për të mbajtur familje, duhet t'i nxisim dhe t'i ndihmojmë të martohen. Ndërsa në zgjedhjen e bashkëshortit/es së duhur, më tepër se pasurinë, pozitën dhe cilësi të tjera materiale, duhet të bëjmë kujdes në preferimin e cilësive shpirtërore, si besimi i drejtë, morali i bukur dhe sjelljet e hijshme. Kjo, sepse në përgjithësi, çiftet që nuk martohen duke marrë për bazë ndjenjat morale dhe fetare, ka më pak mundësi të kenë martesë të lumtur dhe të suksesshme. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:



يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا
وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Tahrim, 6.)

Kur zbriti ky ajet, sahabët fisnikë pyetën:

“O Resulallah! Vetën tonë mund ta ruajmë nga zjarri, po familjen tonë si ta ruajmë?” Resulallahu (a.s.), u përgjigj:

“Urdhërojini ata të bëhen robër të Allahut, të jenë të bindur dhe të kryejnë adhurimet. Pengojini ata nga mosbindja ndaj Allahut dhe bërja e gjynaheve. Kjo pra do të thotë t’i ruash ata nga Xhehenemi.” (Alusi, XXVIII, 156.)

Krahas këtyre, me qëllim që të gëzojmë pasardhës që do të jenë “drita e syve tanë”, Allahu i Madhëruar na mëson të lutemi kështu:

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا
قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“...«O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!»” (Furkan, 74.)



Nga ana tjetër, familjet të cilave Allahu i Madhëruar nuk u ka falur fëmijë, duhet të tregohen të duruar dhe të kënaqur me caktimin e Allahut, duke medituuar mbi këtë ajet fisnik:

وَعَسَى أَنْ تَكْرَهُوا شَيْئًا وَهُوَ خَيْرٌ لَكُمْ وَعَسَى أَنْ تُحِبُّوا شَيْئًا
وَهُوَ شَرٌّ لَكُمْ وَاللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ



“...Ju mund ta urreni një gjë, ndërkohë që ajo është e mirë për ju, e mund ta doni një gjë, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini!” (Bekare, 216)

Po ashtu, ata që janë në këtë gjendje, sipas mundësive që kanë, duhet të kërkojnë një rrugë ngushëllimi për veten e tyre, duke u bërë familje për të varfrit, të vetmuarit, e sidomos për fëmijët jetimë. Kështu, ata jo vetëm gjejnë ngushëllim për mungesën e një fëmije, por i shpëtojnë nga jeta e keqe dhe e vetmuar edhe ata për të cilët do të kujdesen. Lidhur me këtë, ata duhet të marrin si parim hadithin e Profetit tonë (a.s.), në të cilin thuhet:

“Personi që kujdeset për jetimin e vet apo për jetimin e një personi tjetër, ka për të qenë së bashku me mua në xhenet, ja kështu.”

Raportuesi i hadithit, Malik ibn Enesi tregon se si Profeti (a.s.) kishte ngritur dorën dhe kishte treguar bashkë gishtin tregues dhe gishtin e mesit. (Muslim, Zuhd, 42.)

Ky detyrë përfshin të gjithë besimtarët, sepse besimtari është një njeri me horizont altruist, që mendon për fëmijët e të tjerëve, njësoj si për fëmijët e vet. Fëmijët e mbarë që edukohen në një ambient familjar ku mbizotëron jeta shpirtërore, do të jenë patjetër sadaka e rrjedhshme për prindërit e tyre. Po ashtu, ata që i marrin nën mbrojtje jetimët, do të fitojnë edhe kënaqësinë e Allahut dhe të Profetit tonë (a.s.). I Dërguari i Allahut (a.s.), i pyeste shpesh shokët e vet se, “a e kishin përkëdhelur kokën e ndonjë jetimi atë ditë?”



Gjatë një ankete të zhvilluar mes fëmijëve lustraxhi, një djalë i vogël 9 vjeçar që shkonte në klasën e tretë, preku zemrat e të gjithëve me fjalët e tij të sinqerta që shprehnin vuajtje dhe hidhërim:

“Dua të shkoj në Xhenet! Atje ka zogi, flutura dhe lule shumëngjyrëshe me aromë të këndshme. Atje dua të ha mollë, portokalle, banane, kivi dhe çdolloj fruti tjetër.

Dua të kem biçikletë, të lexojë libra me përralla dhe nuk dua të punoj më si lustraxhi këpucësh. Atje, dua të ulem, të pushoj e të fle mirë.



Dua të lexoj libra. E nëse e mbaroj shkollën, dua të bëhem doktor që të shëroj të sëmurët.

Jashtë bie borë, kam ftohtë!..”

Këto vajtime të heshtura në shoqërinë e sotme, e shprehin në mënyrë shumë të hidhur përgjegjësinë tonë ndaj atyre fëmijëve të pafajshëm e të vuajtur, të cilët janë braktisur në vetmi përballë luftës së jetës në vorbullën e mizorisë dhe mjerimit!.. Ja pra, këtë fëmijë të pafajshëm, që janë lënë të vetmuar në luftën me jetën, presin të për-malluar mes vajtimeve të heshtura ditën që besimtarët e mirë dhe të mëshirshëm t’u zgjasin dorën e ndihmës dhe jetët e tyre të kthehen në Xhenet...

Mbi të gjitha, më tepër se t’u ngopësh barkun, t’i veshësh me rroba të bukura dhe t’u japësh ndonjë pare xhepi, ata dëshirojnë që tashmë, ne të kuptojmë se ata kanë edhe nevoja shpirtërore. E në fakt, ne, krahas plotësimi të nevojave të tyre materiale, jemi përgjegjës para Allahut edhe për edukimin e tyre fetar e moral. Shoqëria jonë ka shumë nevojë për njerëz të zemrës, të cilët do t’ua shuajnë urinë shpirtërore këtyre shpirtrave të vuajtur dhe do t’ua ngushëllojnë zemrat e hidhëruara.

Të mos harrojmë se, ata që nuk i dëgjojnë rënkimet që thonë, “kini mëshirë!”, janë udhëtarët e hutuar të kësaj jete. Nëse pasionin dhe dashurinë për mëshirën dhe shërbimin nuk e ngremë mbi dashuritë kalimtare të kësaj bote, atëherë e kemi çuar dëm jetën tonë.

Lum si besimtarët që në një kohë kur njerëzit i kanë kthyer dëshirat e egos në idhuj dhe plagët sociale anashkalohen pa u vënë re, ata i kapërcejnë interesat dhe shqetësimet personale dhe e ndjejnë veten përgjegjës për vuajtjet e shoqërisë, duke i shtrënguar në gji jetimët, të vuajturit dhe të vetmuarit!

I lutemi Allahut të Madhëruar të na japë një jetë të devotshme dhe një zemër të mbushur me mëshirë dhe dhembshuri për njerëzit përreth nesh!..

Amin!..

Mbrojtja e brezit -2-



Fëmijët janë amanete hyjnore të cilat u janë falur prindërve të tyre. Fëmijët lindin në natyrshmërinë e pastër islame, prandaj edhe zemra e tyre është si një tokë e pastër, si një xhevahir bruto, që ka nevojë të përpunohet. Nëse ata do të jenë trëndafila apo gjemba, do të japin fruta të hidhura apo të ëmbla, varet nga gjendja e farës shpirtërore që do të hidhet në zemrat e tyre. Shoqëritë e forta, janë vepra familjeve të forta dhe nënave të virtytshme. Shembujt më të mirë të këtyre, janë gratë sahabe. Ato i mësuan fëmijët e vet të sakrifikonin me jetët dhe pasurinë e tyre dhe i mbujtën zemrat e tyre me dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).

MBROJTJA E BREZIT -2-

Në këtë botë, të cilën Allahu e ka krijuar si vend adhurimi, popujt që kanë humbur cilësitë e tyre shpirtërore, manifestimet e tyre të devotshmërisë, nderin dhe vlerën njerëzore, janë fshirë nga harta e botës dhe janë bërë mësim për gjithë popujt e tjerë. Këto na i bënë të ditura Kurani Fisnik, i cili i ndriçon njerëzimit rrugët e lumturisë së përjetshme, duke mbajtur dritën e udhëzimit para tyre.

Për shkak se njeriu është “krijesa më e nderuar”, ndryshe nga krijesat e tjera, atij i kanë ardhur urdhra hyjnorë, që ruajnë dhe përmirësojnë nderin, dinjitetin, maturinë dhe ndjenjën e turpit tek ai. Dhe një prej këtyre urdhrave, është ai në lidhje me “mbulesën”. Ndër të gjitha krijesat, mbulesa është një veçori që ka të bëjë vetëm me njeriun. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

يَا بَنِي آدَمَ قَدْ أَنْزَلْنَا عَلَيْكُمْ لِبَاسًا يُؤَارِي سَوَاتِكُمْ وَرِيشًا
وَلِبَاسُ التَّقْوَىٰ ذَٰلِكَ خَيْرٌ

“O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbulonin vendet e turpshme, si edhe për zbulurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri...” (A'raf, 26.)

Biri i njeriut, është i detyruar të mbulohet për të mbrojtur nderin, ndjenjën e turpit dhe seriozitetin njerëzor që i ka falur Allahu. Për-



ndryshe, këto cilësi njerëzore, do të humbasin dhe njeriu do të bjerë në gradën e krijesave të tjera siç janë kafshët.

Krahas kësaj, humbja e ndjenjës së turpit në shoqëri, përhapja dhe kryerja në mënyrë të hapur e amoralitetit dhe prostitucionit, është një prej shenjave kryesore të kiametit. Në një hadith fisnik thuhet:

“Ndjenja e turpit është prej besimit!” (Buhari, Iman, 3.)

Ademi (a.s.), dhe gruaja e tij Havaja, u turpëruan nga lakuriqësia e tyre edhe pse në Xhenet nuk kishte njerëz të tjerë. Kjo do të thotë se mbulesa dhe motivueset shpirtërore të saj, edukata dhe turpi, janë prej cilësive rrënjësore që gjenden në natyrën e njeriut.

Mevlana ka thënë:

“Pyeta mendjen time: «ç’është besimi?» Mendja u përkul tek veshi i zemrës sime dhe i pëshpëriti: «Besimi është edukatë!»”

Islami ka sjellë disa rregulla në lidhje me veshjen e përshtatshme me dinjitetin njerëzor. Një nga këto rregulla, është edhe ndalimi i veshjeve të ngushta dhe transparente që nxjerrin në pah format e trupit. I Dërguari i Allahut (a.s.), tregohej shumë i kujdesshëm në lidhje me mbulesën e grave.

Njëherë, motra e nënës sonë Aishe (r.anha), Esmaja (r.anha), kishte veshur një rrobë të hollë. Kur Profeti (a.s.), e pa, kthehu menjëherë kokën në anën tjetër dhe tha:

“Oj Esmā! Pasi të kenë arritur moshën e pjekurisë, grave nuk u lejohet që t’u duket tjetër përveçse këtu e këtu -duke bërë me shenjë fytyrën dhe duart-” (Ebu Daud, Libas, 31/4103.)

Nga ana tjetër, mbrojtja e dinjitetit femëror të grave dhe atij mashkullor të burrave është i detyrueshëm. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Meshkujt që vishen si femrat dhe femrat që vishen si meshkuj do të jenë larg mëshirës hyjnore.” (shih. Ebu Davud, Libas, 28.)

Islami i ka falur gruas një pozitë shumë të çmuar. Prandaj, edhe gratë, duhet ta kërkojnë lumturinë e vërtetë në atmosferën e qetë të



Kuranit dhe Sunetit. Por për fat të keq, në ditët tona, si rrjedhojë e premtimeve të ndryshme dhe fjalëve të bukura, gratë po shtyhen ta kërkojnë lumturinë në rrugë. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, gruan e ka krijuar më të pasur se burrin, në aspektin e ndjenjave. Kjo pasuri ndjenjash, i siguron gruas një dobi dhe avantazh të madh në mbrojtjen dhe edukimin e brezit, që është edhe detyra themelore dhe e natyrshme e saj brenda familjes. Por në të kundërtën, nëse gruaja shtyhet dhe detyrohet të hidhet në jetën e vështirë dhe të pamëshirshme të punës jashtë shtëpisë, ajo do të humbasë qetësinë dhe dëlirësinë që e ka brenda familjes, duke u përpjekur të garojë në të njëjtat kushte pune me burrat.

Një burrë i mençur dhe i zgjuar, di t'i lërë jashtë pragut të shtëpisë problemet dhe streset e veta gjatë ditës. Po ashtu, edhe gruaja e mençur, di t'i dalë për zot ndjenjave të saj të natyrshme. Megjithatë, jo rrallë herë gjërat funksionojnë siç duhet dhe njerëzit e humbasin durimin dhe arsyen në marrëdhëniet familjare. Prandaj, Allahu i Madhëruar ka bërë një ndarje shumë të bukur të detyrave që plotësojnë burrin dhe gruan me njëri-tjetrin. Vetëm kur burri dhe gruaja arrijnë ta plotësojnë njëri-tjetrin edhe në aspektin shpirtëror, edhe në atë fizik, mund të shfaqet një pjekur në përputhje me qëllimin e krijimit dhe, në bazë të kësaj, familja dhe shoqëria gjejnë paqen dhe harmoninë.

Për fat të keq, gara e barazisë artificiale mes burrit dhe gruas që ka filluar në kohën tonë, ka cenuar rëndë detyrat e gruas si femër dhe si nënë, paqja familjare ka humbur dhe jeta shoqërore është tronditur me katastrofa të rënda familjare. E në fakt, natyra fizike dhe shpirtërore e gruas dhe burrit, nuk janë të njëjta, që të kërkohej edhe barazi praktike dhe juridike. E rëndësishme, nuk është barazi në çdo fushë, por drejtësia dhe ekuilibri mes të drejtave dhe përgjegjësi.

Kur prishet ekuilibri i cilësive të natyrshme që Allahu i ka dhënë burrit dhe gruas, përplasjet dhe tensionet brenda familjes, i shtyjnë njerëzit e pakënaqur ta kërkojnë lumturinë dhe qetësinë në vende të tjera. Dhe si përfundim, familjet, që janë edhe guri më i shenjtë i themelit të shoqërisë, rrënohen me divorce katastrofike. Në këtë mënyrë,



fëmijët, të cilët tashmë nuk e gjejnë më ngrohtësinë brenda familjes dhe bëhen objekt abuzimesh nga prindërit që duhet të jenë shembull për ta, braktisen në mëshirën e rrugëve. Në përgjithësi, ata largohen prej shtëpisë, bashkohen me fëmijët e tjerë të braktisur rrugëve dhe, brenda një kohe të shkurtër, bien në rrjetën organizatave kriminale të cigareve, alkoolit, drogës, prostitucionit, etj., duke i formuar kështu truallin e përshtatshëm për katastrofat shoqërore. Padyshim se kjo gjendje, sjell me vete edhe një erozion moral shumë të frikshëm, që shkreton jetën e gjithë shoqërisë.

Një nga krimet më të frikshme dhe më të shëmtuara të kohës sonë, është edhe abortimi pa arsye të detyrueshme, vetëm për të mos prishur rehatinë vetjake. Duke hyrë në një garë barbarie me njerëzit gjysmë të egër të kohës së injorancës që i varrosnin të gjalla vajzat e tyre, fëmijët e pa lindur ende, bëhen kurbanë të krimit modern, duke u copëtuar që në barkun e nënës. Më e pakta, kjo është një mosmirënjohje ndaj Allahut të Madhëruar. Përveç kësaj, ata që veprojnë kështu, nuk e dinë aspak se me çfarë surprizash do të përballen në jetë. Ata që e kryejnë këtë krim, duhet të mendojnë mirë se mbase nesër, kur të mbeten të vetmuar, ai që do ta kapë përdore, do të jetë pikërisht ai fëmijë. Ose duhet të paktën të mendojnë se, nëse edhe prindërit e tyre do të kishin vepruar në të njëjtën mënyrë, sot, as ata vet nuk do të ekzistonin.

Gjatë historisë, janë dëshmuar shpesh tablotë katastrofike të brezave egoistë, që për shkak të mungesës së fesë dhe besimit, bëjnë një jetë vetëm në planin material, që s'mendojnë gjë tjetër përveç kënaqjes së dëshirave epshore të egos dhe që i kanë dhënë lamtumirën nderit dhe dinjitetit njerëzor.

Sa i hidhur dhe i shëmtuar është privimi nga këto ndjenja i njerëzve, që konsiderohen si krijesat më të nderuara, në krahasim me bimët dhe kafshët që luftojnë me ndjenjën e mbrojtjes së llojit të tyre! Po ashtu, sa i hidhur është edhe fakti që njeriu i jep lamtumirën gradës njerëzore dhe hyn në cilësimin e ajetit kuranor:

أُولَئِكَ كَالْأَنْعَامِ بَلْ هُمْ أَضَلُّ



“...Ata janë si bagëtitë, madje edhe më ulët se ato...” (A'raf, 179.)

Nëse gruaja jeton në rrugën e natyrshmërisë së vet, ajo e kthen shoqërinë në Xhenet. Familjet e qeta, janë burimi i lumturisë së shoqërisë. Nëse shohim në faqet e historisë, do të vërejmë se shoqëritë janë ndërtuar në sajë të grave, por edhe janë shkatërruar për shkak të tyre. Nëse femrës i tregohen rrugicat, si shkaqe të lumturisë, rrugët e jetës do të mbushen me copa xhamash të thyer.

Ndërsa zgjatja e dorës së ndihmës atyre që bien në vështirësi, në lidhje me mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit si pasojë e përhapjes së shumtë të gjynahut dhe degjenerimit dhe pamundësive materiale e shpirtërore, është jo vetëm një detyrë Islame, por edhe njerëzore. Në një hadith fisnik thuhet:

“Nëse një njeri nuk i shkon në ndihmë një myslimani aty ku i shkelet namusi dhe i diskutohet nderi, edhe Allahu nuk do ta ndihmojë atë në një moment kur të ketë nevojë.”

Ndërsa atë që i shkon në ndihmë një myslimani aty ku i shkelet namusi dhe i diskutohet nderi, edhe Allahu do ta ndihmojë në një moment kur të ketë nevojë!” (Ebu Daud, Edeb, 36/4884.)

Lumturia e gruas, është në mbrojtjen e dinjitetit dhe familjes së saj. Sa bukur shprehet Profeti ynë (a.s.), në lidhje me nënën e devotshme, kur thotë se:

“Xheneti është nën këmbët e nënës.” (Sujuti, I, 125.)

Ndërsa në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), shprehet:

“Kjo botë është një pasuri (gjithçka nga e cila përfiton përkohësisht). Dhe, pasuria më e mirë e saj është gruaja e mirë (e ndershme dhe fetare).” (Muslim, Rada, 64.)

Një nënë e virtytshme, është një prehër mëshire, burim lumturie në familje, dritë e kënaqësisë dhe rehatisë dhe qendra e dhembshurisë së pjesëtarëve të familjes. Ajo është një manifestim i veçantë dhe i zgjedhur i emrave të bukur të Zotit tonë, Rrahman dhe Rrahim, në jetën e kësaj bote. Nënata kanë një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e brezave të mbarë. Në një hadith fisnik, thuhet:



“Gruaja myslimane që angazhohet me edukimin e fëmijëve (jetim) në shtëpinë e vet, do të jetë bashkë me mua në Xhenet.”

(Sujuti, I, 104.)

Duke u nisur nga rëndësia e gruas në familje dhe shoqëri, Profeti ynë (a.s.), ka kërkuar që në lidhje me vajzat të tregohet një kujdes i veçantë:

“Kush i rrit dhe i edukon dy vajza deri në moshën e pjekurisë, unë do të jem pranë tij në Ditën e Kiametit.” Dhe e tregon këtë duke bërë dy gishtat bashkë. (Muslim, Birr, 149)

Ndërsa në një hadith tjetër, ka thënë:

“Kushdo që i edukon mirë dy vajzat e veta, pavarësisht vështirësive që has në këtë çështje, ato do të bëhen mburojë për ta nga zjarri i Xhehenemit.” (Muslim, Birr, 147.)

Një ditë, kur Profeti (a.s.), qëndroi në shtëpinë e vajzës së tij Fatimes (r.anha.), dy nipërit e tij, Hasani dhe Husejni kërkuar ujë prej Profetit (a.s.), i cili i dha më parë Hasanit. Për këtë arsye, Fatimja mendoi se Profeti e donte më shumë Hasanin. Mirëpo, Profeti (a.s.), i tha:

“Jo, por Hasani kërkoi ujë i pari.” (shih. Ahmed, I, 101.)

Më pas, tha:

“Silluni në mënyrë të barabartë me fëmijët tuaj në mirësi. Nëse unë do të mbaja dikë më lart se të tjerët, do të kisha mbajtur vajzat.”

(Hejthemi, IV, 153; Ibn-i Haxher, el-Metalibu'l-Alije, IV, 69.)

Shoqëritë e forta, përbëhen nga familje të forta. Ndërsa familjet e forta, në përgjithësi janë vepra të nënave të virtytshme, që kanë marrë edukim shpirtëror, pra, që kanë kapërcyer pengesën e egos. Shembujt më të mirë të këtyre, janë gratë sahabe. Ato i mësuan fëmijët e vet të sakrifikonin me jetët dhe pasurinë e tyre dhe i mbujtën zemrat e tyre me dashurinë ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Këto gra sahabe, që u edukuan nga Profeti ynë (a.s.), i kritikonin fëmijët e tyre kur ata nuk takoheshin me të Dërguarin e Allahut për një kohë të gjatë. Kështu, njëherë, nëna e Hudhejfes, e kishte kritikuar atë,



nga që nuk e kishte takuar Profetin (a.s.), për disa ditë. Ja si e tregon vetë ai këtë ngjarje:

- Kur je takuar për herë të fundit me Profetin (a.s.)? – më pyeti nëna.

- Kam ca ditë që nuk e kam takuar – iu përgjigja.

U nevrikos shumë dhe më bërtiti.

- Mos u nxeh nënë! Po shkoj menjëherë te Profeti (a.s.), do të fal namazin e akshamit me të dhe do t'i kërkojë falje për ne të dy – i thashë. (Tirmidhi, Menakib, 30\3781, Ahmed, V, 391-392.)

Ja pra, ato nëna që i kanë edukuar kështu fëmijët e tyre, janë takuar me Zotin e tyre me zemër të qetë, pasi kanë ndërtuar një brez shembullor, i cili ka përhapur në të gjithë botën drejtësinë, mirësinë dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Prandaj, edhe sot, njohja e fëmijëve me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.), me të njëjtin entuziazëm dhe pasion që kishin sahabët, duke ua bërë të dashur rrugën e tyre, është detyra e çdo prindi besimtar.

Të parashikosh të ardhmen e një populli, nuk është marifet. Për këtë mjafton të shikosh rininë e tyre. Rinia e çdo epoke jeton sipas karakterit të vet, në një atmosferë entuziazmi të veçantë ku mund të shpenzojë energjinë e vet. Çdo komb merr formë sipas botës shpirtërore dhe intelektuale të rinisë. Nëse rinia e një kombi e harxhon energjinë për mirë, e ardhmja e atij kombi është e ndritur. Mirëpo, në të kundërtën, nëse energjinë e harxhojnë në gjëra boshe, atëherë e ardhmja e atij kombi është e zymtë.

Sot, për të edukuar një brez të virtytshëm, institucioneve të edukimit shpirtëror, e në mënyrë të veçantë, kurseve të Kuranit, u takon një detyrë shumë e madhe, sepse nuk ka gabim më të madh që ia nxin jetën shpirtërore njeriut, sesa neglizhenca që tregohet në lidhje me fjalën e Allahut. Për këtë arsye, në kohën tonë, kur shumica e njerëzve janë dhënë pas mirësive materiale, është bërë e detyrueshme që edukimit në lidhje me Kuranin, t'i jepet një rëndësi edhe më e madhe.

Nuk duhet harruar, se Kurani Fisnik nuk është vepra e një për-



kohshmi, por udhëzuesi më i rëndësishëm i rrugës së drejtë, të cilin Allahu i Madhëruar ua dhuroi robërve të Vet që të gjejnë lumturinë e të dyja botëve. Nga ky aspekt, në institucionet ku zhvillohet edukimi shpirtëror, duhet bërë kujdes i veçantë në këto çështje:

1. Nxënësit, parasëgjithash duhet të konsiderohen si amanet i Allahut. Atyre duhet t'u mësohen mirësitë e Allahut të Madhëruar, morali dhe jeta e të Dërguarit të Tij (a.s.). Edukimi shpirtëror, krahas dijes, duhet të përforcohet edhe me dashurinë, me qëllim që nxënësit të ndjejnë ëmbëlsinë e besimit. Kjo, sepse ëmbëlsia e besimit është një burim i madh energjie për të shërbyer në rrugë të Allahut.

2. Këto institucione edukimi, duhet të jenë çerdhe të dhembshurisë, sakrificës dhe shërbimit. Brenda atyre mureve, krahas dijeve, duhet të jepet një edukim Kurani i mbushur me pasion dhe entuziazëm. Po ashtu, nuk duhet harruar se zbatimi i Kuranit, është i mundur në sajë të vënies në jetë të sunnetit profetik.

3. Nxënësi duhet të trajtohet me mirësjellje, edukatë dhe fytyrë të qeshur. Edhe nëse bën ndonjë gabim, ai duhet korrigjuar me butësi dhe mëshirë.

4. Njeriu ndjen admirim dhe dashuri ndaj personaliteteve dhe karaktereve të lartë. Dhe, atë të cilin e admiron, përpiqet ta imitojë. Kjo, sepse njeriu ndikohet nga njerëzit që i do. Ndërsa dashuria, është si një rrymë elektrike mes dy zemrave. Nga ky aspekt, ata që shërbejnë në fushën e Kuranit, duhet të jenë besimtarë të ditur, të singertë dhe pozitivë.

5. Krahas pastrimit të zemrës, duhet bërë kujdes edhe ndaj pastërtisë së jashtme, duke u bërë shembull i mirë edhe në aspektin e veshjes dhe pamjes. E në fakt, edhe Profeti ynë (a.s.), i jepte shumë rëndësi pastërtisë së trupit dhe të rrobave, dhe nuk e pëlqente aspak shkujdesjen në këtë çështje. Njëherë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ndodhej në xhami, vjen një person me mjekër dhe flokë të shprishura. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), i bëri shenjë me dorë të rregullohej. Më pas, kur personi u kthye i rregulluar i tha:



“A nuk është më mirë kështu, sesa vërtitja poshtë e lart e cilitdo prej jush me flokë e mjekër të hallakatur si shejtan?!” (Muvatta, Shaar, 7; Bejhaki, Shuab, V, 225; Alijijul Kari, Mirkat, VIII, 261.)

Ndërsa njëherë tjetër, një personi tjetër që erdhi pranë tij i çrregullt, i tha:

“A ke pasuri? Si e ke gjendjen?” Kur njeriu i thotë se kishte gjendje të mirë, Resulullahu (a.s.), e urdhëroi:

“Atëherë, meqenëse Allahu të ka dhënë pasuri, le të shihet kjo në trupin tënd!” (Ebu Davud, Libas, 14 / 4063; Nesai, Zinet, 54; Ahmed, IV, 137.)

6. Që të arrihet thellësia e ndjenjave me anë të Kuranit dhe që kuptimet e larta të tij të pasqyrohen në sjellje në formën e veprave të bukura, zemrat duhet të mbushen me energji pozitive, pra, me dashuri dhe frymëzim shpirtëror. Po ashtu, me qëllim që të arrihet përfitimi i duhur prej Kuranit, është e domosdoshme që ai të hapet me respekt, nderim dhe edukatë të lartë dhe t'i lexohet njerëzve me vetëdijen që na ka mësuar Rrahmani, sepse në Kuran urdhërohet:

“I Gjithëmëshirshmi, ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.” (Rrahman, 1-4.)

7. Kurset e Kuranit, krahas dijeve, duhet të synojnë një edukim që thellon ndjenjat e meditimit, specializimit dhe studimit të Kuranit. Në mënyrë të veçantë, duhet të trajtohen temat në lidhje me mesazhet që përfitohen nga historitë e profetëve në Kuran, problematikat që do të shfaqen në shoqëri deri në ditën e kiametit, informacionet në lidhje me shenjat e kiametit dhe gjykimet që bëjnë dallimin mes besimit dhe mohimit, bindjes dhe mosbindjes, haramit dhe hallallit, të vërtetës dhe të pavërtetës, etj.

8. Ata që janë të ngarkuar me detyra në institucionet e edukimit, duhet të kenë vetëdije të lartë sakrifice dhe shërbimi. Për rrjedhojë, ata duhet të jenë njerëz të pajisur me moral të bukur, mëshirë, butësi, altruizëm dhe shumë virtytet të tjera morale. Krahas këtyre, kudo që të jetojnë, ata duhet të dinë si të ruajnë ekzistencën dhe besimin e tyre. Ata, duhet të zotërojnë një karakter dhe personalitet të atillë që,



edhe nëse ndodhen në një ambient problematik, duhet të ndikojnë në mënyrë pozitive, e të mos ndikohen nga vet negativisht. Po ashtu, ata duhet ta ruajnë zemrën nga shqetësimet për interesa të kësaj bote, si pasuri dhe pozitë.

9. Mësuesit në këto institucione, duhet të ruhen nga sjellje që do ta ftohën nxënësin nga edukimi, si ashpërsia, trajtimi i padrejtë, mbajtja me hatër, dhuna, etj. Ata që merren me edukimin në fushën e Kuranit, nuk duhet të harrojnë kurrë se një ditë do të japin llogari para Allahut të Madhëruar. Prandaj ata nuk duhet të sillen me nxënësit sikur janë në sistem ushtarak dhe duke i bërë gjërat me detyrim, pa singëritet dhe pa entuziazëm. Nuk duhet harruar se për çdo njeri të fituar ka shpërblime, por edhe për çdo njeri të humbur, ka përgjegjësi të madhe në ditën e kiametit.

10. Në edukim, çdo gjë duhet të bëhet në mënyrë të matur dhe të ekuilibruar. Asgjë nuk duhet të jepet përnjëherësh, por dalëngadalë, duke ndihmuar që të përvetësohet dhe mësohet me anë të të kuptuarit, e jo thjesht memorizimit. Po ashtu, duhet marrë parasysh niveli i kuptimit të nxënësve dhe nuk duhet të sforcohet të mësojë gjëra të rënda, pa kuptuar më parë ato themeloret.

11. Temat duhet të tregohen me shembuj të shumtë dhe me pyetje-përgjigje, duke u mbështetur me referenca dhe fakte, me qëllim që të bëhen më të lehta për t'u mbajtur mend dhe më ndikuese. Mjeshtëria dhe arti më i madh i një edukuesi, është gjetja e një damari në shpirtin e nxënësit dhe depërtimi në zemrën tij.

12. Edukuesit duhet të jenë të aftë ta kuptojnë gjendjen e nxënësve e tyre nga pamja e jashtme. Ata duhet t'i çmojnë nxënësit e tyre dhe duke u interesuar personalisht për ta, duhet të përpiqen tua zgjidhin problemet.

13. Shërbimi ndaj robërve të Allahut duke i falënderuar, duhet të bëhet parim i punës, sepse në sajë të tyre, ai ka mundësinë ta bëjë këtë shërbim. Për këtë arsye, buzëqeshja dhe falënderimi ndaj njerëzve gjatë shërbimit shpirtëror, duhet të bëhet natyrë e çdo edukuesi.



14. Ata që do të përçojnë dashurinë për besimin në zemra, më parë duhet të përmirësojnë zemrat e veta. Përndryshe, edhe ndikimi i fjalëve të tyre pakësohet. Puna më e vështirë, është edukimi i njeriut. Ai që nuk mund të edukojë veten e tij, si mund të edukojë dikë tjetër, të cilit nuk ia njeh botën e brendshme?

Në veprën Mesnevi të Rumiut, zë vend një tregim i tillë mësim-dhënës:

Një ditë, një person iu bë shok rruge Isait (a.s.). Duke shkuar së bashku, personi pa në një skaj të rrugës ca eshtra dhe iu lut Isait (a.s.):

“M’i mëso edhe mua “fjalët e mëdha” që t’i ringjall këto eshtra e t’i ngre në këmbë!”

Isai iu përgjigj:

“Kjo punë nuk është për ty! Për ta kënduar ato “fjalë” dhe për ta ringjallur të vdekurin, duhet të kesh shpirt më të pastër se shiu dhe të jesh më shkathët se melekët në adhurim! Ato fjalë të mëdha, kërkojnë gjuhë të kulluar dhe një zemër të pastër. Pra, njeriu duhet të mos jetë i përlyer me haram dhe ashtu si melekët, ai duhet të mos e njohë as kundërshtimin, sepse vetëm njeriut me shpirt të pastër, i pranohet lutja... Për shembull, ta zëmë se more në dorë shkopin e Musait. Mirë, po a ke fuqi ti ta kthesh atë gjarpër dhe ta urdhërosh? Edhe vetë Musai u frikësua kur shkopi i tij u kthye në gjarpër... Pra, ç’dobi do të kesh po ta këndosh dhe ta mësosh përmendësh atë “fjalë të madhe”, kur ti nuk e ke shpirtin e pastër të Isait?”

Por njeriu i paditur prapë nuk heshti e i tha:

“O Isa! Po s’e pata unë këtë fuqi, të paktën këndoji ti ato eshtra!”

Isait (a.s.) i erdhi shumë turp nga fjalët e atij njeriu të trashë dhe tha:

“O Zot! Ç’është urtësia e këtij misteri? Pse ky mendjelehtë është i prirë të kundërshtojë kaq shumë? **Zemrën e vet e ka të vdekur, por përpiket ta ringjallë kufomën e tjetrit!** E në fakt, atij i duhet të ringjallë zemrën e vet të vdekur! Në vend që të lutet për ta ringjallur zemrën e vet, përpiket t’i ringjallë të tjerët! Ç’është kjo padituri!? Ç’është kjo mendjelehtësi!?”



Si shihet edhe në këtë shembull, një edukues që s'mund t'i bëjë zemrat e vogla dhe të pafajshme të ndjejnë dashurinë dhe pasionin për besimin, për shkak se nuk e ndjen as në zemrën e vet dhe një hoxhë që nuk mund t'i bëjë të tjerët të shijojnë prej burimi të pashtershëm shpirtëror të Kuranit, për shkak se nuk e ka shijuar as vet, kanë me të vërtetë përgjegjësi dhe gjynahe të mëdha mbi supe. Kjo, sepse nxënësit, edukimin e të cilëve e ka marrë përsipër në institucionin ku ndodhet, janë amanet i Allahut për të. E, nëse ai nuk mundet t'u japë edukimin e duhur shpirtëror nxënësve, padyshim se ai u hyn në hak atyre.

Ja pra, brezat shembullorë që do të mbushin faqet e nderit të së ardhmes, do të jenë produkti i një edukimi shpirtëror të pajisur me të gjitha cilësitë pozitive. Brezat që ia kanë arritur kësaj, janë ngritur dhe kanë qëndruar në këmbë në sajë të ndihmës së Allahut. Kështu, një nga perandoritë më jetëgjata në historinë e botës, ajo Osmane, është e njohur për respektin, madhërimin, dashurinë dhe shërbimin ndaj Kuranit Fisnik.

Fëmijët janë amanete hyjnore të cilat u janë falur prindërve të tyre. Fëmijët lindin në natyrshmërinë e pastër islame, prandaj edhe zemra e tyre është si një tokë e pastër, si një xhevahir bruto, që ka nevojë të përpunohet. Nëse ata do të jenë trëndafila apo gjemba, do të japin fruta të hidhura apo të ëmbla, varet nga gjendja e farës shpirtërore që do të hidhet në zemrat e tyre.

Mbrojtja e fëmijëve nga zjarri i Xhehenemit nga prindërit e tyre, është më e rëndësishme se mbrojtja nga zjarri i kësaj bote. Dhe, mbrojtja nga zjarri i Xhehenemit, arrihet duke u mësuar atyre besimin, farzet, haramet, adhurime dhe duke i ruajtur nga njerëzit e pafe dhe të paedukatë. Prindërit që nuk ua mësojnë dhe nuk ua bëjnë të dashur fëmijës së tyre Allahun dhe Profetin (a.s.), konsiderohen si shkatërrues të kësaj bote dhe botës tjetër për fëmijën e tyre.

Nga ana tjetër, edukimi i fëmijës, duhet të fillojë që prej moshës tre vjeçare. Mendimet apo fjalët e kota, si; “është ende i vogël, nuk kupton, etj.” duhen hedhur mënjanë. Përkundrazi, saherë t'u jepet mundësia, prindërit duhet të flasin pranë fëmijëve në lidhje me madhështinë e



Allahut, krijimin dhe mirësitë që ka falur Ai dhe domosdoshmërinë për ta falënderuar Atë. Po ashtu, ata duhet të flasin për faktin se në çdo moment jemi të vëzhguar nga kamerat hyjnore, duhet të flasin për botën tjetër, përgjegjësitë dhe llogarinë. Prandaj, prindërit duhet të llogarisin mirë se, nëse fëmijët nuk e marrin siç duhet edukimin fetar Islam në këto moshë, më vonë do të jetë më e vështirë të edukohen.

Mos ngritja e fëmijës për namaz me arsyen që të mos ftohet apo të mos e prishë gjumin, është një nga shkatërrimet më të mëdha që bëhet të ardhmes së fëmijës. Ky veprim, nuk është mirësi, por një e keqe e madhe ndaj fëmijës. Për t'i edukuar siç duhet fëmijët e tyre, prindërit duhet t'i mësojnë ata që në moshë të vogël me adhurim dhe bamirësi dhe duhet t'i mbrojnë nga ndikimet negative të shoqërisë ku jetojnë.

Një fëmijë i mbarë, nuk është vetëm një nga pasuritë më të çmuara të kësaj bote, por edhe një vlerë e madhe e pandërprerë që do të vazhdojë edhe në jetë tjetër. Për këtë arsye, çarja dëm e një mirësie hyjnore si fëmija, për interesa të kësaj bote, do të ketë përgjegjësi të madhe në të dyja botët.

Neglizhimi i botës shpirtërore të fëmijëve, duke i dhënë rëndësi vetëm nivelit të tyre në botën materiale, duke lejuar të bëhen kapitali i rrugëve, shoqërisë së keqe, krimit dhe degenerimit moral, është mosmirënjohja më e madhe që bëhet ndaj kësaj mirësie hyjnore.

Prandaj, për ne është e domosdoshme që, për të arritur lumturinë e përjetshme, duhet që mundësitë që na janë dhënë në këtë botë, e sidomos fëmijët, t'i orientojmë drejt kënaqësisë hyjnore. Që varri ynë, banesa e fundit për ne në këtë botë, të mos mbetet i shkretë, i pavizituar dhe i errët, duhet t'i vlerësojmë mirë këto ditë të jetës, duke u përpjekur të lëmë pas një brez të mbarë. Pra, t'i bëjmë fëmijë tanë një kapital të madh të zemrave tona, që ata të jenë sadakaja jonë e pandërprerë në udhëtimin tonë të gjatë dhe të vështirë në botën tjetër...

I lutemi Allahut të Madhëruar që mirësitë si martesë, familja dhe fëmijët tanë, të jenë shkak i lumturisë sonë në të dyja botët!..

Amin!..

Përgjegjësia ndaj fëmijëve



Trashëgimtarët më të afërt të një besimtari, janë fëmijët e tij. Ndërsa trashëgimia e vërtetë që duhet t'u lihet atyre, është pasuria e përjetësisë. Fëmijëve tanë nuk duhet t'u lëmë trashëgim pasuri dhe kënaqësitë e përkohshme, por një lumturi që nuk vyshket dhe nuk shterohet. Dhe ajo është Kurani Fisnik dhe Sunneti profetik që na ka lënë amanet i Dërguari i Allahut (a.s.). Kujdesi që duhet treguar në përcjelljen e këtij amanet tek fëmijët tanë, konsiderohet një sadaka e pandërprerë. Ndërsa neglizhimi i kësaj detyre, do të jetë një fatkeqësi për çdo prind në botën tjetër.

PËRGJEGJËSIA NDAJ FËMIJËVE

Kjo botë, është një fushë e gjerë sprove e shtruar para nesh me mirësitë, dashuritë, punët dhe ëndrrat e saj. Dhe, mirësitë që i përkasin kësaj bote, si pasuria, prona dhe fëmijët, janë brenda fushës së sprovës, të cilat janë lënë nën administrimin tonë për t'u kthyer në kapital të botës tjetër. Për rrjedhojë, është e domosdoshme që mundësitë e kësaj bote, t'i përdorim për arritjen e lumturisë në botën tjetër. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

الْمَالُ وَالْبَنُونَ زِينَةُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَالْبَاقِيَاتُ الصَّالِحَاتُ خَيْرٌ
عِنْدَ رَبِّكَ ثَوَابًا وَخَيْرٌ أَمَلًا

“Pasuria dhe djemtë janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira te Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe, janë më të mira sa i përket shpresës (për shpëtim).” (Kehf, 46.)

Nëse pasuria, prona dhe fëmijët, përdoren në rrugën e Allahut, ato marrin cilësinë e “stolisë”. Por, nëse përdoren pa kriter vetë për hir të dëshirave vetjake, ato kthehen në “sprovë” të rëndë.

Trashëgimtarët më të afërt të një besimtari, janë fëmijët e tij. Ndërsa trashëgimia e vërtetë që duhet t'u lihet atyre, është pasuria e përjetësisë. Fëmijëve tanë nuk duhet t'u lëmë trashëgim pasuri dhe



kënaqësitë e përkohshme, por një lumturi që nuk vyshket dhe nuk shterohet. Dhe ajo është Kurani Fisnik dhe Sunneti profetik që na ka lënë amanet i Dërguari i Allahut (a.s.). Kujdesi që duhet treguar në përcjelljen e këtij amanet tek fëmijët tanë, konsiderohet një sadaka e pandërprerë. Ndërsa neglizhimi i kësaj detyre, do të jetë një fatkeqësi për çdo prind në botën tjetër.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا
وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ

“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Tahrim, 6.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Të gjithë jeni çobanë dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj (ata që keni nën vete)... Burri është çobani i familjes së tij dhe është përgjegjës për tufën e tij. Gruaja, është çobane në shtëpinë e burrit të saj dhe po ashtu është përgjegjëse për tufën e saj...” (Buhari, Ahkam 1; Muslim, Imaret 20.)

Nga ky hadith, kuptohet qartë se prindërit janë përgjegjës për fëmijët në mënyrë të përbashkët. Po ashtu, në një hadith tjetër, thuhet:

“Qerasini dhe edukojini mirë fëmijët tuaj!” (Ibn Maxhe, Edeb, 3.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Asnjë baba nuk mund t’i lërë fëmijë trashëgimi më të mirë se morali i bukur.” (Tirmidhi, Birr, 33/1952.)

“Nga të drejtat e fëmijës mbi të atin, është që babai i tij, t’i vërë emër të bukur dhe ta edukojë mirë.” (shih. Bejhaki, Shuab, VI, 401 – 402.)



Prindërit që e kanë kuptuar mirë përgjegjësinë ndaj fëmijëve, duhet të përpiqen të jenë shembulli më i mirë për ta në adhurime, në vepra dhe në moral të lartë. Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë të vërtetë:



Abdullah ibn Abbasi (r.a.), tregon:

Një natë (gjatë fëmijërisë), qëndrova në shtëpinë e bashkëshortes së Profetit (a.s.), Mejmunes (r.anha), e cila është njëkohësisht edhe tezja ime. Atë natë namazin e jacisë e falëm së bashku me xhemat. Pasi fjeti për njëfarë kohe, Profeti (a.s.), u zgjua përsëri për të falur namaz nate. Po ashtu, u zgjua edhe tezja ime. Ata kujtonin se unë isha duke fjetur, por unë i dëgjoja kur bisedonin. Duke parë nga unë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

- Paska fjetur vocërraku!

Kurse unë, duke buzëqeshur thashë:

- Po çohem edhe unë për t'u falur.

U çova, mora abdest dhe u përgatita për namaz. Profeti (a.s.), më vendosi në krahun e djathtë të tij kurse tezja ime qëndroi mbrapa. Në këtë mënyrë falëm namaz me xhemat. Nuk e harroj kurrë atë namaz dhe atë kënaqësi shpirtërore që kam përjetuar atë natë. (shih. Buhari, Ilm, 41.)

Po ashtu, kur ishte ende i vogël, Ibn Abbasi (r.a.), merrte pjesë në namazet e xhenazes dhe të bajramit së bashku me Profetin (a.s.) dhe merrte frymëzim prej adhurimeve të Profetit (a.s.). (shih. Buhari, Xhenaiz, 60; Idejn, 16.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), qëndronte shpesh me fëmijët, hante së bashku me ta dhe i korrigjonte gabimet e tyre me një metodë që ua vinte në lëvizje botën mendore dhe shpirtërore. Lidhur me këtë, Ebu Hafsi (r.a.), tregon:

Unë kam qenë një fëmijë i edukuar nën kujdesin e Profetit (a.s.). Kur haja, lugën e shtija në të gjithë pjesët e pjatës. Për këtë arsye, i dërguari i Allahut (a.s.), më pati thënë:

“Biri im! Thuaj Bismilah, ha me dorën e djathtë dhe në pjesën e pjatës që ke para vetes!”

Që prej asaj dite unë kam ngrënë ashtu siç më ka mësuar Profeti (a.s.). (Buhari, Et'ime 2, 3; Muslim, Eshribe 108, Ibn Maxhe, Et'ime 8.)

Në një transmetim tjetër, i drejtohet përsëri këtij vogëlushi me

butësi dhe dashuri, duke i thënë, *“Afroju sofrës biri im!”* (shih. Ibn-i Haxher, el-Isabe, II, 519.)

Shkurtimisht, nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të jenë të përsosur, duhet të përpiqemi të bëhemi prindër të përsosur. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Jini të ndershëm me gratë e huaja, që edhe gratë tuaja të jenë të ndershme. Silluni mirë ndaj prindërve tuaj, që edhe fëmijët tuaj të sillen mirë me ju. Dikujt që i vjen vëllai duke i kërkuar ndjesë, le ta pranojë qoftë në të drejtë qoftë në të padrejtë. Përndryshe, nuk mund të vijë te unë, te burimi i Keutherit në Xhennet.” (Hakim, IV, 170/7258.)

Nga ana tjetër, fëmijëve tanë duhet tu flasim bukur dhe nuk duhet t'i mallkojmë në zemërim e sipër. Lidhur me këtë, tregohet:

Një person, shkoi tek Abdullah bin Mubareku dhe iu ankua për pabindshmërinë e fëmijës së vet. Abdullah bin Mubareku e pyeti:

“A e ke mallkuar atë fëmijë?”

“Po!” -tha ai si në faj.

“Atëherë, ti je bërë shkak i prishjes së fëmijës tënd!” -u përgjigj Abdullah bin Mubareku.

Një çështje tjetër e rëndësishme, në të cilën duhet të bëjnë kujdes prindërit, është që të mos i gënjejnë ata dhe të bëhen gjithmonë she-mbull i fjalë së drejtë. Abdullah bin Amr (r.a.), tregon:

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte në shtëpinë tonë, nëna më thirri dhe më tha:

“Eja të të jap diçka!” I Dërguari i Allahut e pyeti:

“Çfarë ke menduar t'i japësh?” Nëna ime u përgjigj:

“Doja t'i jepja një hurmë.” I Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“Dije se po të mos i kishe dhënë gjë, do të të shkruhej një gjynah për gënjeshtëri.” (Ebu Davud, Edeb, 80/4991; Ahmed, III, 447.)

Ndërsa në një hadith tjetër, thuhet:



“Ndihmojini fëmijët tuaj që të bëjnë mirësi! Ai që dëshiron, mund t’ia largojë fëmijës së vet ndjenjën e kryeneçësisë.” (Hejthemi, VIII, 146.)

Krahas përpjekjeve konkret për edukimin e fëmijëve, prindërit duhet të luten vazhdimisht për fëmijët e tyre, sepse bashkimi i këtyre dy pikave është i domosdoshëm. Ibn Abbasi (r.a.), ka thënë:

“I dërguari i Allahut (a.s.), më shtrëngoi në gji dhe u lut; «O Allah, mësoja urtësinë këtij fëmije!»” (Buhari, Ashabu’n-Nebi, 24.)

Në sajë të begatisë së kësaj lutjeje, Ibn Abbasi (r.a.), arriti aq shumë dije, sa mori edhe titujt, “Dijetari i Popullit” dhe “Përkthyesi i Kuranit”.

Lidhur me edukimin e fëmijëve tanë, është mirë t’u vëmë veshin këtyre këshillave të të parëve tanë të devotshëm:

Ebu Zekerijja el-Anberi ka thënë:

“Dija pa edukatë, është si zjarri pa dru, ndërsa edukata pa dije, si shpirt pa trup.”

Po ashtu, këto këshilla që Aliu (r.a.), ia ka dhënë djalit të tij, në të njëjtën kohë janë mësim edhe për ne:

“Biri im! Parasëgjithash frikësoju Allahut siç duhet! Zbatoji të gjitha urdhrat e Tij! Ngjalle zemrën me përmendjen e Tij! Kapu fort pas litarit të Allahut, sepse përveç këtij litari, nuk do të gjesësh lidhje tjetër më të fortë mes teje dhe Allahut.

Ringjalle zemrën duke e kujtuar seriozisht vdekjen dhe çastin e fundit! Dije se çdo gjë do të asgjësohet dhe zemrës i thuaj se nuk do të ekzistojë më!

Dëgjoji mirë këshillat e mia dhe kuptoi! Dije se Allahu i Madhëruar, i Cili ka në dorë vdekjen e çdo gjallesë, ka në dorë edhe jetën e tyre. Ai që u jep jetë gjallesave, Ai edhe ua merr në fund. Ai është që i bën të pasurit të varfër, e të varfrit të pasur. Ai është jep çdolloj sëmundjeje dhe fatkeqësie. E po Ai jep edhe zgjidhjen dhe shërimin e tyre. E gjithë bota, me gurët, tokën, ngjyrat, format, pemët dhe frutat e saj, janë të

Atij dhe sipas dëshirës dhe urdhrit të Tij lëvizin. Po ashtu, edhe bota tjetër, me llogarinë, dënimin, Xhenetin, Xhehenemin dhe çdo gjë tjetër që ne nuk e dimë, është e Tij.

Sado që të përparosh në dije, përsëri do të ketë diçka që nuk e di, sepse përtej fushës së mendimit dhe fuqisë së shikimit, ekzistojnë edhe shumë të vërteta të tjera. Nëse arrin të zotërosh ndonjërin prej këtyre dhe nëse Allahu të mëson disa urtësi dhe të fshehta, bëj kujdes e mos guxo të mendosh se i ke fituar me fuqinë tënde! Përkundrazi, kërko mbrojtjen e Allahut prej kësaj! Për Të qofshin adhurimet e tua dhe ndaj Tij qoftë dashuria dhe frika jote!

Me pak fjalë, mirësia e kësaj bote është e pakët, jeta e saj e shkurtër, buzëqeshja e saj hipokrizi, kthimi i shpinës fatkeqësi, kënaqësia dhe ëmbëlsia e saj e kalimtare, vlera e saj e përkohshme dhe gjynahu i saj i përjetshëm... Mos harro se, kreu të çdo të keqeje, është dashuria për pasurinë, ambicia dhe lakmia. Këto cilësi të këqija, nuk duhet të gjejnë rrugën për në zemrën tënde! Bëhu i devotshëm, që të jesh i përmbajtur! Pra, përdori sa më pak mirësitë e kësaj bote dhe mos u jep pas tyre, por shpenzoi në rrugën e Allahut!”

Ndërsa Shejh Edebali e këshillon kështu Osman Gazin, të cilin e kishte si djalin e vet:

“Bëhu fjalë hapur! Mos e merr çdo fjalë mbi vete! Po i pe gjërat që është më e dobishme, madje të nevojshme të fshihen, mos i thuaj; po i dite, mos i trego! Mos shko në atë vend ku të duan, aq shpesh sa të bëhesh i mërztishëm, se të tronditen dashuria dhe konsiderata!..

Të të vijë më keq për këta tre persona: Për dijetarin mes injorantëve, për atë që ka qenë i pasur dhe është varfëruar dhe për atë që e ka humbur konsideratën ndërsa ka qenë i respektuar! Mos harro se ata që zënë vend lart, nuk janë aq në siguri sa ata të poshtmit!..

Fitorja më e madhe është ta njohësh vetveten. Njeriu është armik i vetvetes! Por kur e njeh vetveten, bëhet mik i vetvetes!”

Po ashtu, edhe vet Osman Gazi, e këshillon kështu djalin e tij, Orhan Gazin:



“O bir, punët e fesë vëri para të gjitha të tjerave, sepse sigurimi i zbatimit të një farzi (detyrimi fetar) bëhet shkak për fuqizimin e fesë dhe shtetit! Prandaj mos e lër mangët respektin ndaj dijetarëve të fesë dhe plotësimin e të drejtave të tyre që punët e sheriatit të ecin në rregull!..

O bir, kush nga familja ime largohet nga rruga e drejtë dhe drejtësia, mbettë ditën e ringjalljes pa ndihmën dhe ndërmjetësimin e Profetit tonë (a.s.)!

Kurrë mos u krekos me ushtrinë dhe pasurinë tënde! Merr mësim nga gjendja ime e tanishme që jam si një milingonë e pafuqishme! Unë që mu dhanë shumë favore të Allahut pa qenë i denjë për to!

Edhe ti ec në rrugën time! Kujdesu për të drejtën e Zotit dhe të robërve të Tij! Mjaftohu me të ardhurat e tua nga thesari i shtetit! Mos bëj shpenzime të tjera veç nevojave të domosdoshme të shtetit! Kështu, pasardhësit e tu do të të marrin shembull! Mos i hap shteg padrejtësisë dhe dhunës, ji gjithmonë i drejtë dhe i matur! Në të gjitha punët e tua mbështetu te Allahu, prej Tij kërkoje ndihmën dhe Atij përgjërohu!”

Në të njëjtën mënyrë, edhe Orhan Gazi, e ka këshilluar kështu djalin e vet, Murad Hanin:

“Biri im! Mos u krekos me madhësinë e sundimit tënd! Mos harro se, kjo botë nuk i mbeti as Sulejmanit (a.s.). Edhe sundimi i tij përfundoi, sepse çdo sundim i kësaj bote është i përkohshëm. Mirëpo, kjo jetë, është një mundësi e madhe për të gjithë. Prandaj, vlerësoje mirë këtë mundësi që të shërbesh në rrugën e Allahut dhe të përfitosh ndërmjetësimin e Profetit tonë (a.s.), në botën tjetër!

Nëse e sheh këtë botë nga dritarja e botës tjetër, do të kuptosh se kjo botë nuk vlen aq sa të sakrifikosh lumturinë e përjetshme të jetës tjetër!..”

Ndërsa Imam Gazaliu -rahmetullahi alejh-, e ka këshilluar kështu djalin e vet:

“Biri im! Ashtu siç nuk mund të ketë vepër pa dije, edhe dija pa vepër është një çmenduri. Dije se, dituria që sot nuk të largon prej gjy-



naheve dhe nuk të afron me adhurimet, as nesër nuk do të të largojë prej zjarrit të Xhehenemit (dhe nuk do të të afrojë me Xhenetin)."

Omer Bin Abdulazizi, konsiderohet si kalifi i pestë i drejtë në historinë Islame. Ai arriti majat në dije, kulturë dhe devotshmëri dhe, vetëm në dy vite e gjysmë të detyrës së tij si kalif, kreu shumë vepra të mëdha. Por, që prej ditës kur u bë kalif, qëndrimi i tij ndaj fëmijëve të vet ndryshoi. Ditën kur hipi në fron, gjatë ceremonisë së besatimit të popullit tek sundimtari, për shkak të turmës së madhe, djalit të tij, Abdulmelikut, iu gris rroba. Kur e pa këtë, Omeri i tha të birit:

"Biri im, shko qepe rrobën! Mbase prej kësaj dite, nuk do të kesh mundësi të gjesh rrobë tjetër dhe do të kesh nevojë për këtë."

Omer bin Abdulazizi, shkonte çdo natë tek vajzat dhe, pasi i pyeste si ishin, shkonte të flinte. Një natë, shkoi përsërit tek ato siç e kishte zakon. Kur vajzat e dëgjuan se u erdhi babai, mbyllën gojët e tyre me duar dhe hapën derën. Kur Omeri e pyeti kujdestaren e tyre se pse vepruan ashtu, ajo iu përgjigj:

"Përveç thjerrëzave dhe qepës, nuk kanë ushqim tjetër. Prandaj ato i mbyllën gojët, që të ju të mos e ndjenit erën e qepës!" Për shkak të këtij veprimi plot edukatë dhe delikatesë, Omer bin Abdulazizi i rrodhën lot dhe u tha vajzave:

"Bijat e mia! Nëse do të kishit kërkuar ushqime të ndryshme dhe mirësi të kësaj bote, kjo do të ishte një përgjegjësi e rëndë për babanë tuaj në botën tjetër."

Njëherë tjetër, Omer bin Abdulazizi, kur ishte në shtratin e vdekjes, të afërmit e pyetën:

"Lër ndonjë testament, që pas vdekjes tënde, familjes t'i jepet diçka prej thesarit të shtetit!" Mirëpo, ai tha:

"Fëmijët e mi, do të bëhen ose të mirë, ose të këqij. Nëse bëhen të mirë, nuk do të kenë nevojë për diçka të tillë. E nëse bëhen të këqij, atëherë nuk duhet t'u lë gjë atyre. Prandaj, në të dyja rastet, nuk e shoh të nevojshme këtë."



Muadh bin Xhebeli (r.a.), e ka këshilluar kështu djalin e tij:

“Biri im! Kur të falësh namaz, mendo sikur të jetë namazi i fundit që fal dhe mos shpresë se do të arrish përsëri një kohë të tillë namazi!..

Biri im! Një njeri besimtar, duhet të vdesë ndërmjet dy punëve të mira. Domethënë, kur besimtari bën një punë të mirë, duhet të synojë të bëjë një punë tjetër të mirë dhe nuk duhet të fusë ndërmjet tyre asnjë punë të keqe!”

Të gjitha këto këshilla dhe porosi, janë parime të rëndësishme për orientimin, edhe të vetes, edhe të fëmijëve tanë drejt kënaqësisë hyjnore. Në bazë të këtyre parimeve, para se t'i japim lamtumirën kësaj bote të përkohshme në të cilën jetojmë, duhet t'i braktisim dëshirat dhe lazdrimet e egos tonë dhe të përpiqemi të përgatitemi për llogarinë në botën tjetër. Dhe për këtë, duhet të mendojmë mirë se ku e shpenzojmë jetën, ku e fitojmë dhe e harxhojmë pasurinë, sa punojmë me fëmijët tanë dhe a do të jenë ata nder apo turp për ne në ditën e kiametit? Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَاعْلَمُوا أَنَّمَا أَمْوَالُكُمْ وَأَوْلَادُكُمْ فِتْنَةٌ وَأَنَّ اللَّهَ عِنْدَهُ أَجْرٌ عَظِيمٌ

“Ta dini se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë dhe se vetëm tek Allahu është shpërblimi i madh.” (Enfal, 28.)

Nëse një fëmijë mëson fenë e tij sipas sunnetit profetik, përgatitet për botën tjetër dhe zotëron moral të bukur, ai do të jetë lumturi në ditën e gjykimit, edhe për vete, edhe për prindërit e tij. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Pas vdekjes (një) robit i ngrihet grada, e ai pyet:

«O Zoti im! Nga erdhi ky shpërblim?» Allahu i Madhëruar përgjigjet:

«Fëmija i mirë e i devotshëm (që ke lënë pas), u lut dhe kërkoi falje për ty.»” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 1; Ahmed, II, 509.)

Siç transmetohet nga Ibn Abbasi (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“I vdekuri në varr, është si personi që është duke u mbytur në det dhe kërkon ndihmë i tmerruar. Ai pret dua prej babait, nënës, vëllait dhe prej shokëve të tij të singertë e besnikë. Nëse do të vinte një dua, për të do të ishte gjëja më e çmueshme dhe më e dashur në botë. Padyshim se Allahu i Madhëruar, në sajë të begatisë së duave të të gjallëve, i shpërblen banorët e varreve sa madhësia e maleve. Ndërsa dhurata më e bukur që mund t’i dërgojnë të gjallët të vdekurve, është kërkimi i faljes për ta dhe sadakaja në emrin e tyre.”

(Dejlemi, Musned, IV, IV, 103/6323; Ali el-Muttaki, XV, 694/42783; XV, 749/42971.)

Në këtë situatë, ajo që do t’i vijë në ndihmë njeriut, është sadakaja e rrjedhshme që ai ka lënë në këtë botë, e cila është shpëtimi ynë në varr dhe në botën tjetër. Dhe, një nga sadakatë më të rëndësishme, është fëmija i mirë që lëmë pas.

Lidhur me këtë, një prej të parëve të letërsisë turke, Ashik Pasha, i cili ishte njeri i brumosur me besim dhe autori i veprës “Garibname” në fushën e tasavufit, ka numëruar katër rrugë për vazhdimësinë e brezit njerëzor:

1. Trashëgimia e gjakut: Kjo përbëhet nga fëmijët që vijnë prej sojit të vetë njeriut dhe vazhdimësia e këtyre varet nga kaderi (caktimi i Allahut). Vjen një ditë dhe mund të ndërpritet. Nëse ata që vijnë pas janë të dobishëm, s’ka më mirë. Por në të kundërtën, njeriut nuk i bën asnjë dobi.

2. Trashëgimia ekonomike: Kjo trashëgimi nënkupton shërbimin e bamirësisë, që njeriu e ka bërë me pasurinë dhe pronën e tij. Për sa kohë që ato bamirësi vazhdojnë të kenë dobi, ato vazhdojnë t’i shkruhen si sevap edhe atij që i ka bërë.

3. Trashëgimia e udhëzimit: Këtu përfshihen fëmijët dhe nxënësit e mirë, të cilët njeriu i ka edukuar dhe i ka lënë pas. Ky brez vazhdon, nëse edhe këta vazhdojnë të edukojnë njerëz të tjerë pas tyre.



4. Trashëgimia e ditorisë dhe urtësisë: Këtu hyjnë librat e dobishëm që njeriu ka shkruar, me qëllim që të jenë ushqyes të mendjeve dhe zemrave të njerëzve të tjerë. Ky është edhe brezi më i frytshëm dhe më i vazhdueshëm. Një vepër e shkruar, është si një letër udhëzimi që u dërgohet njerëzve të panjohur që do të vijnë deri në Ditën e Kiametit.

Si përfundim, pikat kryesore në të cila prindërit duhet të bëjnë shumë kujdes, janë këto:

Nuk duhet të lejojmë që mes fëmijëve të shfaqet smirë dhe duhet t'i këshillojmë të mbajnë gjithmonë drejtësinë. Kur të rriten e të kenë arritur pjekurinë dhe seriozitetin e duhur për të mbajtur familje, duhet t'i nxisim dhe t'i ndihmojmë të martohen. Ndërsa në zgjedhjen e bashkëshortit/es së duhur, më tepër se pasurinë, pozitën dhe cilësi të tjera materiale, duhet të bëjmë kujdes në preferimin e cilësive shpirtërore, si besimi i drejtë, morali i bukur dhe sjelljet e hijshme. Kjo, sepse në përgjithësi, çiftet që nuk martohen duke marrë për bazë ndjenjat morale dhe fetare, ka më pak mundësi të kenë martesë të lumtur dhe të suksesshme. Po ashtu, ne duhet t'i ruajmë fëmijët nga çdolloj sjellje negative që ua dobëson botën shpirtërore, si shëtitjet e panevojshme, sorollatjet e kota, vonesa në shtëpi, shoqëria e keqe, etj. Ne duhet t'i edukojmë ata me vetëdijen e detyrave që kanë ndaj mësuesve, të mos-huarve, të afërmve, fqinjëve, të dobëtëve, të vetmuarve dhe nevojtarëve, etj. Ne duhet të lutemi shpesh për ta dhe t'i mësojmë të vizitojnë të sëmurët e të jenë bujarë, duke synuar që shpirtrat e tyre të pastër të shijojnë ëmbëlsinë e bamirësisë. Krahës edukimit shpirtëror, ne duhet tu mësojmë atyre historinë e Profetit tonë (a.s.) dhe atë të të parëve tanë, duke u folur atyre për mëshirën, trimërinë, sakrificat, drejtësinë dhe shumë virtyet të larta në sajë të të cilave janë bërë të famshëm në historinë tonë.

Fëmijët e atyre prindërve, të cilët bëjnë kujdes në këto çështje, bëhen bejja e syrit të fesë, atdheut dhe mbarë kombit. Lum ato nëna të mira, nën këmbët e të cilave ndodhet Xheneti! Lum ata baballarë

të mirë, që lutjet e tyre janë si lutja e Profetit (a.s.), për umetin! Lum ata prindër që i edukojnë fëmijët e tyre në atë mënyrë, që të jenë për ta sadaka të rrjedhshme!..

I lutemi Allahut të Madhëruar të na japë fëmijë të mbarë dhe të dobishëm për fenë, atdheun dhe kombin tonë dhe t'i ruajë ata nga vorbulla e kaosit dhe së keqes së kohës sonë!..

Amin!..



Dashuria



Dashuria është si një linjë elektrike midis dy zemrave. Të dashuruarit nuk mund të rrinë pa përmendur vazhdimisht atë që dashurojnë. Ato tregohen bujarë me të gjitha mundësitë e tyre ndaj të dashurve dhe përpiqen ta gjejnë lumturinë, duke sakrifikuar çdo gjë për njëri-tjetrin.

Për të peshuar se sa të mbushur e kemi zemrën tonë me dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), duhet të mendojmë se sa i përdorim mirësitë e përkohshme për të arritur dashurinë hyjnore. Duhet të bëjmë kujdes që dashuria të mos mbetet thjesht një pretendim i thatë, i cili nuk zbret kurrë prej gjuhëve drejt zemrave tona!..

DASHURIA

*“Mos ndërtoni tyrbe madhështore
mbi varrin tim! Lëreni të hapur nga
sipër, dhe trupin tim varroseni direkt
në tokë, që shirat që janë mëshirë e
Allahut, të bien mbi mua!”*

Amaneti i Sulltan Murad Hanit të II

Dashuria, është shija, gëzimi, qetësia dhe lumturia e jetës sonë të përkohshme. Ajo është brumosur me brumin dhe ekzistencës dhe majanë e dashurisë. Aftësia për të dashuruar është një nga dhuratat më të mëdha që Allahu u ka dhënë robërve të Tij. Nisur nga kjo, dashuria jonë duhet të orientohet drejt atyre që e meritojnë dhe zotërojnë zemra që kanë kuptuar të vërtetën e miqësisë. Kjo shkallë në dashuri, është një basamak drejt arritjes së dashurisë hyjnore. Mirëpo për fat të keq, shumica e njerëzve, dashurinë, që është një mirësi hyjnore, e çojnë dëm për hir të dëshirave kalimtare të egos.

Dashuria që nuk mund ta gjejë atë që e meriton, është një shpërdorim i hidhur i kësaj bote të përkohshme. Dashuritë që ngecin në grackën e interesave të pavlera e të ulëta, u ngjajnë luleve që çelin në qoshe të kalldrëmeve, të cilat herët a vonë janë të dënuara të shke-len apo të këputen. Sa i pafat është një diamant i rënë në rrugë! Sa



humbje e hidhur është të jesh pasuria e padrejtë në një dorë që nuk e meriton!

Mevlana Xhelaledin Rumi, lidhur me ata që e çojnë dëm kapitalin e dashurisë për hir të krijesave të përkohshme, duke u privuar nga dashuria hyjnore, bën një përngjasim të tillë:

“Kush ia jep zemrën dynjasë, i ngjan gjahtarit që gjuan hije. E si mund të jetë hija pronë e tij?! Kështu, një gjuetar budalla, pandehu se hija e zogut, ishte vet zogu dhe deshi ta kapte. Mirëpo, edhe zogu mbi degë, u shastis prej këtij të marri!”

Ndërsa një i urtë ka thënë:

“Për shkak të mëshirës dhe dhembshurisë ndaj robërve të Vet, Allahu i Madhëruar, i ftoi ata të ushqejnë dashuri ndaj Vetes së Tij. Por robërit e pafat, e refuzuan këtë. Për rrjedhojë, si ndëshkim i këtij gjynahu, Allahu i Madhëruar i bëri ata të dashurohen pas atyre që nuk i mëshirojnë.”

Zemrat në të cilat nuk mbijnë farat e dashurisë, nuk mund të shpëtojnë nga stina e vjeshtës. Të gjendura nën robërinë e ndjenjave egoiste, në një farë kuptimi, ato bartin kufomën e ndjenjave shpirtërore. Kurse dashuritë që frymëzohen nga burimi hyjnor nën atmosferën shpirtërore, janë si lulet e kopshteve të Xhenetit që përkëdhelen nga njëmijenjë aroma të këndshme. Edhe nëse herë pas here mund tu bien gjethet dhe t'i vyshken lulet, ato shpërthejnë përsëri të begata me buzëqeshjen e pranverës.

Ata që arrijnë ta perceptojnë dashurinë hyjnore, që është edhe burimi i të gjitha dashurive, mund të miqësohen me çdo krijesë. Pra, ata fitojnë aftësinë për t'i parë krijesat me syrin e mëshirës së Krijuesit. Të gjithë ata që e kanë arritur këtë gradë të lartë, i kanë asgjësuar të gjitha kënaqësitë e egos dhe jetojnë të vetëdijsëm se kënaqësia e vërtetë, është njohja dhe dashuria për Allahun.

Në një hadith kudsî thuhet:

“...Robi Im, nuk mund të më afrohet me asnjë gjë tjetër më të dashur se punët që ia kam bërë farz/të detyrueshme. Robi Im mu-



ndohet të më afrohet vazhdimisht me adhurime vullnetare (përveç farzeve). Më në fund, Unë e dua atë. Kur Unë e dua robin Tim, bëhem veshi që dëgjon, syri që shikon, dora me të cilën mban, këmba me të cilën ecën...» (Buhari, Rikak, 38.)

Kjo majë shpirtërore, ashtu si majat më të larta në botën tonë, është shumë e rrallë. Ata që arrijnë ta bëjnë mbizotëruese këtë frymëzim shpirtëror hyjnor në personalitetin dhe mendimin e tyre, shpëtojnë nga të qenit njerëz të rëndomtë. Njerëz të tillë, i shohin me sy tjetër ndodhitë dhe krijesat e tjera.

Për ata që mund të dëgjojnë me të vërtetë, prej një lule delikate, rënkimit të një bylbyli dhe gurgullimit të një përroi perceptohen melodi të veçanta. Beshtarët e devotshëm, zemrat e të cilëve janë të mbushura me pasion dhe dashuri, arrijnë të zhyten në mësimet e manifestimeve të mrekullueshme të urtësive hyjnore në këtë gjithësi. A është e mundur për një mendje të shëndoshë dhe një zemër të gjallë të mos preket nga meloditë e djegëse të dashurisë ndaj Allahut, kur i shohin gjithë këto mrekulli të urtësisë dhe artit hyjnor të ekspozuara në gjithësi?..

Dashuria shpreh vlerë të barabartë me rëndësinë dhe përsosmërinë e krijesës që duhet. Nga ky aspekt, niveli më i lartë që mund të arrihet në dashuritë njerëzore, është dashuria për të Dërguarin e Allahut (a.s.), sepse në dashurinë ndaj një qenieje njerëzore, nuk mund të imagjinohet ndonjë njeri që e meriton më tepër dashurinë se sa ai.

Megjithatë, edhe ai nuk është stacioni i fundit në dashuri, sepse për njeriun, synimi përfundimtar të cilit i takon dashuria, është Krijuesi i gjithësisë, Allahu i Madhëruar. Mirëpo, për të arritur dashurinë e Allahut, është e domosdoshme ta kuptojmë siç duhet edhe dashurinë për Profetin (a.s.), që është edhe shkalla e fundit në dashurinë për qeniet njerëzore, sepse ata që nuk e përfjethesojnë dashurinë për Profetin (a.s.), nuk mund ta arrijnë dashurinë për Allahun.

Nuk duhet harruar se, i vetmi lum mëshire dhe dashuri që të çon në oqeanin e dashurisë për Allahun, është Profeti ynë (a.s.), sepse dashuria për të, është dashuri për Allahun, bindja ndaj tij, është bindje ndaj Allahut dhe mosbindja ndaj tij, është mosbindje ndaj Allahut. Nisur



nga kjo, ekzistenca e Profetit tonë (a.s.), është strehë dashurie për të gjithë njerëzimin. Në një ajet fisnik urdhërohet:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ الْهَلَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ الْهَلُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”. (Al-i Imran, 31.)

Padyshim se treguesi më i qartë i dashurisë është bindja; sakrifica për hir të të dashurit. I dashuruari, i bindet të dashurit aq sa dashuri ka në zemrën e tij. Nëse në themel të sjelljeve gjendet dashuria, aty do të ketë sinqeritet, dashamirësi dhe begati. Veprat bëhen sublime kur ato bëhen mbi truallin e dashurisë. Kurse sjelljet pa dashuri, pra që nuk vijnë nga zemra dhe bëhen me detyrim, për shkak se janë të pasinqerta, nuk mund të bëjnë gjë tjetër përveçse të fryjnë egon.

Kjo ndodhi që transmetohet nga Ebu Berze (r.a.), është një she-mbull i veçantë që tregon se sa i bindur duhet të jetë njeriu ndaj atij që dashuron:

Kur ndokujt prej ensarëve i bëhej vajza për martesë, nuk e martonte atë pa marrë më parë mendimin dhe këshillën e Profetit (a.s.):

Një ditë Profeti (a.s.), i tha njërit nga ensarëve:

“Dua vajzën tuaj prej jush!” Sahabiu me një gëzim të madh i tha:

“Dakord, o Resulullah! Ky është nder për mua.” Më pas Resulu-llahu (a.s.), i tha:

“Nuk e dua për vete, por Xhulejbibin!” (Xhulejbibi ishte një sahabi i zi dhe jo shumë i pashëm.)

Ensari i tha:

“Atëherë, le ta pyes të ëmën e vajzës.” – dhe iku. Edhe e shoqja në fillim u gëzua, por kur dëgjoi emrin e Xhulejbibit, tha:

“Për Xhulejbibin? Jo vallahi, nuk mund ta jap vajzën për të!”



Vajza, e cila dëgjoi bisedën e tyre, i pyeti:

“Kush është shkesi juaj për mua?”

E ëma ia tregoi situatën. Atëherë vajza iu drejtua:

“Po refuzoni dëshirën e Resulullahut?! Më lini tek Resulullahu, ai patjetër që nuk lejon të dëmtohem.”

I ati shkoi tek Resulullahu (a.s.) dhe i tha përgjigjen e vajzës. I Dërguari i Allahut (a.s.), e martoi vajzën me Xhulejbibin.

Pas pak kohësh, Profeti (a.s.), zhvilloi një betejë dhe si triumfues të betejës, Allahu u fali shumë plaçkë lufte. Kur po përgatiteshin për t'u kthyer, Profeti (a.s.), i pyet sahabët:

“A keni humbur ndokënd prej shokëve tuaj?”

“Jo!” -Thanë ata.

“Por unë nuk po e shoh Xhulejbibin. Kërkojeni atë!” -Urdhëroi Profeti (a.s.).

Sahabët filluan ta kërkonin Xhulejbibin (r.a.) dhe më në fund, e gjetën të vdekur mes shtatë idhujtarëve të vrarë. Më pas i thanë Profetit (a.s.):

“Ja ku është o Resulullah! Paska vrarë shtatë idhujtarë, e më pas ka rënë dëshmor.”

Profeti (a.s.), erdhi dhe tha:

“Ai ka vrarë shtatë mohues, e ata e martizuan atë. Ai është prej meje dhe unë jam prej tij!” Fjalinë e fundit e përsëriti dy apo tre herë dhe më pas urdhëroi të hapej një varr. Kur varri u bë gati, e mori trupin e pajetë të Xhulejbibit në krahët e vet dhe e vendosi personalisht në varr.

Një prej të mëdhenjve të tabiinëve, Thabit el-Bunani, ka thënë:

“Ndër gratë e ensarëve, nuk kishte grua më bujare se ajo e Xhulejbibit (r.a.), sepse Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“O Allah! Jepi plot mirësi e begati kësaj gruaje dhe mos ia bëj jetën të mundimshme!” Prandaj edhe begatia e kësaj duaje është vërejtur haptazi në jetën e saj. (Ahmed, IV, 422, 425; Hajthemi, IX, 367 – 368.)

Veprimi më i vogël që bëhet me zemër, është më i vlefshëm se veprat e pasinqerta që duken sa një mal. Dhe manifestimi më i rëndësishëm i kësaj, e tregon veten në dashurinë për Allahun, që është edhe niveli më i lartë i dashurisë. Megjithatë, ashtu si për çdo gjë tjetër, edhe krijuesi i dashurisë, është Vet Allahu i Madhëruar. Pra, nëse nuk do Ai, robi nuk mund të ngrihet në këtë gradë. Prandaj, ajo që i takon robit në këtë çështje, është të vazhdojë t'i lutet Allahut dhe të strehohet tek Ai. Në një ajet fisnik thuhet:

قُلْ مَا يَعْبُورُ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“Thuaj: «Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...»” (Furkan, 77.)

Treguesi i dashurisë për Allahun dhe mënyra e arritjes së dashurisë së Tij, është që pasi të kryesh me përkushtim të madh detyrat më të vogla të adhurimit që Allahu ia ka bërë farz dhe obligim, të përpiqesh me edukatë të lartë, me respekt dhe dëshirë të zjarrtë, që të falësh nafile dhe të bësh vepra të mira edhe kur nuk janë obligim, thjesht për shkak të dashurisë dhe dashamirësisë që të vjen nga zemra. Të arrish dashurinë e Allahut duke vazhduar në këtë gjendje, do të thotë të realizosh qëllimin e krijimit të njeriut, sepse në Islam, kulmi i obligimeve hyjnore dhe qëllimi i fundit që i parashtrohet njeriut, është “të takohet me Allahun”. Dhe, kapitali më i rëndësishëm i kësaj është dashuria. Veprat e tjera janë shfaqje e kësaj dashurie.

Sa më shumë të shtohet dashuria për Allahun në zemrën e besimtarit, aq më shumë shtohen edhe veprat për hir të Allahut. Për këtë arsye, ata që fillojnë të përparojnë në dashurinë ndaj Allahut, nuk mjaftohen më vetëm me adhurimet farz, por fillojnë të kryejnë edhe shumë adhurime vullnetare me përkushtim dhe pasion të madh. Si rrjedhojë e kësaj, ashtu siç i shtohet dëshira për ujë një njeriu në shkretëtirë, edhe këtyre besimtarëve u shtohet dëshira për sa më shumë adhurime. Ata që arrijnë në gradë të tillë, tashmë nuk i ngushëllon më asgjë përveç kthimit tek Allahut. Prandaj, atë nuk mund ta kënaqë më asgjë përveçse realizimi i këtij ajeti:



يَا أَيَّتُهَا النَّفْسُ الْمُطْمَئِنَّةُ
ارْجِعِي إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً

“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty!” (Fexhr, 27-28.)

Besimtarët që e arrijnë këtë nivel të dashurisë hyjnore, tashmë ndjejnë nevojën të qëndrojnë më tepër me Allahun, duke dëshiruar t’ia kushtojnë çdo moment të jetës së tyre rrugës së Tij. Për rrjedhojë, ata janë të gatshëm të shpenzojnë në këtë rrugë jetën, pasurinë, pronën dhe gjithçka që kanë. Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik urdhëron:

“O ju që besuat! Kush prej jush largohet nga feja e tij, atëherë Allahu do ta sjellë një popull që Ai i do ata dhe ata e duan Atë, të cilët janë të përlur ndaj besimtarëve, por krenarë ndaj jo besimtarëve, që sakrifikojnë në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohen kërcënimit të askujt. Kjo është mirësi e Allahut që ia jep kujt të dojë. Allahu është dhuruesi, i dijshti.” (Maide, 54.)

Pra, për të arritur mirësinë e dashurisë së Allahut, më parë duhet që Allahu ta dojë robin e Vet. Prandaj, është e nevojshme që ne të përpiqemi vazhdimisht me adhurime dhe shërbime të dobishme në rrugën e Allahut, me qëllim që të fitojmë kënaqësinë e Tij. Krahas kësaj, ai që e do Allahun, është modest dhe i butë me besimtarët. Ndërsa kur përballet me mohuesit e Allahut, tregohet i palëkundur, dinjitoz dhe i sigurt në vetvete. Ai duhet të përpiqet fort në rrugën e Allahut duke sakrifikuar çdo gjë që posedon, nuk duhet të ketë frikë nga asgjë, nuk duhet t’u vërë veshin qortimeve dhe fyerjeve të njerëzve dhe duhet të eci në rrugën që ai beson se është e drejtë.

Ky shembull i Ammar bin Jasirit (r.a.), e tregon shumë bukur dashurinë për Allahun e Madhëruar. Kur po kalonte në bregun e lumit Eufrat për të marrë pjesë në një luftë, Ammar bin Jasiri (r.a.), e shprehte në këtë mënyrë dashurinë që kishte ndaj Allahut:

“O Allah! Sikur ta di se po të hidhem nga ky mal, kjo do të jetë shkak që të kënaqesh më shumë nga unë, do ta bëja menjëherë këtë.

Sikur ta di se, po të hidhem në zjarr, kjo do të jetë shkak që të kënaqesh më shumë nga unë, do ta bëja menjëherë këtë. O Zoti im! Sikur ta di se, po të mbytem duke u hedhur në ujë, kjo do të jetë shkak për të fituar më shumë kënaqësinë tënde, edhe këtë do ta bëja menjëherë. O Allah! Unë po luftoj vetëm për Ty dhe të lutem që të mos humbas, sepse unë të dua Ty.” (Ibn Sa’d, III, 258.)

Ndërsa kjo gjendje e Talha bin Bera (r.a.), është një shembull i bukur që tregon edhe dashurinë ndaj Allahut, edhe dashurinë ndaj Profetit (a.s.). Para se të ndërronte jetë, Talha bin Bera (r.a.), tha:

“Më varrosni shpejt dhe më çoni tek Zoti im. Mos e lajmëroni të Dërguarin e Allahut, sepse kam frikë se mos i bëjnë ndonjë dëm jahuditë gjatë udhës për këtu. Nuk dua që i Dërguari i Allahut të pësojë gjë të keqe për shkakun tim.”

Më pas, për shkak se ra edhe nata, Talha bin Beran (r.a.), e varrosën pa lajmëruar të Dërguarin e Allahut (a.s.). Në mëngjes, kur e lajmëruar të Dërguarin e Allahut (a.s.), ai shkoi tek varri i Talhas (r.a.) dhe u lut me këto fjalë:

“O Allah! Pranoje Talhan i kënaqur prej tij, e ai i kënaqur prej Teje!” (Shih. Ibn-i Esir, Usdu’l-Gabe, II, 29.)

Dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), është thelbi i fesë sonë dhe rruga më e mirë për të shkuar tek Allahu, sepse dera e pranimit në audiencën hyjnore, hapet vetëm në sajë të çelësit të dashurisë. Mirëpo, edhe dashuria nuk duhet të jetë thjeshtë një pretendim i thatë. Fjalët boshe që mbeten veç fjalë, e nuk kanë asnjë ndikim konkret, nuk kanë të bëjnë aspak me dashurinë e vërtetë. Mbi të gjitha, kjo gjendje, thjesht sa përkëdhel egon.

Shembujt më të bukur të dashurisë së vërtetë, i kanë shfaqur sahabët, sepse me jetën dhe përpjekjen e tyre në rrugën e Allahut, u bënë shembuj të gjallë të dashurisë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.). Ja disa prej këtyre shembujve:

Profeti (a.s.), e kishte zakon të dërgonte mësues në fiset përreth, me qëllim që t’u mësonin atyre Islamit. Dy nga fiset që kishin kërkuar



mësues, ishin edhe fiset Adal dhe Kare. Për këtë arsye, një grup prej dhjetë vetave doli në udhë për të shkuar tek këto fise. Mirëpo, gjatë udhëtimit, grupi ra në pusi dhe tetë prej mësuesve ranë dëshmorë, ndërsa dy të tjerë u kapën rob. Dy mësuesit që ranë rob, ishin Zejdi dhe Hubejbi (r.anhuma.). Që të dy iu dorëzuan idhujtarëve të Mekës, të cilët më pas i vranë. Por, para se ta vrisnin, idhujtarët i thanë Hubejbit (r.a.):

“A do të dëshiroje që tani në vendin tënd të ishte Profeti dhe ti të shpëtoje?”

Hubejbi (r.a.), me keqardhje për Ebu Sufjanin, i cili i bëri edhe pyetjen, tha:

“Jo vetëm që nuk dua që Profeti të jetë në vendin tim, e unë të jem me familjen dhe fëmijët e mi, por unë nuk dëshiroj as që Profetit t’i hyjë qoftë edhe një gjemb në këmbë atje ku ndodhet, për të shpëtuar unë!”

Ebu Sufjani, i cili u shtang i mahnitur nga kjo skenë e pashembullt dashurie, tha:

“Me të vërtetë e mahnitshme! Në këtë botë, ende nuk kam parë dy njerëz që të duhen ashtu siç e duan sahabët Muhamedin.” (Uakidi, I, 360; Ibn Sa’d, II, 56.)

Hubejbi (r.a.), kur u zu rob nga idhujtarët, para se të binte shëhid, kishte vetëm një dëshirë: Dërgimi i një selami të ngrohtë me dashuri e mall, Resulullahut (a.s.)... Por me kë mund t’ia dërgonte?! Pa rrugëzgjdhje tjetër, ai çoi sytë nga qielli dhe u lut:

“Zoti im! Këtu, afër meje nuk ndodhet askush për t’ia përcjellë selamin tim Resulullahut. Përcillja Ti ja Rabbi!”

Në atë moment, i Dërguari i Allahut (a.s.), ishte në Medinë bashkë me sahabët e tjerë dhe u dëgjua tek thoshte:

“Ue alejhi’s-selam (Selami qoftë edhe mbi të!)”

Sahabët të çuditur e pyetën:

“Kujt ia ktheve selamin, o Resulullah?”



“Vëllait tuaj Hubejb. Selamin e tij ma solli Xhebraili!” - iu përgjigj ai. (Shih. Buhari, Xhihad 170, Megazi 10, 28; Vakidi, 1, 354-363.)

Po ashtu, për shkak të dashuri ndaj Profeti (a.s.), të rinjtë sahabë, thuajse garonin me njëri-tjetrin për të qenë korrierët e letrave të Profetit (a.s.), të cilat ftonin në Islam mbretërit dhe sunduesit e kohës. Madje, për të përmbushur edhe dëshirat më të vogla të Profetit (a.s.), ata morën përsipër çdolloj sakrifice, pa nxjerrë asnjëfarë justifikimi, duke kapërcyer male të thepisura dhe shkretëtira pa shfaqur aspak lodhje e mërzi. Gjithashtu, me një trimëri që ua jepte besimi, ata kaluan përmes xhelatëve dhe lexuan letrat e Profetit (a.s.), para mbretërve. Të gjitha këto, janë shfaqje të qarta të dashurisë së madhe që ndjenin ata ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Një tjetër prej shembujve të panumërt që tregon respektin, edukatën dhe dashurinë e sahabëve për Profetin (a.s.), është edhe ky:

Një ditë, Halid bin Velidi (r.a.) kishte shkuar te njëri nga fiset arabe dhe atje, kryetari i fisit i kishte thënë:

“O Halid, na e përshkruaj figurën dhe portretin e të Dërguarit të Allahut!”

“Është e pamundur, fjalët s’mjaftojnë për këtë!” – I ishte përgjigjur Halidi (r.a.).

“Atëherë, të paktën na bëj një përmbledhje me aq sa ta lejon njohja dhe përfytyrimi!” -I kishte thënë arabi.

Dhe Halidi (r.a.) i kishte dhënë këtë përgjigje:

“PO TË THEM VETËM KAQ, QË I DËRGUARI I PËRSHTATET DËRGUESIT. MEQË DËRGUESI ËSHTË KRIJUESI I GJITHËSISË, PËRFYTYROJE DHE PËRSHKRUAJE VET MADHËSHTINË E TË DËRGUARIT!” (Munavi, V, 92; Kastalani, Mevâhib-i Ledünniyye Tercümesi, f. 417.)

Po ashtu, edhe Amr bin As (r.a.), ka treguar një ndodhi të ngjashme:

“Kam qëndruar një kohë të gjatë me Resulullahun (a.s.). Mirëpo, për shkak të ndjenjës së turpit që kisha pranë tij dhe respektit të madh që ushqeja për të, nuk arrita ta ngre dot kokën e ta shihja fytyrën e tij



të bekuar e të ndritur, sa të ngopesha me të. Nëse sot më thonë; «Na e përshkruaj Resulullahun! Na e trego atë!», më besoni, se nuk e bëj dot.» (Muslim, Iman, 192; Ahmed, IV, 199.)

Shfaqjet e dashurisë së sahabëve ndaj Profetit (a.s.), mund t'i shohim në faktin se si i batojnë urdhrat dhe ndalesat e tij dhe se si e ndjekin shembullin dhe moralin e tij, sepse njeriu që dashuron dikë, e imiton atë aq sa dashuri ndjen për të. Ja një shembull tjetër që tregon se Profeti ynë (a.s.), ka qenë mëshirë për botët dhe dashurinë e sahabëve ndaj tij:

Ebu Abdurrahman Xhebeli (r.a.), rrëfen:

Gjatë një fushate luftarake kundër Romakëve, isha në një anije me Ebu Ejub el Ensarin (r.a.). Në krye kishim Abdullah ibn Kajsin (r.a.). Ebu Ejub el Ensari (r.a.), shkoi pranë personit që ishte ngarkuar për të ndarë plaçkën e luftës dhe aty pa një grua duke qarë. Ajo ishte prej robërve të luftës. Kur Ebu Ejub el Ensari (r.a.), pyeti se përse qante ajo grua, i thanë:

“Kjo grua një fëmijë, të cilin e kanë ndarë prej saj, prandaj qan.”

Ebu Ejub el Ensari e gjeti fëmijën dhe menjëherë ia dorëzoi së ëmës. Personi që ndante plaçkën shkoi tek Abdullah ibn Kajsi (r.a.) dhe e informoi për veprimin e Ebu Ejub el Ensarit (r.a.). Kur Abdullah ibn Kajsi e pyeti Ebu Ejub el Ensari se përse veprooi ashtu, ai iu përgjigj:

“*Kam dëgjuar Profetin (a.s.), të thotë: «Kush ndan fëmijën nga nëna e tij, ditën e gjykimit Allahu do ta ndajë nga të gjithë njerëzit e dashur.»*” (Ahmed, V, 422; Tirmidhi, Buju, 52/1283.)

Ja pra, dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), bën të domosdoshme edhe dashurinë dhe mëshirën ndaj të gjitha krijesave, sepse fryti më i rëndësishëm i besimit, është dashuria dhe mëshira. Një shembull i bukur i begatisë së dashurisë dhe mëshirës ndaj krijesave të Allahut dhe faktit që kjo e çon robin në burimin e besimit, është edhe kjo ndodhi:

Në kohën e Profetit (a.s.), jetonte një sahab me moral të bukur, i cili quhej Hakim ibn Hizam (r.a.). Ky sahab ishte njëkohësisht edhe i afërm i nënës sonë Hadixhes (r.anha.). Ai ishte shumë bujar, zemërbutë



dhe bamirës. Në kohën para Islame, ai i shpëtonte nga vdekja dhe i mbronte vajzat e mitura, baballarët e të cilave donin t'i varrosnin të gjalla (për shkak të zakoneve injorante). Një ditë, ai shkoi tek i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe e pyeti:

“Përpara se të përqafoja Islamin, bëja vepra të mira, duke dhënë bamirësi, duke liruar skllevër, si dhe duke mbajtur marrëdhënie të mira me të afërmit dhe faqefisin. A do të kem shpërblim për këto vepra?” Profeti (a.s.), i tha:

“Në fakt, ti për hir të këtyre veprave të mira je nderuar me Islam!” (Buhari, Zekat, 24; Muslim, Iman, 194-196.)

Nisur nga kjo, duhet të mendojmë se, ndërkohë që dashuria dhe mëshira për krijesat, i nderon me mirësinë e besim njerëzit e privuar nga besimi, kushedi se çfarë mirësish të mëdha do t'u sjellë atyre që janë besimtarë...

Një ndodhi tjetër, në të cilën na bëhen të ditura cilësitë që e ngrenë njeriun në grada të larta, është edhe kjo:

Bishri Hafi rahmetullahi alejhi thotë:

“Një natë pashë në ëndërr të Dërguarin e Allahut (a.s.), i cili më tha:

“O Bishr! A e di përse ta ka ngritur Allahu vlerën?” I thashë:

“Jo o i Dërguari i Allahut!” Ai më tha:

*“Ty të ngriti në pozitën e të devotshmëve për shkak se ndoqe sunnetin tim, u shërbeve të devotshmëve, i këshillove vëllezërit në fe dhe për shkak se i doje sahabët dhe pjesëtarët e familjes sime (Ehl-i Bejtin).”*⁵⁷

Besimi është mirësia më e madhe e Allahut ndaj robërve të Vet. Prandaj, Zoti ynë i Madhëruar na paralajmëron dhe na urdhëron që ta ruajmë me shumë kujdes këtë mirësi përgjatë gjithë jetës dhe frymë tonë të fundit ta japim duke qenë me këtë besim:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ

«O ju që keni besuar, kini frikë Allahun me një frikë të denjë dhe mos vdisni vetëm se duke qenë myslimanë!» (Al-i Imran, 102.)

Një nga frytet më të rëndësishme të besimit, është edhe mëshira dhe dashuria ndaj krijesave. Lidhur me këtë, Mevlana Xhelaledin Rumi na sjell një shembull shumë mësimdhënës:

Gjatë një bisede të Mevlanës, vjen një i dehur. Nxënësit e Mevlanës mundohen të nxjerrin jashtë duke e lënduar. Mirëpo, Mevlana i nderuar, duke menduar se i dehuri ishte një njeri që ka ardhur vetëm për të kërkuar të vërtetën, i drejtohet atyre që po mundoheshin ta nxirrnin, duke i qortuar me këto fjalë:

“Ai ka pirë verën, por më duket se jeni dehur ju!”

Kjo ndodhi është një shembull i mirë që na tregon se krijesat duhen parë me syrin e mëshirës së Krijuesit dhe se urrejtja ndaj gjynahut nuk duhet të reflektohet tek gjynahqari, porse në vend të zemërimit, ndaj tij duhet treguar dhembshuri dhe mëshirë.



Nuk duhet harruar se, shoqëria besimtare që gëzojmë sot, është begatia e trashëgimisë së shenjtë të Epokës së Lumturisë. Sahabët dhe dijetarët që i pasuan ndër shekuj, kanë bërë përpjekje të mëdha në përcjelljen e kësaj feje madhështore tek brezat e ardhshëm. Ata u bënë yjet e qiellit të udhëzimit, mësuesit e shkollës së të vërtetës, begatia dhe mëshira e ditëve tona, drita e kohës sonë dhe dëshmitarët e Allahut në tokë.

Përpjekjet dhe sakrificat e jashtëzakonshme që kanë treguar në rrugën e fesë së Allahut Profeti ynë (a.s.), sahabët e tij, dijetarët dhe njerëzit e devotshëm të këtij umeti, duhet të jenë shembujt më të mirë për ne. Për rrjedhojë, është detyra dhe përgjegjësia jonë që të mos e humbasim këtë trashëgimi të shenjtë që na është lënë amanet dhe t'i a përcjellim atë brezave të ardhshëm në mënyrën më origjinale dhe më të pastër. Zemrat besimtare, duhet ta shijojnë gjithmonë me entu-



ziazëm besimi dhe në nivelin më të lartë këtë dashuri hyjnore, sepse lumturia e vërtetë, fillon atëherë kur kapërcehen kufijtë e ngushtë të dashurive të përkohshme dhe relative. Në këtë mënyrë, edhe brezat e mëvonshëm do të ushqejnë dashuri për Allahun dhe Profetin (a.s.). Në një hadith fisnik, thuhet:

“Një pjesë e atyre që më duan më së shumti, do të dalin nga brezat që do të vijnë pas meje. Ata, do të dëshirojnë të sakrifikojnë pasuritë dhe familjet e tyre për të më parë mua.” (Muslim, Xhennet, 12.)

Ndërsa poeti i famshëm turk Fuzuli, e shpreh shumë bukur faktin se qendra e dashurisë është “zemra”, duke na dhënë këtë shembull:

“Ndërkohë që Mexhnuni po sillej vërdallë si vagabond në fshatin e Lejlës, vjen një i huaj dhe e pyet për shtëpinë e Lejlës. Mexhnuni i thotë:

«Mos u lodh kot të kërkosh shtëpinë e saj!» -Dhe duke bërë me shenjë tek zemra e vet, vazhdon e thotë:

«Sepse vendi i Lejlës është këtu!».”

Kështu edhe ne, duke menduar mbi urtësinë e shfaqur në këtë shembull, duhet të llogarisim veten se sa arrijmë ta bëjmë zemrën tonë vendin ku “ndodhet” Allahu i Madhëruar. Pra, sa të mbushur e kemi zemrën me dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij fisnik (a.s.)? A pasqyrohet entuziazmi i besimit në adhurimet dhe veprat tona? Apo mos vallë dashuria jonë është thjesht një pretendim i thatë që mbetet veç në fjalë? Sa përputhen synimet dhe veprat tona me Kuranin dhe Sunnetin? Sa arrijmë t'i përdorim mirësitë e përkohshme të kësaj bote, për të fituar dashurinë hyjnore? Prandaj, duke marrë si parim fjalën e Omerit (r.a.); “Llogariteni veten para se të llogariteni (në gjykatën hyjnore)!” , ne duhet ta peshojmë veten tonë përballë të gjitha të vërtetave.

Lum si ata që marrin prej frymëzimit shpirtëror të personaliteti shembullor të Profetit tonë (a.s.) dhe arrijnë të vërtetën e dashurisë!..

O Allah! Zbukuroji zemrat tona me dashurinë e besimit! Na bëj prej atyre që e dallojnë shëmtinë e mohimit dhe pabindshmërisë dhe ruhen siç duhet prej tyre! Na i bëj të dashur ata që i do Ti



dhe të urryer ata që i urren Ti! Jepi paqe zemrave tona duke na bërë të mundur një jetë të devotshme të mbushur plot me dashuri, pasion dhe entuziazëm besimi! Na e bëj të mundur të largohemi nga kjo botë me dashurinë për Ty, për të Dërguarin Tënd dhe të dashurit e Tu!..

Amin!..



Ihsani dhe mbikëqyrja hyjnore



Ihsani arrihet kur besimtari e ndjen veten vazhdimisht nën vëzhgimin e kamerave hyjnore dhe në atë mënyrë i kryen të gjitha adhurimet dhe veprat e tij. Përfitimi i kënaqësisë prej adhurimeve, të ndihesh i palodhur dhe i pa mërzitur prej tyre, mund të arrihet vetëm në sajë të ndjenjës së ihsanit. Ai që nuk ka ndjenjë ihsani në zemër, lodhet edhe nga falja e namazit. Nëse është i pasur, atij i vjen rëndë të japë zekat dhe sadaka, sepse, për shkak se ndodhet larg ndjenjës së vëzhgimit hyjnor, nuk ka arritur të shijojë as ëmbëlsinë e besimit.

IHSANI DHE MBIKËQYRJA HYJNORE

Ihsan, do të thotë që njeriu të jetë gjithmonë i vetëdijshëm me mendje dhe me zemër se ndodhet gjithmonë nën vëzhgimin e Allahut të Madhëruar, sepse vetëm ata që bartin këtë lloj vetëdijeje dhe botëkuptimi, mund të jenë vazhdimisht të kujdesshëm ndaj adhurimeve, veprave, ndjenjave dhe të gjitha sjelljeve që përfshijnë jetën. Ata e përjetojnë çdo frymë duke pasur parasysh ajetin:

“...Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.” (Kaf, 16.)

Ja pra, kjo është gjendja e ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, në të cilën robi nuk e humb asnjëherë vetëdijen se ndodhen nën vëzhgimin e Zotit të tij të Madhëruar. Dhe me të vërtetë që kjo gjendje, është si një mburojë e fortë kundër gjynaheve, sepse njeriu e ndjen veten në prezencën hyjnore dhe, kur zemra e tij thotë; “O Zot!”, si mund të bëjë gjynahe ndërkohë që është bashkë me Allahun?

Një njeri që e ndjen se e shikojnë dy sy në jetën e përditshme, shmangët nga shumë sjellje dhe fjalë të këqija, edhe pse janë vetëm dy sy të paaftë për ta ndëshkuar... Pra, nëse ky njeri e kupton siç duhet se ndodhet nën kontrollin hyjnor të Krijuesit, pra nëse jeton me ndjenjën e ihsanit, a mund të veprojë diçka në kundërshtim me atë vullnet hyjnor? A do të guxonte të fliste qoftë edhe një fjalë me të cilën nuk është i kënaqur Allahu? Madje, a do të mund të kalonte nëpër mend qoftë edhe një mendim që nuk do ta kishte pranuar Ai? Kurrë!..



Nëse njeriu do të arrinte ta perceptonte shpirtërisht se Allahu i Madhëruar ndodhet më afër tij se damari i qafës së vet, do të jetonte vazhdimisht me frikë ndaj Allahut, do të rrinte vigjilent nga frika e llogaridhënies dhe do t'i mjaftonte qoftë edhe ky ajet i vetëm.

Ja një shembull madhështor nga Epoka e Lumturisë:

Si prijësi i besimtarëve, Omeri (r.a.), shëtiste shpesh nëpër rrugët e Medinës, për të kontrolluar edhe sigurinë, por për pyetur edhe gjendjen e nevojtarëve. Përsëri një ditë, kur ishte duke bërë të njëjtën gjë, i tërhoqi vëmendjen një bisedë që dëgjohej deri jashtë shtëpisë pranë së cilës po kalonte:

“Bija ime! Hidhi pak ujë qumështit që do të shesim nesër!”

Ndërsa vajza thoshte:

“O nënë! A nuk e ka ndaluar kalifi që t'i hedhim qumështit ujë?”

“Bija ime! Si do ta marrë vesh kalifi në këtë orë të mbrëmjes që ne i kemi hedhur ujë qumështit?!” -tha nëna.

Mirëpo, vajza këmbënguli duke thënë:

“O nënë! Le të themi se kalifi nuk na shikon, po as Allahu nuk na shikon? Është e lehtë ta fshehim këtë hile nga njerëzit, por a mund ta fshehim vallë nga Allahu, nga Krijuesi i Gjithësisë që sheh dhe di gjithçka?..”

Zemra e Omerit t, u mbush me gëzim dhe u mrekullua prej kësaj vajze, e cila ishte e vetëdijshme se ndodhej çdo çast nën vëzhgimin hyjnor. Prandaj dhe e mori këtë vajzë si nuse për djalin e tij. Omer bin Abdulazizi i famshëm, i cili njihet si kalifi i pestë, e ka prejardhjen prej këtij brezi.

Pra, e gjithë çështja, është të jetojmë të vetëdijshëm se ndodhemi nën kontrollin hyjnor të Allahut të Madhëruar. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ

“...Ai është me ju kudo që jeni!..” (Hadid, 4.)



Allahu i Madhëruar është në çdo vend, në çdo çast dhe pranë çdo gjëje. Ai di çdo lëvizje që bëhet dhe i ka robërit e Vet nën vëzhgim të pandërprerë. Nëse do të ishte e kundërta, kjo do të shprehte një mangësi të Allahut të Madhëruar. Mirëpo, Allahu është i pastër dhe larg çdo mangësie. Nëse njeriu arrin ta kuptojë në mënyrë të përsosur këtë të vërtetë, do të përparonte në pastrimin e egos dhe të zemrës. Atëherë, tek ai do të fshiheshin të gjitha shqetësimet e kësaj bote të përkohshme dhe vendin e tyre do ta zinin shqetësimet dhe përgatitjet për botën tjetër. Ndjenja e të qenit në prezencën hyjnore, e bën njeriun të jetë gjithmonë vigjilent dhe e ruan nga çdo gjynah dhe vepër e keqe.

Një njeri i devotshëm, ka thënë:

“Asnjë udhëtar nuk fle në stacion. Ai përgatitet dhe shkon tek mjetet që e çojnë atje ku dëshiron të shkojë. Ai nuk i hipën trenit të gabuar. Pra, edhe kjo botë është si një stacion në krahasim me botën tjetër. Për këtë arsye, është e domosdoshme të shtojmë forcën e mendjes dhe të zemrës.”

Nëse nga një anë, e vërteta se Allahu i Madhëruar është me ne kudo që ndodhemi, na drithëron, nga ana tjetër, kjo gjë na lehtëson dhe na qetëson. Për shkak se ky fakt e konkretizon frikën ndaj Allahut, ajo na drithëron, e për shkak se na bën të shijojmë afërsinë me Allahun, ajo na jep një qetësi në shpirt. Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar e shpreh kështu faktin se Ai ndodhet gjithmonë pranë robërve të Vet:

“A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë që është në qiej dhe në Tokë?! Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti; as midis pesë vetave e që Ai të mos jetë i gjashti; as kur janë më pak, as kur janë më shumë, që Ai të mos jetë me ata, kudo që të ndodhen; Ai në Ditën e Kiametit do t’i njoftojë ata se çfarë kanë bërë, se, me të vërtetë, Allahu di çdo gjë!” (Muxhadele, 7.)

Në kohën e kalifatit të tij, Omeri (r.a.), e dërgoi Muadhin (r.a.), tek fisi Beni Kilab, me qëllim që të dërgonte paratë që duheshin paguar nga arka e shtetit, të jepte mallrat që duheshin dhënë dhe do t’u shpërndante të varfërve zekatin e marrë nga të pasurit.

Muadhi (r.a.), e kreu me kujdes detyrën që kish marrë përsipër dhe po kthehej me kujtime të bukura, duke qenë se kishte fituar shumë zemra. Në kthim, atij nuk i kishte mbetur asgjë nga pasuria e kësaj bote, përveç një shalli që e kishte hedhur në supe. Madje, ky shall ishte i njëjti shall që kishte edhe kur kishte vajtur, të cilin e përdorte për t'u mbrojtur nga pluhuri dhe dielli.

Një herë, bashkëshortja e tij nuk duroi dhe e pyeti:

“Ata që kanë një punë të tillë, marrin një pagesë të caktuar dhe sjellin dhurata në shtëpi. Ku janë dhuratat e tua?”

Muadhi (r.a.), u përgjigj:

“Unë kam me vete një që më mbikëqyr dhe nuk më ndahet kurrë. Ai llogarit gjithçka që marr dhe jap.”

Bashkëshortja e tij u zemërua dhe tha:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), të besonte ty për gjithçka. Edhe Ebu Bekri po ashtu. Tani që erdhi Omeri po dërgon me ty dikë që të mbikëqyr? Të ka vënë ndjekës për gjithçka që bën?”

Fjala shkoi te bashkëshortja e Omerit (r.a.), pastaj tek vet Omeri, i cili e thirri Muadhin (r.a.) dhe e pyeti me qortim:

“Ç’janë këto gjëra që kam dëgjuar o Muadh, kur unë nuk kam dërguar ndonjë njeri që të të mbikëqyr? Ti pandeh se unë nuk të besoj?”

Përgjigja e Muadhit (r.a.), ishte shumë kuptimplotë:

“O prijësi i besimtarëve! Vetëm këtë munda t’i them gruas për t’u justifikuar. Ndërsa ajo që kam thënë për një që më mbikëqyr, nuk është për mbikëqyrjen tuaj, por për mbikëqyrjen e Allahut. Me qëllim që të mos e humbas shpërblimin e shërbimit që kam bërë, unë nuk mund të marr asgjë për veten time, edhe nëse është e lejuar...”

Omer (r.a.), e kuptoi se çfarë kishte pasur për qëllim me këto fjalë, sepse Muadhi (r.a.), nuk ishte i dhënë pas gjërave të kësaj bote. Më pas, duke e përgëzuar, Omeri (r.a.), i dha disa dhurata nga vetja e tij dhe i tha:



“Shko e fitoje zemrën e familjes tënde me këto!”



Një tjetër shembull që e shpreh në qartë ihsanin dhe mbikëqyrjen është ky:

Një ligjërues po tregonte në minber situatën e kiametit. Në mesin e xhematit ndodhej edhe Imam Shibli. Ligjëruesi, nga fundi i bisedës së tij numëroi në mënyrë të detajuar disa pyetje që Zoti do t’u bëjë njerëzve në natën e varrit:

“Do të pyetet ku e ke përdorur dijen, ku e ke harxhuar pasurinë, si e ke kaluar jetën, në çfarë gjendjeje i ke adhurimet, a i ke kushtuar kujdes haramit dhe hallallit?.. Do të pyetet për këto, e këto!..”

Por për shkak se ligjëruesi nuk tërhoqi vëmendjen në thelbin e çështjes, edhe pse dha gjithë ato detaje, Imam Shibli ndërhyri dhe tha:

“I nderuar! Keni harruar pyetjen më të rëndësishme! Allahu do ta pyesë njeriun: **«O rob i im! Unë isha me ty, po ti me kë ishe?»**”

Kështu, mësimi më i rëndësishëm që duhet marrë nga këto ndodhi, është që duhet të jetojmë me vetëdijen se ndodhemi vazhdimisht nën mbikëqyrjen hyjnore. Pra, të jetojmë gjithmonë me ndjenjën e “ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore”.

Rasti i Muadhit (r.a.), është një shembull i jashtëzakonshëm i altruizmit dhe devotshmërisë. Ndërsa për ata që punojnë vazhdimisht në institucionet e shërbimit, është e natyrshme të marrin një pagë të caktuar për punën që bëjnë, me qëllim që të sigurojnë jetesën. Megjithatë, edhe ata që punojnë në institucionet e shërbimit, mund të punojnë si vullnetarë për hir të Allahut edhe jashtë orarit të punës për të cilën paguhen, duke u përpjekur të tregojnë shembullin e tyre të altruizmit dhe sakrificës për hir të Allahut.

Po ashtu, edhe ky hadith fisnik, është shumë domethënës në lidhje me domosdoshmërinë e vetëdijes ndaj mbikëqyrjes hyjnore:

“Mos hyni në biseda të panevojshme duke e harruar Allahun, sepse bisedat e tepërta që bëhen duke harruar Allahun, e ngurtë-



sojnë zemrën. Dhe, personi që është më larg Allahut, është ai me zemër të ngurtë.” (Tirmidhi, Zuhd, 62.)

Për këtë arsye, frymëzimin shpirtëror të adhurimeve në kohën para agimit, duhet ta reflektojmë në çdo moment të ditës sonë. Ato çaste të veçanta të kohës para agimit, duhet të jenë një lloj modeli për pjesën tjetër të ditës. Robi që i rregullon në këtë mënyrë netët dhe ditët e veta, ka arritur një nivel devotshmërie me të cilin është i kënaqur Allahu i Madhëruar. Në këtë gradë, njeriut i zhduken të gjitha veset e këqija që ka në zemër dhe fillojnë të shfaqen virtytet të bukura dhe morale të larta. Kjo arrin deri aty sa ai fillon të ndjejë kënaqësi shpirtërore kur tregohet i mëshirshëm, i mirësjellshëm, i dashur, bujar, durimtar, falës dhe i ndjeshëm ndaj njerëzve të tjerë. Ai e llogarit veten vazhdimisht dhe gëzon vetëkontrollin e duhur, duke u ruajtur nga gjynahet dhe çdo pakujdesi që mund ta çojnë drejt gjynaheve. Kjo, sepse tashmë ai ka filluar ta ndjejë prezencën hyjnore pranë vetes në mënyrë të pandërprerë.

Ajo që e shpëtoi Jusufin (a.s.), nga kurthi i shëmtuar i një gruaje të pushtetshme dhe të bukur që e ftoi në amoralitet duke i thënë, “Eja tek unë!”, ishte pikërisht vetëdija ihsanit dhe e mbikëqyrjes hyjnore në zemrën e tij.

Prandaj, ndjenja e ihsanit duhet të bëhet e qëndrueshme në zemër dhe duhet të reflektohet në vepra. Përndryshe, shprehja vetëm me gjuhë e ndjenjës së ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, nuk ndikon aspak në zemër.

Për këtë arsye, njeriu duhet që dashuria e njeriut për gjërat e përkohshme të orientohet tek Allahu dhe të kërkojë kënaqësinë e Atij që është Krijuesi i gjithçkaje. Kur dashuria e zemrës i dorëzohet Allahut, tek njeriu shfaqet përkorësia. Kur shfaqet përkorësia, pasurisë dhe pronës i bie vlera, por mbeten si diçka që duhen shfrytëzuar për të fituar kënaqësinë e Allahut, domethënë fitojnë vlerë duke u shpenzuar në rrugë të Tij. Kështu, zemra gjen rrugën e vërtetë në të cilën duhet të jetë, sepse tashmë ajo ushqen dashurinë që ka për Allahun me punë të mira që ia kënaqin shpirtin.



Ashtu si një lum që kur përzhohet me ujin e detit, nuk i mbetet më cilësi dhe ngjyrë vetjake, por merr ngjyrën dhe cilësitë e detit, kështu është edhe ihsani. Prandaj mund të themi se ihsani dhe mbikëqyrja hyjnore janë esenca dhe thelbi i besimit. Frytet devotshmërisë dhe diturisë, si frika, sinqeriteti dhe devotshmëria, të cilat duhen në çdo adhurim dhe në bukuritë e sjelljes, mund të fitohen vetëm me ndjenjën e ihsanit, sepse për çdo punë të mirë që bëhet duke e ditur se Allahu po të shikon, çel filizat e sinqeritetit, nxjerr lulet e devotshmërisë dhe jep frutat e përkushtimit ndaj Allahut. Të qëndrosh në rrugë të drejtë e larg mëkateve edhe në vende ku nuk të shikon askush, është e mundur vetëm me vetëdijen se “Allahu më shikon gjithmonë dhe në çdo vend!”.

Vejsel Karanin e pyeti nëna e tij:

“O biri im, si mund të bësh adhurim gjithë natën deri në mëngjes? Si mund të durosh?”

Vejsel Karani, tha:

“O nëna ime e dashur! Adhurimin e bëj për Zotin. Zemra ime zgjerohet me përkushtim dhe lidhjet e mia ndërpriten me tokën dhe me çdo ndjenjë trupore, aq sa nuk di se ç’është lodhja. Pastaj, befas e kuptoj se ka ardhur agimi!..”

“O Uvejs, çfarë është ky lloj përkushtimi?”

“Ky lloj përkushtimi është i atillë që, shpirti nuk ndjen asgjë, edhe nëse e godet trurin një shigjetë.”

Është i njohur rasti i Aliut (r.a.), i cili i plagos në këmbë nga një shigjetë gjatë një beteje. Ajo i shkaktonte aq shumë dhimbje, sa që nuk mundën t’ia heqin, sado që u munduan. Mirëpo, më në fund, Aliu (r.a.), u tha t’ia hiqnin ndërkohë që ishte duke falur namaz. Kur u veprua në këtë mënyrë, shigjeta u nxor pa shkaktuar shumë dhembje. Pas kësaj, Aliu (r.a.), i pyeti:

“Çfarë bëtë?”

“E nxorëm shigjetën!” -Thanë.



Mirëpo, Aliu (r.a.), kishte arritur gjendjen e përsosur të përkushtimit në namaz, aq sa ishte shkëputur fare nga kjo botë. Pra, kjo gjendje e Aliut (r.a.), është një shembull i gjallë i ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore.

Shkurtimisht, të kesh një entuziazëm të tillë në adhurime dhe të mos lodhesh prej tyre, është e mundur vetëm në sajë të ndjenjës së ihsanit. Ai që nuk e zotëron ndjenjën e ihsanit në zemër, lodhet nga namazi dhe nguron në dhënien e zekatit, sepse nuk e ka shijuar ende ëmbëlsinë e besimit.

Nisur nga kjo, mund të thuhet se; falja e namazit me përkushtim, dhënia e zekatit dhe dhurimit me gjithë zemër, agjërimi me devotshmëri, kryerja e haxhit me entuziazëm, pastrimi i zemrës, ekuilibrimi i saj mes frikës dhe shpresës dhe pajisja me moral të bukur, janë të mundura vetëm në sajë të ndjenjës së ihsanit.

Ndërsa gjendja e ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, arrihet duke e përmendur Allahun e Madhëruar në mënyrë të vazhdueshme, sepse dhikri siguron lidhjen e mendjes dhe zemrës me Allahun dhe forcon dijen. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar, kur e dërgoi Musain (a.s.) dhe vëllain e tij Harunin (a.s.), tek Faraoni me detyrën e udhëzimit, i urdhëroi kështu:

اَذْهَبْ أَنْتَ وَأَخُوكَ بِآيَاتِي وَلَا تَنِيَا فِي ذِكْرِي

“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së më përmenduri Mua!” (Ta-Ha, 42.)

Në lidhje me dhikrin gjejmë shumë ajete në Kuranin Fisnik. Mirëpo, vetëm ky ajet mjafton për të shprehur rëndësinë e tij. Dhikri është i vetmi mjet për ndriçimin e zemrës dhe kënaqësinë e saj. Në një ajet urdhërohet:

أَلَا بِذِكْرِ اللَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

“...Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Ra'd, 28.)



Një zemër e kënaqur me përmendjen e Allahut, tashmë ka arritur cilësinë e zemrës së pastër për të cilën flitet në Kuranin Fisnik:

“Ditën kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen tek Allahu me zemër të pastër!” (Shuara, 88-89.)

Nëse njeriu e kapërcen pengesën e egos dhe si rezultat i meditim të vdekjes arrin të përparojë në drejtim të virtyeteve të fshehura në shpirtin e tij, vdekja i shfaqet si një kusht i domosdoshëm për takimin e jashtëzakonshëm me Zotin e Lartëmadhëruar. Në këtë mënyrë, vdekja e cila në përgjithësi shkakton drithërima të ftohta tek njerëzit, tek ai kthehet në një emocion të takimit me më të dashurin e tij. Vdekje të tilla, siç shprehet edhe një nga të mëdhenjtë e mistikës Islame, Mevlana Xhelaledin Rumi janë “Sheb-i Arus”, pra “net dasme”. Kjo është një rrugë e tillë, që zbukuron edhe vdekjen, e cila është ndodhia më e tmerrshme për njeriun. Dhe, për “ta zbukuruar vdekjen”, është e domosdoshme të kapërcehet pengesa e egos dhe të arrihet përsosmëria me anë të gjendjeve shpirtërore, si pendimi, përkushtimi i lartë ndaj Zotit, mbështetja tek Allahu, ndjenja e mjaftueshmërisë, përmendja e Allahut dhe orientimi për tek Ai, durimi, ndjenja e mbikëqyrjes dhe ndjenja kënaqësisë ndaj caktimit Tij.

Sipas një transmetimi, profeti Isa (a.s.), rastisi një njeri të sëmurë me njolla në lëkurë dhe tëmtha të bërë gropë nga sëmundja. Njeriu, sikur të mos e ndjente fare sëmundjen që kishte, thoshte me vete:

“O Zot! Falënderimet e pafundme të takojnë Ty, që më ke shpëtuar prej halleve të cilat ua ke dhënë shumë njerëzve të tjerë!..”

Isai (a.s.), për të kuptuar nivelin e botëkuptimit të këtij njeriu dhe përsosmërinë e tij shpirtërore, i thotë:

“O njeri! Çfarë është ai hall prej të cilit Allahu të ka shpëtuar?!”

I sëmuri u përgjigj:

“O i Dërguar i Allahut! Sëmundja dhe belaja më e keqe, është shkujdesja e zemrës ndaj Allahut. Falënderuar qoftë Allahu i Madhëruar, që unë ndjej kënaqësinë dhe frymëzimin shpirtëror të të qenit bashkë me Të. Më duket sikur nuk ndjej asnjë prej sëmundjeve të trupit tim...”

Nëse do t'i përmbledhnim të gjitha këto të vërteta, urtësi dhe mësim, do të thoshim se; aspekti juridik-vendimor (fetva) i fesë përbën shtyllat kryesore të një ndërtese, kurse aspekti i devocionit (takva) janë elementët plotësues rreth atyre shtyllave bashkë me elementët e bukurisë dhe hijeshisë. Mistika Islame, që nga një anë i bashkon këto dy veçori, nga një anë tjetër, si shtesë ndaj aktit të bukur dhe përsosmërisë morale, shtjellon njeriun, jetën dhe gjithësinë dhe siguron me anë të një urtësie më të gjerë, njohjen dhe zbatimin e përgjegjësive. Prandaj, në çështjen e dashurisë dhe njohjes së Allahut, mistika Islame ka cilësinë e një dritareje shpirtërore të hapur drejt miraxhit në zemrat e robërve.

Siç e prekëm edhe kur i erdhi vendi, mistika është identiteti i mundësisë për ta përjetuar Islamin me kriteret e sinqeritetit, devocionit, përkushtimit, ndjenjës së ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, çiltërsisë, nënshtrimit dhe afërsisë e dashurisë ndaj Zotit. Dhe çështja më me rëndësi e tij, është jo aq parashtrimi i këtyre të vërtetave, sesa reflektimi i tyre në jetën tonë në raport me mundësitë dhe kapacitetet tona! Dijetarët e hershëm, pas çdo predikimi dhe këshille bënin dhe pas çdo bukurie hyjnore e morali të lavdërueshëm që tregonin, theksonin se “të thuash, është e lehtë, të dëgjosh, është e lehtë, por të veprosht ashtu siç duhet është shumë e vështirë!..” dhe bënë sugjerime në rrugën e arritjes së zemrave në përkryerje.

Prandaj, synimi themelor i mistikës islame është t'i bëjë gonxhet e zemrës të lulëzojnë me anë të zemzemit të kulturës shpirtërore, eliksirit të devocionit dhe t'ua mundësojnë robërve bashkimin me Zotin pa rënë në disfatë në këtë botë, e cila është një shkretëtirë indiferentizmi. Ata që e kuptojnë dhe e jetojnë këtë të vërtetë, kanë arritur ta kuptojnë dhe jetojnë tasavufin. Siç kanë thënë të mëdhenjtë e tasavufit:

“Tasavufi është një përjetim, që vetëm ai që e shijon, e di!..”

E shpreh ndryshe, tasavuf, do të thotë të përfitosh prej jetës profetike 23 vjeçare të të Dërguari të Allahut (a.s.). Dhe, një praktikues i vërtetë i mistikës Islame, është ai që e përjeton personalisht në mënyrën më të përsosur Kuranin Fisnik dhe Sunnetin autentik në të gjitha aspektet, si në adhurime, ashtu edhe në vepra dhe moral. Po ashtu,



tasavuf do të thotë të reflektosh në jetë hadithin e Xhibrilit (ku përkufizohen shkurtimisht besimi dhe ihsani). Krahas këtyre, kjo rrugë na orienton drejt urdhrit hyjnor:

فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ

“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar!..” (Hud, 112.)

Urdhër ky, që siç shprehet edhe vet i Dërguari i Allahut (a.s.); “i ka thinjur flokët”. E në fakt, duhet ditur se i Dërguari i Allahut (a.s.), gjatë gjithë jetë së tij profetike prej 23 vitesh, ka marrë pjesë në shumë beteja, por asnjë prej tyre nuk ka qenë aq e vështirë sa të shprehej; “më ka thinjur”. Ai ka vuajtur urinë për ditë të tëra, e nuk iu thinjën flokët. Ka humbur shumë të dashur të zemrës, si Hadixhen, Hamzanë dhe shumë të tjerë, por nuk ka thënë “mu thinjën flokët”. Madje, atij i kanë vdekur gjashtë prej shtatë fëmijëve dhe një pjesë e nipërve e mbesave sa ka qenë ende gjallë, por prapë nuk iu thinjën flokët. Deri kur u zbrit ajeti: **“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar!..”**, kur në flokët dhe mjekrën e tij të bekuar u shfaqën thinjat përnjëherësh...

Ruga e takimit është një korridor shumë i gjatë dhe i ngushtë. I mbushur me sprova dhe vështirësi. Në të gjenden përgjegjësi të cilat zbardhojnë flokët e një profeti. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka jetuar çdo moment të jetë së vet me vetëdijen e ihsanit dhe pas çdo shkalle që ka kapërcyer në udhën drejt takimit me Zotin, ka kërkuar falje dhe ka bërë teube për shkallët e mëparshme në të cilat ka qenë. Po ashtu, ai ka shprehur dobësinë e vet përballë manifestimeve të pa-fundme hyjnore të cilat i dëshmonte përherë, duke thënë:

“O Zot! Nuk munda të të njoh ashtu siç duhet dhe ashtu siç të takon... Nuk munda të të adhuroj ashtu siç e meriton...” (Munavi, Fejdul-Kadir, II, 520.)

Nën dritën e kësaj të vërtete të madhe, ajo që na takon neve në çështjen e ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, është që, pasi ta kemi

perceptuar mbikëqyrjen hyjnore të Allahut mbi ne, ta orientojmë jetën tonë duke marrë gjithmonë shembull Profetin tonë (a.s.), i cili ishte në shkallën më të lartë të vetëdijes së ihsanit. Pra, të marrim shembull prej durimit, bujarisë, besnikërisë, namazit, agjërit, haxhit, zekatit, shehadetit, stilit të jetesës, vullnetit të shërbimit, drejtësisë dhe ndërgjegjes së tij. Kjo, sepse Profeti ynë (a.s.), është i vetmi shembull i bukur dhe konkret për gjithë njerëzimin deri në ditën e kiametit. Ai është dëshmitari dhe udhërrëfyesi ynë në të dyja botët...

Për të arritur zotërimin e ndjenjës së ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore, ne duhet ta përgatitim truallin e tij duke pastruar egon dhe purifikuar zemrën në përputhje me ajetin fisnik:

قَدْ أَفْلَحَ مَنْ زَكَّاهَا

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë!” (Shems, 9.)

Ndërsa për realizimin e kësaj, duhet të bëjmë kujdes të veçantë në disa çështje kryesore siç janë:

- Ushqimi hallall,
- Respektimi i të drejtave të njerëzve dhe krijesave të tjera,
- Adhurimi në kohën para agimit,
- Përkushtimi në adhurime, madhërimi dhe zbatimi i urdhrave dhe ndalesave të Allahut me dëshirë dhe entuziazëm,
- Pjesëmarrja në shërbimet me dobi sociale,
- Dhurimi prej pasurisë me gjithë shpirt për hir të Allahut,
- Shoqërimi me njerëzit e devotshëm,
- Angazhimi me Kuranin dhe shërbimi ndaj tij,
- Ruajtja e dhikrit në mburojën e zemrës,
- Largimi nga morali i keq (egoizmi, pandehja, përgojimi, shpërdorimi, koprracia, gënjeshtria, smira, ambicia, dyfytirësia, hipokrizia, dashuria për pozitë e pushtet, thashethemet, etj.)



- Meditimi i vdekjes, pra, të mendosh rreth vdekjes dhe të rrisësh vigjilencën e devotshmërisë në çdo frymëmarrje, deri në frymën e fundit.

I lutemi Allahut të Madhëruar, ta na e bëjë të mundur të gjithëve që, çdo manifestim të devotshmërisë që përfshin jetën tonë, t'i kryejmë me vetëdijen e ihsanit dhe mbikëqyrjes hyjnore!..

Amin!..



Jeta dhe pasuria



Aftësia e vërtetë, është mbushja e zemrës me ndjenjën e bujarisë dhe altruizmit dhe shndërrimi i mirësive që na ka dhënë Zoti dhe tregtinë e kësaj bote, në pasurinë e botës tjetër. Nga ky aspekt, pasuria më e mirë, është ajo që është dërguar para të zotit të saj në ahiret. Ndërsa jeta më e mirë, është ajo që përdoret në rrugën e kënaqësisë së Allahut. Ata që dinë ta vlerësojnë siç duhet jetën dhe pasurinë, janë si dielli; e ndriçojnë çdo cep të errët me anë të mirësive dhe bamirësive, duke lëshuar rreze drite mbi zemrat nevojtare dhe të lodhura.



JETA DHE PASURIA

Në këtë botë, ku jemi dërguar për t'u sprovuar, në krye të mirësive më të mëdha që i janë falur birit të njeriut, vijnë “jeta dhe pasuria”, të cilat besimtarët janë të detyruar t'i përdorin për qëllime serioze dhe për ideale të larta. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

إِنَّ اللَّهَ اشْتَرَى مِنَ الْمُؤْمِنِينَ أَنْفُسَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ بِأَنْ لَهُمُ الْجَنَّةَ

“Besimtarët e vërtetë janë ata që blejnë xhenetin në këmbim të pasurisë dhe vetes së tyre.” (Teube, 111.)

Çdo lloj mirësie dhe mundësie, si jeta dhe pasuria, që Allahu i Madhëruar i ka falur birit të njeriut, janë amanete që i janë lënë në përdorim. Pra, çdo mirësi është prej Tij dhe i takon vetëm Atij. Prandaj edhe zemra e ndriçuara janë gjithmonë të vetëdijshme se:

“Ai merr, Ai jep dhe Ai bën gjithçka!..”

Si rrjedhojë e kësaj vetëdijeje, robërit e devotshëm të Allahut, kanë arritur të kuptojnë dobësinë dhe gjendjen e tyre të “hiçit” përballë Zotit të gjithësisë. Në këtë mënyrë, ata kanë jetuar gjithmonë me vetëdijen se çdo gjë i përket vetëm Allahut të Madhëruar.

Kurse për ata që i përdorin në mënyrë të gabuar mirësitë që u ka falur Allahu, në vend që t'i përdorin për tu afruar me Të, në Kuranin Fisnik urdhërohet:



قُلْ إِنْ كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ
وَأَمْوَالٌ اقْتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا
أَحَبَّ إِلَيْكُمْ مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ
فَتَرَبَّصُوا حَتَّى يَأْتِيَ الْهَلُ بِأَمْرِهِ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ

“Thuaj: «Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.»” (Teube, 24.)

Kështu, që t'i përdorim në rrugën e kënaqësisë hyjnore, në përputhje me këtë ajet fisnik mirësitë e jetës dhe pasurisë, të cilat na janë dhënë si amanet për t'u sprovuar me to në këtë botë, duhet t'u bindemi urdhrave të Allahut dhe të pasojmë me përpikëri sunnetin e të Dërguarit të Tij (a.s.). Për rrjedhojë, kështu tregohet qartë edhe dashuria jonë për Allahun dhe Profetin (a.s.), sepse kush dashuron me të vërtetë, e ka për kënaqësi të sakrifikojë për atë që dashuron aq sa dashuri ndjen për të.

Djali i Ebu Musa el-Esh'ariut (r.a.), Ebu Bekri, na transmeton këtë ndodhi që tregon se, njeriu që dashuron, mund të japë edhe jetën e vet për hir të dashurisë:

“Babai im, Ebu Musa (r.a.), kishte qëndruar përballë armikut dhe tha:

«I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Padyshim se dyert e Xhenetit janë nën hijet e shpatave!”»

Pas kësaj, një person në gjendje të mjerueshme kokë e këmbë, ngrihet e pyet:

«O Ebu Musa! E ke dëgjuar vet personalisht këtë nga i Dërguari i Allahut?»



«Po, vet e kam dëgjuar!» - përgjigjet Ebu Musa (r.a.). Sapo e dëgjoi këtë, personi që pyeti u kthye tek shokët dhe duke u thënë atyre: «Ju përshëndes!», e thyen këllëfin e shpatës dhe e hedh tutje. Më pas, vërsulet drejt armiqve me shpatë në dorë dhe lufton me ta derisa bie dëshmor.” (Muslim, Imare, 146; Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 23/1659.)

Për sahabët, mjaftonte që i Dërguari i Allahut (a.s.), të thoshte vetëm një fjalë. Tashmë, nuk ekzistonte më asnjë mirësi e kësaj bote që nuk mund të sakrifikohej për të. Madje, ata e jepnin edhe jetën e tyre pa iu dridhur fare qerpiku.

Çmimi më i rëndë dhe më i vështirë për t'u paguar, është ai i dashurisë së besimit, sepse në sajë të tij hapen horizontet e zemrës dhe si jeta, ashtu edhe pasuria, mund të shpenzohen bujarisht me gjithë dëshirë aty ku ndodhet kënaqësia e Allahut të Madhëruar. Në një ajet fisnik urdhërohet:

لِلْفُقَرَاءِ الَّذِينَ أُحْصِرُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ لَا يَسْتَطِيعُونَ ضَرْبًا فِي
الْأَرْضِ يَحْسَبُهُمُ الْجَاهِلُ أَغْنِيَاءَ مِنَ التَّعَفُّفِ تَعْرِفُهُمْ بِسِيمَاهُمْ
لَا يَسْأَلُونَ النَّاسَ إِلْحَافًا وَمَا تُنْفِقُوا مِنْ خَيْرٍ فَإِنَّ اللَّهَ بِهِ عَلِيمٌ

“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato.” (Bekare, 273.)

Në zemrat e atyre që sakrifikojnë çdo gjë në rrugën e Allahut, shfaqet një lloj urtësie dhe intuete në lidhje me njohjen nga pamja e jashtme e nevojtarëve, dhe ndjenja e dhurimit, kthehet në një lloj profesioni për ta. Nisur nga kjo, besimtarët e pasur, duhet ta vënë pasurinë e tyre në shërbim të dijes, moralit dhe atyre që ia kanë kushtuar jetën shërbimit ndaj Kuranit Fisnik. Po ashtu, ata duhet të interesohen për nevojtarët dhe të varfrit dhe nuk duhet të largohen prej ambienteve ku jetojnë besimtarët e vuajtur.

Ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në vende të gabuara, janë duke shpërdoruar mirësinë që u ka falur Allahu, i Cili në lidhje me fundin e hidhur të njerëzve të tillë indiferentë, është shprehur kështu:

وَالَّذِينَ يَكْنِزُونَ الذَّهَبَ وَالْفِضَّةَ وَلَا يُنْفِقُونَهَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ
فَبَشِّرْهُمْ بِعَذَابٍ أَلِيمٍ يَوْمَ يُحْمَى عَلَيْهَا فِي نَارِ جَهَنَّمَ
فَتُكْوَى بِهَا جِبَاهُهُمْ وَجُنُوبُهُمْ وَظُهُورُهُمْ هَذَا مَا كَنْتُمْ
لَأَنْفُسِكُمْ فَذُوقُوا مَا كُنْتُمْ تَكْنِزُونَ

“...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hirtë Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t’u thuhet: «Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!»” (Teube, 34-35.)

Nga ky aspekt, ne kemi përgjegjësinë që ta sistemojmë jetën dhe pasurinë tonë në përputhje me qëllimin e jetës së përjetshme.

Shejh Sadi Shirazi, i qorton me këto fjalë ata janë tepër të dhënë pas jetës së kësaj bote dhe sillen me koprraci:

“Mos kujto se do të lartësohesh duke mbledhur para. Uji që nuk lëviz, qelbet dhe thahet. Përpiku ta dhurosh dhe ta bësh të rrjedhshëm. Ujin që rrjedh e ndihmon qielli. Lëshon shi, i dërgon rrëke dhe e bën det.”

Kështu që, aftësia e vërtetë, është mbushja e zemrës me ndjenjën e bujarisë dhe altruizmit dhe shndërrimi i mirësive që na ka dhënë Zoti dhe tregtinë e kësaj bote, në pasurinë e botës tjetër. Nga ky aspekt, pasuria më e mirë, është ajo që është dërguar para të zotit të saj në ahiret.

Këto fjalë urta të Ebu Dherrit (r.a.), e përmbledhin shumë bukur idenë se si duhet të jetë këndvështrimi i një besimtari ndaj kësaj bote dhe mirësive të saj:



“Një mall ka tre ortakë. I pari është i zoti i mallit, pra, ti. I dyti është kaderi (caktimi). Se çfarë do të të sjelli (ai mall), mirësi apo fatkeqësi, nuk të pyet ty. Ndërsa i treti, është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh)! E, pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti jep llogari për të. Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!

Allahu i Madhëruar urdhëron: **«Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...»**⁵⁸. Ja, kjo deve është pasuria ime që e dua më shumë dhe po e dërgoj (jap sadaka) para vetes (në ahiret që të më presë atje).” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163.)

Pra, mirësitë që ka falur Allahu, duhet të jenë një dritë përjetësie që e afrojnë robin drejt Zotit të vet, sepse vetëm nëse mirësitë e jetës dhe pasurisë shpenzohen në rrugën e Allahut mund të quhen “stoli”, siç shprehet Kurani. Përndryshe, ato kthehen në “sprovë”.

I Dërguari i Allahut (a.s.), shprehet:

“Çdo popull ka fitnen (sprovën) e vet. Dhe fitnja e popullit tim është pasuria.” (Tirmidhi, Zuhd, 26.)

Lidhur me përdorimin në mënyrë të drejtë të mirësive të jetës dhe pasurisë, ka shumë paralajmërime hyjnore. Ja disa ajet fisnike në lidhje me këtë çështje:

“Por, i Dërguari dhe ata që besojnë në të, luftojnë me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre. Për ata do të ketë çdo të mirë dhe pikërisht ata do të jenë të shpëtuarit.” (Teube, 88.)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا هَلْ أَدُلُّكُمْ عَلَىٰ تِجَارَةٍ تُنْجِيكُمْ مِنْ عَذَابِ أَلِيمٍ
تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَتُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ بِأَمْوَالِكُمْ
وَأَنْفُسِكُمْ ذَلِكُمْ خَيْرٌ لَكُمْ إِنْ كُنْتُمْ تَعْلَمُونَ

58. Al-i Imran, 92.

“O besimtarë, a doni t’ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm?! Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe trupin tuaj. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju.” (Saff, 10-11.)

Ndërsa në një hadith fisnik thuhet:

Ebu Said el-Hudri (r.a.), transmeton:

Një ditë, një beduin e pyet të Dërguarin e Allahut (a.s.):

“O i Dërguar i Allahut, kush është njeri i dobishëm?” Profeti (a.s.), përgjigjet:

“Ai që lufton me jetën dhe pasurinë e tij në rrugë të Allahut!”

(Buhari, Xhihad 2; Rikak 34.)

Po ashtu, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se Ai i do shumë ro-bërit e Vet që punojnë me jetën dhe pasurinë e tyre në rrugën e Tij:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا مَنْ يَرْتَدَّ مِنْكُمْ عَنْ دِينِهِ
فَسَوْفَ يَأْتِي اللَّهَ بِقَوْمٍ يُحِبُّهُمْ وَيُحِبُّونَهُ أَذِلَّةٌ
عَلَى الْمُؤْمِنِينَ أَعِزَّةٌ عَلَى الْكَافِرِينَ
يُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا يَخَافُونَ لَوْمَةَ لَائِمٍ
ذَلِكَ فَضْلُ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَنْ يَشَاءُ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ

“O ju që besuat! Kush prej jush largohet nga feja e tij, atëherë Allahu do ta sjellë një popull që Ai i do ata dhe ata e duan Atë, të cilët janë të përlur ndaj besimtarëve, por krenarë ndaj jo besimtarëve, që sakrifikojnë në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohen kërcënimit të askujt. Kjo është mirësi e Allahut që ia jep kujt të dojë. Allahu është dhuruesi, i dijshti.” (Maide, 54.)

Mirëpo, kuptimi i xhihadit me pasuri dhe jetë, siç përshkruhet në ajete dhe hadithe, nuk është vetëm luftë me armë kundër armikut. Lufta është mjeti i fundit që përdoret për të zhdukur padrejtësinë dhe



mizorinë dhe për të vendosur drejtësinë. Qëllimi i xhihadit, është çlirimi, dhe çlirimi më i vyer, është ai i zemrave.

Kur kanë zbritur ajetet për xhihadin në periudhën e Mekës, besimtarët nuk ishin në gjendje për të luftuar. E vetmja gjë që mund të bënin ata përballë terrorit dhe diktatit të injorancës ishte të ofronin një personalitet besimtari që rrezatonte mirësinë dhe drejtësinë e Islamit. Kurani, këtë gjendje të tyre e ka përkufizuar si xhihad të madh:

فَلَا تَطْعِ الْكَافِرِينَ وَجَاهِدْهُمْ بِهِ جِهَادًا كَبِيرًا

“Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë nëpërmjet këtij (Kurani)!” (Furkan, 52.)

Në Kuranin Fisnik gjenden shumë ajete në lidhje me “luftën në rrugën e Allahut” me qëllimin për të udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë. Mirëpo, vetëm në një pjesë të kufizuar të këtyre ajeteve flitet për luftë me armë. Madje, edhe ajo bëhet nëse është e detyrueshme. Në Islam, nuk ka ndonjë luftë me qëllim tjetër përveç mbrojtjes dhe “ila-ji kelimetullah”, pra lartësimi dhe përhapjes së fjalës së Allahut. Luftërat e zhvilluar vetëm për të gllabëruar toka, janë padrejtësi të jashtëzakonshme që e poshtërojnë qenien njerëzore. Mirëpo, në Islam lufta bëhet vetëm për shkaqe sublime, si vënia në vend e drejtësisë, hapja e rrugës së udhëzimit të njerëzve dhe eliminimin e padrejtësisë. Përndryshe, siç shprehet edhe Kurani:

مَنْ قَتَلَ نَفْسًا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِي الْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ
النَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَا أَحْيَا النَّاسَ جَمِيعًا

“...Kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...” (Maide, 32.)

Ja, pra, çdo lloj përpjekje dhe sakrificë që do të bëjnë myslimanët

brenda këtyre kriterëve dhe me synime Islame, me pasurinë dhe jetën e tyre, do të meritojë një favor të madh hyjnor nga Zoti, siç është Xheneti.

Nga ana tjetër, përdorimi i jetës dhe pasurisë në rrugën e Allahut, pajisja me moral të bukur dhe pastrimi i shpirtit me vepra të mira, arrihet vetëm nëse këto shpenzohen ashtu siç ka urdhëruar Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij (a.s.). Një besimtar, prej cilësdo shtresë të shoqërisë qoftë, i varfër, i mesëm apo edhe i pasur, ai duhet të marrë shembull jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), sepse ai ka qenë njeriu më bujar si në kamje, ashtu edhe në skamje. Ai i nxiste sahabët në bujari pa bërë dallim nëse ishin të pasur apo të varfër.

Madje, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), propozonte mbledhjen e ndihmave për qëllime fetare, edhe gratë dhe vajzat i dhuronin me gjithë dëshirë stolitë e tyre, si vathët, byzylykët dhe gjerdanët. Po ashtu, edhe ata sahabë që ishin aq të varfër sa nuk kishin asgjë në këtë botë, bënë gjithçka që kishin mundësi, duke sjellë dru nga mali ose duke nxjerrë ujë nga pusi vetëm e vetëm që të fitonin shpërblimet e dhurimit.

Një prej atyre që e kanë përjetuar këtë entuziazëm, ishte edhe Ebu Akil el-Ensari (r.a.), i cili në këmbim të dy masave me hurma, barti ujë gjithë natën dhe, gjysmën e fitimit e mbajti për nevojat e familjes, ndërsa gjysmën tjetër ia dorëzoi të Dërguarit të Allahut (a.s.), me shpresën që të fitonte kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.⁵⁹

Për rrjedhojë, edhe pse sasinë e sadakasë e përcakton mundësia që çdokush ka për të dhuruar, vlerën e vërtetë të saj tek Allahu i Madhëruar, e përcakton shkalla e sakrificës dhe bujaria në zemër.

Shembullin më i bukur të përdorimit të jetës dhe pasurisë në rrugën e Allahut, e kanë dhënë sahabët e Profetit tonë (a.s.). Ata e vunë të gjithë jetën dhe pasurinë e tyre bujarisht në dispozicion të mirësisë dhe ftesës për shpëtimin e përjetshëm. Kjo gjendje e Omerit (r.a.), është njëri prej shembujve të panumërt të këtij fakti:

Ibn Omeri (r.a.), tregon:

59. shih. Taberi, X, 251.



“Babait tim, Omerit i pati rënë për pjesë një tokë (nga plaçka e luftës) në Hajber. Ai shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Në Hajber kam fituar një tokë, që deri më sot nuk kam pasur një të tillë. Çfarë më urdhëron të bëj me të?”

Profeti ynë i nderuar (a.s.), i tha:

“Nëse dëshiron, bllokoje dhe bëje vakëf (për hir të Allahut)! ”

Nisur nga këto fjalë, Omeri (r.a.), e bëri vakëf atë me këto kushte:

“Kjo tokë nuk mund të shitet, nuk mund të dhurohet dhe nuk mund të trashëgohet. Kjo është për të varfrit, për të afërmit, për lirin e robërve, për t’u shpenzuar në rrugën e Allahut, për ata që kanë mbetur në rrugë dhe për udhëtarët. Për atë që e administron, nuk ka problem të hajë prej saj pa i depozituar për vete të ardhurat e saj. Gjithashtu mund t’i japë për të ngrënë edhe shokut të tij.” (Buhari, Shurut, 19; Vesaja, 28; Ejman, 33; Muslim, Vasijet, 15.)

Sot, edhe ne duhet ta krahasojmë gjendjen tonë me dashurinë dhe pasionin e besimit të sahabëve dhe të llogarisim veten tonë. Sahabët nuk kishin frikë nga varfëria dhe dhuronin aq sa kishin mundësi, me qëllim që ta shndërronin jetën e kësaj bote në kapitalin e jetës së përjetshme. Prandaj, edhe ne duhet të marrim shembull prej entuziazmit të tyre dhe të mendojmë për jetën tonë në botën tjetër. Në një hadith fisnik thuhet:

“Kush dëshiron botën tjetër, Allahu ia pasuron zemrën dhe ia lehtëson punët. Ndërsa kjo botë, i ujen nga pas e nënshtruar. Kush dëshiron këtë botë, Allahu vendos varfërinë midis dy syve të tij dhe ia vështirëson punët. Ndërsa prej kësaj bote nuk përfiton më shumë se sa i është caktuar.” (Tirmidhi, Kiamet, 30/2465.)

Për rrjedhojë, ajo që i ka hije një besimtari, është të zgjedhë qetësinë e ndërgjegjes që i jep bujaria, në vend të stresit egoist që i jep koprracia, duke sakrifikuar prej jetës dhe pasurisë së vet në rrugë të Allahut.

Sa bukur e shpreh Mevlana vetinë e bujarisë dhe ndjenjën e koprracisë që është e kundërta e saj:

“Bujaria është dega e selvisë së Xhenetit. Turp për atë që e lëshon nga dora këtë degë. Ai që mbjell, në fillim e zbraz hambarin, por më pas korr shumë. Kurse ai që e mban farën në hambar, e bën atë ushqim për minjtë.”

Nuk duhet harruar se në realitet, pasuria i takon vetëm Allahut. Njeriu është vetëm përdoruesi i saj, ose një lloj arkëtar i për një kohë të caktuar. Përndryshe, pasuria që shpërdorohet nga njeriu duke pandehur se ajo do t'i mbetet atij përjetësisht dhe duke jetuar në tokë në mënyrë indiferente sikur të ishte i pavdekshëm, nuk mund të jetë gjë tjetër veçse turp dhe helmim i shpirtit për të zotin.

وَلَا يَحْسَبَنَّ الَّذِينَ يَبْخُلُونَ بِمَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ هُوَ خَيْرًا
لَهُمْ بَلْ هُوَ شَرٌّ لَهُمْ سَيُطَوَّقُونَ مَا بَخُلُوا بِهِ يَوْمَ الْقِيَمَةِ وَاللَّهُ
مِيرَاثُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ

“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, kurrsesi të mos mendojnë se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar do t'u ngarkohet atyre në qafë Ditën e Kiametit. E Allahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe Allahu e di mirë ç'punoni ju.” (Al-i Imran, 180.)

Në lidhje me ata që i çojnë dëm mirësitë që i ka dhuruar Allahu, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Mos u josh (o Muhamed) nga pasuria dhe fëmijët e tyre, sepse nëpërmjet tyre Allahu kërkon t'i ndëshkojë ata në këtë jetë, në mënyrë që t'u dalë shpirti duke qenë jobesimtarë.” (Teube, 85.)

Pasuritë e kësaj bote që nuk lejojnë rrezet e ndritura të botës shpirtërore në zemër, janë vetëm mirësi që mund të ndahen nga shejtanët. Një jetë që shpërdorohet vetëm me portofol dhe kasaforta, nuk është e vështirë të kuptohet se do të jetë shprehja e një katastrofe mes dy gurëve të varrit.



Transmetohet se:

“Në ditën e kijametit do të sillet një rob shumë i pasur, të cilit Allahu i Madhëruar i thotë:

«Çfarë të ka penguar ty të më adhurosh Mua?» I pasuri thotë:

«O Zot! Mua ma mori mendjen pasuria e shumtë.» Mirëpo, Allahu i Madhëruar, duke i dhënë shembull Sulejmanin (a.s.), i thotë:

«A mos ishe më i pasur se robi im Sulejmani? Përse atij nuk ia mori mendjen pasuria?» (shih. Bursevi, Ruhu'l-Bejan, IV, 258; Bejhaki, Shuabu'l-Iman, V, 202-203.)

Ndërsa Allahu i Madhëruar, e shpreh kështu fundin e keq të kaplimit të zemrës nga dashuria për pasurinë e kësaj bote:

“(Mjerë për atë) që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut.” (Humeze, 2-7.)

Ata që e kanë kaluar jetën në mënyrë indiferente, vetëm duke mbledhur pasuri, kur të nisen për në varr do ta kuptojnë se në dorë nuk u ka mbetur gjë tjetër përveç dheut. Jeta është një udhëtim në një korridor të ngushtë mes djepit dhe varrit. Lumturia e dy botëve fillon me deshifrimin e enigmës së vdekjes në mendjen njerëzore, e cila gjendet mes djepit dhe varrit. Besimtarët me zemër të pasur që arrijnë ta deshifrojnë këtë enigmë, nuk e fusin pasurinë e tyre në zemra. Në këtë mënyrë, ata lenë mbi shiritin e jetës së tyre virtytet morale, vepra të mira dhe kujtime me bukur të paharrueshme.

Rëndësinë e eliminimit të dëshirave të egos dhe të mos futjes në zemër të dashurisë ndaj pasurisë së kësaj bote, Xhelaledin Rumi na e tregon me këto shembuj:

“Nëse uji hyn brenda në anije, ai e mbyt atë. Ndërsa uji nën anije e mban atë në sipërfaqe dhe e shpie në destinacionin e dëshiruar.”

“Nëse kërkon një zemër të pastër dhe një mendje të shëndoshë, grisi perdet e tamahut!”

Në një vend ku jeta dhe pasuria përdoren të shoqëruara me dije dhe moral të bukur, vihen re pamje të Xhenetit. I Dërguari i Allahut (a.s.), i pyeste shokët e tij:

“A keni përkëdhelur sot kokën e ndonjë jetimi?”

“A keni vizituar ndonjë të sëmurë?”

“A keni marrë pjesë në ndonjë xhenaze?..”

Pra, edhe ne si besimtarë, duhet ta ndiejmë veten përgjegjës për rrethin dhe shoqërinë ku jetojmë dhe të përpiqemi t'i kryejmë pa neglizhencë detyrat tona ndaj saj. Ata që dinë ta përdorin në mënyrë të dobishme jetën dhe pasurinë e tyre, janë si dielli; e ndriçojnë çdo cep të errët me anë të mirësive dhe bamirësive, duke lëshuar rreze drite mbi zemrat nevojtare dhe të lodhura. Ashtu siç është e pamundur për diellin të mos ngrohë, ashtu është e pamundur edhe për shpirtrat e fuqishëm të cilët e jetojnë jetën në mënyrën më të bukur dhe me vetitë më të mira, të mos jenë të dobishëm për veten e tyre e për të gjitha krijesat e tjera dhe, të mos përhapin përreth bukuri përreth tyre.

Përgëzuar qofshin ata besimtarë që në zemra vendosin besimin, në gji mbajnë Kuranin dhe në ndërgjegjet e tyre rrisin moralin e bukur, duke jetuar kështu në pranverën e lumturisë së përjetshme. Ata që fitojnë prej hallallit dhe e shpenzojnë në rrugën e Allahut. Ata që shoqërohen me të devotshmit dhe përfitojnë prej frymëzimit dhe urtësisë së tyre shpirtërore. Ata që ia kushtojnë jetën Allahut për udhëzimin e të tjerëve, që i duan të varfrit e ndershëm dhe i ndihmojnë ata për hir të Allahut, duke mos i lënë t'u thyhet dinjiteti. Ata që për shkak se përpiqen vazhdimisht të pastrojnë egon e tyre, ndërkohë që përmirësojnë sjelljet, i mbushin zemrat me gëzim dhe frymëzim hyjnor. Ata i shpenzojnë mundësitë që kanë në rrugën e Allahut, duke iu bindur urdhrit hyjnor, « قُلِ الْعَفْوَ » “(jepni) «Tepriçën!»...”⁶⁰. Ata që kujdesen për amanetin dhe respektojnë zotimet e tyre. Ata që punojnë në rrugën e Allahut me mëshirën dhe mbrojtjen e Tij, janë besimtarë. Të gjitha bukuritë u takojnë të devotshmëve.

60. Bekare, 219.



I lutemi Allahut të Madhëruar të na përfshijë në bashkësinë e robërve të Tij fatlumë, të cilët janë çelësi i të mirave dhe kyçi i të këqijave! Allahu na e bëftë të mundur t'i shpenzojmë këto ditë të shkurtra të kësaj jete për hir të jetës së pafundme të botës tjetër, duke shkuar në vendin e përjetësisë ballëlartë dhe fytyrëndritur!..

Amin!..



Krahthyerit në shoqërinë tonë:

Jetimët dhe skamnorët



“A bëhesh vëlla i hidhërimeve dhe vetmisë sime?”

Një besimtar i mirë, duhet t'i kërkojë dhe t'i gjejë vet nevojtarët, të vetmuarit, skamnorët dhe jetimët dhe t'ua gëzojë zemrat e tyre të thyera si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror. Ai që kërkon dhe gjen jetimin dhe nevojtarin, duhet të mendojë të Dërguarin e Allahut (a.s.), sepse edhe

Profeti ynë (a.s.), ishte jetim. Sadi Shirazi shprehet:

“Miqë e vërtetë të Allahut, bëjnë pazar në dyqanet ku nuk shkon askush...”

KRAHTHYERIT NË SHOQËRINË TONË: JETIMËT DHE SKAMNORËT

*Kërko në këtë botë,
dhe gjej ata që ditën e kanë të errët!
Që pasi të vdesësh,
kjo mirësi të jetë ndriçim për ty.*

Allahu i Madhëruar, e ka krijuar njeriun si krijesën më të nderuar dhe çdo gjë në tokë, ia ka lënë atij amanet. Njeriu, të cilit i është dhënë një autoritet i madh, është i detyruar të zotërojë një vetëdije të lartë devotshmërie karshi Krijuesit të vet dhe të bartë ndjenjën e ihsanit.

Thelbi i Islamit në aspektin shpirtëror, është monoteizmi në besim, etika/edukata në vepra dhe mëshira në orientim. Mëshira është fryti i parë i besimit. Një zemër pa mëshirë e ka humbur cilësinë dhe ndjeshmërinë njerëzore dhe e ka çuar dëm ndërgjegjen. Fjala “bismilah”, e cila është fillimi i çdo pune të mirë dhe Fatihaja, që është surja e parë e Kuranit të Madhëruar, fillon me emrat “Rahman” dhe “Rahim”, që shprehin mëshirën dhe dhembshurinë e Allahut. Edhe jetët e profetëve, të sahabëve dhe dijetarëve të nderuar janë të mbushura plot me ndodhi që shprehin mëshirë. E në fakt, ëmbëlsia e besimit shihet më tepër tek mëshira. Kurse mëshirë, do të thotë të japësh atë që ke, atij që është më i privuar se ty. Po ashtu, në këtë botë, mëshira është paqe e ndërgjegjes dhe përgëzim Xheneti, ndërsa në botën tjetër është kapitali i një lumturie të përjetshme.



Në ditët tona, mëshira është cilësia e vetme që do ta bëjë besimtarin të jetojë me pasionin e besimit, të shpëtojë nga mbizotërimi i egos dhe të thellohet shpirtërisht. Ndërsa frytet e mëshirës, janë virtytet e bukura, si bujaria, modestia, shërbimi, falja dhe shpëtimi nga smira. Kurse nivelin e dashurisë, e nxjerr në pah sakrifica dhe dashuria në shërbim. Rruga më e shkurtër që një besimtar të pajiset me mëshirë, dhembshuri, butësi dhe ndjesi shpirtërore, kalon nga sakrificat që bëhen me jetën dhe pasurinë. Për rrjedhojë, një sahabiu që ankohej për ngurtësinë e zemrës së vet, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha:

“Nëse dëshiron të të zbutet zemra, ushqeje të varfrin dhe përkëdheli kokën jetimit!” (Ahmed, II, 263, 387.)

Ndërsa Sadi Shirazi këshillon kështu:

“Virtyti në shërbim, është të falënderosh për shëndetin dhe forcën, duke mbajtur peshën e të dobëtëve.”

Ashtu siç është e përmalluar për shirat e begatë toka e çarë nga etja, ashtu edhe shtresa më nevojtare e shoqërisë sonë janë jetimët dhe skamnorët. Ata janë amaneti i Zotit për ne. Në shumë ajete të Kuranit Fisnik dhe në shumë hadithe autentike, porositemi t’u shërbejmë nevojtarëve dhe të mbrojmë jetimët dhe skamnorët.

Në Kuran urdhërohet:

وَأَتُوا الْيَتَامَىٰ أَمْوَالَهُمْ وَلَا تَبَدِّلُوا الْخَبِيثَ بِالطَّيِّبِ
وَلَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَهُمْ إِلَىٰ أَمْوَالِكُمْ إِنَّهُ كَانَ حُوبًا كَبِيرًا

“Jepuni pasurinë jetimëve, mos ua ndërroni sendet e tyre të mira me tuajat të këqija. Mos e harxhoni pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj!..” (Nisa, 2.)

“...Të pyesin ty për jetimët, thuaju: «T’u bëni mirë atyre është vepër e bukur. Nëse jetoni bashkë me ata, dijeni se janë vëllezërit tuaj!»...” (Bekare, 220.)

“Të pyesin ty çfarë të japin si lëmoshë. Thuaju: «Çfarëdo ba-



mirësie që bëni, ajo le t'u takojë prindërve, farefisit, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarëve.»... (Bekare, 215.)

“Vërimi në provë jetimët, derisa të bëhen për martesë!..” (Nisa, 6.)

“E kur në ndarjen e trashëgimisë të jenë të pranishëm farefisi i largët, jetimët dhe të varfrit, u dhuronit edhe atyre diçka dhe thuajuni fjalë të ëmbla!” (Nisa, 8.)

“...Allahu ju udhëzon që të silleni drejt me jetimët. Allahu është në dijeni të çdo të mire që bëni.” (Nisa, 127.)

Ndërsa Ibn Abbasi (r.a.), tregon:

“Kur u zbritën ajetet e Allahut: **«Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë!..»**⁶¹ dhe **«Vërtet, ata që shpenzojnë pasurinë e jetimit pa të drejtë, vetëm mbushin barkun e tyre me zjarr dhe ata do të digjen në zjarrin flakërues.»**⁶², sahabët që kishin jetimë (nën kujdesje), shkuan dhe e ndanë ushqimin dhe pijen e tyre nga të vetat. Madje, ata nuk e preknin ushqimin dhe pijen e jetimit, edhe nëse tepronte diçka prej tyre, por e ruanin derisa jetimi e hante vet, ose të prishej...” (Ebu Daud, Uesaja, 7/2871; Nesai, Uesaja, 11.)

Po ashtu, në një transmetim tjetër të Ibn Abbasit (r.a.), thuhet:

Një herë, Aliu ujiti për tërë natën një bahçe me hurma për të fituar një sasi të caktuar elbi. Kur gdhiu, mori atë sasi elbi që ishte haku i tij i punës dhe shkoi në shtëpi. Një të tretën e sasisë së elbit që fitoi Aliu atë natë, e bluan të gjithë së bashku si familje, që të gatuanin një ushqim të veçantë që quhej “hazira”. Pasi përgatitën hazirën, u duk në derë një i varfër që kërkonte ushqim. Ata i dhanë ushqim nga ai që e kishin bërë gati. Më pas morën një të tretën e dytë të elbit që Aliu kishte fituar duke punuar tërë natën, e bluan dhe e gatuan për ta ngrënë. Atë çast ia behu një jetim, që kërkoi diçka për të ngrënë. Ata ia dhanë menjëherë jetimit atë që kishin përgatitur për të ngrënë vetë. Pastaj filluan të bluanin e të përgatisnin pjesën e mbetur të elbit. Kur ushqimi u bë

61. En'am, 152.

62. Nisa, 10.

gati, u shfaq në derë një idhujtar i zënë rob, i cili u kërkoi diçka për të ngrënë. Kështu, edhe sasinë e fundit të ushqimit ia dhanë atij, duke e kaluar të uritur atë ditë. Sipas një transmetimi tjetër, kjo histori ka ndodhur kur Aliu së bashku me familjen e tij kanë qenë agjërueshëm. Tre nevojtarët, pra i varfri, jetimi dhe skllavi kanë ardhur në prag iftari. Ushqimi u është dhënë këtyre të varfërve të sipërpërmendur, ndërsa pjesëtarët e kësaj familjeje të nderuar e kanë bërë iftarin vetëm me ujë. Kjo ngjarje u bë shkak për shpalljen e këtyre ajeteve:

وَيُطْعَمُونَ الطَّعَامَ عَلَىٰ حَيْثُ مَسْكِينًا وَيَتِيمًا وَأَسِيرًا
 إِنَّمَا نُطْعِمُكُمْ لَوَجْهِ اللَّهِ لَا نُرِيدُ مِنْكُمْ جَزَاءً وَلَا شُكْرًا
 إِنَّا نَخَافُ مِنْ رَبِّنَا يَوْمًا عَبُوسًا قَمْطَرِيرًا
 فَوَقَّيْهُمْ اللَّهُ شَرَّ ذَلِكَ الْيَوْمِ وَلَقَّيْهُمْ نَصْرَةً وَسُرُورًا

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura. Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.” (Insan, 8-11) (Vahidi, Esbabu Nuzul, s. 470; Zemahsheri, el-Keshshaf, VI, 191-192; Razi, XXX, 244.)

Në këtë ajete fisnike, Allahu i Madhëruar, na jep sihariqin e shpërblimit me Xhenet të sakrificave dhe mirësive që bëhen ndaj të varfërve, jetimëve dhe robërve. Disa nga porositë lidhur me dhurimin e sinqertë me gjithë zemër për të cilin bëjnë fjalë ajetet, mund t’i shprehim edhe kështu:

Besimtari duhet të kujdeset për vëllain e tij mysliman, edhe nëse vet është më nevojtar se ai. Ai duhet ta ndjejë në zemrën e tij vuajtjen e krahëthyerve të shoqërisë. Njohja, qarja e halleve dhe plotësimi i nevojave të tyre duhet të bëhet pjesë e natyrës së besimtarit.

Nga ana tjetër, sadakatë e dhëna, nuk duhet të jenë për interesa



të përkohshme të kësaj bote, por vetëm për hir të Allahut. Prandaj, gjatë ndihmës ndaj nevojtarëve, duhet bërë kujdes i madh që të mos i bëjmë ata të ndihen në siklet dhe të na jenë mirënjohës. Në një hadith fisnik thuhet:

“Thirrmëni të dobët të tuaj, sepse ju ndihmoheni dhe furnizoheni vetëm (me lutjen dhe begatinë) e personave të dobët nga ju!” (Ebu Davud, Xhihad, 70; Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 198.)

“Allahu e ndihmon këtë popull për shkak të duave, namazeve dhe singeritetit të të dobëtëve.” (Nesai, Xhihad, 43.)

Ndërsa Ebu'l-Lejs Semerkandi ka thënë:

“Dhuruesi, duhet t'i japë nevojtarit, me një ndjejnë falënderimi...” Kjo, sepse në sajë të tij, ai që dhuron do të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe do të largojë prej vetes fatkeqësitë, sëmundjet dhe problemet.

Po ashtu, edhe Rumi e shpreh shumë bukur faktin se ai që përfiton më shumë prej dhurimeve dhe ndihmave, është ai që jep:

“Ashtu sikundër bukuritë kërkojnë pasqyrë të pastër, edhe bujaria kërkon njerëz të varfër dhe të dobët. Fytyra e të bukurve duket bukur në pasqyrë, edhe bukuria e bujarisë dhe e mirësisë del pah tek të varfrit dhe të dobët.”

Një çështje shumë e rëndësishme që kuptohet prej ajeteve që përmendëm më herët, është edhe se; “dhurimi” është një nga veprat më të rëndësishme që do të na mbrojnë nga tmerri i ditës së kiametit. Po ashtu, dhurimi që bëhet në mënyrë të singertë, do të pranohet tek Allahu dhe ditën e kiametit do t'ia zbardhë fytyrën të zotit.

Në tjetër çështje mbi të cilën duhet të fokusohemi, është edhe fakti se Allahu i Madhëruar dëshiron që besimtarët t'i kryejnë këto lloj veprash të mira e të singerta.

Një tjetër shembull i këtij altruizmi tregohet në lidhje me Davud-i Tain:

Një ditë, nxënësi që i shërbente, i tha:

“Kam pjekur pak mish. A dëshironi të hani?”



Mësuesi heshti dhe kjo nënkuptoi miratim për nxënësin. Mirëpo, Davud-i Tai, tek po shikonte mishin që nxënësi i solli, e pyeti atë:

“Kemi ndonjë gjë të re për gjendjen ekonomike të filan jetimëve, bir?”

Nxënësi iu përgjigj:

“Nuk ka asnjë gjë të re në lidhje me ta, vetëm të vjetra, ato që i dini edhe ju.”

Pas kësaj përgjigjeje, Davud-i Tai tha:

“Atëherë këtë drekë dërgojua atyre, menjëherë!”

Nxënësi i tij i sinqertë, që dëshironte ta ndante këtë ushqim me mësuesin e tij, këmbënguli duke i thënë:

“Mësues i nderuar, ka kohë që ju nuk keni ngrënë aspak mish!..”
Mirëpo, Davud-i Tai ia ktheu:

“O bir, nëse unë do ta ha këtë mish që ke sjellë dhe përgatitur enkas për mua, pa kaluar shumë ai do të dalë jashtë. Por, nëse mishin në fjalë do ta hanë jetimët, ai do të ngjitet deri në Arshi Ala, ku do të na paraqitet si sevap në botën tjetër!..”

Ja pra, ky është një shpirt i lartë, që e ndjen veten përgjegjës ndaj shoqërisë, u qan hallet jetimëve dhe qëndron me të vuajturit!.. Vallë, ata që sot notojnë në luks dhe kënaqësi, sa arrijnë t'i ndjejnë vuajtjet e njerëzve të braktisur në vetmi?..

Allahu i Madhëruar, ndihmën që i bëhet nevojtarëve, e konsideron sikur t'i jetë bërë Atij dhe na bën të ditur se ky është një tregues i afërsisë së robit me Të. Në një ajet fisnik urdhërohet:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تُحِبُّونَ

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...” (Al-i Imran, 92.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kur Allahu ia do të mirën dikujt, e bën atë të përparojë në



rrugën e shërbimit dhe të kryerjes së nevojave të të tjerëve.” (Sujuti, II, 4/3924.)

Po ashtu, në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a.), i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Ai që ndihmon gratë e veja dhe nevojtarët, do të fitojë sevape ashtu si personi që bën xhihad në rrugën e Allahut.”

Raportuesi thotë se Profeti ka thënë edhe se:

“Ai person, është si besimtari që fal namaz pa ndalur mbrëmjeve dhe agjëron pa ndërprerje gjatë ditëve.” (Buhari, Nafakat 1, Edeb 25, 26; Muslim, Zuhd 41, Tirmidhi, Birr 44; Nesai, Zekat, 78; Ibn Maxhe, Tixharat 1.)

Nga ana tjetër, Allahu i Madhëruar, duke i paralajmëruar në mënyrë të ashpër ata që qëndrojnë indiferent ndaj nevojtarëve, urdhëron:

كَلَّا بَلْ لَا تُكْرِمُونَ الْيَتِيمَ
وَلَا تَحَاضُّونَ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ

“Nuk është kështu! Por ju nuk silleni mirë me jetimët dhe nuk e nxitni njëri-tjetrin për t’i ushqyer të varfrit!” (Fexhr, 17-18.)

Sot jetojmë në një periudhë kur vështirësitë ekonomike kanë arritur nivele të larta. Por në kohët e stabilitetit ekonomik, ai që zotëron sasinë e duhur të pasurisë për të dhënë zekat, duhet të japë edhe më shumë se aq. Një e dyzeta e pasurisë dhe një e dhjeta e prodhimeve bujqësore për të cilat jemi urdhëruar t’i japim si zekat, në fakt janë sasia minimale që duhet të japim. Por, që njeriu të rrisë nivelin shpirtëror dhe gradën e afërsisë dhe dashurisë ndaj Allahut, duhet ta shtojë edhe më tepër këtë sasi, sepse në Kuranin Fisnik urdhërohet:

وَيَسْأَلُونَكَ مَاذَا يُنفِقُونَ قُلِ الْعَفْوَ

“...Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: «Tep-ricën!»...” (Bekare, 219.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“Njeriut bujar mos ia vini re gabimet, sepse saherë që ai gabon padashje, Allahu i Madhëruar e mban përdore.” (Hejthemi, VI, 282.)

Po ashtu, në një hadith tjetër, Profeti (a.s.), thotë:

“Sa shok i mirë është pasuria për një mysliman. Mjafton që atë pasuri t’ia japi të varfrit, jetimit dhe udhëtarit!” (Ahmed, III, 21.)

T’i japësh hakun pasurisë që zotërohet është e mundur vetëm nëse njeriu nuk e shpenzon atë në vende të ndaluara fetarisht dhe duke qëndruar larg dy rreziqeve të mëdha për pasurinë që janë shpërdorimi dhe kopraccia. Dhe, lumturia e vërtetë e pasurisë, fillon duke menduar dhe duke u kujdesur për nevojtarët, të vetmuarit dhe jetimët. Mbase një prej shkaqeve më të mëdha të problemeve në shoqërinë tonë, është edhe moskokëçarja dhe indiferenca që tregojmë përballë skenave të fatkeqësive që shohim para nesh.



Lidhur me jetimët gjenden shumë hadithe autentike, një pjesë e të cilave janë si më poshtë:

“Atë që merr një jetim në mesin e myslimanëve dhe e shpie në shtëpi për ta ushqyer, Allahu ka për ta vendosur patjetër në Xhenet, nëse ai nuk ka kryer ndonjë gjynah të pafalshëm.” (Tirmidhi, Birr, 14/1917.)

“Nëse dikush përkëdhel kokën e ndonjë jetimi vetëm për Allahun, Allahu do ta shpërblej me sevape, mirësi për çdo fije floku që ka prekur.” (Ahmed, V, 250.)

“Shtëpia më e mirë, është ajo ku trajtohen mirë jetimët. Ndërsa shtëpia më e keqe, është ajo ku keqtrajtohen jetimët.” (Ibni Maxhe, Edeb, 6.)

Njëherë, Profeti (a.s.), tha:

“Unë dhe ai që kujdeset për jetimin kemi për të qenë në xhenet ja kështu!” – duke ngritur dorën lart dhe duke treguar pranë njëri-tjetrit gishtin treguesin me gishtin e mesit. (Buhari, Talak 25, Edeb 24, Ebu Davud, Edeb 123; Tirmidhi, Birr 14.)



Ndërsa në një hadith tjetër thuhet:

“Unë jam më afër çdo besimtari sesa vetja e tij. Kur vdes dikush, pasuria që lë i takon të afërmve të tij. Por nëse lë borxhe dhe jetimë, borxhet më takojnë mua (t’i shlyej), ndërsa për jetimët e kam unë për detyrë të kujdesem.” (Muslim, Xhuma, 43.)

Nga ana tjetër, vëmë re se nën mbrojtjen dhe kujdesin e vetë të Dërguarit të Allahut ndodheshin disa fëmijë jetimë. Siç transmeton Ibn-i Sa’di, Ebu Uname (r.a.), para se të vdiste, i la Profetit (a.s.), amanet tri vajzat e veta të vogla, Kebshen, Habiben dhe Farian. Për rrjedhojë duke treguar interesimin e duhur për ato vajza, Profeti (a.s.), siguroi rritjen e tyre nën vëzhgimin dhe edukimin e tij. (Ibn-i Sa’d, III, 610.)

Po ashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), është kujdesur edhe për fëmijët jetim të grave të veja me të cilat është martuar, duke i edukuar dhe trajtuar njësoj si fëmijët e vet. Kështu, ai është bërë shembull personal për gjithë myslimanët në lidhje me kujdesin dhe edukimin e jetimëve.

Krahas Profetit (a.s.), edhe nëna jonë Aisha (r.a.), ka marrë nën kujdesje dhe ka edukuar vajzat jetime të vëllait të saj, Muhamedit. (shih. Muvatta, Zekat, 10.)

Asgjë tjetër nuk i ka më tepër hije njeriut sesa meditim, mëshira dhe dhembshuria. Pamëshirshmëria është banditizëm. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Mëshira merret vetëm prej zemrës së atij që është bandit.”
(Tirmidhi, Birr, 16/1923; Ebu Daud, Edeb, 58/4942.)

Ndërsa në hadithe të tjera thuhet:

“Ata që mëshirojnë, do t’i mëshirojë Allahu i Madhëruar, i Cili është i Mëshirshëm, Rrahman. Mëshironi dhe kini dhembshuri ndaj atyre që janë në tokë , që t’ ju mëshirojnë ata që janë në qiell.”
(Tirmidhi, Birr, 16/1924.)

“Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet!” (Buhari, Edeb, 18; Muslim, Fedail, 65.)

Nga ana tjetër, të parët tanë, të cilët në shërbimet e vakëfit e



kanë pasqyruar në kriteret më ideale dashurinë dhe dhembshurinë, kanë treguar edukatë, delikatesë dhe një kujdes shumë të madh edhe në mbrojtjen e nderit dhe ndjenjave të të mjerëve, të varfërve, të vejave dhe jetimëve. Me qëllim që ai, i cili jepte lëmoshë dhe ai, i cili e merrte, të mos e shikonin njëri-tjetrin, ndërtuan “gurët e lëmoshës” nëpër xhami. Po ashtu, me qëllim që të mos lëndonin ndjenjat e nevojtarëve dhe familjeve të dëshmorëve, ndihmën ushqimore ndaj tyre e shpërndanin natën vonë, duke treguar kështu metodën shembullore të sjelljes, e cila realizohej në bazë të kriterëve më ideale të mëshirës dhe dashurisë. Madje, themelimi i vakëfeve të posaçme vetëm për të paguar dëmin që një shërbëtor mund të shkaktonte aksidentalisht gjatë punës, tregon një thellësi ndjenjash të paimagjinueshme, të cilat ngjallin mahnitje në zemrat e njerëzve edhe sot e kësaj dite. Të gjitha këto janë parime jetësore, të cilat duhet të kujtohen me respekt dhe të fitohen, me qëllim që nderi dhe ndjenjat njerëzore të respektohen siç duhet edhe në ditët tona.

Në periudhën e vështirë të pushtimit të Stambollit, pas Armëpushimit të Mudros më 1918, jetimoret u dëmtuan rëndë. Por, me gjithë kushtet e vështira, gjyshërit tanë nuk i lanë në rrugë jetimët. Shumë saraje dhe godina u shndërruan në vendstrehim për jetimët.

Në të njëjtën periudhë, katër mijë djem dhe dy mijë vajza të mbetur jetimë si pasojë e gjenocidit të çetave armene, u strehuan dhe akomoduan nga gjyshërit tanë. Një pjesë të mirë e mori nën mbrojtje Kazim Kabekir Pasha. Më vonë, nga këta fëmijë u krijua një ushtri e cila më pas i shërbeu atdheut dhe popullit. Një pjesë e tyre më vonë vazhduan rrugën e studimeve, duke dhënë kontributin e tyre në fusha të ndryshme.

Për rrjedhojë, duke menduar për sakrifica e bëra në ato ditë skamjeje dhe varfërie, duhet të krahasojmë vete me mundësitë që kemi sot. Sot, ne e kemi për detyrë që t'i zgjasim dorën e shpëtimit, jetimëve, skamnorëve dhe të pashpresëve që përpëliten në vorbullën e mjerimit. E shprehur ndryshe, nevoja e vërtetë e njerëzimit, është kuptimi siç duhet i përmbajtjes së gjerë të Islamit dhe të dëshirojmë për të vuajtu-



rit, atë që dëshirojmë për veten; të mendojmë se “ne mund të ishim si ata, e ata si ne”.

Ashtu si sendet, edhe njeriu është një amanet. Madje, çdo gjë në këtë botë është amanet. Ndërsa dorëzimi i amanetit në vendin e vet, është shkak i mëshirës hyjnore. Dhurimi dhe ndihma nuk bëhet vetëm në aspektin material. Njeriu duhet të dhurojë prej çdo të mire që i ka falur Allahu. Duke e ndjerë veten përgjegjës për shoqërinë, myslimani duhet shpenzojë prej çdo mundësie që zotëron, si pasuria, koha, dija, mëshira, dhembshuria, etj., duke u përpjekur të lehtësojë sado pak vuajtjet e nevojtarëve. Nuk duhet harruar shembulli i Omerit (r.a.), i cili kërkonte nevojtarët duke bartur thasët me miell dhe ndjenja e tij e përgjegjësisë edhe për delen që dëmtohet buzë lumit Tigër.

Në kushtet e sotme, butësia dhe mëshira me vëllazëri fetare të mbushur plot me dashuri ndaj atyre që kërkojnë udhëzim, ndaj të vobektëve, jetimëve dhe të vuajturve, është një nga detyrat më të rëndësishme vëllazërore që përbën shkakun për të fituar kënaqësinë hyjnore.

Një shembull tjetër i ndjenjës së lartë të përgjegjësisë, është edhe Imami i famshëm Ebu Hanife. Në kohën e tij, Ebu Hanife kishte komshi një djalë të ri pijanec, i cili pinte nga mëngjesi deri në darkë. Ndërsa natën nuk rrinte rehat, por i shqetësonte njerëzit duke thirrur, e duke sharë me fjalor të pistë.

Një natë, ky i ri nuk u dëgjua fare. Për këtë arsye, Ebu Hanife u interesua nëse i kishte ndodhur ndonjë gjë të riut. Shokët e tij i thanë se ishte grindur për shkak të pijes dhe e kishin futur në burg. Ebu Hanifja u mërzi shumë për këtë. Prandaj shkoi në burg dhe iu lut autoriteteve që ta lironin. Mirëpo, nëpunësit i thanë se ai mund të lirohej vetëm me garanci. Për rrjedhojë, Ebu Hanife i doli garant dhe e shpëtoi nga burgu.

Kur mësoi këtë, i ri shkoi menjëherë tek Ebu Hanife dhe derdhi lot pendese, duke i thënë se, tashmë kishte hequr dorë nga pija. Më pas, ai i dha fjalën që këtej e tutje do të bëhej një fqinj dhe student i denjë për të. Ebu Hanife, e pa të riun me dhembshuri dhe me keqardhje i tha:



“Djalosh, në fakt ne të kemi lënë në humbje, sepse nuk u përpoqëm të vinim tek ti. Prandaj, je ti që duhet të na e bësh hallall!”

Pra, ne kemi shumë nevojë ta kuptojmë mirë një vetëdije të tillë dhe ta zbatojmë atë në jetën tonë! Kjo, sepse edhe fëmijët e braktisur rrugëve, të rinjtë që kanë rënë në kthetrat e drogës dhe alkoolit dhe jetimët nëpër jetimore, konsiderohen fëmijët tanë. Të rinjtë, shumica e të cilëve ende nuk kanë arritur moshën e pjekurisë dhe janë si një degë e njomë pranverore, janë shtyrë drejt plehërishtës së shoqërisë përpara syve të botës. Me anë të helmeve që thithin, janë duke djegur mushkëritë dhe duke asgjësuar funksionet e trurit dhe të zemrës së tyre. Duke u kthyer në armiq të shoqërisë, ata bëhen pjesëtarë të detyrueshëm të bandave kriminale. Pra, sa e ndiejmë veten përgjegjës që nuk ua kemi kultivuar ndjenjat fetare, morale dhe atdhedashëse?

Aspekti i jashtëm i fesë kuptohet dhe mësohet me anë të mendjes, aspekti i brendshëm shpirtëror, pra, thelbi i saj, kuptohet dhe mësohet me zemër. Rezultatet më të begata në edukimin dhe menaxhimin e njerëzve, arrihen në sajë të mëshirës dhe dashurisë, sepse shumë njerëz që nuk mund të kontrollohen me forcë, mund t'i nënshtrohen dashurisë dhe mëshirës. Për këtë arsye, sot, ne duhet të pajisemi me cilësi të bukura që janë shfaqje e mëshirës, si dhurimi, ndihma dhe mbështetja e nevojtarëve. Ashtu siç na duhet t'i mësojmë fëmijët tanë me namaz që në moshë të vogël, ne duhet t'i mësojmë edhe me ndjesinë e ndihmës dhe dhurimit, duke u futur në zemra entuziazmin për të ndihmuar nevojtarët dhe të vuajturit. Nëse nuk i mësojmë me këto cilësi të bukura që në moshë të njomë, më vonë, do ta kemi të vështirë të arrijmë rezultate të kënaqshme. Ata duhet të rriten me vetëdijen se pronari i vërtetë i çdo gjëje është Allahu i Madhëruar dhe vet ata janë thjesht përdorues, menaxhues apo arkëtarë të mirësive hyjnore. Brezat e edukuar në këtë mënyrë, mund ta rigjallërojnë ndjenjën e ndihmës dhe solidaritetit në shoqërinë tonë.

E thënë shkurt, besimtarët me ndjenja të larta dhe shpirt delikat, janë të detyruar të gjenden pranë nevojtarëve, të vetmuarve dhe jetimëve të pambrojtur që kanë nevojë për ndihmë. Një besimtar i mirë,



duhet t'i kërkojë dhe t'i gjejë vet nevojtarët, të vetmuarit, skamnorët dhe jetimët dhe t'ua gëzojë zemrat e tyre të thyera si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror. Ai që kërkon dhe gjen jetimin dhe nevojtarin, duhet të mendojë të Dërguarin e Allahut (a.s.), sepse edhe Profeti ynë (a.s.), ishte jetim.

I lutemi Allahut të Madhëruar t'i bëjë zemrat tona burim mëshire dhe përkujdesjeje për të gjitha krijesat për hir të Krijuesit! O Allah! Shndërroji të gjitha gjynahet dhe gabimet tona në sevape dhe vepra të bukura! Na e bëj të gjithëve të mundur që në audiençën hyjnore të çlirohemi prej të gjitha gjynaheve për hir të punës, shërbimit dhe kujdesit tonë ndaj kauzës Islame, të vuajturve dhe nevojtarëve!..

Amin!..



PËRMBAJTJA

Parafjalë.....	5
Bulëza lumturie -1- Nga bota e zemrës së të dashurve të Allahut (LLOGARIA E NJË DITE).....	15
Bulëza lumturie -2- Nga bota e zemrës së të dashurve të Allahut (ZEMRA E PASTËR).....	31
Reflektimet e moralit profetik tek sahabët -1-	45
Reflektimet e moralit profetik tek sahabët -2-	57
Entuziazmi i besimit të sahabëve në hapat e të Dërguarit të Allahut (a.s.).....	69
Paqja dhe ngushëllimi që të fal besimi.....	81
Kujtime nga Epoka e Lumturisë Uhudi.....	95
Kujtime nga Epoka e Lumturisë Tebuku.....	111
Pajisja me moralin profetik.....	125
Edukimi i Kuranit Fisnik.....	137
Dashuria dhe shërbimi ndaj Kuranit Fisnik.....	153
Ramazani i bekuar	169



Haxhi i pranuar dhe umreja	185
Jehona shpirtërore e Mevlanës.....	203
Vetëdija e amanetit dhe përgjegjësisë në udhëheqje.....	215
Dashuria për pushtet dhe përgjegjësia e udhëheqjes.....	233
Mbrojtja e brezit -1-.....	247
Mbrojtja e brezit -2-.....	261
Përgjegjësia ndaj fëmijëve.....	277
Dashuria	291
Ihsani dhe mbikëqyrja hyjnore.....	309
Jeta dhe pasuria.....	325
Krahthyerit në shoqëri në tonë:	
Jetimët dhe skamnorët.....	341

